

**KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII**

**KONFERENCA MBARËKOMBËTARE  
FARMACEUTIKE VII  
“SË BASHKU PËR FARMACEUTIKËN”**

**LIBRI I ABSTRAKTEVE**

**Organizator Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë në  
bashkëpunim me  
Odën e Farmacistëve të Kosovës**

**12-13 Prill 2024**

**Tiranë**

**Komiteti Organizativ**

**Defrim Goma – Kryetar**

**Mirsie Doka  
Adelina Surdulli  
Teuta Balidemaj  
Artida Pashaj  
Pranvera Rroko**

**Komiteti Shkencor**

**Prof. Dr. Ledjan Malaj – Kryetar**

**Prof. Dr. Suela Kellici  
Prof. Dr. Vilma Papajani  
Prof. Asoc. Zehadin Gashi  
Prof. Asoc. Mirela Miraçi  
Prof. Asoc. Ela Hoti  
Prof. Asoc. Brunilda Myftari  
Prof. Asoc. Entela Haloci  
Prof. Asoc. Erjon Troja  
Prof. Asoc. Klejda Harasani  
Prof. Asoc. Iris Hoxha  
Prof. Asoc. Kleva Shpati  
Prof. Asoc. Rezarta Shkreli  
Prof. Asoc. Edita Alili-Idrizi  
Dr. Shk. Linda Matua  
Dr. Shk. Nora Hasani**

# KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

## SPONSOR PLATINUM



## SPONSOR I ARTË



## SPONSOR I ARGJENDTË



## SPONSOR I BRONZTË



## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII



Të dashur kolegë, pedagogë dhe studentë të farmacisë,

duke ju falenderuar për pjesëmarrjen, vijnjë së bashku në traditën e konsoliduar tashmë, të organizimit të këtij eventit shkencor farmaceutik mbarëkombëtar, me pjesëmarrje të gjerë nga të gjitha viset shqiptare.

Konferenca Mbarëkombëtare “Së Bashku për Farmaceutikën”, e shtata në rradhë, që Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë organizon në bashkëpunim me Odën e Farmacistëve të Kosovës, vjen këtë herë me një larmi temash dhe lektorësh nga Shqipëria, Italia, Zvicra, Kosova, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Mali i Zi.

Në këtë konferencë dy ditore, rreth 150 pedagogë dhe kolegë të nderuar, të cilët i falenderoj për zemërsisht, do trajtojnë mbi 150 tema që i përkasin zhvillimeve bashkëkohore, në fushat e shkencave mjekësore të aplikuara në farmaceutikë, nutricion, legjislacion, marketing, menaxhim i farmacisë dhe i Covid - 19, farmakoekonomi, utilizim i barnave, farmaci industriale dhe shkenca farmaceutike.

Sfidat globale aktuale në fushën farmaceutike, por dhe më gjerë, na diktojnë edhe ne farmacistëve shqiptarë, që të gjithë së bashku, të vemë energjitë, dituritë dhe angazhimin tonë në funksion të përgatitjes për përmbushjen me sukses të misionit tonë fisnik, mision që ka në thelb garantimin e shëndetit të qytetarëve.

“Së bashku për Farmaceutikën” nuk ka qenë dhe nuk është thjesht një sllogan apo një titull Konference.

“Së Bashku për Farmaceutikën” është një angazhim për të përbashkuar idetë dhe eksperiencat e të gjithë kolegëve, që nëpërmjet

## **KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII**

kontributit që japin çdo ditë në sektorët ku punojnë, i japin vlerën që meriton profesionit të farmacistit.

Ky event ka lindur dhe është zhvilluar duke patur si një nga objektivat e tij promovimin dhe mbështetjen e vlerave që përçojnë profesionistët e farmaceutikës dhe të shkencave mjekësore, kudo që ata ushtrojnë aktivitetin e tyre.

Kam besimin e plotë që në përfundim të kësaj Konference të gjithë do kemi dhënë dhe marrë mesazhe shumë të rëndësishme mbi gjendjen aktuale, fokusin dhe strategjitë që nevojiten për ta çuar farmaceutikën shqiptare në nivelet bashkëkohore, të gatshme të ballafaqohet me çdo sfidë që mund të përballet në të ardhmen.

Një falenderim të veçantë dëshiroj të bëj për Komitetin Shkencor, të drejtuar nga Prof. Dr. Ledjan Malaj, si dhe Komitetin Organizativ, për rolin, angazhimin dhe kontributin e çmuar në garantimin e suksesit të kësaj Konference.

Realizimi në këto nivele i Konferencës, nuk do të ishte i mundur, pa mbështetjen financiare të sponsorave tanë, të cilët gjithashtu i falenderoj shumë për zëmërsisht.

Në cilësinë e Presidentit të Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë, dëshiroj t'i shpreh mirënjohjen më të thellë të gjithë kolegëve, për profesionalizmin, përkushtimin dhe humanizmin që tregojnë çdo ditë gjatë ushtrimit të profesionit tonë të nderuar.

**President i Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë**

**Defrim GOMA**

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII



Në emër të Komitetit Shkencor të Konferencës Mbarëkombëtare Farmaceutike VII shpreh falenderim dhe mirënjohje për interesin e jashtëzakonshëm dhe kontributin shkencor e profesional të sjellë në këtë event të rëndësishëm të organizuar nga Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë në bashkëpunim me Odën e Farmacistëve të Kosovës. Përgëzoj anëtarët e Komitetit Shkencor dhe Komitetit

Organizativ për bashkërendimin e punëve, përzgjedhjen e tematikave, përgatitjen e materialeve të konferencës dhe komunikimin e vazhdueshëm me të ftuarit dhe pjesëmarrësit në këtë aktivitet. Ndjem mirë kur shikoj sesi kjo konferencë rritet nga hera në herë në numër pjesëmarrësish, në cilësinë e punimeve dhe mbi të gjitha në dëshirën e kolegëve për të qenë pjesë e këtij organizimi të përbashkët. Njohja e ndërsjellë me këta kolegë, shumë nga të cilët vijnë nga jashtë Shqipërisë, pjesë e akademisë apo e profesionit, shpalosja e kërkimeve dhe botëkuptimit të tyre për situatën aktuale dhe të ardhmen e fushave farmaceutike e mjekësore na shton entuziazmin dhe krenarinë profesionale për të vazhduar në rrugëtimin tonë. Kjo atmosferë pozitive vërehet edhe në praninë e studentëve të farmacisë të cilët janë pjesë e rëndësishme e konferencës dhe afrohen në mënyrë të shëndetshme me profesionin që kanë zgjedhur. Ndjem i privilegjuar të jem sërish Kryetar i Komitetit Shkencor të kësaj konference dhe falenderoj Presidentin UFSH z. Defrim Goma dhe Këshillin Kombëtar UFSH për besimin e dhënë. Dëshiroj që secili nga ne të gjejë tematikën që i përshtatet dhe të marrë frymëzim për të qenë pjesë aktive e progresit të farmaceutikës mbarëkombëtare.

**Kryetari i Komitetit Shkencor**

**Prof. Dr. Ledjan Malaj**

PËRMBAJTJA

KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII “SË BASHKU PËR FARMACEUTIKËN”: SHKENCA MJEKËSORE TË APLIKUARA NË FARMACEUTIKË DHE NUTRICIONI .....	21
HEPATITI KRONIK C, SËMUNDJE QE SHËROHET PLOTËSISHT .....	22
ANTIMYKOTIKËT NË INFEKTOLOGJI DHE PËRQASJET TERAPEUTIKE NË TË ARDHMEN .....	23
PERDITESIM MBI UDHERREFYESIT E TRAJTIMIT TE INFEKSIONEVE SEKSUALISHT TE TRANSMETUESHME: PERSHKRIMI “OFF LABEL” I TERAPISE ANTIMIKROBIKE DHE ROLI I FARMACISTIT .....	25
BARNAT HIPOGLICEMIANTE DHE SËMUNDJA ALZHEIMER .....	26
TERAPITE E REJA NE TRAJTIMIN E SEMUNDJES PULMONARE INTERSTICIALE .....	28
KOLESTEROLI FLUID ASCITIK: NJË SHËNUES I THJESHTË PËR ASCITET MALINJE .....	29
ADENOKARCINOMA INTRAMUKOZALE GASTRIKE - EGC (KANCERI I HERSHËM GASTRIK) DHE RËNDËSIA E ENDOSKOPISË (EGDS) NË DIAGNOZËN E HERSHME. NJË RAPORTIM RASTI .....	31
NDIKIMI I HERV (HUMAN ENDOGENOUS RETROVIRUSES) MBI GJENET EMBRIONALE DHE MEKANIZMAT E SINJALIZIMIT INTRA QELIZOR PI3K-AKT-MTOR NE KARCINOMAT E DISTRIKTIT KOKE QAFE DHE MODELIMI I TYRE NGA DROGA TE ANESTEZISE.....	34

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

EFEKTET ANESORE TE CDK4/6 INHIBITOREVE DHE MENAXHIMI I TYRE NE KANCERIN METASTATIK TE GJIRIT. EKSPERIENCA JONE.....	36
BIOPSIA OSTEOMEDULARE NË MIELOFIBROZË NJË PARAMETËR TERAPEUTIK.....	37
PËRDORIMI I ANTIBIOTIKËVE NË TERAPINË PERIODONTALE .....	39
FARMACISTI SI SHTYLLË KRYESORE NË MENAXHIMIN E ADERENCËS SË PACIENTËVE NDAJ TERAPISË. SFIDAT AKTUALE DHE POTENCIALET PËR PËRMIRËSIM .....	40
ROLI I PAJISJEVE MJEKËSORE ME BAZË SUBSTANCA NATYRALE NË FUSHËN TERAPEUTIKE: NJË RAPORT I QËNDRUESHËM PËRFITIM/RREZIK PËR PACIENTËT DHE MJEDISIN .....	42
TERAPIA ME MODULATORËT NË FIBROZËN KISTIKE .....	43
KU JEMI DHE DREJT KUJT PO SHKOJMË NË MENAXHIMIN E HEMOGLOBINOPATIVE.....	44
NUTRICIONI DHE JETËGJATËSIA.....	46
NDIKIMI I NDËRVEPRIMIT TË ELEMENTËVE USHQIMORË NË RISKUN PËR KANCER KOLOREKTAL .....	48
QASJA DIETISTIKE DHE INTEGRIMI SUPLEMENTATIV SI NJE STRATEGJI KUNDER PLAKJES .....	49
NDËRVEPRIMI MIDIS STRESIT OKSIDATIV, INDEKSIT TË MASËS TRUPORE (BMI) DHE PARAMETRAVE TË TJERË TË SHËNDETIT .....	51



## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

VLERËSIM I SUPLEMENTEVE NË INFERTILITETIN MASHKULLOR.....	52
SHTESAT USHQIMORE NË FOKUS: INTERFERENCAT NË SAKTËSINË E TESTEVE LABORATORIKE.....	53
SHENDETI I MJEDISIT DHE AI HUMAN PERMES MENAXHIMIT TE MBETJEVE SHTAZORE .....	55
METEOROPATIA DHE RREZIKU KARDIOVASKULAR .....	56
REVOLUCIONI I KUJDESIT SHËNDETËSOR NË KUFIJTË E INOVACIONIT DHE TEKNOLOGJISË - NJË STUDIM I GJERË MBI PERSPEKTIVAT E PROFESIONISTËVE TË SHËNDETIT .....	58
PREPARATET BIMORE NË TRAJTIMIN E SIMPTOMAVE TË MENOPAUSËS .....	60
ROLI I MIKOTOKSINAVE NË DEMENCË.....	61
PËRDORIMI I FITOTERAPISË NË MOSHËN PEDIATRIKE. SIGURIA DHE ROLI I FARMACISTIT ...	63
ROLI I NJË STILI JETE TË SHËNDETSHËM NË PACIENTIN DIABETIK.....	65
PREPARATET ME BAZË BIMORE NË SHTATZËNI; DISA ASPEKTE MBI PËRDORIMIN E SIGURT TË TYRE.....	66
IMPAKTI I MIKROBIOMËS NË SISTEMIN NERVOR QËNDROR DHE NË PATOGJENEZËN E SËMUDJEVE NEURODEGENERATIVE.....	68
RIMODELIMI I ACIDEVE YNDYRORE NË FETUS SI SHKAK I PREZENCËS SË DIABETIT MELLITUS GESTACIONAL.....	69

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

EFEKTET POZITIVE TE PROBIOTIKEVE NE KONSTIPACIONIN TEK FEMIJET .....	71
KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII “SË BASHKU PËR FARMACEUTIKËN”: FARMAKOEKONOMIA, UTILIZIMI I BARNAVE DHE SHKENCAT MJEKËSORE TË APLIKUARA NË FARMACEUTIKË .....	73
ADRESIMI I RISKUT KARDIO RENAL NË DIABET .....	74
TARGET TERAPIA ME TKI, NJE REVOLUCION NE PROGRES NE TRAJTIMIN E LEUCEMISE MIELOIDE KRONIKE (LMC) .....	76
VITAMINA D DHE SEMUNDJET ALERGJIKE.....	78
EFEKTET ANESORE TE KEMIOPREPARATEVE NE MOSHAT PEDIATRIKE .....	79
MELASMA, SFIDAT DHE RISITE NE TRAJTIM.....	81
BARNAT E REJA NË ONKOLOGJI. OPTIMIZËM DHE PENGESA?.....	82
GURËT NË VESHKA: EPIDEMIOLOGJIA, PATOFIZIOLOGJIA, IMPLIKIMET SISTEMIKE SI DHE STRATEGJITË TERAPEUTIKE.....	83
NDËRHYRJA KORONARE PERKUTANE NË NJË PACIENT QË PREZANTOHET ME INFARKT INFERIOR TË MIOKARDIT DHE ORIGJINË ANORMALE TË ARTERIES KRYESORE TË MAJTË NGA SINUSI KORONAR I DJATHTË.....	85
“HEMOALB”- NJE STUDIM RETROSPEKTIV I PACIENTEVE HEMOFILIKE NE SHQIPERI .....	87

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

PËRSHKRIMI ‘OFF-LABEL’ I BARNAVE NË KËNDVËSHTRIMIN E PROFESIONISTËVE TË SHËNDETËSISË.....	89
PARANDALIMI I ZHVILLIMIT TË NGJARJEVE KARDIOVASKULARE, PËRDORIMI I KALKULIMIT TË RISKUT NË SHËRBIM PRIMAR SHËNDETËSOR, ROLI I FARMACISTIT .....	91
DERIVATET E KUMARINËS PENGOJNË MIGRIMIN E QELIZAVE KANCEROZE TË GJIRIT.....	92
KRAHASIMI I BARNAVE ANTIDIABETIKE TEK PACIENTET ME DIABET GESTACIONAL: NJË RISHIKIM SISTEMATIK I LITERATURËS .....	94
ROLI I FARMACISTIT NE TRAJTIMIN E PACIENTEVE .....	96
REKOMANDIMET E PERDORIMIT TE TERAPIVE ANTILIPEMIANTE NE SEMUNDJEN KRONIKE TE VESHKAVE.....	97
KRAHASIMI I FUNKSIONEVE RENALE TË PACIENTËVE ME DHIMBJE KOKE KRONIKE DHE SIMTOMATIKE GJATË TRAJTIMIT TË TYRE ME NSAID TË NDRYSHËM .....	98
INFEKSIONET E TRAKTIT URINAR, PROBLEMATIKA DHE REZISTENCA BAKTERIALE E E.COLI.....	99
UTILIZIMI I ANTIBIOTIKËVE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS 2011 – 2022 .....	101
RIMBURSIMI BAZUAR NË DIAGNOZË KUNDREJT RIMBURSIMIT BAZUAR NË LISTË POZITIVE BARNASH .....	103

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

VLERËSIM MBI MODELET E PËRSHKRIMIT TË BARNAVE BAZUAR NË INDIKATORËT E ORGANIZATËS BOTËRORE TË SHËNDETËSISË.....	104
OPIOIDET NGA ANALGJEZIA TEK DEPENDENCA – E TASHMJA DHE E ARDHMJA FARMAKOLOGJIKE E TRAJTIMIT TE DEPENDENCES NGA OPIOIDET.....	106
NDËRHYRJET E FARMACISTËVE DHE ROLI I TYRE NË KUJDESIN GERIATRIK.....	108
VLERËSIMI I EFEKTIVITETIT TË TRASTUZUMAB NË KANCERIN E GJIRIT TË HERSHËM DHE HER 2+ TË SHPREHUR.....	109
KEQPËRDORIMI I BARNAVE - SI TË PËRMIRËSOJMË PËRSHKRIMIN DHE PËRDORIMIN E BARNAVE NË SHQIPËRI .....	111
«SEMAFORI I MEDIKAMENTEVE»	NJË
SISTEM I RI NË NDIHMË TË PACIENTIT .....	112
NDËRVEPRIMET E BIMËS ACHILLEA MILLEFOLIUM ME BARNAT, MEKANIZMI I VEPRIMIT DHE FARMAKOKINETIKA .....	114
CDK4/6 INHIBITORËT NË TRAJTIMIN E KANCERIT TË GJIRIT: PRAKTIKA AKTUALE DHE E ARDHMJA PREMTUESE .....	115
PËRGATITJET GALENIKE NË PRAKTIKËN FARMACEUTIKE: NJË STUDIM MBI SUSPENSIONIN ORAL TË IBUPROFENIT.....	117
PËRDORIMI I ANTAGONISTËVE TË RECEPTORËVE TË ANGIOTENSINËS II RIMBURSUAR GJATË VITEVE 2017-2023 NË SHQIPËRI.....	118
RISIA E BARNAVE BIOLOGJIKE.....	120

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

VLERËSIMI SASIOR I LISTËS SË BARNAVE ESENCIALE PËR FËMIJË: SHQIPERIA SI RAST STUDIMOR.....	121
ALOPECIA: RISITË E TRAJTIMIT .....	123
KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII “SË BASHKU PËR FARMACEUTIKËN”: FARMACI INDUSTRIALE DHE KËRKIM NË SHKENCA FARMACEUTIKE .....	125
POLIMERËT SI EKSPIENTË NË TEKNOLOGJINË FARMACEUTIKE, RISHIKIM LITERATURE.....	126
MUNDËSIA E TRANSFORMIMIT TË PRODUKTEVE FARMACEUTIKE TË GATSHME NË LABORATORIN MAGJISTRAL.....	128
HARTIMI DHE VLEFISHMËRIA E INSTRUMENTIT PËR PËRGATITJE TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM SIPAS GMP NËPËRMES METODËS DELPHI.....	129
STUDIMI I MODIFIKIMIT TË CILËSIVE TË POLIMERIT PVA, ME MUNDËSI APLIKIMI PËR INKAPSULIMIN E BARNAVE MJEKËSORE. ....	131
FORMULIMI I TABLETAVE ME ÇLIRIM TË VONUAR TË DIKLOFENAK NATRIUMI DUKE PËRDORUR NJË SISTEM POLIMERIK.....	133
NDËRVEPRIMET ME NDIKIM MBI BIODISPONIBILITETIN E BARNAVE ANTI INFLAMATORE JO STEROIDALE.....	134
NJË RRUGË E LEHTË PËR ZBATIMIN E SISTEMEVE ME PËRDORIM TË VETËM NË PRODHIMIN E PRODUKTEVE TË MEDIKAMENTEVE NË INDUSTRIJË FARMACEUTIKE .....	135

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

ROLI I FARMACISTIT NË KËSHILLIMIN E PACIENTËVE PËR VETËMJEKIMIN E SËMUNDJEVE TË LËKURËS ME KORTIKOSTEROIDE .....	137
MJALTI, E ARDHMJA NË PËRDORIMET FARMACEUTIKE PËR MJEKIMIN E PLAGËVE SFIDUESE.....	139
EKSTRAKTET BIMORE SI ANTIOKSIDANTE NATYRORE NË PRODUKTET KOZMETIKE .....	140
TRENDI I PËRDORIMIT TË DERMOKOZMETIKËVE GJATË VITIT 2020 NË SHQIPËRI.....	142
ROLI I PRODUKTEVE KOZMETIKE DHE KOZMECEUTIKE NË SINERGJI ME PREPARATET FARMACEUTIKE, NË PARANDALIMIN DHE MENAXHIMIN E SIMPTOMAVE KLINIKE TË ACNE VULGARIS .....	144
ZHVILLIMI I FORMULIMIT TË MINOXIDIL 2% DHE 5% TRETËSIRË PËR SKALPIN .....	146
INOACIONI NË RECETAT E RIMBURSUESHME NË SHQIPËRI: PËRPARIMET, TENDENCAT DHE NDIKIMI NË KUJDESIN SHËNDETËSOR. NJË UDHËRRËFYES PËR TË ARDHMEN.....	147
SONDA MOLEKULARE “DUAL MODE” PËR APLIKIME NË IMAZHIT BIOLOGJIK.....	148
PREVALENCA E PËRGATITJEVE GALENIKE NË PRAKTIKËN FARMACEUTIKE NË SHQIPËRI .....	150
STRATEGJIA E KONTROLLIT TË KONTAMINIMIT- NJË RRUGË DREJT SUKSESIT .....	152
TEKNIKAT E ANALIZËS DHE KONTROLLIT PËR NANOPRODUKTET FARMACEUTIKE .....	153

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

PROFILI KIMIK I VAJRAVE ESENCIALË, NGA DISA BIMË AROMATIKO-MJEKËSORE TË VENDIT TONË, ME AKTIVITET POTENCIAL ANTIMIKROBIK.....	154
VALIDIMI I METODËS BIOANALITIKE KROMATOGRFIA E LËNGËT BASHKË ME SPEKTROMETRIN E MASËS (LC-MS/MS) PËR VLERËSIMIN E MBETJEVE TË ANTIMIKROBIKËVE NË QUMËSHT .....	156
PËRDORIMI I SHKARKIMEVE UJORE TË IMPIANTEVE TË PËRPUNIMIT TË BIMËVE MEDICINALE NË SHQIPËRI DHE ROLI INHIBUES I TYRE NDAJ KORROZIONIT ELEKTROKIMIK TË METALEVE.....	158
QASJET E REJA TE NUTRACEUTIKEVE NE TRAJTIMIN E PATOLOGJIVE KORONARE. EVIDENCAT E RASTEVE KLINIKE <i>IN VIVO</i> .....	160
VLERËSIMI I DISA BRENDEVE TË FILM-TABLETAVE TË METFORMINËS PËR CILËSINË DHE EKUIVALENCËN QË QARKULLOJNË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS.....	161
ELEMENTET ME POTENCIAL TOKSIK NË ÇAJIN E MALIT ( <i>SIDERITIS SCARDICA</i> ) NGA MAQEDONIA E VERIUT .....	163
FITOTERAPIA PER FARMACISTET .....	165
NDËRVEPRIMET E BARNAVE NË TË SËMURËT DIABETIKË .....	166
TEKNOLOGJITË INOVATIVE PËR TË MENAXHUAR AFLATOKSINAT B1 DHE M1 NË USHQIME DHE PËRFITIMET E APLIKIMIT.....	168

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

VENDOSJA E VLEFSHMËRISË SË NJË METODE PËR IDENTIFIKIMIN DHE PËRCAKTIMIN E PENICILLAMINËS ME METODA INSTRUMENTALE	169
FORMULIMI I DISA FORMAVE FARMACEUTIKE ME BIMË MJEKËSORE SI ALTERNATIVË E PËRDORIMIT TË ANTIINFLAMATORËVE DHE ANTITUMORALËVE NË PATOLOGJI ORALE .....	170
SHËNDETI MENDOR, NJË STUDIM TEK ADOLESHENTËT E QYTETIT TË TIRANËS DHE ELBASANIT. TERAPIA E KOMBINUAR .....	172
VLERËSIM KRAHASUES I SHKALLËS SË DEPËRTIMIT TË NJË PRODUKTI TOPIK NË VARËSI TË MEMBRANËS SË PËRDORUR.....	174
SINTEZA DHE ANALIZA FIZIKO-KIMIKE E DERIVATEVE TË POLISULFURUARA .....	175
NJË KËNDVËSHTRIM I RI RRETH EKSTRAKTIMIT TË SPECIT DJEGËS (Capsicum Annum) ME ORIGJINË SHQIPTARE.....	177
STUDIMI DHE ANALIZA E PRANISË SË AFLATOKSINES B1 NË QUMËSHTET FORMULË DHE DRITHËRAT E SHITURA NË FARMACI.....	178
KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII “SË BASHKU PËR FARMACEUTIKËN”: LEGJISLACION, MARKETING, MENAXHIM I FARMACISË DHE I COVID-19 .....	180
NJOHURITË E STUDENTËVE TË SHKENCAVE MJEKËSORE QË NDJEKIN STUDIMET PRANË UMT MBI FARMAKOVIGJILENCËN.....	181
ROLI I FARMACISTIT NË DHËNIEN E SHËRBIMEVE FARMACEUTIKE .....	182



## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

FARMAKOVIGJILENCA DHE RAPORTIMI I EFEKTEVE TË PADËSHIRUARA NËPËRMJET APLIKACIONIT AKBPM .....	184
KRAHASIMI I RREGULLOREVE /UDHËZUESVE EVROPIANE PËR PRODHIMIN E RADIOFARMACEUTIKËVE DIAGNOSTIKUES ME RREGULLORET AKTUALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT.....	185
STUDIM MBI NJOHURITË DHE KONTRADITAT MBI PËRGJEGJËSITË MORALE DHE LEGALE NË PRAKTIKËN FARMACEUTIKE.....	187
BARNAT E FALSIFIKUAR – ASPEKTET LIGJORE.....	188
MENAXHIMI DHE MARKETINGU FARMACEUTIK..	190
RENDËSIA DHE SFIDAT NË SHPËRNDARJEN E MATERIALEVE INFORMUESE TEK PROFESIONISTËT SHËNDETËSOR SI PJESË E FARMAKOVIGJILENCËS .....	191
PLATFORMAT MEDIATIKE DHE PROMOVIMI I SHËNDETIT PUBLIK .....	192
FARMAKOVIGJILENCA: INICIATIVAT NË PROGRAMET E FARMAKOVIGJILENCËS NË BOTË DHE SITUATA NË SHQIPËRI .....	194
NDIKIMI I PROMOCIONIT NË KËRKESËN PËR BARNA PA RECETË (OTC BARNA).....	196
FARMACIA SOCIALE, ROLI DHE RËNDËSIA NË KUJDESIN SHËNDETËSOR .....	197
VLERËSIMI I FLETËUDHËZUESVE TË BARNAVE NGA KËNDVËSHTRIMI I PACIENTËVE.....	199

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

MARKETINGU DIXHITAL SI FORMË E RITJES DHE FUQIZIMIT TË MARKËS NË INDUSTRIJË FARMACEUTIKE .....	200
VEPRA PENALE E FALSIFIKIMIT TË PRODUKTEVE FARMACEUTIKE .....	202
HARMONIZIMI I LEGJISLACIONIT FARMACEUTIK: NJË STUDIM KRAHASUES MIDIS EMA DHE FDA ....	204
STUDIM MBI MARKETINGUN FARMACEUTIK NE SHQIPERI, NE PERIUDHEN JANAR 2024.....	205
ROLI I FARMACISTIT NË MJEKËSINË NUKLEARE GJATË PUNËS ME BURIME RADIOAKTIVE, SFIDAT DHE RREZIQET .....	206
THE IMPORTANCE AND APPLICATION ARTIFICIAL INTELLIGENCE IN PHARMACY .....	207
MANIFESTIMET KARDIOVASKULARE TË SINDROMËS SË ZGJATUR COVID NË POPULLATËN SHQIPTARE ME DIABET .....	209
PËRDORIMI I ANTIBIOTIKËVE NË KONTEKSTIN E COVID-19: PERSPEKTIVA NGA FARMACISTËT SHQIPTARË.....	210
FARMAKOGENOMIKA NË FARMACEUTIKË.....	212
VAKSINIMI KUNDËR LISË NË SHQIPËRI DHE PERSPEKTIVAT NË MBROJTJEN IMUNITARE EDHE NDAJ LISË SË MAJMUNIT .....	213
SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE NE LIDHJE ME VIROZAT RESPIRATORE DHE PRAGU EPIDEMIK NE SHQIPERI NE JANAR TE 2024 .....	214

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

IMUNOLOGJIA E INFEKSIONIT NGA SARS-COV-2 DHE PËRGJIGJJA IMUNE NË SUBJEKTET E IMUNIZUARA .....	216
REZISTENCA ANTIMIKROBIKE (AMR) NJË FENOMEN NË RITJE PAS PANDEMISË .....	217
ANALIZA EPIDEMIOLOGJIKE E SEZONIT TË PARË TË INFLUENZËS MBAS PANDEMISË SË COVID-19 NË WALES.....	218
FITOTERAPIA OSE MJEKESIA BIMORE NENKUPTON PERDORIMIN E BIMEVE PER VLEREN E TYRE MJEKESORE, EFEKTIN E TYRE TERAPEUTIK DHE KUADRI LIGJOR RREGULLUES PER PERGATESAT BIMORE.....	220
NDËRHYRJET DHE ROLI I FARMACISTIT NË MENAXHIMIN E SËMUNDJES PULMONARE OBSTRUKTIVE KRONIKE (SPOK).....	221
EDUKIMI I VAZHDUESHËM PROFESIONAL PËR FARMACISTËT PAS PËRFUNDIMIT TË STUDIMEVE UNIVERSITARE PËRMIRËSIMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL DHE KUJDESIT NDAJ PACIENTËVE	222
INTELIGJENCA ARTIFICIALE (AI) NË FARMACEUTIKË .....	224
SITUATA POST-COVID DHE TENDENCA E PËRDORIMIT TË ANTIBIOTIKËVE; (SPITALI RAJONAL I LEZHËS SI RAST STUDIMI).....	226
TERAPITË GJENETIKE NË DISA PATOLOGJI ME INTERES SOCIAL & KLINIK.....	227
NANOTEKNOLOGJIA DHE NANOMJEKËSIA NË BARNA .....	228

**KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII**

STRATEGJITË E REJA TË NANOSISTEMEVE PËR  
TRAJTIMIN EFEKTIV TË SËMUNDJEVE KRONIKE.. 230

NDIKIMI I TRETËSAVE NË KARAKTERISTIKAT E  
NANOGRIMCAVE TË MENADIONIT DHE STUDIMI I  
TRETSHMËRISË SË TIJ ..... 231

**KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII**

**KONFERENCA MBARËKOMBËTARE  
FARMACEUTIKE VII “SË BASHKU PËR  
FARMACEUTIKËN”: SHKENCA MJEKËSORE  
TË APLIKUARA NË FARMACEUTIKË DHE  
NUTRICIONI**

**HEPATITI KRONIK C, SËMUNDJE QE SHËROHET  
PLOTËSISHT**

*Jovan Basho*

*Shërbimi Hepatologji/Gastroenterologji, QSU "Nënë Tereza",  
Tiranë.*

Infeksioni prej viruseve C (deri sot janë konfirmuar 7 të tillë) është një prej infeksioneve më të përhapur e më problematikë në mbarë botën. Sipas të dhënave të vitit 2019 (dmth para pandemisë së Covid-19), në botë kishte 58 milion njerëz me hepatopati kronike C. Prej tyre rreth 400 000 vetë vdesin çdo vit. Në vitin 2016 OBSH paraqiti një plan ambicioz për ta eliminuar këtë sëmundje deri në vitin 2030, gjë kjo e bazuar në mjekimet e sotme: antiviralët me veprim të drejtpërdrejtë. Deri në vitin 2019, u diagnostikuan vetëm 21% nga 58 milion njerëz me hepatite kronike C, ndërkohë që vetëm 13% u mjekuan.

Progresi shumë i madh i bërë vitet e fundit në zbulimin e barnave me veprim antiviral të drejtpërdrejtë (frenusit e proteazave dhe polimerazës) kanë bërë që kjo sëmundje të konsiderohet si sëmundje e shërueshme. Kështu, janë zbuluar shumë barna që frenojnë proteazën (me prapashtesën ...previr), proteinën jo strukturore virale NS5A (me prapashtesën ...asvir) dhe polimerazën (me prapashtesën ...buvir), në bashkëshoqërime farmakologjike nga më të ndryshmet. Këto barna kanë bërë që dëmtimet e mëlçisë nga virusi C, të shihen sot si dëmtime plotësisht të shërueshme, pavarësisht gjendjes morfologjike dhe funksionale të mëlçisë në momentin e diagnozës. Për më tepër janë përcaktuar edhe gjendjet rezistente ndaj mjekimit të lidhura kryesisht me barnat që frenojnë NS5A.

Në vendin tonë rimburohen thuajse të gjitha barnat DAA.

Kërkimet farmakologjike të viteve të fundit kanë bërë që të marrë përparësi mjekimi me bashkëshoqërimin Sofosbuvir + Velpatasvir, Sofosbuvir + Daclatasvir dhe Glecaprevir + Pibrentasvir

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

(gjenotipet 1-6) dhe Grazoprevir + Elbasvir (gjenotipet 1,4). Ndërkohë bashkëshoqërim tepër i efektshëm, në rastet e rralla rezistente ndaj barnave të para është bashkëshoqërimi: Sofosbuvir + Velpatasvir + Voxilaprevir.

Në qershor të këtij viti (2022), OBSH, paraqiti strategjitë e saj për vitin 2030, për të pakësuar infeksionin nga HCV në masën 90% dhe vdekjet në masën 65%. Për këtë gjë nevojitet thjeshtësimi i shërbimit mjekësor duke ia ngarkuar mjekimin mjekut të përgjithshëm, thjeshtësimi dhe përhapja masive e testimit të ngarkesës virale të virusit, HCV RNA dhe shtrirjen e mjekimit edhe tek fëmijët dhe adoleshentët.

Të gjitha këto kanë rritur ndjeshëm shpresën e mjekëve dhe të sëmurëve për mundësi të mëdha mjekimi, në luftën për shrrënjosjen e virusit C, pavarësisht stadit klinik e morfologjik në të cilin zbulohet patologjia hepatike.

**Fjalë kyçe:** HCV, DAA (direct acting antivirals), goals of WHO for 2030.

## ANTIMYKOTIKËT NË INFEKTOLOGJI DHE PËRQASJET TERAPEUTIKE NË TË ARDHMEN

*Prof. Dr. Najada Como*

*Shërbimi i Semundjeve Infektive, QSU Nene Tereza*

Infeksionet fungale përfaqësojnë një problematikë në rritje për një numër të konsiderueshëm pacientësh të imunokompromentuar. Megjithëse disa lloje fungesh janë plotësisht të afta të shkaktojnë infeksione tek individët e shëndetshëmimunokompetent, shumica e tyre janë patogjenë oportunistë, që kërkojnë një bujtës të ndjeshëm. Individët të cilët zhvillojnë këto infeksione ,ofrojnë një sërë kushtesh

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

adaptuese për rritjen e fungeve në organizmin e tyre, midis tyre më i rëndësishëm është kompromentimi i funksionit të sistemit imunitar. Si pasojë e kësaj , funget janë në gjendje të shkaktojnë një sere infeksionesh që variojnë nga infeksionet e lëkurës dhe mukozave deri tek infeksionet invazive kërcënuese për jetën. Trajtimi efektiv I infeksioneve mykotike invasive në përgjithësi është mbështetur në tre klasa të antimykotikëve sistematikë: azole, ekinokandinat dhe polienet. Megjithatë, ndërsa tre klasa të antimykotikëve sistematikë mund të duken të mjaftueshme, rezistenca ndaj edhe njërit prej këtyre antimykotikëve ka potencialin të kufizojë opsionet terapeutike, veçanërisht nëse janë në lojë faktorët e tjerë si toksiciteti ose ndërveprimet me medikamentet. Sot, me ndryshimin progresiv të epidemiologjisë së infeksioneve dhe rezistencës në rritje ndaj terapisë antifungale, marrja e vendimeve terapeutike bazuar në supozimet e klasës antifungale ose mekanizmin e veprimit nuk është më një strategji e besueshme. Hapi tjetër i rëndësishëm do të jetë vlerësimi i klasave të reja të antimykotikëve, aktualisht në zhvillim e sipër, për dobinë e tyre të mundshme përkundrejt rezistencës antifungale. Aktualisht, një numër komponimesh të reja farmakologjike si karbazole, furanet dhe benzimidazole janë nën investigim. Pavaresisht mekanizmit të veprimit jo plotësisht të njohur, këto preparate kanë arritur të evidentojnë tashme një efekt antifungal të mirë ndaj shtameve të njohura si rezistente.

**Fjalët kyçe:** Infeksionet mykotike , agjentët antimykotikë, zhvillimi i preparateve antimykotike



**PERDITESIM MBI UDHERREFYESIT E TRAJTIMIT TE  
INFEKSIONEVE SEKSUALISHT TE TRANSMETUESHME:  
PERSHKRIMI “OFF LABEL” I TERAPISE  
ANTIMIKROBIKE DHE ROLI I FARMACISTIT**

*Prof. Dr. Arjan Harxhi*

*Departamenti i Semundjeve Infektive, FM, UMT*

Një nga shqetësimet më të vazhdueshme për shëndetin publik vazhdojnë të jenë infeksionet seksualisht të transmetueshme (IST) dhe pasojat e tyre. Një pjesë e madhe e IST-ve ndodhin tek adoleshentët dhe të rinjtë, dhe me pasoja të rënda si infertiliteti dhe sëmundjet sistemike. Kohët e fundit, ka pasur prova në rritje për rezistencën antimikrobiqe në shtamet e gonorresë dhe klamidias, gjë që ka ofruar nevojën për të përditësuar udhërrefyesit e trajtimit për të parandaluar rezistencën e vazhdueshme dhe për të ulur shkallën e dështimit të trajtimit.

Menaxhimi i rastit me IST ka si objektiv kryesor të sigurojnë një diagnoze dhe mjekim të bazuar në një përjasje klinike, laboratorike dhe sindromike. Udhërrefyesi i Unionit Nderkombëtar të IST rekomandon përdorimin e skemes së kombinuar me dy antibiotike për trajtimin e gonorese së pakomplikuara: ceftriaxon 1 gr im plus azitromycine 2 gr doze unike pos, ndërsa për mjekimin e uretritit nga klamidia skemen me doksiciklinike 100mg 2 here në ditë për 7 ditë ose azitromycine 1 gr pos doze unike. Gjithashtu, udhërrefyest e fundit rekomandojnë përdorimin e doksiciklines tek MSM dhe transgendet si mjekim parandalues të infeksioneve bakteriale pas një ekspozimi seksual (PEP=profilaksi pas ekspozimit) me doze 200 mg doze unike , 24 deri 72 ore pas ekspozimit seksual.

Kur një mjek përshkruan një bar jo sipas indikacioneve specifike të dhëna në fletën aprovue ( “label”) , veprimi i tij duhet të jetë i bazuar në evidenca të sakta të sigurisë të mbështura në literaturë si

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

dhe mbi gjykimin mjeksor te eksperteve. Perdorimi “ off label” mund te perfshije ndonje rrisht te caktuar, porse ne pergjithesi ai eshte i bazuar ne studimet shkencore qe perfshijne kerkime ekstensive qe e tejkalon ndonjehere provesin e rishikimit dhe aprovimit nga agjensite aprovuese si FDA dhe EMA. Farmacisti ka te drejte te pyese pse eshte pershkruar medikamenti dhe te diskutoje pershtatshmerine para zbatimit te recetes. Megjithate farmacisti duhet ta kuptoje qe pershkrimi per nje perdorim “ off label” nuk perben nje “shkelje” qe duhet te coje automatikisht ne nje refuzim per zbatim te recetes. Farmacisti do te vazhdoje te jape barna me perdorim jo sipas aprovimeve zyrtare te agjensive, por duke u bazuar ne evidencat shkencore dhe literaturen e publikuar per te cilat ai duhet te jete ne dijeni.

### **BARNAT HIPOGLICEMIANTE DHE SËMUNDJA ALZHEIMER**

*Prof. Asoc. Ilir Alimehmeti*

*Zv. Dekan, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë,  
Anëtar i Komisionit të Përhershëm të Shëndetësisë, Akademia e  
Shkencave e Shqipërisë*

Demencat, të kryesuar nga sëmundja Alzheimer, janë kthyer në problem madhor të shëndetësisë në vendet e zhvilluara. Të dhëna gjithnjë e më të shumta po mbështesin konceptin se Sëmundja Alzheimer është thelbësisht një sëmundje metabolike, e cila vjen si pasojë e dëmtimit progresiv të aftësisë së trurit për të përdorur glukozën dhe për t’iu përgjigjur stimulimit nga insulina dhe nga faktori i rritjes i ngjashëm me insulinën (IGF). Për më shumë, natyra heterogjene e Sëmundjes Alzheimer mund të shpjegohet vetëm

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

pjesërisht përmes prirjes së trurit për të depozituar proteina strukturore oligomerike të keqpërpunuara, të keqpalosura dhe të agreguara, duke përfshirë këtu peptidet e amiloidit  $\beta$  dhe taun e hiperfosforiluar. Të dhënat sugjerojnë se, në mënyrë që të zhvillohen qasje diagnostike dhe terapeutike më realiste ndaj Sëmundjes Alzheimer, në hipotezat kërkimore duhet të përfshihen edhe faktorë të tjerë, si dëmtimi i metabolizmit të energjisë, stresi oksidativ, neuroinflamacioni, rezistenca ndaj insulinës/IGF dhe deficiencia e insulinës/IGF në tru.

Të dhëna si klinike ashtu edhe eksperimentale e kanë lidhur hiperinsulineminë kronike me dëmtimet konjitive dhe neurodegenerimin të shkaktuar nga rritja e akumulimit apo nga reduktimi i klirensit të A $\beta$ PP-A $\beta$  nga sistemi nervor qendror. Si rrjedhojë, rikthimi në normë i përgjigjes ndaj insulinës si edhe përdorimi i terapisë me insulinë mund të çojë drejt përmirësimit të performancës konjitive, pavarësisht nga variabiliteti i efekteve të tyre mbi ngarkesën cerebrale me A $\beta$ PP-A $\beta$ . Nga ana tjetër, të dhënat eksperimentale mbështesin konceptin se efektet toksike të A $\beta$ PP-A $\beta$  mund të promovojnë insulinorezistencën. Të marra së bashku, këto të dhëna sugjerojnë se mund të krijohet një qark feedback pozitiv i neurodegenerimit progresiv, në të cilin insulinorezistenca nxit akumulimin e A $\beta$ PP-A $\beta$ , ndërsa toksiciteti i fibrilave A $\beta$ PP-A $\beta$  nxit insulinorezistencën cerebrale. Ky fenomen mund të shpjegojë se përse matja e nivelit të A $\beta$ PP-A $\beta$  në likidin cerebrospinal dhe imazheria cerebrale janë të pamjaftueshëm si biomarkues të veçuar gjatë diagnostikimit të Sëmundjes Alzheimer, dhe përse rezultatet e studimeve klinike të monoterapisë me anti-A $\beta$ PP-A $\beta$  kanë qenë zhgënjyese.

Të dhënat e agreguara sugjerojnë se insulinorezistenca dhe insulinodeficiencia cerebrale mund të kthehen në objektiva terapeutike në përpjekje për të ndalur përparimin e Sëmundjes Alzheimer ose për të kthyer prapa ecurinë natyrore të patologjisë. Gjatë prezantimit do të diskutohen edhe efektet terapeutike të trajtimeve të ndryshme, të cilat shënjestrojnë rolin e rezistencës dhe deficiencës së insulinës/IGF në tru, duke përfshirë këtu përdorimin e

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

insulinës intranazale, të inkretinave dhe të agjentëve insulinosensibilizues, së bashku me përfitimet potenciale të ndryshimit të stilit të jetës, me qëllim modifikimit e riskut për zhvillimin e dëmtimeve të lehta konjitive ose të Sëmundjes Alzheimer.

Në përmbledhje, të dhënat mbështesin me forcë nocionin se, në terren të Sëmundjes Alzheimer, duhet të braktisen strategjitë diagnostike dhe terapeutike unimodale dhe të fillojë implementimi i qasjeve multimodale.

### TERAPITE E REJA NE TRAJTIMIN E SEMUNDJES

#### PULMONARE INTERSTICIALE

*Ervin Rapushi, Artur Zoto, Teuta Backa*

*Sherbimi i Reumatologise QSUNT*

Semundja pulmonare intersticiale (ILD) perben nje komplikacion te mbi 200 semundjesh te cilat prekin pulmonin dhe komplikohen me kete patologji, shumica e ketyre semundjeve jane shume te rralla. ILD eshte nje manifestim i shpeshte i semundjeve sistemike autoimmune si AR, LES, DM-PM, Sclerodermia sistemike. Shpesh here ajo mund te paraqitet edhe si idiopatike. Fibroza progressive e parenkimes pulmonare shkakton perkeqesim te funksionit pulmonar, simptomave respiratore dhe te cilesise se jetes. Fibroza pulmonare ne ILD paraqet nje mortalitet te larte. HRCT eshte ekzaminimi i zgjedhur per kete patologji dhe per vleresimin e progresionit te fibrozës pulmonare. Diagnoza e hereshme eshte e rendesishme per te filluar mjekimin sa me shpejte.

Menaxhimi farmakologjik i ILD bazohet ne varesi te patologjise qe e ka shkaktuar dhe ne faktin nese mbizoteron inflamacioni apo fibroza.

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

Në sëmundjet mbizotëruese me inflamacion, kortikosteroidet dhe agjentët imunomodulues janë baza e trajtimit. Antifibrotikët fillimisht u prezantuan në fibrozën pulmonare idiopatike (IPF). Kohët e fundit, koncepti i fibrozës pulmonare progresive (PPF) ka dale për të përshkruar sëmundjet fibrotike të mushkërive të ndryshme nga IPF që zhvillojnë, brenda një periudhe prej 1 viti, një sjellje progresive të sëmundjes. Përdorimi i antifibrotikëve mund të ngadalësojë përkeqësimin e PPF, të ngjashme me efektet e tyre të dobishme në IPF, dhe trajtimi me nintedanib sugjerohet te pacientët me PPF, kur menaxhimi standard për ILD fibrotike ka dështuar.

**Fjalë kyçe:** ILD, IPF, PPF

### KOLESTEROLI FLUID ASCITIK: NJË SHËNUES I THJESHTË PËR ASCITET MALINJE

*Hysni Dede MD, MSc<sup>1</sup>, Rovena Roshi MD, MSc<sup>2</sup>, Prof. Dr. Enver Roshi MD, PhD<sup>3</sup>, Prof. Dr. Jovan Basho MD, PhD<sup>3,4</sup>*

*<sup>1</sup> Gastrohepatologist in German Hospital International, Tirana, ALBANIA*

*<sup>2</sup> Primary Health Care Physician, Tirana, ALBANIA*

*<sup>3</sup> University of Medicine of Tirana, ALBANIA*

*<sup>4</sup> Gastrohepatology Service University Hospital Center “Mother Teresa” Tirana, ALBANIA*

Introduction: Ascites is of Greek derivation (“askos”) and refers a bag or a sack. The word is a noun and describes pathologic accumulation within the peritoneal cavity. The differential diagnosis of ascites is a common clinical problem. However, the capability to distinguish

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

malignant from non-malignant causes of ascites using available biochemical techniques would obviate many expensive and time-consuming diagnostic studies on patients presenting with ascites of unknown etiology. Therefore, this study was planned to evaluate the diagnostic efficacy of ascitic fluid cholesterol in comparison to triglycerides and glucose, in differentiating "malignant" from non-malignant ascites.

**Materials & Methods:** A total of 72 patients (64 with non-malignant ascites and 8 with malignant) were evaluated for triglycerides, cholesterol and glucose in serum & ascitic fluid at the same time.

**Results:** The mean ascitic cholesterol level was significantly ( $p < 0.05$ ) higher in malignant ascites ( $83.3 \pm 31.1$ ) than in non-malignant ascites ( $13.4 \pm 9.8$ ), with a cut off level of 70 mg/dl for ascitic fluid cholesterol ( $p=0.0001$ ) comparing with triglycerids and glucose respectively ( $36.0 \pm 15.9$ ) and ( $109.1 \pm 37.2$ ) in malignant ascites, and ( $40.9 \pm 45.8$ ) and ( $147 \pm 46.5$ ) in non-malignant ascites ( $p$  value was respectively 0.7 and 0.032).

**Conclusions:** Ascitic cholesterol level was significantly ( $p < 0.05$ ) higher in malignant ascites ( $83.3 \pm 31.1$ ) than in non-malignant ascites ( $13.4 \pm 9.8$ ), ( $p=0.0001$ ). It helps in diagnose as a simple marker for malignant ascites. Triglycerides and glucose do not affect the diagnostic orientation of malignant ascitic fluids except, respectively, in the cases of chylous and tubercular ascitic fluids.

**Keywords:** cholesterol, ascites, triglycerides, glucose, non-malignant ascites, malignant ascites

**ADENOKARCINOMA INTRAMUKOZALE GASTRIKE -  
EGC (KANCERI I HERSHËM GASTRIK) DHE RËNDËSIA E  
ENDOSKOPISË (EGDS) NË DIAGNOZËN E HERSHME.  
NJË RAPORTIM RASTI**

*Hysni Dede*

Introduction: Gastric cancer (GC) accounts for 10% of all cancer-related deaths. Although the reported 5-year overall survival rates in advanced GC range from 15% to 52 % , those in early gastric cancer (EGC) range from 88% to 97%. Early detection and treatment contribute to decreased mortality rates. With the increased use of endoscopic treatment in EGC, the natural history of EGC must be considered in order to evaluate the efficacy of endoscopic resection and to improve treatment decision-making; this is particularly relevant for elderly patients. However, the chronological changes of GC, including whether mucosal GC can progress to advanced cancer, remain unclear due to a lack of follow-up with high-resolution endoscopic images. Nevertheless Gastrectomy with lymphadenectomy is the gold standard treatment. We present a case with EGC (Early gastric cancer - Gastric Intramucosal adenocarcinoma) treated with gold standard treatment despite his age (an elderly patient).

Early gastric cancer (EGC) is defined as a cancer confined to the mucosa or submucosa, regardless of lymph node metastasis. The most common histologic type is tubular adenocarcinoma. EGC is preceded by a cascade of precancerous lesions: chronic gastritis (atrophic or not) → intestinal metaplasia (complete or not) → low grade dysplasia → high grade dysplasia (in situ carcinoma) → invasive carcinoma. Diagnosis is made by endoscopy confirmed by biopsy. Lymph node metastasis is the most important prognostic factor. 5 year cancer specific survival for gastric cancer confined to the mucosa and submucosa is 99.3% and 96.7%, respectively

Known in terminology also as mucosal or submucosal gastric carcinoma, it is a malignant neoplasm of stomach, located in stomach (Cardia: 18.8%, Corpus / fundus: 13.4%, Antrum / angularis /

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

pylorus: 67.8%): In response to gastric epithelial injury, mainly by environmental factors such as *Helicobacter pylori* and Epstein-Barr virus (EBV) induced chronic inflammation, gastric stem cells in the affected region become dysfunctional, leading to dysregulated differentiation and gastric carcinoma. It is a multifactorial disease (hereditary factors include *CDH1* mutation and *APC* mutation, while environmental factors include smoking, diet (high intake of salt, preserved or smoked foods, meat), *Helicobacter pylori* or EBV infection). It can be sporadic in 90% of cases and familial / hereditary setting in 10%:

Case report: A 83-year-old man (Q.SH) in 21 July 2021 was referred to Gastro-Hepatology Department of German International Hospital in Tirana for digestive disturbances like:

Epigastric pain, feeling of rapid satiety and abdominal discomfort after eating, slight weight loss (about 4 kg in the last 3 months) with a history of several years of these complaints, no personal and family history of digestive tract pathology, no other concomitant diseases. Smoker for years (10-15 cigarettes / day) and non-consumer of alcohol and other addictive substances. General condition good and refuses to perform Fibrogastroscopy and other recommended examinations by continuing the treatment with PPI given a few weeks ago by the family doctor.

Reappearance again after 2 months on September 29, 2021 where he performs the Fibrogastroscopy procedure during which in addition to pronounced gastritis and significant hiatal hernia, the presence of an area above the level of the mucosa, about 3-4 cm in diameter with a rough surface is noticed in the antrum. , multilobular, extremely fragile and slightly bloody appearance from which the biopsy was taken.

The biopsy result is: Intramucosal Gastric Adenocarcinoma (gastric mucosa with glands with "back-to-back" architecture with epithelium with pronounced grade dysplasia invading the lamina propria).

All other laboratory blood examinations resulted within the norm while other imaging examinations (Abdominal ultrasound, Thorax radiography, CT-thorax-abdomen) did not detect metastases.



## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

After subtotal gastrectomy and part of the omentum, the histopathological examination revealed the histopathological picture of severe diffuse chronic gastritis, with pronounced intestinal metaplasia and moderate to severe multifocal mucosal dysplasia, and the presence of *Helicobacter pylori*. No lymph nodes were identified and the omentum was clean.

Conclusion: The progression of the patient's clinical condition after the intervention and onwards was very good and without the presence of the patient's symptoms and previous complaints.

Early endoscopic diagnosis with biopsy not only minimizes the risk of further invasion of early gastric cancer over time, but also increases patient survival through adequate treatment tailored to the patient's individual profile (age, concomitant diseases, etc.)

**NDIKIMI I HERV (HUMAN ENDOGENOUS  
RETROVIRUSES) MBI GJENET EMBRIONALE DHE  
MEKANIZMAT E SINJALIZIMIT INTRA QELIZOR PI3K-  
AKT-MTOR NE KARCINOMAT E DISTRIKTIT KOKE  
QAFE DHE MODELIMI I TYRE NGA DROGA TE  
ANESTEZISE**

*Ermal Pashaj<sup>1</sup>, Martina Giudice<sup>2</sup>, Vita Petrone<sup>2</sup>, Marialaura Fanelli<sup>2</sup>, Rossella Chirico<sup>2</sup>, Filadelfo Coniglione<sup>3 4</sup>, Claudia Matteucci<sup>2</sup>, Chiara Cipriani<sup>2</sup>, Emanuela Balestrieri<sup>2</sup>*

*<sup>1</sup> Department of Surgery at Catholic University 'Our Lady of Good Council', Tirana, 1000, Albania;*

*<sup>2</sup> Department of Experimental Medicine, University of Rome Tor Vergata, Rome, 00133, Italy;*

*<sup>3</sup> Department of Surgical Science, Catholic University 'Our Lady of Good Council', Tirana, 1000, Albania;*

*<sup>4</sup> Department of Clinical Science and Translational Medicine, University of Rome Tor Vergata, Rome, 00133, Italy.*

Objektiva: Karcinomat e distriktit koke qafe perfshijne onkopatologji qe derivojne nga epiteli mbulues I kavitetit oral, rino-oro-hypofaringut. Raporte te ndryshem tregojne se droga te ndryshme anestetike te perdorura gjate kirurgjise mund te modelojne duke frenuar apo stimuluar avancimin e tumorit. Propofoli dhe Ropivacaina jane bare te perdorura gjeresisht si droga anestezie locale dhe gjenerale. ne studime shkencore te meparshme eshte pare se aktivizimi i HERVs ne qelizat kanceroze perkon me shtimin e agresivitetit te tyre dhe aftesise per tu riprodhuar. HERVs jane mbetje gjenome te integruar ne ADN tone si derivate i infeksioneve te meparshme nga Retrovirus egzogjen, dhe perlllogaritet se perbejne rreth 8 % te kodit tone gjenetik. Keto mbetje jane kryesisht te fjetura pra inefikase, te cilat mund aktivizohen nga stimuj te vecante egzogjen duke bere te mundur prodhimin e proteinave patogjenike. Ky studim hulumton mbi rolin e familjeve te caktuara HERV, ne tre linja qelizore te karcinomes skuamoqelizore te distriktit koke qafe,

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

dhe efektet e drogave si propofol dhe ropivakaina, ne aktivitetin e gjeneve embrionale dhe mekanizmat intraqelizore PI3K/AKT/mTOR pathway.

Materiali dhe Methoda: Linja qelizore te karcinomes skuamoqelizore te hypofaringut (FaDu), qeliza te karcinomes se gjuhes dhe (SCC-25) dhe qeliza te adenokarcinomes gjuhes (CAL-27) u mbollen ne culture dhe u trajtuan me perqendrim te ndryshme te Propofol dhe Ropivakaine. Shprehia relative e HERV-K, HERV-H, OCT4, NANOG, SOX2, KFL4, dhe PI3K/AKT/mTOR pathway u vleresua me RT-Real-time PCR.

Rezultate: Ropivacaina promovon shprehjen e HERV-K ne qelizat kanceroze te linjes FaDu dhe SCC-25, nderkohe qe Propofoli frenon shprehjen e kesaj familje retrovirale. Ne linjen e qelizave kancerogjene CAL-27, Propofol promovon shprehjen e HERV-K. HERV-H. Ky ekspresion reduktohet vetem ne linjen qelizore kanceroze FaDu nga Propofoli. Persa I perket gjeneve embrionale ne linjen FaDu shprehja e OCT4, dhe NANOG promovohet nga Ropivakaina dhe frenohet gjate trajtimit me Propofol, nderkohe qe ne linjen CAL-27, te dy anestetiket promovojne shprehine e SOX-2. PI3K/AKT/mTOR pathway, ne qelizat FaDu, shprehia e PTEN frenohet nga Ropivakaina dhe promovohet nga Propofol, kur TSC1 reduktohet nga ekspozimi me Propofolin. Ne linjen qelizore CAL-27, trajtimi in vitro me Propofol promovon shprehjen e PIK3CB, AKT, mTOR, RPS6KB1, EIF4EBP1 dhe EIF4E nderkohe qe redukton shprehine e PTEN.

Perfundime: Ky studim in vitro jep njohuri te reja mbi shprehine e familjeve te caktuara te Retoviruseve Endogjen (HERV), gjeneve embrionale dhe mesazhereve intraqelizore PI3K/AKT/mTOR ne linjat qelizore kanceroze te distriktit koke qafe. Keto shprehi gjenike dhe proteinike bashke me pasojat e tyre modelohen si nga perqendrimi i drogave ashtu dhe nga llojet e linjave qelizore probabilisht nga stadi i diferencimit te ketyre qelizave çka mund te jete mjaft e dobishme me implikimin e vet ne vendimarjen klinike.

**EFEKTET ANESORE TE CDK4/6 INHIBITOREVE DHE  
MENAXHIMI I TYRE NE KANCERIN METASTATIK TE  
GJIRIT. EKSPERIENCA JONE**

*Dr. Flutura Proko, Dr. Bledi Kreka, Dr. Sabo Ademi, Prof. Asoc. Silvana Celiku, Prof. Asoc. Dhurata Tarifa, Dr. Amanda Zeko, Dr. Enkeleja Çuedari, Dr. Anila Kristo, Dr. Jona Prifti*

Hyrje: Cyclin-dependent kinase (CDK) 4/6 inhibitorët janë bërë standard i trajtimit në kancerin e gjirit metastatik HR-pozitivë, HER2 negative. Ata kanë treguar dyfishim të efektit terapeutik. Tre janë CDK4/6 inhibitorët e aprovuar: palbociclib, ribociclib, and abemaciclib. Secili prej tyre mund të perdoret në kombinim me një inhibitor aromataze, ose fulvestrant, si linjë e parë trajtimi, ose pas progresit të sëmundjes, duke pasuar endokrinoterapinë. Efektet anesore më të shpeshta janë hematologjike si, neutropenia, por gjithashtu edhe jo hematologjike si demtim i funksionit hepatic, zgjatje e segmentit QT, diarre.

Qellimi: Qellimi i këtij studimi është evidentimi i efekteve anesore, nga përdorimi i CDK4/6 inhibitorët, monitorimi dhe menaxhimi i tyre në kohën e duhur.

Materiale dhe Metoda: Rishikimi i literaturës dhe eksperiencës jone në Onkologji në përdorimin e CDK4/6 inhibitorëve nga viti 2017 – 2023. Konkluzione: Në përgjithësi CDK4/6 inhibitorët janë të tolerueshëm. Efektet anesore kryesore të lidhura me CDK4/6-inhibitorët janë të njejta duke përfshirë neutropeninë dhe efektet gastrointestinale. Megjithatë, midis tyre ekzistojnë diferenca. Efekti anesor më i shpeshtë për palbociclib dhe ribociclib është neutropenia, ndërsa zgjatja e segmentit QT dhe toksiciteti hepatic është vënë re vetëm tek ribociclib. Toksiciteti gastrointestinal ndodh kryesisht nga abemaciclib. Në ndryshim nga kimioterapinë, në rastin e CDK4/6 inhibitorëve, toksiciteti mund të menaxhohet me reduktimin dhe modifikimin e dozës. Prandaj edukimi i pacientëve, monitorimi i hershëm dhe menaxhimi në kohën e duhur i efekteve anesore, bën të mundur minimizimin e tyre, si edhe shmangien e ndërprejeve të trajtimit.

**Fjalët kyçe:** kancer gjiri metastatik, palbociclib, ribociclib, abemaciclib, CDK4/6 inhibitor, endokrinoterapi, efekt anesor.

**BIOPSIA OSTEOMEDULARE NË MIELOFIBROZË NJË  
PARAMETËR TERAPEUTIK**

*Dr. E. Çeliku<sup>1</sup>, Prof. M. Ikonimi<sup>1</sup>, Dr. I. Rugeja, Dr. F. Ymeri, Dr. A. Daizi*

*Laboratori i Anatomisë Patologjike, QSUT “Nënë Tereza”, Tiranë*

Hyrje: Histologjia e biopsisë osteomedulare është e përbërë nga disa struktura të rëndësishme si parenkima, e përbërë nga klonet hemopoetike qelizore, stroma delikate e formuar nga fijet retikulare si dhe kocka spongioze. Raporti midis tyre, sasia e tyre si dhe ndryshimet në raportet midis tyre si dhe sasia e fibrozës retikulare dhe të kolagjenit, janë elementë të rëndësishëm në diagnozën histopatologjike të sëmundjeve malinje dhe jo-malinje hemopoetike, ndër to janë sëmundjet mieloproliferative. Në rutinën e laboratorit të anatomisë patologjike ngjyrimet e përdorura për të identifikuar sasinë e fibrozës përdoren ngjyrimet speciale citokimike si Gomorri (silver stain) për identifikimin e fijeve retikulare dhe Trikrom për shfaqjen e fijeve të kolagjenit të tipit të parë. Prania e fibrozës në sëmundjet mieloproliferative janë të lidhura me një abnormalitet qelizor dhe kanë rëndësi prognostike si dhe orientojnë trajtimin e tyre.

Qëllimi: Ekzaminimi dhe numri i rasteve të ardhura në laboratorin e Anatomisë Patologjike në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, të diagnostikuara me mielofibrozę dhe përcaktimi i nivelit të fibrozës në to.

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

Materiale dhe metoda: Metoda e përdorur është teknika histologjike klasike e modifikuar sipas protokolleve për procesimin e biopsive osteomedulare. Seksionet histologjike fiksohen në formalinë 10% për 24 orë, futen në dekalçifikim për 3 orë (deri në 24 orë) me ETDA, procesohen në histokinetë, vendosen në blloqe parafine dhe priten në mikrotom me trashësi 1µm. Më pas një seksion ngjyroset me hematoksilinë/eozinë, një me Gomorri dhe një tjetër me Trikrom. Mbulohen me lamelë dhe ekzaminohen nga mjekët anatomopatolog të specializuar në laboratorin tonë. Metoda e përdorur për përcaktimin e fibrozës bazohet në klasifikimin European i cili e ndan atë në: a) gradë 0: normal; b) grade 1: fije të pakta retikulare perivaskulare; c) gradë 2: fije retikulare difuze dhe fije kolagjeni; d) gradë 3: fije retikulare dhe kolagjeni difuze dhe osteosklerozë

Përfundime e konkluzione: Fibroza në biopsinë osteomedulare është e pranishme në shumë patologji malinje dhe jo-malinje hemopoetike dhe është prominente në mielofibrozë. Niveli i fibrozës kontribuon në një çorganizim të mikromjedisit hemopoetik si dhe promovon përparimin e sëmundjes, dhe pse shkak i saj mbetet akoma jo tërësisht i njohur. Shtimi i fijeve retikulare dhe të kolagjenit ka një rëndësi prognostike që injorohet nga sistemet aktuale të vlerësimit të ecurisë së sëmundjes. Identifikimi i fibrozës dhe përcaktimi i saktë i nivelit të saj, në biopsinë osteomedulare në MF do të çojë, potencialisht, në terapi më efektive. Strategjitë anti-fibrotike janë duke u vlerësuar aktualisht në një numër sprovash terapeutike që synojnë të eliminojnë elementet malinje të palcës kockore dhe të promovojnë hematopoezën normale.

Në të ardhmen, vërtetimi i ndikimit prognostik të fibrozës në BOM bashkë me kombinimin e strategjive anti-fibrogjenike me trajtimet aktualisht të disponueshme, do të çojë në përmirësimin e simptomave klinike në mielofibrozë.

**PËRDORIMI I ANTIBIOTIKËVE NË TERAPINË  
PERIODONTALE**

*MSc. Eni Jani, Prof. Dr. Edit Xhajanka, MSc. Anis Thodhorjani,  
MSc. Neda Hysenaj, MSc. Eneida Prifti*

*Fakulteti i Mjekësisë Dentare  
Klinika Stomatologjike Universitare*

Objektivat: Qëllimi i këtij prezantimi është shpjegimi i tre problematikave që hasen gjatë patologjisë periodontale: A janë efektive antibiotikët sistematikë nëse biofilmi nuk ndërpritet? A mund të ndikojë lloji i pastrimit të biofilmit subgingival në rezultatet klinike të terapisë antimikrobiale ndihmëse? A varet efikasiteti i terapisë antimikrobiale sistemike ndihmëse nga cilësia e pastrimit të biofilmit subgingival dhe sekuenca pastrim-përdorimi i antibiotikëve?

Materiali dhe Metoda: Punimet përkatëse u kërkuar, u analizuar në mënyrë kritike dhe u nxorën të dhënat e tyre.

Rezultatet: Për problematikën e parë, u rishikuan studimet që vlerësojnë ndjeshmërinë e bakteve në biofilma dhe studimet klinike që vlerësojnë antibiotikët sistematik si monoterapi. Për problematikën e dytë, u vlerësuan studimet klinike që krahasojnë antibiotikët sistematikë si ndihmës me terapi jo-kirurgjikal ose me kirurgjinë periodontale dhe provat klinike duke përdorur antibiotikë sistematikë me kirurgjinë periodontale. Për problematikën e tretë, një rishikim i mëparshëm sistematik u përditësua.

Përfundim: Nëse antibiotikët sistematikë indikohen në terapinë periodontale, ato duhet të jenë ndihmëse ndaj pastrimit mekanik. Nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur përdorimin e tyre me kirurgji periodontale. Provat indirekte sugjerojnë që marrja e antibiotikëve duhet të fillojë në ditën e përfundimit të pastrimit, pastrimi duhet të përfundojë brenda një kohe të shkurtër (mundësisht 1 javë) dhe me një cilësi të përshtatshme, për të optimizuar rezultatet.

**FARMACISTI SI SHTYLLË KRYESORE NË MENAXHIMIN  
E ADERENCËS SË PACIENTËVE NDAJ TERAPISË.  
SFIDAT AKTUALE DHE POTENCIALET PËR  
PËRMIRËSIM**

*MSc. Era Goda<sup>\*1</sup>, MSc. Megi Raidhi<sup>2</sup>*

*<sup>1</sup>Novartis Pharma Services Inc., Representative Office, Tiranë, Shqipëri*

*<sup>2</sup>Vinipharma, Tiranë, Shqipëri*

*e-mail: eragoda88@gmail.com*

Hyrje dhe qëllimi: Aderenca terapeutike përkufizohet si niveli i ndjekjes së këshillave mjekësore dhe përdorimit të barnave sipas udhëzimeve të dhëna nga profesionistët e kujdesit shëndetësor. Kjo përfshin respektimin e udhëzimeve për dozën e barnave, shpeshtësinë e përdorimit dhe kohëzgjatjen e terapisë. Aderenca e saktë siguron që pacienti të përfitojë maksimumin nga trajtimi. Mungesa e aderencës është një problem kyç për pacientët dhe profesionistët e kujdesit shëndetësor, pasi mund të çojë në shtim të shtrimeve hospitalore dhe kosto të larta të kujdesit shëndetësor. Qëllimi i këtij punimi është të rrisë ndërgjegjësimin si dhe vlerësimi aktual e gjithëpërfshirës i situatës, sfidave të shumta dhe zgjidhjeve të mundshme në përmirësimin e shkallës së aderencës ndaj barnave.

Materiale dhe metoda: Është kryer një hulumtim i detajuar i literaturës në databazat kryesore elektronike si PubMed, Medline, dhe Google Scholar, për artikuj të publikuar në 5 vitet e fundit, duke përdorur terma kërkimi specifike. Gjithashtu, për të vlerësuar situatën lokale, është realizuar një studim deskriptiv, *cross-sectional*, nëpërmjet shpërndarjes së një pyetësi në farmacistë e pacientë.

Rezultate: Në shumicën e rasteve, u konstatua se pacientët kanë tendencë për mos të ndjekur në mënyrë të plotë e të saktë përshkrimet



## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

dhe rekomandimet për marrjen e barnave. Janë disa faktorë të cilët mund të ndikojnë në këtë, si mungesa e informacionit rreth barnave, mosbindja për nevojën për trajtim, frika nga efektet anësore të barit, vështirësia në ndjekjen e regjimeve afatgjata të trajtimit, vështirësia në ndjekjen e regjimeve komplekse terapeutike që kërkojnë medikamente të shumta, me dozime e me orare të ndryshme. Nga ana tjetër, duket se farmacistët shpenzojnë një kohë të pamjaftueshme me pacientët e tyre, duke dhënë udhëzime të pakta, apo edhe të paqarta për disa pacientë, pa u përqëndruar në nevojat specifike të pacientëve.

Përfundime: Aderenca terapeutike mbetet ende një problem i rëndësishëm në praktikën farmaceutike. Farmacistët luajnë një rol të rëndësishëm në kujdesin ndaj pacientit duke ofruar informacione për barnat dhe duke monitoruar përdorimin e tyre. Ekziston nevoja për ndërtimin e strategjive të ndryshme farmaceutike, të cilat do të ndihmonin farmacistët të kenë një ndikim pozitiv në respektimin e marrjes së barnave nga pacienti, duke zbatuar njohuritë, përvojën dhe aftësitë e tyre, për të ndihmuar pacientët të arrijnë një rezultat sa më të mirë terapeutik.

**Fjalë kyçe:** aderenca terapeutike, farmacisti, pacientë, terapi.

**ROLI I PAJISJEVE MJEKËSORE ME BAZË  
SUBSTANCA NATYRALE NË FUSHËN  
TERAPEUTIKE: NJË RAPORT I QËNDRUESHËM  
PËRFITIM/RREZIK PËR PACIENTËT DHE  
MJEDISIN**

*Gjergji Lushi*

Kompleksiteti që ndesh punonjësi i kujdesit shëndetësor në praktikën e tij të përditshme, nuk gjen gjithmonë një zgjidhje të plotë në trajtimet farmakologjike të disponueshme. Në fakt, shpesh tek një pacient gjenden modele simptomash të mbivendosura, që i përkasin patologjive të ndryshme, aq sa mund të jetë e vështirë të përcaktohen çrregullimet e ndryshme funksionale si entitete diskrete. Këto kushte karakterizohen nga ndryshimi i proceseve dhe/ose funksioneve, që shpesh janë të ndërvarura (përshkueshmëria e ndryshuar, inflamacioni, mbindjeshmëria, mosfunksionimi i boshtit mikrobiotë zorrë-tru) dhe, për rrjedhojë, zgjedhja e trajtimit duhet të marrë parasysh natyrën e përgjithshme të çrregullimeve.

Pajisja Mjekësore me Bazë Substanca (Medical Device Made of Substances - MDMS) e përbërë nga substanca komplekse ose natyrale, pa efekt receptor, mund të veprojnë në mënyrë sinergjike duke prodhuar efekte në mekanizma të ndryshëm patogjenetikë.

Studimet inovative kanë nxjerrë në pah për herë të parë se si disa MDMS mund të zëvendësojnë barnat në sëmundjet specifike ezofago-gastro-intestinale me një raport të qëndrueshëm përfitim/rrezik për pacientët dhe mjedisin.

Poliprotect, një MDMS i tregtuar në 15 vende evropiane, është një produkt 100% natyral, in cili është dëshmuar të jetë jo inferior ndaj omeprazolit, për sa i përket zbutjes së urthit, dhimbjes epigastrike dhe djegies, duke filluar nga dita e parë e trajtimit dhe në dy javët e para (doza fillestare me 5 tableta në ditë). Produkti ka rezultuar më i mirë në trajtimin sipas kërkesës (mesatarisht 2-3 tableta në ditë) krahasuar me omeprazolin në dy javët në vijim. Për më tepër, Poliprotect i

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

përdorur sipas nevojës kundërshtoi përkeqësimin e parashikueshëm të simptomave pas pezullimit të trajtimit PPI, pa ndikuar në mikrobiotën e zorrëve dhe mjedisin, pasi është një produkt 100% natyral dhe i biodegradueshëm

### TERAPIA ME MODULATORËT NË FIBROZËN KISTIKE

*Evda Vevecka, Eleni Nastas*

*Universiteti Barleti. Fakulteti i Shkencave Mjekësore*

Qëllimi i këtij prezantimi është njohja e punonjësve shëndetësorë mbi përparimet e shkencës në drejtim të zbulimit të molekulave të vogla të quajtura **modulatorë** që kanë transformuar jetën e të sëmurëve në Fibrozë kistike (FK) dhe, sidomos vlerën e tyre për vendin tonë.

Fibroza kistike është sëmundja gjenetike më e shpeshtë në popullsinë kaukaziane. Ajo shkaktohet nga mutacionet në gjenin e FK që çon në prodhimin e një proteine jo normale. Sëmundja prek shumë organe të organizmit, por dëmtimet në traktin respirator janë shkaku kryesor i sëmundshmërisë dhe mortalitetit në individët e prekur. Zbulimi i gjenit në vitin 1989 dhe më pas i strukturës së poteinës që ai kodon, ndihmoi në shumë studime që lidheshin me kuptimin e funksionit jo normal të kësaj proteine, me pasojë gjetjen e barnave që ndërhyjnë në këto çrregullime për t'i korrigjuar ato. **Këto barna u quajtën modulatorë.**

Modulatorët janë barna që kanë aftësi të plotësojnë ose të rivendosin rolin funksional të mutacioneve të FK që shkaktojnë sëmundjen. Ato klasifikohen në disa grupe : fuqizuesit, korigjuesit, stabilizuesit, agjentët depërtues dhe amplifikuesit. Aktualisht janë të aprovuar nga FDA, EMA, dhe t'u hedhur në treg tashmë prej 10 vitesh 4 preparate modulatore, të cilat kanë transformuar jetën e këtyre të sëmurëve. Ato janë **Trikafta** (elexacaftor/tezacaftor/ivacaftor), **Symdeko**

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

(tezacaftor/ivacaftor), (**Orcambi** lumacaftor/ ivacaftor) dhe **Kalydeco** (ivacaftor)

Në këtë prezantim do të paraqesim të dhënat mbi mutacionet e FK të zbuluara në të sëmurët e ndjekur në departamentin e Pediatriisë të QSUT, dhe do argumentojmë bazuar në fakte, që përdorimi i tyre në vendin tonë do jetë jo vetëm një sukses në trajtimi e këtyre të sëmurëve, por edhe një sukses i farmaceutikës dhe shëndetësisë në vendin tonë.

### KU JEMI DHE DREJT KUJT PO SHKOJMË NË MENAXHIMIN E HEMOGLOBINOPATIVE.

*Eleni Nastas<sup>1</sup>, Manika Kreka<sup>2</sup>, Evda Veveçka<sup>1</sup>*

*Universiteti "Barleti"<sup>1</sup> Universiteti i Mjekësisë Tiranë<sup>2</sup>*

Hyrje: Hemoglobinopatitë janë çrregullime të sintezës së hemoglobinës. Afërsisht 7% e popullsisë globale është mbartëse e këtij mutacioni njëgjenik.

Hemoglobinopatitë përmbledhin Drepanocitozën, Beta Talaseminë Major e Intermedia dhe Talaso- Drepanocitozën.

Shqipëria është një vend me endemicitet të lartë për çrregullimet e hemoglobinës. Drepanocitoza si çrregullim cilësor i sintezës së hemoglobinës, paraqet një kompleksitet manifestimesh klinike, jo gjithmonë e dominuar nga anemia kronike, por nga krizat e befta të vazo okluzionit. Episode të tilla mund të cojnë në fenomene iskemike, dhimbje e nekrozë organore. Beta Talasemia Major dhe Intermedia karakterizohet në shumicën e rasteve nga hemoliza kronike dhe nevoja e vazdueshme për transfuzione me masë eritrocitare.

Aktualisht janë sëmundje të rralla me origjinë njëgjenike në Evropë, por sot emigrimi ka sjellë shtim të numrit të individëve që vuajnë një

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

nga këto crregullime duke sjellë një problem të madh në shëndetin publik.

Në 30 vitet e fundit ka ndryshuar në mënyrë spektakolare jetëgjatësia e pacientëve me hemoglobinopati e jeta e tyre është bërë cilësisht më e mire. Dhe kjo falë trajtimeve shumëplanëshe , sidomos falë tipizimit të mirë të transfuzioneve të administruara nga pacientët ( masë eritrocitare ) sipas protokolleve standarde evropiane. Nga ana tjetër, terapia ferrokelante sot edhe orale, me tolerancë dhe efikasitet shumë të mirë në shumicën e rasteve, ka rritur mbijetesën dhe ka shmangur komplikacionet ( kjo kur administrohet si duhet me kompliancë të mirë nga pacienti).

Ende nuk flasim për shërim absolut nga hemoglobinopati. Quket i tille vetëm kur arrihet të realizohet për pacientin Transplanti i palcës Kockore ose Transplanti me qeliza Staminale(Burimore) nga donator i pajtueshëm sipas sistemit HLA. Statistikat sot raportojnë se numri i fataliteteve për subjektet adulte , edhe pse të transfuzionuar rregullisht është tre herë më i lartë se në grupin e individëve të paprekur nga këto crregullime , kjo për shkak të pasojave të mbingarkesës së hekurit të patrajtuar nga transfuzionet jetëshpëtuese.

Konkluzione: Pas Transfuzionit të gjakut, agjentët farmakologjikë (kelatorët) përbëjnë elementin bazë të rëndësishëm për të përmirësuar mbijetesën dhe cilësinë e jetës së pacientëve me talasemi e drepanocitozë. Era e kelatorëve të rinj, e cila ka filluar do të vijojë duke dhënë mundësinë për të qenë të personalizuar sipas moshës e faktorëve të tjerë , të dhënave të specifikimeve genomike etj.

Klasa e re në rritje e barnave e cila mund të reduktojë marrjen e RBC (masës eritrocitare pure red blood cell) duke minimizuar komplikimet e mbingarkesës së hekurit. Terapia genike do të jetë terapia shëruese për pacientët me Talasemi dhe hemoglobinopati të tjera.

Rekomandime:

Vëmendje duhet t'i kushtohet:

- Pabarazisë e cila ende shihet në popullsitë me të ardhura të pakta, ku përparësia duhet të jetë që pacienti të ketë akses në trajtimet ekzistuese të 'standardit të arte'.

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

- Qëndrueshmërisë së trajtimit në të gjitha vendet evropiane dhe jo evropiane. Në fakt qasja në trajtim ndikohet fuqishëm nga kostoja në rritje e trajtimeve novatore dhe jo rritja paralelisht e buxhetit për shëndetësinë.

***"Kënaqësia e standardit më të lartë të arritshëm të shëndetit është një nga të drejtat themelore e çdo qenieje njerëzore, pa dallim"***

## NUTRICIONI DHE JETËGJATËSIA

***Angela Andreoli***

*Assistent Professor of Human Physiology and Nutrition  
Catholic University UNIZKM Tirana and University Tor Vergata  
Rome*

*President Albanian Society Nutrition Science*

[angela.andreoli@uniroma2.it](mailto:angela.andreoli@uniroma2.it)

[a.andreoli@prof.unizkm.al](mailto:a.andreoli@prof.unizkm.al)

The average life expectancy of the world population has increased remarkably in the past 150 years and it is still increasing. Nutrition research has focused on recent decades more on food combination patterns than on individual foods/nutrients due to the possible synergistic/antagonistic effects of the components in a dietary model, Dominguez et al 2021.

Human nutrition, and the determination of what can be considered "ideal" nutrition, is a complex and multifaceted subject that engages many researchers and practitioners. The overall diet, which includes factors such as food composition, calorie intake, and the duration and frequency of fasting periods, plays a crucial role in influencing the duration of maintaining health and functional capacity. Recent studies

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

are uncovering the molecular impact of diet composition and fasting on the aging process.

Promoting longevity can be achieved through various methods; however, it is essential to optimize diet composition and levels to prevent malnourishment and frailty. This optimization should be personalized based on individual characteristics, including genome, adiposity, biological age range, sex, and health status. Body composition is a crucial aspect of maintaining overall health and longevity. It can be influenced by various factors, such as genetics, environment, and lifestyle choices. Assessing body composition is a fundamental tool for nutrition specialists to effectively evaluate nutritional status and monitor progress during dietary interventions. As humans age, there is a natural increase in fat mass accompanied by a gradual decline in lean mass, particularly in bone and muscle mass. Holmes et al. 2021.

Furthermore need to be considered the relationship between circadian timing, nutrition, aging, and longevity. They are a multifaceted interplay that significantly influences overall health. Understanding and optimizing this relationship can provide valuable insights into strategies for healthy aging and longevity.

Aligning dietary habits with circadian rhythms has the potential to optimize metabolic health, support cellular functions, and contribute to a more resilient and healthy aging process. Combining circadian-aligned nutrition with other lifestyle factors, such as sleep hygiene and physical activity, may form a comprehensive approach to promote longevity and well-being. Acosta-Rodríguez VA 2021  
Healthcare professionals, encompassing pharmacists and general practitioners, have the potential to positively influence health, nutrition, and longevity. By offering information, support, and counseling beyond the treatment of existing illnesses, they contribute to building a healthier and more resilient population in the long term. Pharmacists can provide basic nutritional counseling, offering advice on balanced diets, portion control, and healthy food choices. They can also recommend vitamin or mineral supplements if necessary.

**NDIKIMI I NDËRVEPRIMIT TË ELEMENTËVE  
USHQIMORË NË RISKUN PËR KANCER KOLOREKTAL**

*Bledar Kraja*

*Departamenti i Lëndëve Biomjekësore dhe Eksperimentale, Fakulteti  
i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë*

*Shërbimi Universitar i Gastrohepatologjisë, Qendra Spitalore  
Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë*

Hyrje: Elementë të ndryshëm ushqimorë janë konsideruar si faktorë risku për kancerin kolorektal (CRC); megjithatë, nëse yndyrnat e marra me ushqime e rrisin këtë risk është akoma i paqartë. Nga ana tjetër, ndikimi i acideve yndyrorë të marra me ushqime në riskun për CRC mund të modifikohet edhe nga prania e fibrave në dietë.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të analizojmë nëse marrja me ushqime e acideve yndyrorë shumë të pangopur (PUFA) apo acideve yndyrorë të ngopur (SFA) ndikon në riskun për CRC dhe nëse ky risk modifikohet nga marrja e fibrave.

Metoda: Ky studim është kryer me të dhëna të mbledhura nga *Rotterdam Study*, një studim prospektiv, në vazhdim, që ka filluar në vitet 1990-1993 dhe që vlerëson në mënyrë periodike sëmundshmërinë dhe faktorët e riskut në individët mbi 55 vjeç. Në studim u përfshinë 4,902 individë të cilëve iu mblodh informacion për mënyrën e ushqyerjes me anë të pyetësorit mbi frekuencën e konsumit të ushqimeve të caktuara (FFQ). Diagnoza e CRC u konfirmua nga ekzaminimi patologjik. Raportet e gjasave (HRs) u llogaritën nëpërmjet regresionit logjistik (Cox) duke përfshirë të gjithë ndryshorët.

Rezultate: Gjatë ndjekjes 24-vjeçare u identifikuan 218 raste me CRC. Nuk u gjet evidencë e lidhjes së PUFA, n-6 PUFA ose SFA me riskun për CRC, ndërsa n-3 PUFA shoqërohej më risk më të lartë për CRC (HR = 1.46, 95% CI=1.02-2.11 për 3<sup>rd</sup> tertile vs. 1<sup>st</sup> tertile). Nuk kishte evidencë për një ndërveprim statistiki të rëndësishëm mes PUFA, n-6 PUFA apo SFA me fibrat e marra në ushqime në riskun



## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

për CRC. Megjithatë, kishte evidencë të një ndërveprimi të fortë pozitiv mes n-3 PUFA dhe fibrave të marra në ushqime ( $P_{Interaction}=0.03$ ). Gjithashtu, marrja e n-3 PUFA shoqërohej me risk më të lartë për CRC në individët që merrnin sasi të vogël të fibrave në ushqime (HR = 2.01, 95% CI=1.24-3.45 for the 3<sup>rd</sup> tertile vs.1<sup>st</sup> tertile), ndërsa ky efekt nuk vihej re tek individët që merrnin sasi të madhe të fibrave.

Përfundime: Rezultatet e këtij studimi prospektiv sugjerojnë së marrja e n-3 PUFA është e shoqëruar me rritjen e riskut për CRC dhe ky risk mund të modifikohet nga marrja e fibrave në ushqime. Studime të mëtejshme janë të nevojshme për të vlerësuar se si faktorë të tjerë ushqimorë ose jo ushqimorë mund të modifikojnë këtë risk.

## **QASJA DIETISTIKE DHE INTEGRIMI SUPLEMENTATIV SI NJE STRATEGJI KUNDER PLAKJES**

### *Erida Teliti*

Qellimi i këtij presantimi është të bëjë të njohur strategjitë nutricionalë dhe dietike si një mënyrë e re qasjeje kundër plakjes, duke integruar dietën dhe terapinë dietike së bashku me nutraceutikën duke u nderthurur në mënyrë të targetuar dhe personalizuar me fokus qendror pacientin dhe shëndetin e tij. Në rastin e strategjisë anti-aging, pra kundër plakjes në i referohemi një vlersimi global të statusit nutricional si një metodikë të sigurt për terapi precise dhe të personalizuara.

Metoda e zgjedhur është një rishikim i literatures duke përdorur kerkime nga librari online të website-ve si PUBMED dhe USDA dhe abonime të revistave shkencore të lidhura me fushën.

Vitet e fundit literatura shkencore ja pesuar një hov duke vezhguar numrin e madh të botimeve për shkak të vemendjes që ka kjo çështje në ditët e sotme.

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

Ndërhyrja dietike është një strategji parandaluese e sigurt, me spektër të gjerë dhe me kosto të ulët për plakjen e ngadalhtë. Dietat Okinawan, Mesdhetare dhe dietat për të ndaluar hipertensionin (DASH), si dhe kufizimi i kalorive (CR) dhe agjërimi me ndërprerje (IF), janë modele dietike klasike dhe të besueshme që ngadalësojnë plakjen duke rregulluar rrugët e ndjeshmërisë së lëndëve ushqyese, mikrobiotën e zorrëve, metabolizmin dhe imunitetin. Për më tepër, proporcioni i tre makronutrientëve (karbohidratet, proteinat dhe yndyrat) është gjithashtu jetik për ngadalësimin e plakjes, por debatet rreth proporcionit të duhur, veçanërisht raporti i karbohidrateve dhe proteinave, mbeten të panjohura. Respektimi i rreptë dhe gjatë gjithë jetës ndaj këtyre regjimeve është i vështirë, duke nxitur kështu shfaqjen e shtesave të ndryshme dietike, duke përfshirë imituesit natyralë të CR, probiotikët, senolitikët natyralë, vitaminat dhe mineralet thelbësore. Kombinimet e modeleve të ndryshme dietike dhe suplementeve me rrugë të ndryshme mund të kenë efekte shtesë. Shpejtësia e plakjes dhe reagimi dietik i individëve janë shumë të ndryshueshme, duke nënvizuar kështu nevojën për ndërhyrje të saktë dietike kundër plakjes. Nutrigjenomika luan një rol të rëndësishëm në strategjitë dietike të personalizuara. Prandaj, ky argument krahason në mënyrë kritike fektet kundër plakjes së modeleve dhe suplementeve të ndryshme dietike, analizon mekanizmat e tyre dhe përdorimin e kombinuar, dhe propozon drejtime kërkimore në të ardhmen për të arritur strategji të personalizuara dietike për ngadalësimin e plakjes.

Perfundimet ne kete presantim jane te lidhura kryesisht me perpunimin e te dhenave te gjeneruara nga publikime te viteve te fundit ne kete fushe duke qene se kur flasim per strategji kunder plakjes flasim se pari per nje stil jete i cili duhet te sherbeje si nje mjet preventiv per semundje te lidhura me plakjen.

Plakja me rritjen e moshes mesatare te popullates eshte nje ceshtje qe sot trajtohet me nderhyrje te cilat kane kosto te shprehur nga ana ekonomike dhe me e rendeshimja ajo shendetsore.

**NDËRVEPRIMI MIDIS STRESIT OKSIDATIV, INDEKSIT  
TË MASËS TRUPORE (BMI) DHE PARAMETRAVE TË  
TJERË TË SHËNDETIT**

*Albana Daka*

Hyrje dhe qëllimi: Stresi oksidativ është pasojë e prishjes së ekuilibrit midis faktorëve oksidues dhe antioksidues brenda qelizave. Nëse zgjat në kohë mund të çojë potencialisht në dëmtim të shumë strukturave qelizore dhe rritje të riskut të shfaqjes të problematikave të ndryshme shëndetësore. Radikalet e lira prodhohen në pjesën më të madhe të qelizave në organizëm (mitokondri) gjatë reaksioneve metabolike. Antioksidantët kundërshtojnë / neutralizojnë formimin e këtyre radikalëve, duke frenuar dëmtimin oksidativ. Gjatë proceseve inflamatore makrofagët dhe granulocitet prodhojnë agjentë oksidues si Reactive Oxygen Species (ROS) dhe Reactive Nitrogen Species (RNS). Indeksi redoks reflekton ekuilibrin midis agjentëve oksidues si ROS dhe RNS dhe antioksidantëve.

Metodat: Një mostër e rastësishme prej 30 pacientësh u zgjodh nga një grup prej mbi 100 të testuar. Janë vëzhguar parametra të ndryshëm, duke përfshirë BMI, indeksi redoks, rezistenca ndaj insulinës dhe intolerancat ushqimore. Pacientët u kategorizuan në bazë të BMI-së së tyre në grupe me peshë normale, mbipeshë dhe obez. U analizua lidhja midis BMI dhe indeksit redoks (ekuilibri midis agjentëve oksidues dhe antioksidantëve) si dhe lidhja midis profileve të stresit oksidativ dhe rezistencës ndaj insulinës. Përveç kësaj, u ekzaminua lidhja midis indeksit redoks dhe intolerancave ushqimore.

Rezultatet: Ndër pacientët e përzgjedhur rastësisht, 10% kishin një BMI normal, ndërsa 40% ishin mbipeshë dhe 50% ishin obezë. Analiza e BMI-së dhe indeksit redoks zbuloi se pacientët me peshë normale i përkisnin kryesisht profileve A dhe B, ndërsa pacientët me mbipeshë dhe obezë kategorizoheshin kryesisht në profilin E. Për sa i përket profileve të stresit oksidativ dhe rezistencës ndaj insulinës, një pjesë e konsiderueshme e pacientëve me profilin E shfaqnin

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

rezistencë ndaj insulinës. Pacientët me indekse të larta redoks (profili E) treguan intolerancë ndaj mishit të gjedhit, kafesë dhe ushqimeve të lidhura me sheqerin.

Konkluzione: Rezultatet nënvizojnë lidhjen midis BMI-së, stresit oksidativ dhe parametrave shëndetësorë. Individët mbipeshë dhe obezë priren të kenë nivele më të larta të stresit oksidativ, duke kontribuar potencialisht dhe në rezistencën ndaj insulinës. Për më tepër, indekset e larta redoks shoqërohen me intolerancë specifike ushqimore, duke sugjeruar një lidhje midis stresit oksidativ dhe faktorëve dietikë. Këto njohuri theksojnë rëndësinë e menaxhimit të stresit oksidativ përmes ndërhyrjeve në stilin e jetës, duke përfshirë modifikimet e dietës, për të ulur rrezikun e shfaqjes së komplikimeve shëndetësore.

## VLERËSIM I SUPLEMENTEVE NË INFERTILITETIN

### MASHKULLOR

*Prof. Asoc. Enkelejda Goci<sup>1,2</sup>, Stelina Çekrezi<sup>1</sup>*

*<sup>1</sup>Qendra Kërkimore Farmakoterapeutike, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti Aldent*

*<sup>2</sup>Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë*

Hyrje: Steriliteti prek miliona njerëz të moshës riprodhuese në mbarë botën, me rreth 10-15% të çifteve të prekura dhe përbën një problem serioz të shëndetit publik. Përdorimi i shërbimeve të infertilitetit, përfshirë trajtimet farmakoterapeutike, është i përhapur dhe roli i farmacistit si pjesë e ekipit të kujdesit shëndetësor është thelbësor.

Suplementet dietike (DS) përfaqësojnë një qasje të mundshme për të përmirësuar parametrat e spermës dhe fertilitetin mashkullor. Aktualisht tregu farmaceutik ka në dispozicion një gamë të gjerë DS që përmbajnë lëndë ushqyese të ndryshme.

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

Qëllimi i këtij studimi është të parashtrijë rolin e farmacistit si hallkë e rëndësishme e përkujdesjes shëndetësore në fertilitetin mashkullor si dhe një vlerësim i suplementeve dietikë në tregun farmaceutik shqiptar.

Metodologjia: Studimi është mbështetur në kërkim të literaturës mbi infertilitetin mashkullor dhe rolin e farmacistit si dhe vlerësimin e përbërjes së Suplementeve Dietike (DS) në tregun farmaceutik shqiptar.

Rezultate: Nga kërkimi i literaturës shohim që mjaft autorë mbështesin rolin e farmacistit si hallkë e rëndësishme në ndihmesën e pacientëve duke ofruar edukim mbi shkaqet e infertilitetit, zbutjen e faktorëve të rrishtit, opsionet e trajtimit jofarmakologjik dhe farmakologjik, rolin e suplementeve dietikë në trajtimin e infertilitetit mashkullor etj.

Konkluzione Nga vlerësimi i suplementeve dietikë të tregut farmaceutik shqiptar shohim përmbajtje të tyre në përbërës aktiv, si: Zn, CoQ10, L-carnitin, Vit. E, Acid folik, etj, me potencial të njohur mbi përmirësimin e sterilitetit mashkullor.

### **SHTESAT USHQIMORE NË FOKUS: INTERFERENCAT NË SAKTËSINË E TESTEVE LABORATORIKE.**

#### ***Ilda Babamusta***

Hyrje dhe qëllimi: Në epokën e mjekësisë së personalizuar, integrimi i shtesave ushqimore në regjimet e përditshme shëndetësore paraqet një sfidë komplekse në diagnostikimin laboratorik. Përdorimi i gjerë i këtyre suplementeve në popullatë, duke filluar nga vitaminat dhe mineralet e deri te përbërjet bimore, ka çuar në shtimin e rasteve të interferencave në rezultatet e testeve laboratorike. Ky vëzhgim bazohet në eksperiencën tonë profesionale dhe literaturën më të fundit për të evidentuar shkallën e këtij ndikimi, duke synuar

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

ndërgjegjësimin e profesionistëve në përshtatje me praktikat e duhura laboratorike.

Materiale dhe Metodat: Ky studim është një analizë retrospektive mbi rastet e paraqitura në shërbimin ambulator dhe spitalor. Evidencat tona, pa përfshirjen e drejtpërdrejtë të pacientit, u integruan me të dhënat nga studime të publikuara vitet e fundit si dhe konsultimeve me ekspertë në mjekësinë laboratorike, farmakologjinë dhe nutricionin. Vëzhgimet tona nga përvoja klinike përfshijnë raste specifike të mospërputhjes të rezultateve laboratorike si pasojë e mbi apo keqpërdorimit të shtesave ushqimore. Kjo analizë multidimensionale thekson aplikimin e njohurive të përftuara nga literatura në përputhje me ekperiencat në praktikën e përditshme.

Rezultatet: Rezultatet e këtij vëzhgimi nënvizojnë ndikimin e rëndësishëm të suplementeve në testet laboratorike. Veçanërisht hulumtimet kanë evidentuar raste të interferencave që vijnë nga përdorimi në dozë të lartë të shtesave që janë apo kanë në përbajtje Biotinë (njohur si vitamina B7), në testet që përdorin metodën e biotin-streptavidinës (troponinë, TSH apo hormone të tjerë; ndikimi i dozave të larta të vitaminës C në saktësinë e niveleve të glukozës në gjak (metodat e glukozë oksidazës), testet e koagulimit apo nivelet e acidit urik etj; suplementet e hekurit në nivelet e sideremisë apo ferritinës, TIBC; suplementeve të Omega 3 në testet e koagulimit apo profilin e lipideve etj.

Konkluzione: Analiza jonë gjithëpërfshirëse nënvizon ndikimin e rëndësishëm dhe shpesh të nënvlerësuar të suplementeve në rezultatet e testeve laboratorike. Nevojitet gjithashtu ndërgjegjësim dhe një qasje bashkëpunuese midis pacientëve dhe profesionistëve të kujdesit shëndetsor për të evidentuar përdorimin e duhur të shtesave ushqimore dhe ndikimit të tyre para kryerjes të çdo testi laboratorik. Suplemente të veçanta si vitaminat apo dhe mineralet, mund të sjellin ndryshime të konsiderueshme dhe keqinterpretim të mundshëm në procesin e diagnostikimit. Hulumtimet tona të ardhshme synojnë përpilimin e udhëzimeve të standartizuara për mjekët, farmacistët por sidomos pacientët në ndihmë të interpretimit të duhur të ekzaminimeve laboratorike për diagnostikimin klinik sa më saktë.

**SHENDETI I MJEDISIT DHE AI HUMAN PERMES  
MENAXHIMIT TE MBETJEVE SHTAZORE**

<sup>1,2</sup> *Pecnikaj Ilir Ph.D.*

<sup>1</sup>*Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Rr Dibrës, Tiranë,*

<sup>2</sup>*AZ Group, Lagjia Skender Beu, Lezhë, Shqipëri*

Termi “One Health” ka të bëjë me promovimin se shëndeti i njerëzve dhe shëndeti i ekosistemit janë të lidhura pazgjidhshmërisht dhe kërkojnë qasje dhe përpjekje globale për të hartuar dhe zbatuar programe, politika, standarde dhe kërkime, që sektorë të ndryshëm të bashkëpunojnë për të arritur rezultate më të mira për përmirsimin e cilësisë së jetesës, si e tillë të shëndetin publik.

Qasja "One Health", e cila po krijohet gjithnjë e më shumë, është gjithashtu një strategji globale për zbatimin e bashkëpunimeve dhe komunikimit ndërdisiplinor në të gjitha aspektet e shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe mjedisit për të përmirësuar shëndetin e ekosistemit dhe të gjithë qenieve të gjalla.

Qëndrueshmëria, integrimi, ndërveprimi, varësia reciproke, bashkëpunimi nder disiplinorë janë përcaktuesit e qasjes One Health. Në këtë kontekst, bashkëpunimi ndërmjet profesionistëve duhet të bëhet në të gjitha nivelet, duke përfshirë edhe nivelin lokal, ku mund të përfaqësojë një skemë të re menaxhimi që kontribuon në bërjen e organizimit të sistemit shëndetësor efektiv dhe të qëndrueshëm.

Integrimi midis atyre që punojnë në botën mjekësore, veterinarë dhe mbrojtjen e mjedisit përbën, në fakt, një kërkesë thelbësore për aktivitetet parandaluese në luftën kundër zoonozave dhe sëmundjeve të tjera të cilat vijnë si pasojë e intoksikimit nga përdorimi i pa rregullt i mjedisit dhe shfrytëzimi pa kriter i tij.

Studimet e fundit të FAO-s tregojnë se bujqësia dhe blegtoaria janë ende baza e ekonomisë së shumë vendeve në zhvillim sot. Statistikat e përditësuara tregojnë gjithashtu se konsumi i mishit për frymë është

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

rritur më shumë se dy herë në dekadat e fundit, gjë e cila e cila kërkon rritjen e kërkesave për menazhimin e integruar të mbetjeve që rrjedhin prej tyre. Pra është shumë e rëndësishme sqarimi dhe ndergjegjësimi i popullatës për pasojat që rrjedhin nga keq menaxhimi i këtyre mbetjeve.

Ndotja që vjen nga një ton mbetje shtazore, vetëm si efektet e gazeve serrë, pa llogaritur ndotjet që vijnë si rezultat i intoksikomit të ujërave nëntokësore, është e barabartë me ndotjen që bëjnë 11.6 makina në një vit.

### METEOROPATIA DHE RREZIKU KARDIOVASKULAR

*Malvina Hoxha<sup>1\*</sup>, Hedie Haxhiu<sup>2,3</sup>, Bruno Zappacosta<sup>4</sup>*

*<sup>1</sup>Departamenti për Vlerësimin Kimiko–Toksikologjik dhe Farmakologjik të Barnave, Fakulteti i Farmacisë, Universiteti Katolik Zoja e Këshillit të Mirë, Rruga Dritan Hoxha, 1000 Tiranë, Shqipëri. [m.hoxha@unizkm.al](mailto:m.hoxha@unizkm.al)*

*<sup>2</sup>Farmaci Haxhiu, Vlorë, Shqipëri*

*<sup>3</sup>Qendra Mjekësore Haxhiu, Vlorë, Shqipëri*

*<sup>4</sup>Departamenti i Shkencave Biomjekësore, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti Katolik Zoja e Këshillit të Mirë, Tiranë, Shqipëri.*

Hyrje dhe Qëllimi: Meteoropatia, e konsideruar gjithashtu si një sëmundje e re që po rritet me shpejtësi, përfshin një sërë simptomash në përgjigje të ndryshimeve graduale ose të menjëhershme të motit (Hoxha M, 2023). Forma parësore e meteoropatisë prek njerëzit e shëndetshëm, ndërsa forma dytësore prek pacientët me sëmundje kronike, siç janë pacientët me sëmundje kardiovaskulare që mund të kenë një intensifikim të simptomave të tyre. Qëllimi kryesor i këtij studimi është vlerësimi i rrezikut kardiovaskular në pacientët me meteoropati.



## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

Materiale e Metoda: Pubmed dhe Scopus u përdorën si databazat kryesore për rishikimin sistematik të literaturës.

Rezultate: Rezultatet e studimeve evidentojnë lidhjen midis efekteve të përbashkëta të parametrave atmosferikë në sëmundjet akute kardiovaskulare dhe faktorëve kryesorë të rrezikut kardiovaskular (Kuzmenko et al., 2019). Një model i regresionit logjistik është krijuar për të llogaritur krizat e hipertensionit në pacientët me hipertension arterial me rrezik të shtuar të meteoropatisë (Terentjev et al., 2021). Të dhëna të tjera raportojnë lidhjen midis parametrave atmosferikë dhe hiperlipidemisë (Boussoussou et al., 2019). Duke konsideruar se vazodilatimi është pjesë e termoregullimit, por edhe një efekt anësor i diuretikëve, e cila mund të çojë në situata të rrezikshme, doza e diuretikëve apo e barnave të tjera antihipertensivë te pacientët meteoropatikë duhet studiuar më tej.

Përfundime: Pavarësisht diversitetit të të dhënave, studimet raportojnë një rritje të rrezikut kardiovaskular në pacientët meteoropatikë. Studime të mëtejshme duhen kryer tek pacientët me meteoropati në lidhje me efektin e parametrave të ndryshëm meteorologjikë (masa e ajrit, lagështia, shpejtësia e erës, presioni barometrik) në rrahjet e zemrës, presionin e gjakut dhe rrezikun kardiovaskular, si dhe në dozën dhe kohën e marrjes të barnave.

**REVOLUCIONI I KUJDESIT SHËNDETËSOR NË KUFIJTË  
E INOVACIONIT DHE TEKNOLOGJISË - NJË STUDIM I  
GJERË MBI PERSPEKTIVAT E PROFESIONISTËVE TË  
SHËNDETIT**

*Ina Pasho<sup>1</sup>, Erjona Pasho<sup>2</sup>*

*<sup>1</sup>Novartis Pharma Albania/Kosovo/North Macedonia*

*<sup>2</sup>Meilwald Pharmacy, Konrad-Zuse-Straße 14, Erlangen*

Hyrje dhe qëllimi: Kujdesi shëndetësor përballet me një nevojë të vazhdueshme për t'u zhvilluar, në përmbushje të nevojave të pacientëve dhe ofruesve të shërbimit shëndetësor. Për të përmbushur këto nevoja, shihet thelbësor inovacioni në fushën e kujdesit shëndetësor.

Inovacioni i kujdesit shëndetësor përfshin, identifikimin dhe zgjidhjen e sfidave dhe nevojave të kujdesit shëndetësor, gjetjen e metodave të reja dhe efektive për të parandaluar, diagnostikuar dhe trajtuar sëmundjet, si dhe përmirësuar aksesin ndaj shërbimeve shëndetësore.

Materiali e metoda: Studimi ynë, ka për qëllim shqyrtimin e perspektivave dhe qëndrimeve të profesionistëve të shëndetit, lidhur me revolucionin e kujdesit shëndetësor. Ne zhvilluam një studim vëzhgues, deskriptiv, kros-seksional nëpërmjet një sondazhi online, drejtuar profesionistëve të shëndetit që operojnë në fusha të ndryshme të sektorit shëndetësor. Qëllimi ynë ishte trajtimi i disa aspekteve lidhur me inovacionin, dhe se si perceptohen ato nga profesionistët e shëndetit, ku përmendim.: njohuritë e tyre lidhur me inovacionet më të fundit në shëndetësi, ndikimin e inovacionit në cilësinë e kujdesit shëndetësor; grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave shëndetësore nëpërmjet Inteligjencës Artificiale; delegimi i procedurave klinike te mjetet teknologjike, ndikimi dhe avantazhet, si dhe predispozicioni dhe mundësia e tyre për ti aplikuar në praktikën e përditshme.

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

Rezultate: Nga përpunimi i të dhënave të grumbulluara, në aspektin e inovacioneve shëndetësore, rezultatet tregojnë se imunoterapia (45,8%) dhe sequencimi gjenetik (32,1%), përbëjnë pjesën më intriguese për profesionistët e shëndetit. Bashkëpunimi midis akademisë dhe industrisë, vlerësohet si shumë i rëndësishëm nga 63.5% e të intervistuarve dhe si sfida më të rëndësishme, në zhvillimin e inovacioneve të reja shëndetësore nëpërmjet këtij partneriteti, shumica sheh përkthimin e kërkimit akademik në produkte farmaceutike (65,1%). Të intervistuarit shprehën shqetësime, lidhur me përdorimin dhe adaptimin e teknologjive të reja shëndetësore në praktikën e tyre të përditshme, ku mungesa e trajnimeve ka peshën më të madhe (71.7%), dhe për këtë arsye ata preferojnë, që edukimi dhe shpërndarja e informacionit, lidhur me këtë fushë, të zhvillohet kryesisht nëpërmjet aktiviteteve të drejtpërdrejta dhe konferencave shkencore (49%).

Përfundime: Kjo analizë, na ofron një pamje holistike të perspektivave dhe qëndrimeve të profesionistëve të shëndetit në Shqipëri, lidhur me inovacionin në kujdesin shëndetësor dhe evidenton rëndësinë në përmirësimin e cilësisë së kujdesit shëndetësor. Shqetësimet e profesionistëve lidhur me përdorimin e teknologjive të reja, tregojnë nevojën për trajnime dhe edukim të vazhdueshëm. Ky studim kontribuon në kuptimin e thellë të nevojave, sfidave dhe mundësive të implementimit të inovacionit, në kujdesin shëndetësor në vendin tonë.

**PREPARATET BIMORE NË TRAJTIMIN E SIMPTOMAVE  
TË MENOPAUSËS**

*Dr. Aida Keçi (Zaka)<sup>1</sup>, Dr. Ina Xhangoli<sup>2</sup>, Dr. Blerina Hasho<sup>3</sup>*

*<sup>1</sup>Department of Pharmacy, Faculty of Medical Sciences, Aldent University, Tiranë*

*<sup>2</sup>Department of Pharmacy, Faculty of Medical Sciences, Aldent University, Tiranë*

*<sup>3</sup>Department of Pharmacy, Faculty of Medical Sciences, Aldent University, Tiranë*

Hyrje: Menopauza është një proces fiziologjik i cili ndodh natyrshëm në shumicën e grave midis moshës 45 dhe 52 vjeç dhe karakterizohet nga ndryshimet në statusin hormonal dhe në ndërprerjen e ciklit menstrual. Më shumë se 85% e grave e përjetojnë me simptoma problematike, duke përfshirë afshe të nxehta, djersitje gjatë natës, shqetësime të gjumit, mosfunksionim seksual, çrregullime të humorit, shtim në peshë etj

Qëllimi: Ky studim ka për qëllim rishikimin e qasjes aktuale në lidhjen e terapive me bazë bimore, si një zgjidhje alternative, për lehtësimin dhe përmirësimin e simptomave të menopausës.

Metodat: Ky studim përmbushi objektivat nëpërmjet hulumtimit të literaturës nga databaza PubMed duke përdorur si kriter përfshirës studime internacionale të publikuara përgjatë pesë viteve të fundit, nga viti 2018 deri në 2023.

Rezultatet: Në menopauzës, ekuilibri hormonal në trup ndryshon në krahasim me moshën e mëparshme. Prodhimi i estradiolit dhe progesteronit reduktohet. Bazuar në efektet anësore të terapive hormonale, bimët mjekësore kanë paraqitur shumë interes në dekadat e fundit. Prania e fitoestrogjeneve dhe fitoprogesteroneve në bimët medicinale mund të lehtësojnë veçanërisht simptomat e menopauzës në sajë të mekanizmeve të tyre efektive të veprimit. Provat e deritanishme sugjerojnë se kohoshi i zi është i sigurt dhe efektiv për

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

reduktimin e simptomave të menopauzës, kryesisht ne reduktimin e afsheve të nxehta dhe të çrregullimeve të humorit. Ekstraktet e fitoestrogenit, duke përfshirë ushqimet e sojës dhe tërfillit të kuq, kanë një efekt minimal në simptomat e menopauzës, por kanë efekte pozitive shëndetësore në përqendrimet e lipideve plazmatike dhe mund të ulin rrezikun e sëmundjeve kardiovaskulare. Farat e linit karakterizohen nga vetitë antikancerogjene dhe antioksidante, të cilat zvogëlojnë ndjeshëm intensitetin e simptomave gjatë menopauzës.

**Përfundimi:** Bimët mjekësore mund të luajnë një rol të rëndësishëm në trajtimin e simptomave të menopauzës; megjithatë, kërkohen studime të mëtejshme për të mbështetur efikasitetin e tyre në trajtimin e mirëfilltë të menopauzës.

**Fjalë kyçe:** Menopauzë, afshe të nxehta, bimë mjekësore, pagjumësi, fitoestrogjene.

## ROLI I MIKOTOKSINAVE NË DEMENCË

*Hedie Haxhiu<sup>1,2\*</sup>, Malvina Hoxha<sup>3</sup>, Mariagrazia Abbasciano<sup>4,5</sup>, Bruno Zappacosta<sup>6</sup>, Giuseppina Avvantaggiato<sup>4</sup>, Domenico Tricarico<sup>5</sup>*

<sup>1</sup>Farmaci Haxhiu, Vlorë, Shqipëri; email: [hedie\\_haxhiu@hotmail.com](mailto:hedie_haxhiu@hotmail.com)

<sup>2</sup>Qendra Mjekësore Haxhiu, Vlorë, Shqipëri

<sup>3</sup>Departamenti për Vlerësimin Kimiko-Toksikologjik dhe Farmakologjik të Barnave, Fakulteti i Farmacisë, Universiteti

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

*Katolik Zoja e Këshillit të Mirë, Rruga Dritan Hoxha, 1000 Tiranë, Shqipëri.*

<sup>4</sup>*Instituti i Shkencave të Prodhimit të Ushqimit (ISPA), Këshilli Kombëtar i Kërkimeve (CNR), Via Amendola, 70126 Bari, Itali.*

<sup>5</sup>*Departamenti i Farmacisë-Shkencave Farmaceutike, Universiteti i Barit Aldo Moro, 70125 Bari, Itali.*

<sup>6</sup>*Departamenti i Shkencave Biomjekësore, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti Katolik Zoja e Këshillit të Mirë, Tiranë, Shqipëri.*

Hyrje dhe Qëllimi: Demenca është një sëmundje neurodegenerative që karakterizohet nga degjenerimi i parikuperueshëm i aftësive të të mësuarit, kujtesës, mendimit dhe çon në rënien e funksioneve të trurit. Mikotoksinat, metabolitë të prodhuar nga kërpudhat të cilat gjenden ne ushqime, janë shkaktarë të sëmundjeve të ndryshme tek njerëzit dhe kafshët. Për shkak të efekteve të tyre toksike në organizëm, kufijtë maksimal të mikotoksinave në ushqime përcaktohen në nivel Europian. Qëllimi kryesor i këtij studimi është të evidentojë dhe analizojë të gjitha të dhënat e studimeve të kryera aktualisht për lidhjen midis demencës dhe nivelit të mikotoksinave.

Materiale e Metoda: Të gjitha studimet përkatëse nga databazat kryesore u analizuan në përputhje me kriteret e përshtatshmërisë.

Rezultate: Efekti negativ i mikotoksinave, si derivate kërpudhore në forma të ndryshme të demencës si në sëmundjen e Azhaimerit është raportuar në disa studime (Izco et al., 2021; Arce-López et al., 2021). Ekspozimi ndaj mikotoksinave ndërmjet inhalimit në ambiente me myk, mendohet të jetë një nga shkaktarët e Alzheimerit (Chang et al., 2019). Për më tepër, përfshirja e mikotoksinave prezente në ushqime në homeostazën beta-amiloide mund të jetë një faktor i rëndësishëm në procesin neurodegjernativ tek pacientët me Alzheimer (Arce-López et al., 2021). Studime të tjera të kryera si *in vitro* dhe tek njerëzit evidentojnë përfshirjen e mikotoksinës okratoksinës A (OTA) në sëmundjen e Parkinsonit.

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

Përfundime: Studimet aktuale evidentojnë përfshirjen e mikotoksinave në Alzheimer dhe Parkinson. Pavarësisht numrit të kufizuar të të dhënave për përfshirjen e sterigmatocistinës (STER) në Parkinson, studime të mëtejshme duhen kryer për të analizuar nëse nivelet e larta plazmatike të STER-it luajnë një rol specifik vecanërisht në fisiopatologjinë e Parkinsonit. Për më tepër, hulumtimet në popullata të ndryshme në lidhje me efektet e llojeve të ndryshme të mikotoksinave në demencë duhen konsideruar si një prioritet i shëndetit publik.

### **PËRDORIMI I FITOTERAPISË NË MOSHËN PEDIATRIKE.**

#### **SIGURIA DHE ROLI I FARMACISTIT**

*Ela Bebeçi<sup>1</sup>, Vilma Papajani<sup>2</sup>, Rezarta Shkreli<sup>1</sup>*

*<sup>1</sup>Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti ALDENT, Tiranë*

*<sup>2</sup>Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë*

Hyrja dhe qëllimi: Në ditët e sotme konsiderimi i bimëve dhe preparateve bimore si të sigurta dhe pa efekte anësore ka rritur shumë prevalencën e përdorimit të tyre sidomos në grupëmosha të caktuara të popullatës. Sipas studimeve të paraqitura në literaturë ka rezultuar se përdorimi i barnave bimore te fëmijët në vende të zhvilluara si Gjermania është 85.5 %. Duke qënë se informacioni që disponohet mbi efikasitetin dhe sigurinë e preparateve bimore paraqitet i kufizuar dhe i pamjaftueshëm, përdorimi i fitoterapisë në popullatën pediatrike ngre çështje të rëndësishme të lidhura me përdorimin racional si dhe me efektet e padëshiruara që shkaktohen nga to. Pjesa më e madhe e

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

efekteve të padëshiruara të raportuara gjatë përdorimit të preparateve bimore janë rezultat jo vetëm i cilësisë së dobët të tyre por edhe përdorimit të papërshtatshëm, i cili në shumicën e rasteve rezulton nga marrja pa aprovimin dhe këshillat e profesionistit të shëndetit. Qëllimi i këtij punimi është jo vetëm njohja me prevalencën e përdorimit të fitoterapisë në moshën pediatrike në vende të ndryshme të Botës dhe identifikimi i bimëve dhe fitopreparateve të sigurta në këtë moshë, por gjithashtu edhe vënia në dukje e rëndësisë së përdorimit të sigurt të tyre si dhe ndërgjegjësimi i farmacistëve mbi rëndësinë e këshillimit të pacientëve mbi këtë përdorim.

Materiale dhe metoda: Të dhënat janë marrë nga kërkimet në literaturë duke përdorur MEDLINE dhe referenca nga artikuj të revistave të viteve të fundit.

Rezultatet: Duke qenë se përdorimi i fitoterapisë nga moshja pediatrike vitet e fundit ka rezultuar të rritet është e rëndësishme që problematikat e lidhura me sigurinë e tyre të jenë gjithmonë në vëmendje të profesionistëve të shëndetit. Sipas studimeve ka rezultuar se shumë nga preparatet bimore që u jepen fëmijëve në disa shtete të Botës aktualisht nuk përmbushin standardet e praktikave të mira të prodhimit duke treguar kështu mungesën e studimeve për përcaktimin e efikasitetit të tyre. Përdorimi i preparateve bimore pa këshillën e profesionistit të shëndetit është një faktor tjetër i cili ndikon jo vetëm në efikasitetin jo të duhur por edhe në dhënien e efekteve të padëshiruara.

Përfundimet: Problematikat e lidhura me sigurinë e preparateve bimore në moshën pediatrike janë një çështje e rëndësishme për tu vënë në fokus. Informimi i duhur shkencor i farmacistit mbi fitopreparatet në këtë moshë, si dhe këshillimi i pacientëve ndikon në rritjen e sigurisë në përdorim dhe në reduktimin e efekteve të padëshiruara.

**Fjalët kyçe:** Fitoterapi, përdorim, siguri, pediatri, farmacist.



**ROLI I NJË STILI JETE TË SHËNDETSHËM NË  
PACIENTIN DIABETIK**

*Paola Zoga, Suela Këlliçi*

*Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë, UMT*

**Hyrje:** Termi diabet mellitus përshkruan një çrregullim metabolik të karakterizuar nga hiperglicemia kronike.

Diabeti është një sëmundje që po njih gjithmonë e më shumë rritje në popullatë dhe përbën një kërcënim serioz për shëndetin e njerëzimit. Trajtimi i diabetit është një kombinim i terapive medikamentoze me një stil jetese të shëndetshëm. Qasja e pacientit ndaj trajtimit është vendimtare për kontrollin e sëmundjes.

**Qëllimi i studimit:** Qëllimi i studimit është të evidentojë qasjen e pacientëve shqiptarë që vuajnë nga diabeti ndaj terapisë së kësaj sëmundjeje.

**Metoda:** Studimi është bazuar në plotësimin e një pyetëtori të strukturuar nga ana e pacientëve diabetik në Shqipëri (kryesisht Tiranë dhe Berat). Pyetjet e përfshira synonin grumbullimin e informacionit mbi: të dhënat demografike, njohuritë e pacientëve mbi sëmundjen, praktikat alternative të menaxhimit të sëmundjes dhe aksesin në kujdesin mjekësor.

Pyetëtori është administruar në mënyrë personale nga pacientët, të cilët kanë pranuar vullnetarisht përfshirjen në studim. Të dhënat janë mbledhur në periudhën maj-shtator 2023.

**Rezultate:** Në pacientët pjesëmarrës në studim dominojnë pacientët e diagnostikuar me diabet mellitus tipi 2 (60%). 81% prej tyre marrin trajtim medikamentoz për diabetin pavarësisht se 78% e pacientëve ndjekin një dietë ushqimore, 50% e tyre marrin suplemente shtesë dhe 70% e pacientëve kryejnë aktivitet fizik rregullisht. Vlen të theksojmë se 88% e pacientëve e vlerësojnë diabetin si një sëmundje serioze ama nga ana tjetër 93% e tyre pohojnë dhe besojnë se mund ta mbajnë nën kontroll atë.

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

Konkluzione: Dieta ushqimore e kontrolluar, suplementet shtesë dhe aktiviteti fizik nuk e kanë zëvendësuar trajtimin medikamentoz por mund të ndihmojnë në menaxhimin dhe trajtimin sa më të mirë të diabetit. Informacioni i duhur dhe qasja korrekte ndaj trajtimit të diabetit mund të shihet si një strategji e mirë për mbajtjen nën kontroll të sëmundjes.

### **PREPARATET ME BAZË BIMORE NË SHTATZËNI; DISA ASPEKTE MBI PËRDORIMIN E SIGURT TË TYRE**

*Klea Ibi, Vilma Papajani*

*Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë Tirane.*

Përdorimi i preparateve me bazë bimore për menaxhimin e disa problematikave shëndetësore që mund të shfaqen gjatë shtatzënisë, është gjithnjë e më i shpeshtë në vitet e fundit. Nga ana tjetër po i kushtohet vëmendje studimeve mbi sigurinë gjatë aplikimit të tyre. Në literaturën shkencore bashkëkohore janë evidentuar disa bimë mjekësore dhe përgatës të tyre, të cilat nuk këshillohet të përdoren gjatë shtatzënisë.

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

Qëllimi: Evidentimi i përdorimit të preparateve me bazë bimore nga gratë shtatzëna në vendin tonë, me fokus në indikacionet për të cilat ato përdoren dhe sigurinë gjatë aplikimit të tyre.

Materiale dhe Metoda: Mbledhja e të dhënave u krye nëpërmjet një formulari të strukturuar të shpërndarë online gjatë periudhës Mars-Qershor 2023, adresuar farmacistëve të punësuar në farmacitë e rrjetit të hapur në disa qytete si Korçë, Pogradec, Tiranë. Formulari përmbante 13 pyetje, ndërmjet të cilave synohej evidentimi i preparateve me bazë bimore më të kërkuara nga gratë shtatzënë në farmacitë e rrjetit të hapur, çrregullimet shëndetësore për të cilat ato përdoren, efektet anësore të mundshme etj. Të dhënat e përftuara u krahasuan me ato të paraqitura në evidencat fitoterapeutike shkencore bashkëkohore.

Rezultatet: Nga përpunimi i të dhënave, rezultoi se kërkesat për përdorimin e preparateve me bazë bimore nga gratë shtatzëna në farmacitë e rrjetit të hapur në Shqipëri janë të shumta (65%), nga të cilat pjesa më e madhe (45%) rekomandoheshin nga mjeku/farmacisti/infermieri. Disa nga indikacionet për të cilat përdoren më së shumti janë: trajtimi i të përzierave (25% e farmacistëve), trajtimi i infeksioneve urinare (20%), trajtimi i simptomave gripale (20%). Shumica e farmacistëve pjesëmarrës në pyetësor (95%), u përgjigjën se nuk kishin raportime nga gra shtatzëna mbi efekte anësore gjatë përdorimit të preparateve me bazë bimore.

Përfundime: Nga rezultatet e mbledhura nga studimi rezultoi se xhinxheri, menteja, boronica e kuqe, hudhra, eukalpti, çaji jeshil ishin bimët më të përdorura për të menaxhuar problematikat shëndetësore më të shpeshta që shfaqen gjatë shtatzënisë. Farmacisti ka rol të rëndësishëm në informimin dhe këshillimin e grave shtatzëna për një përdorim sa më të sigurt të preparateve me bazë bimore gjatë periudhës së shtatzënisë.

**IMPAKTI I MIKROBIOMËS NË SISTEMIN NERVOR  
QËNDROR DHE NË PATOGJENEZËN E SËMUDJEVE  
NEURODEGJENERATIVE**

*MSc. Rojula Gjuzi<sup>1</sup>, Dr. Eftiola Pojani<sup>2</sup>, Prof. Asoc. Silvi Bozo<sup>2</sup>*

<sup>1</sup> *Farmaciste*

<sup>2</sup> *Departamenti i Teknologjive Kimiko-Farmaceutike dhe Biomolekulare, Fakulteti i Farmacisë, Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë"*

Hyrje: Përkufizimi më i përshtatshëm dhe i afërt i lidhur me funksionet e shumëfishta të mikrobiomës, e përcakton këtë term jo vetëm si bashkësinë e mikroorganizmave të gjallë por edhe si tërësinë e elementëve strukturore, metabolitëve apo molekulave sinjale të prodhuar prej tyre, duke mos harruar dhe kushtet e vetë mjedisit që ato kolonizojnë<sup>1,2</sup>. Studime të fundit kanë treguar që ruajtja e ekuilibrit dinamik të mikrobiomës, jo vetëm luan rol në mbarëvjetjen dhe mirë funksionimin e traktit gastrointestinal, por është i rëndësishëm gjithashtu në zhvillimin e sistemit nervor qendror duke përfaqësuar atë hallkë delikate disekulibri i të cilës shoqërohet me rrezikun e zhvillimit të çrregullimeve dhe sëmundjeve neurologjike<sup>3</sup>. Materialet dhe metodat: Në këtë studim do të analizohet roli i mikrobiomës në zhvillimin e sëmundjeve që prekin sistemin nervor qendror. Për të realizuar këtë studim është kryer një hulumtim i literaturës nga databazat elektronike (MEDLINE, PubMed) duke përdorur si kriter përfshirës studime rezultatet e cilave janë publikuar përgjatë katër viteve të fundit (2019-2023).

Rezultate: Pavarësisht kompleksitetit dhe mekanizmave ende të paekspoluara, zbulimi i ekzistencës së aksit mikrobiomë-zorrë-tru (MGB), si një sistem ndërlidhës mes sistemit nervor enterik dhe atij nervor, ka qenë thelbësor për të nxitur hulumtimet në këtë fushë. Disbioza intestinale kontribuon në zhvillimin e sëmundjeve neurologjike, duke prekur sekretimin e neurotransmetitorëve të tilla si Dopamina, Acetilkolina, të cilat së bashku me disa derivate të tjera të tyre prodhohen si rrjedhojë e veprimtarisë së enzimave të bakteleve në zorrë, duke u shndërruar për pasojë në faktor rreziku për zhvillimin e sëmundjeve neurodegenerative<sup>4</sup>. Për më tepër është vënë re se

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

mikroglija e aktivizuar shkakton shtimin e depozitimit të A $\beta$ , i cili është komponenti thelbësor në formimin e pllakave senile në pacientët me Alzheimer. Depozitimi i shtuar i A $\beta$ , nga ana tjetër nxit një proces proinflamator të vazhdueshëm i shoqëruar me rritje të rrezikut për të rënduar edhe më tej situatën klinike të këtyre pacientëve<sup>5</sup>.

Përfundime: Përpjekja për të kuptuar fuqinë e lidhjes mes mikrobiomës dhe zhvillimit të sëmundjeve neurologjike është thelbësore për të arritur në konkluzione që ofrojnë modele të reja për parandalimin dhe trajtimin e këtyre sëmundjeve. Në këtë kuadër lind nevoja për studime më të thelluara me qëllim analizën e impaktit të aksit MGB në nivel molekular.

**Fjalët kyçe:** mikrobioma, SNQ, sëmundje neurodegenerative, sistemi nervor enterik.

## RIMODELIMI I ACIDEVE YNDYRORE NË FETUS SI SHKAK I PREZENCËS SË DIABETIT MELLITUS GESTACIONAL

*Joana Sheno<sup>1</sup>, Dr. Eftiola Pojani<sup>2</sup>, Prof. Asoc. Silvi Bozo<sup>2</sup>*

<sup>1</sup> *Farmaciste*

<sup>2</sup> *Departamenti i Teknologjive Kimiko-Farmaceutike dhe Biomolekulare, Fakulteti i Farmacisë, Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë"*

Hyrje: Diabeti Mellitus Gestacional (DGM) përfaqëson një situatë metabolike komplekse e shoqëruar me pasoja për shëndetin e nënës dhe të fetusit<sup>1</sup>. Acidet yndyrore janë komponentë biomolekularë me rëndësi të veçantë në zhvillimin e fetusit, kjo falë rolit të tyre jo vetëm si burim energjetik, si elementë strukturorë apo edhe si rregullatorë të

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

faktorëve të transkriptimit. Studime të viteve të fundit kanë vënë në dukje se vecanërisht yndyrnat e pangopura duhet të vihen në dispozicion të fetusit, si struktura thelbësore në zhvillimin e duhur intrauterin dhe cerebral<sup>2</sup>.

Materialet dhe metodat: Në këtë studim do të analizohet ndërlidhja mes çrregullimeve metabolike të nënës dhe rimodelimit të acideve yndyrore të fetusit si pasojë e shfaqjes së diabetit gestacional. Për të realizuar këtë studim është kryer një hulumtim i literaturës nga databazat elektronike (MEDLINE, PubMed) duke përdorur si kriter përfshirës studime rezultatet e cilave janë publikuar përgjatë katër viteve të fundit (2019-2023).

Rezultate: Tek gratë e prekura me DGM, u vu re një ndryshim në shprehjen e gjeneve mARN placentare të lidhura ngushtësisht me metabolizmin dhe transportin e acideve yndyrore në fetus. Me specifikisht, rezultatet nga provat klinike treguan për një reduktim në shprehjen e proteinave placentare transportuese të acideve yndyrore (FATP1, FATP4) dhe një rritje e shprehjes së disa enzimeve të klasës së translokazave (FAT/CD36)<sup>3,4</sup>. Për më tepër, është vënë re gjithashtu një rritje e aktivitetit të lipoproteinë lipazave (LPL), rritje e përqëndrimit placentar të triglicerideve dhe kolesterolit dhe rritje e peshës së fëmijës në lindje<sup>5</sup>.

Përfundime: Roli i DGM është i lidhur dukshëm me çrregullime të metabolizmit të yndyrnave të fetusit, me potencial për tu shndërruar në faktor rreziku apo predispozues në zhvillimin e sëmundjeve që në afatgjatë prekin shëndetin e fëmijës. Nga ana tjetër, disa studime tregojnë se edhe mbipesha gjatë shtatzanisë po rikonsiderohet si faktor akoma më me influencë në nxitjen e profilit të modifikuar të transportit të yndyrnave në fetus sesa edhe vetë DGM.

**Fjalët kyçe:** acidet yndyrore, diabati gjestacional, fetusit, zhvillimi cerebral.

**EFEKTET POZITIVE TE PROBIOTIKEVE NE  
KONSTIPACIONIN TEK FEMIJET**

***Klarita Hoxhallari***

*Farmaciste, Universiteti i Mjekesise*

Hyrje: Probiotiket jane mikroorganizma te gjalla te cilat ndikojne direkt ne mikrobiomen e zorreve. Lindjet preterm, lindjet cezariane, perdorimi i antibiotikeve dhe kufizimi i gjidhenies kontribuojne ne nje sere semundjesh.

Qellimi i studimit: Studimi ka per qellim te vleresoje rolin e probiotikeve ne organizmin e femijeve. Probiotiku Lactobacillus Rhamnosus u studiuu per efektin ne trajtimin e kolikave, diarrese dhe konstipacionit. Gjithashtu perdorimi i laktobacilit Rhamnosus gjate shtatzenise se nenesh u pa ne reduktimin e simptomave te dermatitit te bebi.

Metodologjia: Studimi eshte rishikim literature qe u krye ne 7 baza te dhenash elektronike, Pubmed, Springer, Cochrane, Library, Ovid, Medline, PsycInfo. Artikujt e marre ne shqyrtim ishin ne gjuhen angleze. Ne studimin tone u perfshine studime te tipit rast kontrolli te cilat perfshine perdorimin e probiotikeve.

Konkluzionet: Laktobacili Rhamnosus i perdorur tek bebet qeteson kolikat, permireson diarrene, qeteson simptome, parandalon dermatitin atopik, parandalon alergjine nga proteinat e lopes.

**Fjalet kyçe:** probiotike, mikrobiome, Lactobacili Rhamnosus

**PREGABALINA NE NEUROPATI, RASTE KLINIKE**

*Dr. Shk. Ermir Roçi*

*Neurolog*

*Sherbimi i Stroke-Post stroke*

*QSU "Nene Tereza"*

Pregabalina është një bar anticonvulsant, analgjezik dhe anksiolitik. Paraqitet si GABA analog dhe këto e realizon me mekanizem indirekt duke bllokuar kanalet e Calciumit voltazh dependente. Indikacionet e këtij bari janë: epilepsia, dhimbja neuropatike, crregullimet e ankthit. Pregabalina absorbohet në intestine, ka një biodisponibilitet me të madh se 90%, nuk metabolizohet, ku 98% arrin në SNQ duke kaluar barrieren Hemato-encefalike, dhe eliminohet në urine. Gjëndet në formë capsule, tablet dhe solucion oral. Në dhimbjen neuropatike fillohet në doze 50mg q8h, me doze rritese deri në 300mg/d. Në epilepsinë fokale fillohet me 150mg/d q12h ose q8h në doze rritese deri në 600mg/d. Në crregullimet e ankthit të gjeneralizuar (GAD) doza fillestare është 150mg/d, rritet me 100mg/jave deri në dozen max 600mg/d. Profili i përgjithshëm i efekteve anësore të pregabalinës është i ngjashëm në të gjithë pacientët, me incidence të krahasueshme midis gjinive dhe të gjitha grupmoshave. Në dhimbjen nga neuropatia periferike refraktare, gjatë një analize prospektive 12 javore u vu re që pacientët që kaluan në terapi me pregabalinë, treguan ulje të konsiderueshme dhe klinikisht të rëndësishme të dhimbjes dhe simptomave të lidhura me të (p.sh. simptoma afektive dhe të lidhura me gjumin). Si monoterapi, pregabalina demonstron një efekt të rëndësishëm anksiolitik (HAM-A) që në javën e parë ndersa si terapi shtesë, nga pregabalina mund të përfitojnë pacientë me GAD të cilët nuk i përgjigjen në mënyrë adekuate një SSRI/SNRI si dhe arrin rezulate të dukshme brenda tete javëve nga fillimi i mjekimit.

Fjalë kyçe: Pregabalina, antikonvulsant, analgjezik,



**KONFERENCA MBARËKOMBËTARE  
FARMACEUTIKE VII “SË BASHKU PËR  
FARMACEUTIKËN”: FARMAKOEKONOMIA,  
UTILIZIMI I BARNAVE DHE SHKENCAT  
MJEKËSORE TË APLIKUARA NË  
FARMACEUTIKË**

## ADRESIMI I RISKUT KARDIO RENAL NË DIABET

### **It's More Than the Sugar Control**

*Prof. Myftar Barbullushi*

Sëmundja kardiovaskulare (CV) është shkaku kryesor i sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë në te semuret me diabet të tipit 2 (T2D), që rezulton nga shoqërimi dhe kontributi i mundshëm i shumë faktorëve të rrezikut, duke përfshirë edhe pse jo kufizuar në hipertensionin, dislipideminë, obezitetin dhe vetë diabetin. Përfitime të mëdha shihen kur faktorë të shumtë të rrezikut të CV trajtohen njëkohësisht.

Sëmundja diabetike e veshkave (DKD) shfaqet në 20-40% të pacientëve me diabet dhe është shkaku kryesor i sëmundjes së veshkave në fazën e fundit (ESKD) në SHBA. Diagnoza e saj bazohet kryesisht në praninë e vazhdueshme të albuminës në urine.(albuminuria), renja e filtrimit glomerular të veshkave (eGFR), ose të dyja. Pe me teper, prania e DKD në T2D ka një rol të rëndësishëm keqesues të problemeve CV, megjithëse shpesh neglizhohet nga klinikistët. DKD është një faktor i rëndësishëm kontribues në CV dhe vdekshmërinë nga të gjitha shkaqet, në një masë të tillë që mund të njihet si një faktor i rëndësishëm rreziku i sëmundjes koronare të zemrës. Prandaj, vdekjet e lidhura me komplikacionet vaskulare diabetike janë rritur ndjeshëm gjatë viteve 2000-2016, të nxitura kryesisht nga rritja e vdekshmërisë së komplikacioneve të veshkave.

Diabeti përcaktohet nga një status hiperglicemik: në mënyrë intuitive, kontrolli i glicemisë ka qenë prej kohësh edhe pse themelor për menaxhimin e diabetit për reduktimin e komplikimeve të diabetit. Kontrolli intensiv i glicemisë (IGC), me synimin për të arritur afër normoglicemisë, është treguar në studime të mëdha të randomizuara dhe prospektive se ai vonon fillimin dhe përparimin e DKD në pacientët me T2D. Nga ana tjetër, IGC rezultoi të ketë efekte të

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

diskutueshme në reduktimin e komplikimeve makrovaskulare që lidhen me T2D. Megjithëse është e vështirë të përcaktohet sasia e reduktimit absolut të rrezikut të komplikimeve renale, sepse hipoglikemia dhe polifarmacia e lidhur mund të kenë tejkaluar përfitimet e tyre të mundshme, megjithatë nivelet më të ulëta të HbA1c u shoqëruan me fillimin ose përparimin e reduktuar të DKD në tre IGT.

Rreziku kardiorrenal i mbetur nga ulja e glicemise është përcaktuar si rreziku i progresionit të ngjarjeve CV (MACE ose HF) dhe DKD që mbetet pas kontrollit optimal të glicemisë në T2D. Pavarësisht nga të gjitha përpjekjet dhe sakrificat e bëra nga pacientët dhe mjekët e tyre për të ndjekur një kontroll optimal të glicemisë, është mjaft zhgënjyese të pranosh përfitimet e kufizuara kardiorrenale të marra me IGC në T2D. Në dekadën e fundit, përdorimi i barnave më të reja dhe inovative për uljen e glukozës siguroi çuditërisht një reduktim të ndjeshëm në incidencën e ngjarjeve CV, duke sugjeruar mundësinë e mbrojtjes kardiorrenal përtej kontrollit të glicemisë. Meta-analizat e sprovave të rezultateve kardiovaskulare (CVOT) të raportuara deri më sot sugjerojnë që agonistët e receptorit të peptidit-1 të ngjashëm me glukagonin (GLP-1RA), frenuesit e transportuesit të natriumit të glukozës-2 (SGLT-2i) dhe bllokuesit e receptoreve të aldosteronit reduktojnë rrezikun e MACE aterosklerotike dhe ulin progresionin e demtimit të veshkave drejt dializes, në një nivel të rëndësishëm në pacientët me T2D.

**TARGET TERAPIA ME TKI, NJE REVOLUCION NE  
PROGRES NE TRAJTIMIN E LEUCEMISE MIELOIDE  
KRONIKE (LMC)**

*Prof. Polikron Pulluqi UMT*

Qellimi: Te tregohet qe njohja e biologjise molekulare dhe mekanizmit te lindjes dhe zhvillimit te semundjes krijon mundesine e trajtimeve te sukseseshme dhe racionale.

Objektivat: te tregohet cili eshte defekti genetik i lindjes dhe zhvillimit se LMC. Cila eshte target terapia (frenuesit e tyrozine kinazes (TKI) qe bllokojne pikerisht keto mekanizma te pathfiziologjise te semundjes. Efektiviteti i TKI, si remisioni citogenetik e molekular, jetegjatesia pa semundje, mbijetesia e pergjitheshme. Te tregojte cilat jane treguesit e remisioneve dhe te ndjekjes se semundjes.

Materiali dhe metoda Prezantimi do te jete nje permbledhje e shume punimeve te randomizuara e duple blind nga literatura si dhe nga pervoja shqiptare.

Diskutimi e perfundime

Leucemia mieloide kronike (LMC) ben pjesë në grupin e neoplazive mieloproliferative (NMP) ku qelizat mieloide shumohen në palcën e kockave në mënyrë të pakontrollueshme duke çuar në një numër të madh qelizash mieloide jo normale dhe të papjekura. Këto qeliza leucemike qe nuk funksionojnë siç duhet, grumbullohen e shtohen ne raport me qelizat e tjera duke mbushur palcën e kockave , e per rrjedhoje pengojnë palcën të prodhojë qeliza normale të gjakut.

Në qelizat mieloide te pacientëve me LMC, ekziston një anomali kromozomale e karakterizuar nga një transferim i materialit gjenetik midis krahëve të gjatë të kromozomeve 9 dhe 22. Ky translokacion sjell gjenin (BCR) nga zona e pikës së shkëputjes të kromozomit 22 në kontakt të afër me gjenin homolog të virusit Abelson (ABL) të kromozomit 9 dhe duke dhene një onkogjen hibrid BCR-ABL1. Kromozomi 22 i shkurtuar quhet kromozomi Filadelfia. Prania e kromozomit Philadelphia është damka diagnostike konfirmuese e

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

Ph+ LMC në gjithë jetën. Proteina BCR-ABL, e koduar nga geni hibrid, funksionon si një tirozinë kinazë onkogjene. BCR-ABL aktivizon disa rrugë sinjalizuese në qelizat leucemike që luajnë rol kritik në patogjenezën e Ph+LMC. Mbishprehja ose aktivizimi i vazhdueshëm i këtyre rrugëve çojnë në rritje drastike të proliferimit, mbijetesës dhe lëvizshmërisë, si dhe ulje të adezionit qelizor.

Frenimi i BCR-ABL qelizore me një TKI (inhibitorët e tyrozit kinazës) targetues si imatinib, nilotinib, dasatinib, busatinib, ponatinib etj. çon në frenimin e këtyre funksioneve protumorigjenike. Në prezantim do të tregohet që njohja e biologjisë molekulare, mekanizmi i lindjes dhe zhvillimit të sëmundjes, krijon mundësi të prodhimit të medikamenteve, target terapi shumë efektive; e cila ka arritur që LMC nga një sëmundje vdekjeprurëse për 3-5 vite, ta kthejë në një sëmundje ku jetegjatesia e përgjithshme e pacientëve me LMC të jetë e përafërt me jetegjatesinë në grup popullatën pa sëmundje. Mbijetesia 10 vjeçare pa sëmundje (PFS) e të sëmurëve me LMC nën trajtim me target terapi ishte 81%. Mbijetesia totale (overall survival) (OS) 10 vjeçare e pacientëve me LMC nën trajtim me TKI ishte 87%

OS mbas 10-vitesh me TKI ishte:

ekspozim ndaj 1 TKI), 100%  
ekspozim ndaj 2 TKI), 82%  
ekspozim ndaj 3 TKI), 87%  
ekspozim ndaj 4 TKI) 75%  
ekspozim ndaj 5 TKI) 55%).

OS ishte me e mirë të përcaktuar dhe u përgjigjen ndaj linjes I TKI

Disa TKI bëjnë që pacientët të fitojnë treatment-free remission.

**VITAMINA D DHE SEMUNDJET ALERGJIKE**

*Mehmet Hoxha, Ester Ndreu, Etleva Qirko*

Në vendet perëndimore, incidenca e atopisë dhe sëmundjeve alergjike është gjithnjë e më shumë në rritje; kjo si pasojë e shumë faktorëve si ndotja e ajrit, ekspozimi më i pakët ndaj mikrobeve dhe dieta. Një ndër këta faktorë është dhe vitamina D, roli i së cilës në homeostazën e kalciumit dhe fosfatit njihet mirë; megjithatë, përveç funksioneve tradicionale, vitamina D modulon një sërë procesesh, përfshi ato alergjike si astma, dermati atopik dhe alergjitë ushqimore. Ndër funksionet më të rëndësishme të saj është modulimi i përgjigjes së sistemit imunitar (të lindur dhe të fituar), përmes frenimit të përgjigjes Th2 dhe nxitjes së prodhimit të qelizave natural killer. Studimet e fundit kanë treguar që me pakësimin e niveleve të vitaminës D në serum, shtohen ekzacerbimet e astmës dhe hospitalizimet. Të dhënat eksperimentale sugjerojnë se vitamina D rrit potencialisht përgjigjen terapeutike ndaj glukokortikoideve dhe mund të përdoret si trajtim suplementar në pacientët rezistentë ndaj tyre. Është vënë re se niveli i ulët në gjak i vitaminës D përbën një faktor risku për alergjinë ushqimore, përmes rritjes së predispozitës për infeksione gastrointestinale dhe jo vetëm. Vitamina D është gjithashtu e lidhur ngushtësisht me dermatitin atopik, për shkak të përfshirjes drejtpërdrejt me dy proceset që qëndrojnë në thelb të tij: disfunksioni i barrierës epidermale dhe çrregullimi i përgjigjes imune. Të gjitha këto si edhe publikime të tjera që do të diskutohen më tej, theksojnë nevojën për studime dhe prova klinike që rreken të qartësojnë rolin e vitaminës D në parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve alergjike.

**EFEKTET ANESORE TE KEMIOPREPARATEVE NE  
MOSHAT PEDIATRIKE**

*Donjeta Alia (Bali)<sup>1,2</sup>, M. Kapllanaj<sup>1</sup>; E. Duka<sup>1</sup>; M. Xhafa<sup>1</sup>; A. Godo<sup>1,2</sup>.*

<sup>1</sup> *Sherbimi i Onkohematologjise Pediatrike-QSUNT*

<sup>2</sup> *Departamenti i Pediatrise- FM, UMT*

Hyrje: Kanceri ne femije eshte nje situatë deprimuese si ne rrafshin psiko-emocional ashtu edhe ne ate ekonomik. Prinderve u duhet te perballen me situata shpesh here duket e pazgjdheshme, mjeket onkopediater nga ana tjetër u duhet te perdorin te gjithë arsenalin terapeutik ne dispozicion. Dhe ky arsenal ne fakt nuk nenkupton vetem luften medikamentoze apo radioterapeutike ndaj neoplazise. Kemioterapia (CT) mund te perdoret ne modalitete te ndryshme si neoadjuvante apo adjuvante, terapi induksioni, mbajtese apo paliative.

*Qellimi: Te veme ne dukje efektet kryesor anesore te kemiopreparateve me te perdordshem ne Pediatri, si dhe te njohim me mire preparatet me te perdorshme si terapi suportit, ne rastet e ketyre efekteve.*

Megjithë shkallen e lart te suksesit qe buron prej perdorimit te tyre, ne mjaft raste ato behen shkas per komplikacione te tjera, nga intoleranca e organizmit te femijes. Kjo intolerance mund te manifestohet kliniksht ne forma te ndryshme, me prekje multiorganore dhe deri ne neoplazi sekondare prej perdorimit te saj. Kjo e shton stresin e trajtimit pasi njekohesisht me trajtimin, duhet te fillojme edhe terapine e suportit, qe ne fund te fundit eshte nje kosto shtese psikologjike(financiare dhe shpesh potencon toksicitetin e ketij organizmi te ri.

Onkohematologu pediater vendoset shpesh ne udhekryq, per te zgjedhur rrugen me te mire, duke peshuar perfitimet terapeutike, perkundrejt demeve shendetesore,qe mund te shkaktohen nga perdorimi i kemioterapise.

Materiali: Sfidat e shumta te Onkologjise Pediatrike, mbeten subjekt i preferuar i shume studimeve. Ne vemendje te vecante jane strategjite

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

terapeutike, me efektshmeri me te larte, me toksicitet te pranueshem, per jetegjatesi e jete me cilesore. Fale arritjeve te reja, ne fushen e imunologjise, histokimise, biologjise molekulare dhe asaj citogjenetike, po perpunohen e hartohen protokolle te reja, me qellim trajimin e kurimin perfundimtar.

Perfundime: Futja ne praktiken klinike te trajtimeve multimodale, mundesite per nje terapi suportu me te mire, kane shenuar nje permiresim te ndjeshem te prognozes se malinjiteteve pediatrike. Faktikisht sukseset terapeutike te arritura sot ne trajtimin e neoplazive pediatrike konsiderohen nder sukseset me te rendesishme te fushes se onkohematologjise pediatrike.

Njohja e mire e efekteve anesore te CT, si dhe te preparateve qe perdoren si terapi suportu, nga mjeket pediater, te te gjitha nenspecialiteteve, mjekeve te familjes si dhe farmacisteve ben te mundur minimizimin e demit te tyre ne organizem, shmang ne menyre te konsiderueshme semundje kronike apo invalidizuese qe ne fund te fundit perkthehen dhe ne nje barre me te vogel ekonomike per shoqerine e familjet.

Fjale kyçe: Onkohematologji pediatrike, kemiopreparate, toksicitet, cilesi jete.



**MELASMA, SFIDAT DHE RISITE NE TRAJTIM**

*Monika Fida<sup>1</sup>, Oljeda Kacani<sup>2</sup>, Alesia Palaj<sup>1</sup>, Ina Sotiri<sup>1</sup>*

*<sup>1</sup>Departamenti i Dermatologjise dhe Venerologjise, Qendra Spitalore Universitare “Nene Tereza”, Tirane.*

*<sup>2</sup>Klinika dermatologjike “A Derma”, Tirane.*

Hyrje: Melasma eshte nje çrregullim i pigmentimit shume sfidues ne trajtim per shkak te natyres refraktare dhe riskut te larte per rrekurrence. Melasma paraqitet si nje pigmentim ne ngjyre kafe, ne forme vatrash me kufij te qarte, kryesisht ne buzën e sipërme, hunde, faqe, mjeker dhe balle.

Qellimi: Te identifkohet etiologjia e melasmes, te percaktohet trajtimi i duhur dhe te menaxhohen efektet anesore. Sinteza e melanines ne melanosome dhe shperndarja e tyre ne keratinocyte percakton pigmentimin e lekures. Hiperpigmentimi ndodh kur ky system nuk funksionon sic duhet. Faktoret e implikuar ne zhvillimin e melasmes perfshijne: rrezatimin ultraviolet, çrregullimet hormonale, historia familjare, shtatzania, perdorimi i medikamenteve qe shkaktojne reaksione fototoksike etj. Plani i trajtimit konsiston ne eliminimin e faktoreve te riskut, mbrojtje strikte ndaj rrezatimit ultraviolet dhe trajtimit topical dhe sistemik. Kombinimi i trefishte i hydroquinone, tretinoine dhe fluocinolone acetonide mbetet nje nga trajtimet topikale me te perdorura dhe efikase ne pacientet me melasma. Trajtime te tjera topikale synojne inhibimin e stadeve ndryshme te patogjenezes se melasmes, sic jane acidi azelaic, acidi kojic, acidi glikolik, arbutin etj. Risite e reja ne menaxhimin e melasmes perfshijne edhe acidin tranexamik dhe exozomet.

Konkluzionet: Edukimi i pacientit eshte aspekti me i rendesishem ne regjimin trajtues te melasmes. Rezultatet maksimale ne trajtim jane vene re ne pacientet ne te cilet jane kombinuar disa trajtime si peeling kimik, mezoterapi, microneedling, IPL, dhe lazera te ndryshem.

Fjalet kyçe: melasma, trajtim topikal, peeling kimik, lazera.

**BARNAT E REJA NË ONKOLOGJI. OPTIMIZËM DHE  
PENGESA?**

*Bledi Kreka\*, Flutura Proko, Arvin Dibra, Manika Kreka*

*QSUT "Nënë Tereza" Tiranë  
Shërbimi i Onkologjisë*

Hyrje: Në vitet e fundit shihet një dritë jeshile në drejtim të kuptimit të mekanizmit diagnostik të shumë tumoreve duke sjellë optimizëm në modalitetet e trajtimit.

Terapi të reja të avancuara e të personalizuar duket që do të përmirësojnë e kanë përmirësuar të ardhmen e të sëmurëve me disa tumore malinje në drejtim të shtimit të mbijetesës së lirë nga sëmundja (progression free survival)

Studimet klinike në vazhdimësi, duket se po përmirësojnë trajtimin, duke pasur parasysh profilin genomik, duke rritur mundësinë e përdorimit të barnave orale kundrejt barnave kemioterapi standard venoze.

Metodologjia:

Janë studiuar të dhëna nga Website dhe Revista online për të vlerësuar situatën aktuale të trajtimeve onkologjike në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar.

Rezultatet: Trajtimet onkologjike përbëjnë afërsisht 40% në pipeline-in e barnave të zhvilluara gjatë 2022-2023. Afërsisht 2340 barna onkologjike janë aktualisht në studime klinike .

77% e trajtimeve përbëjnë trajtimet e targetuara të bazuara në një biomarker të parashikueshëm. Sëmundjet apo kanceret e rralla janë në fokusin e trajtimeve të tilla si : melanoma, kanceri renal, kanceri pulmonar ( disa tipe)

Megjithëse shkalla e miratimit të përgjithshëm të barnava është ende e ulët , në 7 vitet e fundit janë miratuar 62 barna të reja onkologjike në USA në 130 indikacione të ndryshme. Kanceret e rralla përbëjnë shumicën e barnave të miratuara, 16 të tilla morën emrin e orphan drug në 2022.

Një tjetër modalitet trajtimi, për të cilën janë miratuar barna, janë të quajturat tissue agnostic therapy. ( barnat që administrohen

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

pavarësisht nga prania e biomarker-ve të tumorit) Shembulli më tipik është Keytruda ( pembrolizumab) inhibitor imun që ndërhyt në proteinën PD-L1 dhe identifikon pacientët nëpërmjet kësaj protein pavarësisht ku është tumori. Që nga miratimi në 2014, tashmë është miratuar për 18 sëmundje onkologjike.

Një tjetër terapi inovative është vitrakvi ( larotrectinib) , por studime të tjera nevojiten. Fillimisht e miratuar nga FDA për trajtimin e tumoreve të shkaktuara nga NTRK, tashmë edhe për trajtimin e kancerit pulmonar, të tiroides dhe gastro-intestinal.

Përfundime: Kërkimi shkencor mbetet sfidë gjithmonë sidomos në fushën e onkologjisë. Rekrutimi i mjaftueshëm i pacientëve është mjaft i rëndësishëm për suksesin e një studimi klinik. Rezultatet nuk mund të kenë sinjifikancë nëse nuk përfshihen shumë pacientë, sidomos në rastin e e tumoreve të rralla. Kërkohet një kohë relativisht e gjatë për të mbledhur të dhëna sinjifikante. Megjithatë bashkëpunimi i farmaceutikës me mjekët klinicienë mbetet i rëndësishëm së vecantë.

### **GURËT NË VESHKA: EPIDEMIOLOGJIA, PATOFIZIOLOGJIA, IMPLIKIMET SISTEMIKE SI DHE STRATEGJITË TERAPEUTIKE**

*Prof. Asoc. Merita Rroji*

*Qendra Spitalore Univeristare” Nënë Tereza”, Sherbimi i Nefrologjisë, Tiranë.*

Hyrje: Nefrolitiazë, ose gurët në veshka, është një çështje shëndetësore në rritje që prek një spektër të gjerë të popullsisë globale, me një prevalencë të veçantë te meshkujt midis 20 dhe 49 vjeç. Gurët, të cilët përbëhen kryesisht nga kalciumi - si oksalat dhe fosfat kalciumi - dhe pasuar nga gurët e acidit urik dhe struvite, janë

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

rezultat i një sërë faktorësh rreziku si historitë personale dhe familjare, zakonet ushqimore, disa gjendje mjekësore dhe ndryshimet në përbërjen urinare.

Qëllimi: Ky referim synon të eksplorojë epidemiologjinë, patofiziologjinë dhe implikimet sistemike të nefrolitiazës, duke theksuar rëndësinë e një qasjeje multidisiplinare për trajtimin dhe parandalimin e saj. Veçanërisht, studimi shqyrton lidhjen midis nefrolitiazës dhe rrezikut të shtuar të sëmundjeve kronike të veshkave (SRK), sëmundjeve kardiovaskulare dhe ndikimit në densitetin mineral të kockave.

Metodologjia: U bë një analizë e thelluar e të dhënave ekzistuese dhe literaturës shkencore për të identifikuar shkaqet kryesore, proceset patofiziologjike dhe pasojat e nefrolitiazës. U morën në konsideratë studime të ndryshme që përfshijnë analizën e rrezikut të SRK, ngjarjeve kardiovaskulare dhe ndikimit në shëndetin e kockave të individët me histori të nefrolitiazës.

Rezultatet: Rezultatet tregojnë një lidhje të qartë midis formimit të gurëve në veshka dhe një rreziku të shtuar të zhvillimit të SRK, veçanërisht te pacientët që formojnë gurë struvite me gure koraliforme dhe pacientët me cistinuri. Po ashtu, u konstatua një rrezik i shtuar për ngjarje kardiovaskulare, përfshirë hipertensionin dhe infarktën e miokardit, si dhe një korrelacion i fortë midis nefrolitiazës dhe uljes së dendësisë minerale të kockave, që çon në një rrezik më të lartë për fraktura.

Përfundime: Evidencat konfirmojnë nevojën për një qasje të integruar dhe multidisiplinare ndaj menaxhimit dhe parandalimit të nefrolitiazës, duke përfshirë edukimin e pacientit për ndryshimet në stilin e jetesës dhe aderimin ndaj trajtimeve. Kjo thekson rëndësinë e njohjes së lidhjeve midis nefrolitiazës dhe pasojave të saj sistemike për të formuluar strategji më efektive parandaluese dhe terapeutike.

**NDËRHRYJA KORONARE PERKUTANE NË NJË PACIENT  
QË PREZANTOHET ME INFARKT INFERIOR TË  
MIOKARDIT DHE ORIGINË ANORMALE TË ARTERIES  
KRYESORE TË MAJTË NGA SINUSI KORONAR I  
DJATHTË**

*Taulant Gishto M.D., Arlind Dragoshi M.D., Leonard Simoni M.D.  
Asst. Prof., Naltin Shuka M.D. PhD.*

*Cardiology Department, University Hospital Center "Mother Teresa"  
Tirana, Albania.*

A 63-year-old male is hospitalized during an episode of NSTEMI and therefore he underwent Coronary Angiography which revealed Two-Vessel coronary artery disease and anomalous origin of Left Main Artery. Left Main Artery and Right Coronary Artery did both originate from right coronary sinus, but with separate ostia.

The patient underwent revascularization of Right Coronary Artery with balloon angioplasty and drug eluting stents.

Background: Coronary artery anomalies are discovered in less than 1% of angiography series. The most prevalent coronary anomaly among all patients receiving coronary angiography is anomalous origin of LCx from right sinus of Valsava (0.41%).<sup>[1,2,3,7]</sup> Other coronary artery anomalies include Left main originating from the right sinus of Valsalva (from the RCA or from a separate ostium) (0.02%); Anterior and unusually high origin of the RCA (0.18%) or RCA originating from the left sinus of Valsalva (0.13%) and coronary artery fistulas. In the case of Left Main artery originating from the right sinus of Valsava, the anomalous artery may take different courses approaching the left side of the heart.<sup>[1,2]</sup> Despite being rare, these anomalies can be life threatening depending on the course of the artery, and in the case of atherosclerotic disease present, revascularization strategy can be challenging.

Case Presentation: A 63-year-old male was admitted to Cardiology Unit following an episode of chest pain and elevation of cardiac enzymes. The patient had a several month history of retrosternal

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

squeezing pain, spreading on both arms and occurring during exertion and episodes of high blood pressure. Smoking history, hypertension and age were some of his risk factors. On physical examination, the patient was alert, in good general condition, with normal vital signs (Blood Pressure 125/70, Heart Rate 75 bpm, SpO<sub>2</sub> 97%, Temperature 36.5° Celsius). Pulmonary and cardiac examination was normal.

Rest ECG showed Sinus Rhythm, a Heart Rate of 75 bpm, Q waves and negative T waves on DII, DIII, aVF. On admission, laboratory tests revealed an elevated Troponin I level 0,170 ng/mL (normal range <0.034 ng/mL) 1 hour from the episode, and had an elevation to 0.530 ng/mL 6 hour from the episode. Complete Blood Count and Biochemistry Panel resulted in normal range.

Admission Echocardiography demonstrated hypokinesis of basal inferior wall, normal size and normal LV function (EF~0.58); mild left atrial dilation.

Based on clinical evaluation, cardiac ultrasound and laboratory tests, the patient was diagnosed as Non-ST-Elevation Myocardial Infarction (NSTEMI). Early reperfusion strategy was decided and he was referred to catheterization laboratory to undergo Coronary Angiography. Coronary Angiography revealed Two-Vessel coronary artery disease and anomalous origin of Left Main Artery. LMA and RCA did both originate from right coronary ostium.

The initial attempt to cannulate the left coronary ostium to assess for left anterior descending and circumflex disease failed. We decided shifting to Judkins Right catheter to engage the right coronary ostium, which revealed a dominant RCA and aberrant origin of Left Main from the right coronary sinus. The aberrant Left Main bifurcated into LAD and a hypoplastic Left Circumflex Artery (LCx).

There was a 99% stenotic lesion in mid RCA, meanwhile Left Anterior Descending Artery (LAD) had a stable 50% stenosis on its mid segment. Despite Left Main's anomalous course, the acute presentation of the patient was related to RCA being the culprit, and unrelated to the aberrant vessel.

The challenging part of revascularization strategy was partly choosing the correct guiding catheter to avoid ischemia of Left Main during the procedure and mainly being careful during manipulation,

because any complication at the area of right coronary ostium could cause fatal consequences to the patient.

The patient underwent a challenging but successful revascularization of RCA with balloon angioplasty and drug eluting stents. Using a Judgkins Right 3.5 guiding catheter, RCA lesion was predilated, and 3 Drug Eluting Stents (DES) were deployed successfully. The angiographic result was satisfactory, with TIMI III flow distally.

**“HEMOALB”- NJE STUDIM RETROSPEKTIV I  
PACIENTEVE HEMOFILIKE NE SHQIPERI**

***Bledi Kalaja<sup>1</sup>, Mirela Xhafa<sup>2</sup>, Daniela Nika<sup>2</sup>, Elizana Petrela<sup>3</sup>***

<sup>1</sup> *Qendra Spitalore Universitare Nene Tereza, Qendra Kombetare e Hemofilise, Tiranë, Shqipëri*

<sup>2</sup> *Qendra Spitalore Universitare Nene Tereza, Qendra Kombetare e Hemofilise, Tiranë, Shqipëri*

<sup>2</sup> *Qendra Spitalore Universitare Nene Tereza, Departmenti i Onko-Hematologjise, Tiranë, Shqipëri*

<sup>3</sup> *Qendra Spitalore Universitare Nene Tereza, Departamenti i Statistikes, Tiranë, Shqipëri*

*email kontakti : bledi\_kalaja@yahoo.com*

Hyrje: Hemofilia A është një patologji gjenetike e trashëgueshme nëpërmjet kromozomit X, në mënyrë recesive të një difekti në informacionin për prodhimin e faktorit tetë të koagulimit të gjakut. Klinikisht kjo shfaqet kryesisht tek meshkujt me fenomene hemorragjike në vende të ndryshme të organizmit nga të cilat më të prekura nga kjo patologji janë artikulacionet, sidomos ato të mëdha. Femrat mund të jenë mbartëse të këtij informacioni të demtuar, por që nuk e shfaqin atë klinikisht.

Hemofilia A mund të klasifikohet në lidhje me nivelin e deficietit të faktorit tetë të koagulimit në tre gradë:

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

Hemofilia A, forma e rëndë (me nivel të faktorit tetë <1%) (Norma 50-150%)

Hemofilia A, forma e mesme (me nivel të faktorit tetë 1-5%)

Hemofilia A, forma e lehtë (me nivel faktori 5-40%)

Kjo është një patologji e cila e shoqëron pacientin gjatë gjithë jetës së tij dhe për këtë arsye është me vlerë të kemi të dhëna në kohë reale për gjendjen dhe trajtimin e këtyre pacientëve për të bërë një menaxhim sa më efikas klinik.

Metodologjia: Studimi u fokusua në një analizim retrospektiv të të dhënave klinike, laboratorike dhe skemave të mjekimit për pacientet me hemofili A për vitet 2018-2019.

Në studim janë përfshirë të dhëna sipas kriterëve të mëposhtme:

-Pacientët e diagnostikuar me hemofili A

-Pacientët me/pa inhibitorë në hemofili A

-Pacientët e diagnostikuar në çfarëdo moshe por që kanë të dhëna për vitet 2018-2019

-Pacientët me hemofili A format e rënda, të mesme dhe të lehta.

Të dhënat për studim janë marrë nga kartelat individuale të çdo patienti dhe nga regjistri i pacientëve me hemofili dhe janë përpunuar elektronikisht.

Rezultate dhe Përfundime: Eshte hera e parë që realizohet një pasqyrim i këtyre të dhënave për pacientët me hemofili, një sëmundje kjo gjenetike dhe e rrallë.

Në total janë përfshire 179 raste me Hemofili A. Nga keta 78% janë adultë (>18 vjeç) dhe 22% jane fëmije.

ABR ( annual bleeding rate- shkalla vjetore e gjakrrjedhjeve) mesatar në vitin 2018 llogaritet 5.43+4.82, ndërsa në vitin 2019, vlera mesatare e ABR llogaritet 6.21+4.62.

Synimi i ketij prezantimi është të paraqesë të detajuara pasqyrën e këtij studimi dhe rekomandimet që lindin për trajtimin sa më efikas të popullatës hemofilike ne Shqipëri, me nje fokus te veçantë në terapitë e reja dhe nevojën për profilaksi në trajtimin e hemofilisë.

**Fjale kyçe:** Hemofili A, ABR, profilaksi, faktor VIII, fenomen hemorragjik, terapi



**PËRSHKRIMI 'OFF-LABEL' I BARNAVE NË  
KËNDVËSHTRIMIN E PROFESIONISTËVE TË  
SHËNDETËSISË**

**Understanding Off-label Practice from Health Care  
Professionals' Perspective**

*Fabiola Noga, Prof. Asoc. Dr. Ela Hoti*

*Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i  
Mjekësisë Tiranë*

Hyrja dhe Qëllimi: Përshkrimi i barnave në mënyrë 'off-label' është një praktikë e shpeshtë në shumë specialitete mjekësore, por me një prevalencë më të lartë në pediatri, neurologji, onkologji, obstetrikë dhe në fushën e patologjive të rralla. Pavarësisht se përshkrimi 'off-label' konsiderohet si një mjet i domosdoshëm për të përmbushur nevojat specifike të pacientëve, përshkrimi i barit jashtë kushteve të specifikuar në përmbledhjen e karakteristikave të produktit mund t'i ekspozojë pacientët në një situatë ku raporti benefit/risk nuk është shumë i favorshëm për ta. Studime të shumta janë realizuar për të kuptuar fenomenin 'off-label' duke patur në fokus aspektin klinik, aspektin ligjor si dhe perceptimin e profesionistëve të shëndetësisë lidhur me këtë praktikë komplekse. Duke njohur rolin kryesor të profesionistëve të shëndetësisë në kujdesin ndaj pacientit, eksplorimi i këndvështrimit dhe eksperiencave të tyre lidhur me procesin e përshkrimit 'off-label' të barnave është i domosdoshëm për të kuptuar sfidat dhe mundësitë që jep kjo praktikë. Qëllimi i këtij hulumtimi është vlerësimi i njohjes së praktikës 'off-label' nga profesionistët e kujdesit shëndetësor, mjekë dhe farmacistë.

Metodologjia: Profesionistët e shëndetësisë janë pyetur në lidhje me eksperiencat e tyre personale nëpërmjet sondazheve me pyetësorë. Përgjigjet e tyre në lidhje me përshkrimin 'off-label' u analizuan dhe u përpunuan sipas këndvështrimit të mjekëve përshkrues dhe farmacistëve zbatues të recetës.

Rezultate: Profesionistët e shëndetësisë, mjekë dhe farmacistë rezultuan të kenë njohuri për përshkrimin 'off-label' të barnave. Sipas

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

perceptimit të farmacistëve, përshkrimet '*off-label*' i kanë hasur gjatë praktikës së tyre në pacientë pediatrikë dhe raportojnë se këto përshkrime janë të përhapura kryesisht në grupmoshën 2-11 vjec. Përshkrimi i barit për një moshë më të re se moshja e rekomanduar është kategoria e përshkrimit '*off-label*' që është raportuar më shpesh nga profesionistët e shëndetësisë. Siguria dhe efikasiteti i barnave të përdorura në mënyrë '*off-label*' paraqitet si shqetësim si nga mjekët ashtu edhe nga farmacistët. Pjesëmarrësit në sondazhe raportojnë nevojën për rregulla dhe protokolle të qarta lidhur me situatat mjekësore ku mund të përshkruhet një bar në mënyrë '*off-label*'.

Përfundime: Gjatë përshkrimit apo ekzekutimit të një recete '*off-label*' profesionistët e kujdesit shëndetësor duhet të peshojnë me përpikmëri përfitimet e mundshme kundrejt rreziqeve në mënyrë që të ruhet siguria e pacientit që do të përdorë një bar për përdorim të pa aprovuar.

**Fjalë kyçe:** përshkrim '*off-label*', profesionistë të kujdesit shëndetësor, perspektiva, sondazh

**PARANDALIMI I ZHVILLIMIT TË NGJARJEVE  
KARDIOVASKULARE, PËRDORIMI I KALKULIMIT TË  
RISKUT NË SHËRBIM PRIMAR SHËNDETËSOR, ROLI I  
FARMACISTIT**

*M. Dibra<sup>1</sup>, M. Mulaj<sup>2</sup>, E. Konda<sup>3</sup>, K. Hoti<sup>4</sup>*

*<sup>1</sup>Mjeke Laboratori, <sup>2</sup>Mjeke Shëndet Publik, <sup>3</sup>Mjeke kardiologe, <sup>4</sup>Mjek Nefrolog*

Hyrje: Sëmundja e arterieve koronare (CAD) mbetet shkaku kryesor i vdekjeve në Evropë<sup>1,2,3</sup>. CAD është shkaku më i zakonshëm i vdekjeve në Evropë duke llogaritur 4.1 milionë vdekje çdo vit. Në përgjithësi, barra e CVD është më e madhe në rajonet me të ardhura mesatare të ESC<sup>1</sup>, Sipas vlerësimit të ESC, Shqipëria konsiderohet një vend me rrezik të lartë.

Përditësimet e fundit në udhëzimet, diagnostikimet e sakta dhe terapitë e reja krijuan qëllimin për të ofruar kujdes parandalues më të përshtatur<sup>4,5</sup>.

Materialet dhe metodat: Ky vëzhgim u krye në nivel Kujdesi Parësor në Shqipëri. Qëllimi i këtij studimi ishte zhvillimi dhe përdorimi i një modeli parashikimi të përditësuar (SCORE2) për të vlerësuar rrezikun 10-vjeçar fatal dhe jo-fatal të sëmundjeve kardiovaskulare (CVD) në individë pa CVD të mëparshme ose diabet të moshës 40-69 në Shkodër, kontroll të rregullt vjetor të njerëzve nga moshë 30-70 vjeç. Nga 150 pacientë të rritur të përzgjedhur rastësisht në kujdesin parësor, vetëm 109 pa ngjarje të mëparshme CV, u përfshinë në studim, 30% e rasteve u plotësuan në nivel farmacie. Të gjithë pacientët në studim kryen këto kritere: gjinia, moshë, statusi i duhanpirjes, presioni sistolik i gjakut dhe kolesteroli total, kolesteroli LDL dhe HDL, glicemia esëll.

Rezultatet: Në punimin tonë, 57.8% ishin femra dhe 42.2% meshkuj, 67,9 % e tyre ishin me LDL > 115 mg/dl, 22% ishin me PAS >125 mmHg, 22% ishin me glicemi esëll > 110 mg/dl, 26.6% ishin <50 vjeç, 55% e tyre kishin rrezikun SCORE2 >2.5% (rrezik mesatar),

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

dhe 73.4% ishin të moshës 50-69 vjeç ku 35% e tyre ishin < 10% dhe > 5%, dhe 8.8% e tyre ishin >10% (rrezik i lartë CV).

Rreziku i parashikuar për SKV ndryshonte në studimin grupor, kundrejt Shqipërisë si një rajon evropian me rrezik të lartë.

Konkluzione: Rëndësia e përdorimit të rregullt të SCORE2 në praktikën e përditshme dhe ndikimi i lartë i kontrolleve vjetore në shërbimet e kujdesit parësor në Shkodër. Vlerësimet individuale të rrezikut 10-vjeçar për ngjarjet kryesore kardiovaskulare (të përsëritura) mund të përdoren gjithashtu për edukimin e pacientit, ku një rol të rëndësishëm paraqet dhe farmacisti.

Theksimi i individëve me rrezik të lartë, sigurimi i pacientëve me më shumë njohuri për prognozën e tyre shëndetësore, duke rritur motivimin e tyre dhe duke ndikuar pozitivisht në respektimin e stilit të tyre të jetesës dhe trajtimin afatgjatë dhe parandalimin e CV-së në kohë, partneriteti i mjekut me farmacistin në edukim dhe parandalim.

## DERIVATET E KUMARINËS PENGOJNË MIGRIMIN E QELIZAVE KANCEROZE TË GJIRIT

*Lulzime Ballazhi\*, Edita Alili-Idrizi, Merita Dauti, Sihana Ameti-Lika, Drita Yzeiri-Havziu, Anife Rustemi-Ameti*

*Fakulteti i Shkencave Mjkësore, Departamenti i Farmacisë, Universiteti i Tetovës, Republika e Maqedonisë së Veriut*

*\*Autori korrespondues: e-mail: lulzime.ballazhi@unite.edu.mk*

Kanceri i gjirit është sëmundje malinje mjaftë e shpeshtë që prek një numër të konsiderueshëm femrash në mbarë botën. Potenciali që qelizat të migrojnë ose të rriten në mënyrë invazive, përveç proliferimit, është faktori më i rëndësishëm për zhvillimin dhe metastazimin e kancerit. Prandaj, për të vlerësuar nëse derivatet e

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

kumarinës ndikojnë në aftësinë e qelizave MCF-7 për të migruar, u krye testi i mbylljes së plagës.

Analiza e migrimit me gërvishtje u krye në qelizat kanceroze të gjirit MCF-7. Këto qeliza u vendosën në pjata me 24 gropëza dhe kur ato e arritën shumimin në konfluencë të plotë, u krye një plagë duke gërvishtur një boshllëk me majën e mikropipetës (100 $\mu$ L). Më pas, komponimet e kumarinës në përqendrime të ndryshme (0.01, 0.02, 0.05, 0.1 mmol L<sup>-1</sup>), të vetëme dhe të kombinuara me Doxorubicinën (1  $\mu$ mol L<sup>-1</sup>), u shtuan menjëherë dhe u mbajtën për 24 orë. U krahasua shpejtësia e mbylljes së plagës së qelizave të trajtuara dhe të patrajtuara. Fotografitë janë bërë me zmadhim 10 $\times$  duke përdorur mikroskopin me kontrast fazor (Zeiss Microscopy, Gjermani) menjëherë pas shkaktimit të plagës dhe në pikat e mëvonshme kohore. Distanca e hendekut u vlerësua në mënyrë sasiore duke përdorur softuerin ImageJ (v. 1.48; Wayne Rasband, NIH, SHBA) duke matur zonën e gërvishtjes në 0 orë dhe 24 orë pas inkubimit. Rezultatet u grumbulluan nga tre eksperimente të pavarura me tre përsëritje për eksperiment.

Duke pasur parasysh se shkalla e mbylljes së plagës pasqyron aftësinë migruese të qelizave të kancerit të gjirit, këto rezultate tregojnë se trajtimi me derivatet e kumarinës mund të pengojë migrimin e qelizave kanceroze.

**Fjalët kyçe:** kanceri i gjirit, terapia e kancerit të gjirit, migrimi i qelizave, derivatet e kumarinës, doxorubicina.

**KRAHASIMI I BARNAVE ANTIDIABETIKE TEK  
PACIENTET ME DIABET GESTACIONAL: NJË RISHIKIM  
SISTEMATIK I LITERATURËS**

*Mysheref Sylbije<sup>1</sup>, Brikena Dacaj Elshani<sup>2</sup>, Myzejen Sylbije<sup>3</sup>*

*<sup>1</sup>Doktor i Mjekësisë, Kosova*

*<sup>2</sup>Profesor Asistent, Specialist në Klinikën e Gjinekologjisë dhe Obstetrikës, Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Prishtina, Kosova*

*<sup>3</sup>Student i Mjekësisë, Univesiteti i Prishtinës, Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Prishtina, Kosova*

Hyrje dhe qëllimi: Diabeti Gestacional është një prej formave të hiperglikemisë që diagnostikohet për herë të parë gjatë shtatzënisë. Krahas masave parandaluese është me rëndësi njohja e barnave që përdoren tek këto paciente. Barnat antidiabetike që përdoren në shtatzëni janë Insulina, Metformina, Glyburidi.

Qëllimi i këtij rishikimi sistematik të literaturës është që të japë infomata në lidhje me aplikimin farmaceutik të antidiabetikëve si Insulina, Metformina dhe Glyburidi tek pacientet me Diabet Gestacional dhe të bëjë krahasimin e tyre.

Materiale e Metoda: Ky punim është rishikim i literaturës. Hulumtimet që janë analizuar janë prova të rastësishme, hulumtime kohort, prova klinike në periudhë kohore nga 2019-2024. Janë përdorur bazat e të dhënave si PubMed, Cohrane, dhe literatura të tjera. Janë analizuar artikuj të plotë të gjuhës angleze, që janë identifikuar duke përdorur fjalët kyçe dhe filtrat si: “Gestational Diabetes”, “Antidiabetics”, “Metformin”, “Glyburide”, dhe “Insulin”.

Rezultate: Kemi përfshirë 6 artikuj me gjithsej 2244 shtatzëna që janë përfshirë në hulumtime. Kriter për përzgjedhje ka qenë diagnoza me Diabet Gestacional dhe trajtimi me antidiabetik si Insulina, Metformina ose Glyburidi. Terapia e linjës së parë mbetet Insulina, përkundër përdorimit të vështirë. Në krahasimin Insulinë dhe

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

Metforminë në një mostër prej 217 pacientesh Metformina ka rritur peshën maternale. Në mostrën prej 890 pacientesh që krahason përdorimin e Insulinës dhe Glyburidit është ardhur në përfundim që është arritë kontrolli glikemik tek mbi 50% të pacientëve që kanë përdorur Glyburidin, në 18% terapia me Glyburide ka dështuar dhe është kaluar në Insulinë. Në mostrën prej 1099 pacientëve është krahasuar Metformina dhe Placebo nuk ka evidencë të mjaftueshme që dëshmojnë efektivitetin e Metforminës kundrejt Placebos. Mostra prej 38 pacientesh dëshmon për ulje të koncentimeve të Metforminës në gjak tek shtatzënat.

Përfundime: Qëllimi i këtij rishikimi të literaturës është që të analizojë dhe sintetizojë informatat në lidhje me efektivitetin dhe sigurinë e antidiabetikëve tek pacientet me Diabet Gestacional. Kemi ardhur në përfundim që krahas ushqimit të shëndetshëm dhe aktivitetit fizik barnat kanë rol esencial tek këto paciente. Përdorimi i Insulinës preferohet më tepër në krahasim me Metforminën dhe Glyburidin për shkak të efekteve anësore më të pakta për nënën dhe fetusin.

Përkundër hulumtimeve të analizuara më sipër ka hapësirë për studim në lidhje me përdorimin e antidiabetikëve tek Diabeti Gestacional.

**ROLI I FARMACISTIT NE TRAJTIMIN E PACIENTEVE**

*Anjeza Kaleci, Novartis Pharma, Shqiperi,*

*Sonila Vito, Universiteti UFO*

Roli i farmacistit ka ndryshuar ndjeshem se fundmi me ndyshimet e menyres se jeteses, plakjes se popullsisë, ngarkesen ne rritje te sherbimit shendetesor, migrimin e stafit mjekesor dhe periudhen e post-covid 19, Ne Janar 2024, autoriteti shendetesor i Anglise, NHS (National Health Service) vendosi qe farmacistet te trajtojne paciente me semundje jo-serioze duke evituar viziten tek mjeku i familjes, duke lehtesuar keshtu baren e sistemit shendetesor dhe lehtesimin e vizites se pacientit. Farmaciste te trajnuar vleresojne dhe trajtojne pacientin per sinozit, dhimbje fyti, dhe veshi, herpes, infeksione te traktit urinar tek femrat dhe te tjera. Po ne vendin tone si eshte situata? A trajtohen keta paciente nga farmacisti de facto, a po konsiderohet edhe de juro. Kemi organizuar nje pyetesor i cili i eshte derguar publikut (ne rolin e pacientit) per te vleresuar sherbimin e mare nga farmacistet si dhe nje pyetesor qe i eshte derguar farmacisteve per te mare opinionin e tyre mbi kete diskutim. Po kurikulumi universitar a e mbeshket kete nisme? Ndersa pacientet i drejtohen shpesh farmacistit per t'u trajtuar per probleme shendetesore jo-serioze duke mare nje sherbim te kenaqshem dhe qe u kursen kohe, farmacistet e rinj nuk suportohen mjaftueshem nga programi universitar i cili eshte akoma i varfer ne drejtim te pergatitjes se tyre me njohurite klinike.



**REKOMANDIMET E PERDORIMIT TE TERAPIVE  
ANTILIPEMIANTE NE SEMUNDJEN KRONIKE TE  
VESHKAVE**

*Prof. Asoc. Nereida Spahia*

*Shërbimi i Nefrologjisë. Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë*

**Hyrje:** Sëmundja kardio-vaskulare është shkaku kryesor i vdekshmërisë në Sëmundjen Kronike të Veshkave (SKV), dhe sikurse në popullatën pa SKV, dislipidemia është një kontribues i rëndësishëm. SKV shoqërohet me një profil lipidik atherogjenik, që karakterizohet kryesisht nga nivele të larta të triglicerideve dhe nivele të ulëta të HDL-kolesterolit.

**Qëllimi:** Ky prezantim synon të paraqesë një përmbledhje të të dhënave mbi dislipideminë dhe riskun e rritur kardio-vaskular në SKV si dhe një rishikim të rekomandimeve të përdorimit të terapipe antilipemiantë në këtë popullatë.

**Metodologjia.** U morën në konsideratë studime të ndryshme, u bë një analizë e të dhënave ekzistuese dhe literaturës shkencore, si dhe rekomandimeve të shoqatave internacionale europiane dhe amerikane lidhur me përdorimin e terapipe antilipemiantë në SKV.

**Rezultatet:** Të dhënat kliniko-laboratorike sugjerojnë, që përbërja e grimcave të lipoproteinave ndryshon nga SKV dhe se kjo përbërje e ndryshuar dhe/ose ngarkesa e lipoproteinës mund të jetë shkaku i rritjes së riskut për sëmundje kardiovaskulare në SKV. Përdorimi i statinave është treguar të jetë i sigurt dhe efikas në uljen e lipideve dhe i dobishëm në reduktimin e ngjarjeve kardiovaskulare në individët me SKV, qysh në stadet e hershme deri në ato terminale si dhe pas transplantit të veshkave. Ky përfitim nuk është kaq i sigurtë në pacientët me trajtim hemodialitik. Përveç statinave, udhëzuesit klinikë rekomandojnë përdorimin e kombinuar të statinave me ezetimibe, ndërsa terapi më të reja si frenuesit e PCSK9 janë shoqëruar me të dhëna të favorshme në studimet klinike.

**Perfundime:** Antilipemiantët tashme rekomandohen nga shoqatat internacionale si pjesë integrale e trajtimit të pacientëve me SKV, me qëllim uljen e riskut kardiovaskular dhe mortalitetit e morbiditetit të lidhur me të. Kjo është një strategji trajtimi që duhet implementuar në praktikën klinike.

**KRAHASIMI I FUNKSIONEVE RENALE TË PACIENTËVE  
ME DHIMBJE KOKE KRONIKE DHE SIMTOMATIKE  
GJATË TRAJTIMIT TË TYRE ME NSAID TË NDRYSHËM**

*Drita Yzeiri-Havziu, Arlinda Haxhiu-Zajmi, Arijeta Shabani,  
Dorentina Bexheti, Edita Alili-Idrizi, Merita Dauti, Nexhibe Nuhii,  
Gjylai Alija, Lulzime Ballazhi, Sihana Ahmeti-Lika*

*Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore,  
Universiteti i Tetovës, Tetovë, Republika e Maqedonisë së Veriut  
\*Autori korespondues: e-mail: [drita.havziu@unite.edu.mk](mailto:drita.havziu@unite.edu.mk)*

Hyrje: Dhimbja e kokës është një simptom i zakonshën që haset në popullatën e përgjithshme si dhe në praktikën mjekësore në mbarë botën. Pavarësisht përdorimit prej më shumë se një dekadë të një klase të re të barnave specifike për migrenën me efikasitet superior, triptanet, NSAIDs mbeten në terapitë më të përdorura për sulmin e migrenës. Efektet anësore të barnave anti-inflamatore josteroide (NSAIDs) ndërmjetësohen nëpërmjet frenimit të sintezës së prostaglandinës nga ihibimi jo specifike i ciklooksigenaza, duke çuar në vazokonstriksion dhe dëmtime reverzibile të veshkave gjatë hipoperfuzionit. Prologimi i zbulimit të hershëm mund të çojë në dëmtim akut të veshkave (AKI). Parametrat standarde për të ndjekur progresin e AKI, janë të papërshtatshme dhe varen nga dëmtimi i veshkave.. Qëllimii i studimit është ndjekja e funksionit të veshkave me përdorim të indikatorve specifik për zbulimin e hershëm të nefrotoxicitetit tek pacientët me cefalea-migrenë të trajtuar me NSAID për një periudhë të gjatë me kokëdhimbje kronike dhe simptomatologjike.

Përshkrimi i metodologjisë: Ne përdorëm metodën e Jaffe për përcaktimin e kreatininës në serum/urinë dhe analizat enzimatike për acid urik në serum dhe  $\gamma$  glutamyl transferazë ( $\gamma$ -GT) në urinë dhe serum. Shkalla e filtrimit glomerular (GFR) është llogaritur me formulën Cockcroft Gaunt dhe Jon selektive elektroda (ISE) përdoret për përcaktimin e elektroliteve në serum. Ekzaminimi i nefelometrisë

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

dhe kolorimetrisë fotoelektrike u përdor për të përcaktuar albuminën urinare, mikroalbuminurinë, dhe  $\beta$ 2-mikroglobulinën ( $\beta$ 2M) në urinë për të monitoruar funksionin glomerular dhe tubular. Testuam gjithsej 96 pacientë me migrenë të trajtuar një periudhë të gjatë me NSAID të ndryshme, terapinë e kombinuar (analgetikë, antidepressivë dhe triptan) dhe pacient të trajtuar për më shumë se 5 vjet për dhimbje koke të herëpashershme (simptomatike) të krahasuar me 80 të ekzaminuar të grupit të kontrollit.

Rezultatet-Nuk janë konfirmuar ndryshime renale në nivel glomerular dhe tubular, gjatë zbatimit të protokollit me standard nefrologjik - kreatininë (serum/urinë), GFR., statusi elektrolit (serumi) dhe acidi urik, me përjashtim të pacientëve me kokëdhimbje kronike që trajtohen me Ketoprofen kanë rezultuar me hiperkalemia Tek biomarkerët specifikë të urinës mikroalbuminuria kemi kostatuar rritje të lartë të vlerave në të gjitha grupet e pacientëve, veçanërisht në pacientët që janë trajtuar me NSAID dhe terapi e kombinuar në krahasim me grupin e kontrollit .

Konkludim -Duke ndjekur nivelet e biomarkerëve specifikë në urinë, mund të rekomandojmë monitorim të vazhdueshëm të funksioneve renale gjatë përdorimit të grupeve të ndryshme të NSAID dhe terapisi të kombinuar.

**Fjalë kyçe:** barnave anti-inflamatore josteroide, migrenë, efektet anësore

## INFEKSIONET E TRAKTIT URINAR, PROBLEMATIKA DHE REZISTENCA BAKTERIALE E E.COLI

*Ajeda Malaj*

Hyrije dhe Qëllimi: Infeksionet e traktit urinar (ITU) janë ndër infeksionet bakteriale më të zakonshme, duke prekur 150 milionë njerëz në mbarë botën çdo vit (Mlugu, 2023). Pavarësisht faktit që të

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

dy gjinitë janë të ndjeshme ndaj infeksionit, prevalenca në gjininë femërore është më e lartë për shkak të anatomisë dhe fiziologjisë së tyre riprodhuese (Czajkowski K, 2021). Infeksioni shkaktohet zakonisht si pasojë e invadimit bakterial të traktit urinar, duke përfshirë traktin urinar të poshtëm dhe të sipërm (Clinic, 2022). Ndër llojet bakteriale, *Escherichia coli* përbën 80% deri 85% të infeksioneve, ndjekur nga llojet e *Staphylococcus* që përbëjnë 10% deri 15% (Zhou Y, 2023). Antibiotikët janë trajtimi i parë për ITU-të, por disa lloje patogjenesh, veçanërisht *E. coli*, kanë shfaqur një rezistencë të lartë kundër një shumëllojshmërie antibiotikësh (Poirel L, 2020). Ky prezantim synon të thellohet në karakteristikat e *E. coli* si shkaktar i ITU-ve, të identifikojë faktorët që ndikojnë në infeksion dhe të hulumtojë trajtimet efektive.

**Materiale dhe Metoda:** Ky studim u bazua në analizën e të dhënave të mbledhura nga pacientët e diagnostikuar me infeksione të traktit urinar (ITU). Mostrat e urinës u mblodhën nga 45 pacientë (8.89% meshkuj dhe 91.11% femra), të cilët u paraqitën në qendrat e ndryshme shëndetësore në Durrës dhe kishin shfaqur probleme të traktit urinar. Analiza e të dhënave u krye bazuar në një plan paraprak duke përdorur paketën statistikore SPSS.

**Rezultate:** Një total prej 45 mostrash të urinës u mblodh nga pacientët e dyshuar, nga të cilët një numër total prej 82.22% tregoi rritje të rëndësishme bakteriale dhe u përfshi në studim. Moshat që rezultuan më të prekura ishin 41-60 vjeç. Në këtë studim, rezultatet pozitive me *E. coli* përbënin rreth 69.70% krahasuar me bakteret e tjera shkaktarë të infeksioneve urinare (p.sh., *Staphylococcus spp.*, 18.18%). Gjatë këtij studimi, nuk u konstatua asnjë rezultat pozitiv në gjininë mashkullore. Ky dallim në gjini lidhet ngushtë me pH-në dhe osmolaritetin e urinës, duke e fuqizuar kështu hipotezën se infeksionet e traktit urinar ndodhin më shpesh te femrat (Lai HC, 2021).

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

Përfundime: Studimi tregoi një prevalencë të lartë të rasteve pozitive me E. coli, si dhe një rezistencë ndaj terapive klasike. Rreth 15.15% e pacientëve pozitivë me E. coli u gjetën të jenë totalisht rezistentë ndaj trajtimit me penicilinë, dhe rreth 12.12% treguan rezistencë të ndërmjetshme. Ky konkluzion nënvizon sërish nevojën për të zhvilluar strategji të reja për menaxhimin e infeksioneve të traktit urinar dhe për të luftuar më tej rezistencën ndaj antibiotikëve.

### UTILIZIMI I ANTIBIOTIKËVE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS 2011 – 2022

*Arianit Jakupi<sup>1</sup>, Skender Radoniqi<sup>2</sup>*

<sup>1</sup>*Fakulteti i Farmacisë - IAL UBT*

<sup>2</sup>*Meditech - Rr. Marigona Residence 10500 Preoce, Gracanicë, Kosovë*

Hyrje dhe qëllimi: Konsumi i lartë i antibiotikëve është një nga komponentët e rëndësishëm të krijimit dhe zhvillimit të rezistencës antimikrobike. Rezistenca antimikrobike është një nga sfidat më të mëdha të shëndetësisë globale të kohës së re dhe prandaj edhe kujdesi i shtuar në secilën komponentë veç e veç është prioritet. Objektiv i këtij hulumtimi është evidentimi i utilizimit të barnave të kësaj klase, monitorimi i trendit përgjatë viteve duke krijuar dëshmi për politikëbërje.

Materiale dhe metoda: Metodologjia e përdorur është e zhvilluar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë përmes klasifikimit ATC të barnave pastaj përdorimit të Dozave të Definuara Ditore (DDD) si dhe Dozave të definuara Ditore për banorë në vit (DID). Këta indikatorë japin rezultate numerike të cilat njëkohësisht janë të krahasueshme edhe me vendet tjera të rajonit dhe BE në mënyrë që

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

përveç trendit në vend të krahasohen edhe ndryshimet me vendet tjera.

Rezultatet: Në vitin 2011 të dhënat kanë treguar utilizimin prej 26.3 DID e cila shifër ishte në pjesën e sipërme të tabelës për nga utilizimi në shtetet Europiane por me marrjen e masave të ndryshme të zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit për rezistencën antimikrobike këto shifra ndryshuan përgjatë viteve duke pësuar rënie. Të dhënat e vitit 2018 tregojnë se utilizimi ka rënë në 22.9 DID dhe kjo tregon se duke përfillur me përpikmëri masat e parapara mund ti shohim edhe rezultatet konkrete. Mirëpo më tej të dhënat e viteve në vijim sidomos të fillimit të pandemisë japin një pasqyrë me rritje domethënëse të konsumit. Indikatorët matës përfshijnë krahasimin e klasave dhe nënklasave të ndryshme të antibiotikëve dhe deri te utilizimi i secilit antibiotik individual, ku shihet përdorim më i lartë i cefalosporinave dhe kinoloneve dhe sidomos ceftriaxonit.

Përfundime: Të dhënat tregojnë qartë se ku është gjendja e Kosovës në raport me rajonin dhe pjesët tjera të BE si dhe kur analizohen në mënyrë të detajuar klasat, nënklasat dhe antibiotikët individual mund të vijmë në përfundim se trendi i rënies së utilizimit ishte pozitiv kurse keqpërdorimi i antibiotikëve të caktuar posacërisht në pandemi na obligon për marrjen e masave dhe gjetjen e alternativave më të përshtatshme terapeutike për ato indikacione.

**Fjalët kyçe:** Utilizimi i barnave, Antibiotikët, Rezistenca antimikrobike.

**RIMBURSIMI BAZUAR NË DIAGNOZË KUNDREJT  
RIMBURSIMIT BAZUAR NË LISTË POZITIVE BARNASH**

*Prof. Asoc. Dr. Gazment KODUZI\**

*\*Drejtues i Shoqatës shqiptare të farmaekonomisë,  
Profesor, Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan*

Hyrje: Sistemi shëndetësor shqiptar ka reflektuar si çdo sektor tjetër, zhvillimet politike dhe ekonomike të shoqërisë. Para vitit 1990, gjatë sistemit politik komunist, sistemi shëndetësor ishte organizuar sipas atij rus Semashko, të njëjtin që u zbatua në gjithë vendet e Europës qendrore dhe lindore, pjesë të kampit komunist. Në këtë sistem, i financuar nga buxheti i shtetit, barnat bliheshin me lekë në dorë, përveç barnave për fëmijët 0-1 vjec , që i merrnin papagesë. Me ndryshimet politike në vitin 1990-1991, Shqipëria kaloi nga sistemi komunist në atë capitalist, duke ju nënshtuar reformave të thella politike, ekonomike, strukturore dhe institucionale. Me qëllim mbrojtjen e qytetarëve nga shpenzimet katastrofike në rast sëmundje, në vitin 1994, me Ligjin 7870 datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” u krijua skema e sigurimeve shëndetësore, duke zgjedhur modelin Bismarkian për financimin e sistemit shëndetësor. Fillimisht në skemë u përfshinë mjeku i familjes dhe lista e barnave me rimbursim. Lista e barnave filloi me 200 principe bazë sipas udhëzimeve të Organizatës Botërore të Shëndetsisë. Që prej 1995 kur u krijua lista e parë e barnave me rimbursim bazuar në klasifikimet ATC, edhe sot në vijim, vazhdon i njëjti parim i krijimit të listës së barnave me rimbursim. Rimbursimi i barnave bazuar në një listë pozitive, shpesh herë krijon barrë financiare për pacientët, të diagnostikuar me diagnoza të ndryshme, ku barnat që janë pjesë e skemës së mjekimit, nuk janë në listën pozitive të barnave me rimbursim, ose që janë pjesërisht. Gjithashtu, në listën e barnave me rimbursim, ka një kolonë që kufizon diagnozat në të cilat mund të përdoret një bar, pamvarësisht efektit të tij më të gjerë. Ndërkohë, në vende të tjera, si Gjermani, të cilat kanë të njëjtin

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

system financimi në shëndetësi, atë Bismarkian, ka një përqsasje tjetër të trajtimit të patologjive të ndryshme përmes skemës së sigurimit shëndetësor, duke rimbursuar trajtimin e diagnozës. Kjo kryhet duke përcaktuar fillimisht paketën e përfitimeve nga sigurimi shëndetësore, miratimin dhe aplikimin e protokolleve klinike, dhe në momentin që pacienti diagnostikohet, mjeku përshkruan mjekimin dhe pacienti i merr barnat me rimbursim.

Rimbursimi bazuar në diagnozë, ka përparësi kundrejt atij me listë positive barnash, si për pacientin ashtu edhe për sistemin shëndetësor. Pacienti merr mjekimin e duhur dhe të plotë, ulen shpenzimet nga xhepi, ulet barra e sëmundshmërisë në komunitet, përmirësohet gjendja shëndetësore e pacientëve, rritet interesi i kompanive farmaceutike për regjistrimin e barnave dhe formëdozave të ndryshme, ulet presioni ndaj sistemit shëndetësor.

**Fjalët kyçe:** Barna me rimbursim, sistemi shëndetësor, pacienti, diagnozë

### VLERËSIM MBI MODELET E PËRSHKRIMIT TË BARNAVE BAZUAR NË INDIKATORËT E ORGANIZATËS BOTËRORE TË SHËNDETËSISË

*Rezarta Shkreli<sup>1</sup>, Markida Margjeka<sup>2</sup>, Judita Perndrecaj<sup>2</sup>*

*<sup>1</sup>Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti Aldent, Tiranë*

*<sup>2</sup>Farmaci rrjeti hapur, Tiranë*

Hyrje: Përshkrimi jo racional i barnave çon në trajtim jo të efektshëm të sëmundjes, në shfaqjen e efekteve të padëshirueshme, në kohëzgjatjen e sëmundjes, si dhe në efekte ekonomike për shoqërinë. Më shumë se gjysma e të gjitha barnave përshkruhen, shpërndahen ose tregtohen në mënyrë jo të duhur dhe 50% e pacientëve nuk i



## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

marrin ato në mënyrë korrekte. Studimi i modeleve të përdorimit të barnave ndërmjet profesionistëve është i një rëndësie jetike për shkak të prezencës në rritje të përdorimit irracional të barnave dhe rezistencës mikrobike.

**Qëllimi:** Qëllimi i këtij studimi ishte vlerësimi i modeleve të përdorimit racional të barnave referuar indikatorëve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, në qytetin e Shkodrës dhe të Tiranës.

**Materiale dhe metoda:** Studimi kishte si qëllim vlerësimin e indikatorëve të përshkrimit të barnave në receta të përshkruara nga mjekët, konkretisht janë analizuar 1006 receta të përzgjedhura nga 20 farmaci të ndryshme në qytetin e Shkodrës. Gjithashtu për vlerësimin e indikatorëve të kujdesit ndaj pacientit dhe të indikatorëve të shërbimit mbi shëndetin janë studiuar 100 receta të përzgjedhura random në qytetin e Tiranës. Nga indikatorët e studiuar përmëdim: indikatorët përshkrues, indikatorë të kujdesit ndaj pacientit, indikatorë të shërbimit për shëndetin. Përpunimi statistikor i rezultateve të përfuara është bërë duke përdorur paketën statistikore MedCalc 10.

**Rezultate:** Rezultatet e përfuara për të gjithë indikatorët e përshkrimit të barnave, për të dy qytetet ku u krye studimi i tejkalonin kufinj të lejuara nga OBSH, në mënyrë të veçantë përqindja e barnave të përshkruara me antibiotike, përqindjen e recetave me injeksione, përqindja e barnave të përshkruar me emër xhenerik. Përsa i përket indikatorëve të kujdesit ndaj pacientit vlen të theksohet se 65–70% e të gjithë përshkrimeve bëhet me emërtime tregtare, koha e konsultimit farmacist-pacient dhe ajo e dorëzimit të barnave rezultuan afërsisht të njëjta me vendet e tjera në zhvillim dhe përqindja e barnave të përshkruara nga lista e barnave thelbësore ishte shumë e vogël. Numri i barnave në recetë luhatej nga një në gjashtë.

**Përfundime:** Përgjithësisht indikatorët e analizuar janë larg kufirit të indikatorëve të përcaktuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.

**Fjalë kyçe:** Përdorim irracional barit, indikatorët e përshkrimit, indikatorët e kujdesit ndaj pacientit, lista e barnave thelbësore, Organizata Botërore Shëndetësisë

**OPIOIDET NGA ANALGJEZIA TEK DEPENDENCA – E  
TASHMJA DHE E ARDHMJA FARMAKOLOGJIKE E  
TRAJTIMIT TE DEPENDENCES NGA OPIOIDET**

*Aurora Braçe, Kleva Shpati, Erda Qorri, Aida Dama, Edlira Kaloshi, Emi Panariti, Erina Hilaj, Lorela Ohri*

*Departamenti Farmaci, FSHM , Albanian University*

Hyrje: Opioidet janë vlerësuar si ndër barnat më efektive për trajtimin e dhimbjes. Përdorimi i tyre në menaxhimin e dhimbjeve akute të forta dhe dhimbjeve kronike që lidhen me sëmundje të përparuara mjekësore konsiderohet si standard i kujdesit në shumicën e botës. Në të kundërt, administrimi afatgjatë i një opioidi për trajtimin e dhimbjeve kronike jo kanceroze vazhdon të jetë i diskutueshëm. Shqetësimet në lidhje me efektivitetin, sigurinë dhe përgjegjësinë e abuzimit kanë evoluuar gjatë dekadave, ndonjëherë duke çuar një perspektivë më kufizuese dhe ndonjëherë duke çuar në një gatishmëri më të madhe për të mbështetur këtë trajtim. Problemi është se analgjezikët më të fuqishëm të opiumit janë gjithashtu më të rrezikuarit për të shkaktuar abuzim dhe varësia. Pavarësisht dekadave të kërkimeve, kompanitë farmaceutike nuk kanë qenë në gjendje të sintetizojnë ligande opioidë që mbajnë potencë të lartë analgjezike, por me potencial të reduktuar abuzimi.

Qëllimi: Qëllimi i studimit tonë është të vlerësojmë evidencat e deritanishme te vendeve te ndryshme se kur mund te perdorim ne menyre te sigurte opioidet per trajtimin e dhimbjes kronike si dhe cilat jane trajtimet farmakologjike te se tashmes dhe te ardhmes per trajtimin e dependences nga opioidet.

Metodologjia: Rishikimi i strukturuar i literaturës duke përdorur MEDLINE, Embase, Current Contents, dhe Cochrane library, dhe artikuj të tjerë në Internet nxjerrë nga lista e botimeve të ketyre artikujve. Studimet u konsideruan potencialisht të rëndësishme, nëse përfshinin termin "opioides, analgesy, dependence, pharmacological

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

tretaments". U konsideruan studimet e kontrolluara te randomizuara (RCT), studimi i kohortës, studimi i kontrollit të rasteve, studimi i vëzhgimit, meta-analizë, apo rishikimi sistematik.

Rezultatet: Kohët e fundit, disa vende po pësojnë një rritje të konsumit të opioidit, jo vetëm në përdorimin e tij rekreativ, por edhe në recetat mjeksore, keqpërdorimit dhe abuzimit të opioideve. Përdorimi i opioideve për dhimbjen kronike jo maligne mbetet e diskutueshme, për arsye se mund të shkaktohet abuzim dhe varesi. Përgatitjet me veprim të gjatë, të tilla si fentanili transdermal dhe ndoshta disa forma të opioidëve të tjera me çlirim te ngadaltë, të cilat mbajnë përqendrimet konstante të opioideve në plazmë, minimizojnë shfaqjen e simptomave 'mes dozës' siç janë tërheqja dhe euforia e shkaktuar nga opioidet. Rekomandimet për përdorimin e opioideve për të trajtuar dhimbjen kronike jo malinje kanë ndryshuar gjatë dekadave të fundit.

Konkluzionet: Metadoni, buprenorfina dhe naltreksoni me çlirim të zgjatur konsiderohen trajtimet më efektive për të ulur marrjen e paligjshme të varësisë nga Opioidet. Numri i synimeve të reja farmakologjike është vazhdimisht në rritje, por shpesh shumë studimet premtuese në faza preklinike dështojnë në provat klinike. Sidoqoftë, duhet të jemi optimistë, pasi janë bërë përparime të mëdha vitet e fundit, por mbetet shumë për t'u përmirësuar në një sëmundje po aq të rëndësishme dhe komplekse sa varësia nga opiumi.

**NDËRHYRJET E FARMACISTËVE DHE ROLI I TYRE NË  
KUJDESIN GERIATRIK**

*Prof. Asoc. Klejda Harasani, Msc. Theodhora Mici*

*Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i  
Mjekësisë, Tiranë*

Hyrje dhe qëllimi: Aktualisht jetojmë në dekadën për plakjen e shëndetshme (2021–2030), të përcaktuar nga OKB pas shndërrimeve të mëdha demografike në drejtim të rritjes së popullatës së moshuar. Farmacistët si pjesë integrale e sistemit shëndetësor janë të përfshirë në nivele të ndryshme dhe në mënyrë domethënëse në kujdesin shëndetësor për të moshuarit.

Objektivi kryesor i studimit tonë ishte realizimi i një rishikimi të literaturës rreth ndërhyrjeve të farmacistëve dhe rolit të tyre në kujdesin geriatrik.

Materiale e metoda: Kërkimi u krye për artikuj në bazat e të dhënave PubMed / Medline dhe Google Scholar, në gjuhën angleze, që tregonin llojin dhe rezultatet e ndërhyrjeve të farmacistëve, duke përfshirë aspekte të ndryshme të kujdesit të të moshuarve në komunitet, në spitale si dhe në shtëpitë e të moshuarve.

Rezultate: Në të gjithë studimet e përfshira doli në pah se farmacistët, si anëtarë të ekipeve multidisiplinare dhe në çdo mjedis të kujdesit shëndetësor, luajnë një rol të rëndësishëm në përdorimin e duhur të farmakoterapisë në pacientët e moshuar të sëmurë. Ndërhyrja e tyre mund të ndihmojë në përmirësimin e aderencës ndaj mjekimit, parandalimin e ndërveprimeve midis barnave dhe ngjarjet e padëshiruara, duke kontribuar në përdorimin racional të barnave.

Në Angli, farmacistët kryejnë rishikim të strukturuar të barnave në pacientët me regjime komplekse terapeutike, dhe ata gjithashtu lejohen të përshkruajnë barna si përshkrues të pavarur. Në Gjermani, farmacistët e komunitetit kryejnë rishikim të barnave për pacientët mbi 65 vjeç me polifarmacitë. Në Australi, farmacistët përfshihen në një program të quajtur "Shqyrtimi i barnave në shtëpi", ku një

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

farmacist i akredituar rishikon përdorimin e barnave, ndihmon në minimizimin e reaksioneve të padëshiruara dhe përmirëson shkrimleximin shëndetësor. Sistemi shëndetësor i Kanadasë ofron një konsultë farmacisti të quajtur "MedsCheck", ku farmacistët intervistojnë pacientët dhe rishikojnë barnat e përshkruara dhe ato pa recetë të pacientëve. Gjithashtu, ata hartojnë planin e kujdesit farmaceutik gjatë pranimit, qëndrimit ose daljes nga spitali si dhe ndjekjen e pacientit pas daljes. Në Portugali farmacisti realizon Shërbimin e Rishikimit të Barnave (RevM) i cili përfshin zbulimin e problemeve të lidhura me barin dhe rekomandimin e ndërhyrjeve nga farmacisti.

Përfundime: Ka evidenca të mjaftueshme se farmacistët luajnë një rol të rëndësishëm për promovimin e plakjes së shëndetshme, të organizuar në mënyra të shumëllojshme në vende të ndryshme të botës. Prania e një farmacisti në ekipet e kujdesit shëndetësor sjell përfitime të mëdha për shëndetin e pacientëve të moshuar, rritjen e cilësisë së jetës dhe uljen e kostove.

### **VLERËSIMI I EFEKTIVITETIT TË TRASTUZUMAB NË KANCERIN E GJIRIT TË HERSHËM DHE HER 2+ TË SHPREHUR**

*Erina Hilaj*

Hyrje: HER2 është një protein/receptor i rritjes i cili nëse ndodhet në sasi të madhe në qelizën e tumorit të kancerit të gjirit do të thotë se tumori është HER2+ ose HER2 i shprehur. Kjo proteinë nxit shumimin e qelizës së tumorit dhe si rrjedhojë rritjen e tij. Trastuzumabi është një bar kimioterapeutik që efektin e jep pikërisht duke bllokuar receptorin HER2+ dhe përdoret vetëm në gratë të cilat e kanë të shprehur këtë proteinë në tumorin e tyre, dmth janë HER2+. Trastuzumabi është një bar shumë i shtrenjtë i cili po përdoret në kimioterapinë adjuvante të grave të diagnostikuara me kancer gjiri në QSU "Nënë Tereza" që prej vitit 2007-të.

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

Qëllimi; Qëllimi i këtij studimi është vlerësimi i efektivitetit të target terapisë me Trastuzumab të dhënë krahas regjimit AC/T (kimioterapi me bazë taksane të gratë e diagnostikuara me kancer gjiri dhe HER 2+ të shprehur.

Materiale dhe metoda; Në QSUT “Nënë Tereza” Trastuzumabi jepet në mënyrë konkomitante me kimioterapinë me bazë taksane për 12 cikle çdo 3 javë. Ky është një studim retrospektiv bazuar në të dhënat e marra nga kartelat. Për të vërejtur efikasitetin e target terapisë me trastuzumab gratë e trajtuara me kimioterapi me bazë taksane i ndamë në dy grupe. Në grupin e parë u përfshinë gratë e trajtuara me AC/T dhe Trastuzumab, kurse në grupin e dytë gratë e trajtuara vetëm me kimioterapinë me bazë taksane AC/T. U vlerësuar mbijetesa pa sëmundje (relaps/jorelaps) në pesë vite.

Rezultate; Përdorimi i Trastuzumabit është shumë më efikas se mospërdorimi i tij për shmangien e relapsit tek gratë me HER2+ të shprehur. Ky ndryshim është statistikisht domethënës.

Përfundime; Trastuzumabi, si target terapi e dhënë njëkohësisht me kimioterapinë me bazë taksane është trajtimi standard i kancerit të gjirit për gratë me HER2+. Gratë me kancer gjiri me HER2 të shprehur janë më të rrezikuara për rishfaqje të sëmundjes dhe për vdekjen krahasuar me gratë me HER2 të pashprehur prandaj vlerësimi i efikasitetit të target terapisë për këto paciente paraqet një interes të shtuar. Studime të ndryshme ashtu si vërtetoi dhe studimi ynë kanë vërtetuar se Trastuzumabi i dhënë njëkohësisht me kimioterapinë ka treguar se zgjat mbijetesën e përgjithëshme dhe mbijetesën pa sëmundje

**KEQPËRDORIMI I BARNAVE - SI TË PËRMIRËSOJMË  
PËRSHKRIMIN DHE PËRDORIMIN E BARNAVE NË  
SHQIPËRI**

*Dr. Shk. Florjana Rustemi*

*Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor*

Hyrje dhe qëllimi: Përshkrimi i papërshtatshëm dhe keqpërdorimi i barnave ul cilësinë e sistemit të kujdesit shëndetësor, çon në menaxhimin e keq të burimeve dhe rezultojnë në shpenzime më të larta të pacientëve në drejtim të kujdesit shëndetësor në përgjithësi. Ky punim ka për qëllim të shqyrtojë përvojën e përshkrimit dhe përdorimit të barnave dhe të sugjerojë disa rekomandime për të përmirësuar përdorimin e barnave në Shqipëri.

Materiale dhe metoda: Monitorimi i përshkrimit dhe përdorimit të barnave në Shqipëri sipas standarteve të shkrimit dhe ruajtjes së recetës mjekësore duke u bazuar në ligjin për barnat, literaturën mjekësore përkatëse dhe të dhënat e marra nga Fondi i Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor. Korrelacion ndërmjet statistikave të morbiditetit të sëmundjeve të caktuara dhe konsumit të vërejtur për barna të caktuara ose krahasimi i konsumit të trajtimeve alternative brenda një kategorie të caktuar terapeutike.

Rezultate: Nga të dhënat e studiuara rezultojnë variacione ndërmjet morbiditetit të raportuar dhe konsumit të barnave, si rrjedhojë edhe e përdorimit të protokolleve të ndryshme të mjekimit.

Përfundime: Rekomandojmë disa ndërhyrje jo të kushtueshme për sistemin shëndetësor të tilla si: protokollet standarde dhe të unifikuara të trajtimit dhe udhërrëfyes të trajtimit; lista e barnave esenciale; edukimin e vazhdueshëm të profesionistëve të kujdesit shëndetësor me fokus problem-based training; etj. Kjo strategji e thjeshtë dhe jo e kushtueshme mund të përmirësojë cilësinë e kujdesit shëndetësor dhe të zvogëlojë shpenzimet për barna në Shqipëri dhe në vendet e tjera në zhvillim.

«SEMAFORI I MEDIKAMENTEVE»  
NJË SISTEM I RI NË NDIHMË TË PACIENTIT

*MSc. Fatbardh Plangaj<sup>1</sup>, Prof. Dr. Ledjan Malaj<sup>2</sup>*

*<sup>1</sup>SuperVisor Farmaceutik “Ditë e Natë”*

*<sup>2</sup>Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë*

\*Informacioni për barnat përbën një ndër kriteret me rëndësi të praktikës së mirë në farmaci.

Ky informacion normalisht duhet të merret nga mjeku, farmacisti, fletë-përshkruesi, tashmë shfrytëzohet edhe interneti.

Për arsye specifike të secilit nga këto burime, sërish ka vështirësi dhe mungesë të një informimi të mirë dhe të shpejtë.

Rreth kësaj, është menduar dhe punuar për të gjetur një formë të re ndihmëse në informim, e cila do të ndihmonte, lehtësonte dhe shpejtonte informimin dhe përdorimin korrekt të barnave.

Duke gjetur një ngjashmëri figurative dhe konceptuale, duke shfrytëzuar njohjen masive të parimit dhe rolit të Semaforit, duke shfrytëzuar kuptimin qindravjeçar “NDAL” para Semaforit, është përpiluar një sistem shenjash me tre ngjyrat e njohura ndërkombëtarisht të këtij të fundit.

Sistemi quhet “Semafori i Medikamenteve” i cili u prezantua dhe u provua para pacientëve të një farmacie, me të cilët u bashkëbisedua dhe për 50 barnat më të përdorshëm u përpiluan dhe printuan në fletushka të vogla “Semaforët” përkatës të këtyre medikamenteve.

Sa herë që Pacientët kishin për të marrë një ndër këto barna për të cilët u përpiluan semaforët, bari shoqërohej edhe me semaforin e tij.



## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

Shumica e Pacientëve janë shprehur pozitivisht për këtë metodë, e kanë vlerësuar si të shpejtë dhe shumë të kuptueshme.

Fiksuan dhe kuptuan në mënyrë të shpejtë “Ndalimet” me ngjyrë të kuqe, ”Kujdesin” me ngjyrë portokalli dhe “Lejimet” me ngjyrë Jeshile.

Shumica e pacientëve kërkonin dhe dëshironin që “Semafori” të ngjitej apo të vendosej në një nga faqet e paketimit të jashtëm të Barit.

Semafori është një ndihmë plus në përdorimin korrekt të barnave dhe shmangien e gabimeve mjekësore.

Semafori së pari ndihmon Pacientin, gjithashtu duke i patur çdo ditë para syve aftëson dhe perfeksionon profesionalisht farmacistin.

Pozicioni më i dëshiruar për pacientin dhe më rezultativ është vendosja e tij në një nga faqet e jashtme të paketimit të barit.

\*Duke qenë se Fletë-përshkruesja është një dokument standart me informacion zyrtar për barin, dhene nga prodhuesi dhe është i kontrolluar, për hartimin e “Semaforit ” jemi referuar këtij dokumenti.

NDËRVEPRIMET E BIMËS *ACHILLEA MILLEFOLIUM*  
ME BARNAT, MEKANIZMI I VEPRIMIT DHE  
FARMAKOKINETIKA

*MSc. Edlira Kaloshi<sup>1</sup>, Prof. Dr. Lirika Kupe<sup>2\*</sup>, Prof. As. Kleva Shpati<sup>2</sup>, Prof. As. Marsela Alikaj<sup>2\*</sup>, Md. Herion Paza<sup>3</sup>*

*<sup>1,2</sup>Albanian University, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Departamenti i Farmacisë. <sup>2\*</sup>Universiteti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit, Departamenti i Shkencave Agronomike <sup>3</sup>Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Shërbimi Urgjencës dhe Pediatriisë së Përgjithshme*

*Achillea millefolium* është një bimë e njohur e familjes Asteraceae që përdoret si në mjekësinë tradicionale ashtu edhe në atë alternative. Përfitimet shëndetësore të ekstrakteve të kësaj bime rezultojnë nga një sërë metabolitësh dytësorë që përfshijnë flavonoidet, acidet fenolike, terpenet, guaianolidet, fitosterolet, acidet yndyrore dhe acidet organike. Studimet in vitro, të *Achillea millefolium* kanë treguar se ka veti anti-inflamatore. Studimet në kafshë kanë treguar se zvogëlon spazmat e muskujve të lëmuar, ul presionin e gjakut, shkakton zgjerim të bronkeve dhe ndalon gjakderdhjen, përmirëson alergjitë sezonale dhe problemet gastrointestinale. Përveç kësaj, aplikohet në mënyrë topike si locion ose pomadë për inflamacionet e lëkurës, plagët, prerjet dhe gërvishtjet. Ekstraktet e *Achillea millefolium* shfaqin veti premtuese antimikrobike dhe antioksidante, të cilat i bëjnë ato përbërës të vlefshëm në produktet farmaceutike dhe kozmetike, *Achillea millefolium* është gjithashtu një kandidat premtues për kërkime të mëtejshme në zhvillimin e agjentëve të rinj terapeutikë .Duke përmbledhur provat e disponueshme nga studimet in vitro, in vivo dhe klinike, ky rishikim i literaturës synon të ofrojë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të mekanizmit të veprimit, vetive farmakokinetike, ndërveprimeve me barnat dhe tolerueshmërisë së *A. Millefolium* për të dhënë informacion mbi përfitimet dhe kufizimet e mundshme të përdorimit të tij si një agjent terapeutik.

**Fjalë kyçe:** *Achillea millefolium*, mekanizmi i veprimit, ndërveprimet e barnave, vetitë farmakokinetike.

**CDK4/6 INHIBITORËT NË TRAJTIMIN E KANCERIT TË**

**GJIRIT: PRAKTIKA AKTUALE DHE E ARDHMJA**

**PREMTUESE**

*Dr. Amanda Zeko<sup>1</sup>, D.Sh.M Artan Bodeci<sup>1</sup>, Prof. Majlinda Ikonimi<sup>2</sup>, Dr. Bledi Kreka<sup>1</sup>, Dr. Flutura Proko<sup>1</sup>, Prof. Asoc. Silvana Çeliku<sup>1</sup>, Dr. Sabo Ademi<sup>1</sup>, D.Sh.M Elvisa Kozma<sup>1</sup>, Dr. Ejona Çeliku<sup>2</sup>, Dr. Jusilda Dervishi<sup>3</sup>, Dr. Paola Cenollari<sup>1</sup>*

<sup>1</sup>*Shërbimi Onkologjik, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë.*

<sup>2</sup>*Shërbimi i Laboratorit të Anatomisë Patologjike, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë.*

<sup>3</sup>*Spitali Rajonal Korçë.*

Hyrje: Përdorimi i CDK4/6 inhibitorëve në trajtimin e kancerit të gjirit metastatik me receptorë hormonal pozitiv dhe HER2 negativ është bërë i mundur dekadën e fundit duke shënuar dhe arritjen më të madhe në trajtimin e këtij nëntipi. Kanceri i gjirit me receptor hormonal pozitiv (HR+) dhe HER2 negativ (HER2-) përbën të paktën 60% deri në 70% të të gjitha rasteve të kancerit të gjirit [1]. Mekanizmi kanonik që qëndron në themel të aktivitetit të frenuesve CDK4/6 është frenimi i fosforilimit të proteinës tumor supresore retinoblastomës, e cila parandalon proliferimin e qelizave malinje. Aktualisht ekzistojnë tre frenues CDK4/6 që janë aprovuar nga FDA: palbociclib, ribociclib dhe abemaciclib. Palbociclibi u aprovua si linjë e parë trajtimi në kombinim me një inhibitor të aromatazës në trajtimin e kancerit të gjirit metastatik HR+/HER2- në gratë në postmenopauzë bazuar në fazën e dytë të studimit PALOMA-1/TRIO-18 dhe fazës së tretë të studimit PALOMA-2. Palbociclib u aprovua në kombinim me fulvestrantin si linjë e dytë trajtimi bazuar në rezultatet e fazës së tretë të studimit PALOMA-3. Ribociclib u aprovua si linjë e parë trajtimi në Mars të vitit 2017 në kombinim me një AI bazuar në rezultatet e fazës së tretë të studimit MONALEESA-2 dhe si linjë e dytë ose e parë trajtimi në kombinim me fulvestrantin bazuar në rezultatet e fazës së tretë të studimit MONALEESA-3.

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

Abemaciclib u aprovua si linjë e parë trajtimi në kombinim me një AI në shkurt të vitit 2018 bazuar në rezultatet e fazës së tretë të studimit MONARCH-3; si linjë e dytë apo e mëvonshme në kombinim me fulvestrantin bazuar në rezultatet e MONARCH-2 dhe si linjë e tretë ose e mëvonshme trajtimi si agjent i vetëm bazuar në rezultatet e MONARCH-1. Rezultatet e shkëlqyera të vërejtura me frenuesit CDK4/6 në trajtimin e kancerit të gjirit metastatik HR+/HER2- nxiti vlerësimin e këtyre agjentëve edhe në stadin e hershëm të kancerit të gjirit. Studimet mbi CDK4/6 inhibitorët në neoadjuvancë mund të kategorizohen në dy grupe: ato që krahasojnë kombinimin CDK4/6 i+ terapi endokrine kundrejt terapisë endokrine dhe ato që krahasojnë kombinimin CDK4/6 i+ terapi endokrine kundrejt kimioterapsë standarde. Në grupin e parë përfshihen MONALEESA-1 dhe FELINE për ribociclibin, Pallet për palbociclibin dhe NeoMONARCH për abemaciclibin. Kombinimi me CDK4/6 inhibitor tregoi kapacitetin më të madh antiproliferativ por ende nuk janë raportuar rezulate mbi kohën e lirë pa evente . Në grupin e dytë përfshihen NeoPal për palbociclibin dhe CORALLEEN për ribociclibin. Edhe në këtë rast kombinimi me CDK4/6 inhibitor tregoi një efekt antiproliferativ më të shpejtë dhe më të madh bazuar në ndryshimet e Ki67 . Katër studimet që po eksplorojnë inkorporimin e CDK4/6 inhibitorëve në fushën adjuvante janë: PALLAS dhe PENELOPE-B për palbociclibin, MONARCH-E për abemaciclib dhe NATALEE për ribociclibin. Ky i fundit duke treguar një përmirësim sinjifikant në kohën e lirë pa sëmundje hodhi dritë mbi rishkimin e trajtimit adjuvant të kancerit të gjirit me receptorë hormonal pozitiv . Një sërë studimesh të reja po investigojnë inkorporimin e CDK4/6 inhibitorëve në trajtimin e kancerit të gjirit HER2 pozitiv. Krahas pritjes së rezultateve përfundimtare deri më tani është konstatuar që më së shumti përfiton nëntipi HR pozitiv dhe HER2 pozitiv.

Objekti: Qëllimi i këtij prezantimi do të jetë kuptimi i mekanizmit të veprimit, paraqitja e rekomandimeve aktuale, eksperiencës klinike dhe përditësimi me mundësitë e reja në përdorimin e CDK4/6 inhibitorëve në trajtimin e kancerit të gjirit.

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

Materiale dhe metoda: Rishikimi i literaturës dhe rezultatet e studimeve të reja klinike mbi CDK4/6 inhibitorët në trajtimin e kancerit të gjirit.

Konkluzione: CDK4/6 inhibitorët kanë ndryshuar qasjen ndaj trajtimit të kancerit të gjirit të avancuar HR+/HER2- në dekadën e fundit. Rezultatet e sukseshme të deri tanishme dhe kuptimi më i mirë i mekanizmit të tyre të veprimit kanë iniciuar një sërë studimesh për inkorporimin e tyre edhe në trajtimin e stadi të hershëm të kancerit të gjirit HR+/HER2- si dhe në trajtimin e nëntipeve të tjerë duke e shndërruar në klasën e agjentëve targetues më premtues në trajtimin e kancerit të gjirit.

**Fjalët kyçe:** kanceri i gjirit, cdk4/6 inhibitorët, studimet e reja.

### PËRGATITJET GALENIKE NË PRAKTIKËN FARMACEUTIKE: NJË STUDIM MBI SUSPENCIONIN ORAL TË IBUPROFENIT

*Delina Xhafaj<sup>1\*</sup>, Magi Asllani<sup>2</sup>, Ederina Karriqi<sup>3</sup>, Erjona Sheqeri<sup>3</sup>*

<sup>1</sup>*Department of Pharmacy, Faculty of Medical Sciences, Albanian University, Tirana, Albania*

<sup>2</sup>*ItalPharma Pharmacy, Tirana, Albania*

<sup>3</sup>*Department of Pharmacy, Faculty of Medical Sciences, Albanian University, Tirana, Albania*

Disa formulime jo-sterile (magjistrale dhe oficinale) përgatiten në farmaci sipas procedurave dhe formulacioneve të caktuara. Ato janë thelbësore për shumë pacientë që nuk mund të marrin barnat standarde për arsye të ndryshme, si p.sh. rregullimi i dozës, alergjia, ose mungeses në treg. Megjithatë, ato paraqesin rreziqe më të larta se barnat industriale, pasi nuk kanë kaluar një kontroll para-tregu për sigurinë, efikasitetin, dhe cilësinë. Qëllimi i studimit është të formulojë dhe të vlerësojë stabilitetin e suspencionit oral të

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

ibuprofenit, një formulim pediatrik i përgatitur, në një laborator didaktik të galenikes. Suspensionet orale të ibuprofenit u përgatitën me dy baza të ndryshme: bazë sheqeri të thjeshtë dhe bazë karboksimetilceluloze. Çdo suspension u ruajt në dy kushte të ndryshme: temperaturë ambienti dhe frigorifer 10°C. Përmbajtja dhe stabiliteti i suspencionit u analizuan me një metodë spektrofotometrike në ditë të ndryshme të ruajtjes. Pamja e përgjithshme, pH-ja dhe indeksi i refraksionit u matën gjithashtu. Rezultatet treguan se suspencionit oral të ibuprofenit kishte një uniformitet të lartë të përmbajtjes dhe stabilitet në kohë. Suspensionet përmbajtën më shumë se 90% të përqendrimit të tyre fillestar pas 15 ditësh ruajtje. pH-i, indeksi i refraksionit dhe pamja e suspencionit nuk ndryshuan ndjeshëm gjatë periudhës së studimit. Suspensionit oral të ibuprofenit i përgatitur në kushte didaktike farmaceutike me një bazë të thjeshtë dhe i ruajtur në temperaturat e frigoriferit tregoi një stabilitet dhe cilësi të lartë. Ky studim ofron informacione të dobishme për farmacistët dhe edukatorët që janë të përfshirë në praktikën galenike.

**Fjalët kyçe:** Përgatitje Galenike; Suspension oral i ibuprofenit; Stabilitet; Laborator Didaktik Farmaceutik

## PËRDORIMI I ANTAGONISTËVE TË RECEPTORËVE TË ANGIOTENSINËS II RIMBURSUAR GJATË VITEVE 2017-2023 NË SHQIPËRI

*Alida Sina*

*Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor*

Hyrje dhe qëllimi: Sëmundjet kardiovaskulare janë shkak kryesor i vdekshmërisë në mbarë botën dhe hipertensioni është një faktor rreziku i modifikueshëm për këto sëmundje. Antagonistët e receptorëve të angiotensinës II (ARB) përbëjnë një nga klasat

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

kryesore të barnave që përdoren për trajtimin e hipertensionit dhe insuficiencës kardiake. Udhëzuesit europianë rekomandojnë terapi të kombinuar me dy barna, mundësisht në një tabletë të vetme, për shumicën e pacientëve hipertensivë, si terapi fillestare. Kombinimet e preferuara përfshijnë ARB+diuretik ose ARB+blokues të kanaleve të kalciumit. Nëse presioni i gjakut nuk kontrollohet me kombinimin me dy barna, trajtimi rritet në kombinimin me tre barna, ARB+blokues të kanaleve të kalciumit+diuretik tiazidik, mundësisht në një tabletë të vetme. Qëllimi i këtij studimi retrospektiv është të vlerësojë modelin e përdorimit të ARB, si produkte të vetme kundrejt kombinimeve të tyre në një tabletë, rimbursuar në vendin tonë gjatë viteve 2017-2023 për trajtimin e pacientëve ambulatorë.

Materiale e metoda: Të dhënat elektronike mbi konsumin vjetor të ARB rimbursuar në vendin tonë gjatë viteve 2017-2023 u mblodhën nga databaza e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Të dhënat për popullatën në studim në nivel vendi u morën nga Instituti i Statistikave (INSTAT). Për kuantifikim e përdorimit të ARB, të vetme dhe të kombinuara, në DDD/1000 banorë/ditë, u përdor metodologjia ATC/DDD e cila është njohur nga Organizata Botërore e Shëndetësisë si standart ndërkombëtar në studimet e përdorimit të barnave.

Rezultate: Konsumi total i ARB të rimbursuar në vendin tonë, produkte të vetme dhe të kombinuara, ishte rritur me 20% gjatë viteve 2017-2023, por trendi i rritjes së përdorimit ishte më i shprehur për kombinimet e ARB-ve, nga 9.1 DDD/1000 banorë/ditë në 20.37 DDD/1000 banorë/ditë. Raporti i përdorimit të ARB, produkte të vetme kundrejt produkteve të kombinuara, të dyfishta dhe të trefishta, nga 85:15 në vitin 2017 paraqitej 73:27 në vitin 2023. Kombinimet e dyfishta të ARB predominonin në përdorim kundrejt kombinimeve të trefishta ARB+blokues të kanaleve të kalciumit+diuretik, duke përbërë përkatësisht 78% dhe 22% të konsumit total të rimbursuar të kombinimeve të ARB në vitin 2023.

Përfundime: Modeli i rritjes së përdorimit në vite të ARB të kombinuara dhe të rimbursuara në vendin tonë është në përputhje me

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

udhëzuesit ndërkombëtarë që rekomandojnë kombinimet e ARB, mundësisht në një tabletë të vetme, për trajtimin e hipertensionit, për shkak të efikasitetit, tolerueshmërisë dhe adherencës më të mirë ndaj mjekimit.

**Fjalët kyçe:** ARB, përdorim i barnave, hipertension, produkte të kombinuara.

### RISIA E BARNAVE BIOLOGJIKE

*MSc. Marsida Reli*

*e-mail: marsida31@hotmail.com*

Ky dokument eksploron fushën në zhvillim të barnave biologjike, duke i krahasuar ato me barnat konvencionale dhe duke u thelluar në përdorimin e tyre në rritje, kuadrin ligjor në Shqipëri, dhe përfshirjen e tyre në listen spitalore të barnave të rimbursuara në vend. Barnat biologjike paraqesin një ndryshim të rëndësishëm nga barnat konvencionale. Ato janë të derivuara nga organizmat e gjalla dhe ofrojnë qasje terapeutike të targetuara. Kjo qasje është e ndryshme nga qasja e barnave konvencionale, të cilat sintetizohen kimikisht. Përdorimi i barnave biologjike është rritur në mënyrë të dukshme në fushën e bio-terapisë dhe imunoterapisë, duke ofruar rrugë të reja për trajtimin e sëmundjeve komplekse si kanceri dhe çrregullimet autoimune.

Në Shqipëri, kuadrin ligjor që rregullon barnat biologjike është në zhvillim e sipër dhe synon të adresojë këto terapi të reja. Ligji shqiptar për barnat dhe produktet farmaceutike është duke u përshtatur për të përballuar sfidat unike të barnave biologjike, siç janë kërkesat për ruajtje, kompleksitetet në prodhim, dhe shqetësimet rreth biosimilaritetit. Ky dokument gjithashtu diskuton vendin e barnave biologjike në sistemin shëndetësor shqiptar, veçanërisht në lidhje me politikat e rimbursimit dhe praninë e këtyre barnave pranë farmacisë



## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

se rimbursimit QSUNT. Përfshirja e këtyre barnave në listën spitalore të barnave të rimbursuara tregon një njohje të rëndësishme të tyre dhe një angazhim për t'i bërë ato të aksesueshme për pacientët.

Nëpërmjet këtij punimi vihet në pah potenciali transformues i barnave biologjike në kujdesin shëndetësor së bashku me sfidat dhe mundësitë që ato paraqesin në kontekstin e legjisllacionit dhe politikave shëndetësore shqiptare.

**Fjalët kyçe:** barnat biologjike, barna konvencionale, legjisllacioni shqiptar, barna të rimbursueshme, politika mjekësore, farmaci spitalore

### VLERËSIMI SASIOR I LISTËS SË BARNAVE ESENCIALE PËR FËMIJË: SHQIPERIA SI RAST STUDIMOR

*Eriona Petro<sup>1,2\*</sup>, Aukje Mantel-Teeuwise<sup>2</sup>, Hendrika van den Ham<sup>2</sup>, Velisha Ann Perumal-Pillay<sup>3</sup>, Fatima Suleman<sup>3</sup>*

<sup>1</sup> *Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Durrës, Shqipëri*

<sup>2</sup> *Utrecht Qendra Bashkëpunuese e OBSH-së për Politikën dhe Rregullimin Farmaceutik, Divizioni i Farmakoepidemiologjisë dhe Farmakologjisë Klinike, Instituti i Shkencave Farmaceutike të Utrehtit (UIPS), Universiteti i Utrehtit, Holandë*

<sup>3</sup> *Qendra Bashkëpunuese e Organizatës Botërore të Shëndetësisë për Politikën Farmaceutike dhe Praktikën e Bazuar në Dëshmi, Disiplina e Shkencave Farmaceutike, Shkolla e Shkencave Shëndetësore, Universiteti i KwaZulu-Natal, Afrika e Jugut*

*\*erionapetro@hotmail.com*

Hyrje: Barnat esenciale janë thelbësore për arritjen e mbulimit shëndetësor universal (UHC), i cili siguron që të gjithë njerëzit të kenë akses në shërbimet shëndetësore, duke përfshirë medikamentet

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

thelbësore, pa implikuar vështirësi financiare. Megjithatë, ekziston një pakicë globale e formulimeve të barnave pediatrike të përshtatshme për moshën për të trajtuar dhe parandaluar patologji të ndryshme, veçanërisht në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme. Si rezultat, ekziston një boshllëk i madh në të dhenat mbi aksesin e barnave për fëmijët. Si një veprim global për të përmirësuar aksesin në barna specifike për fëmijët, Lista e Barnave Esenciale të OBSH-së për Fëmijë (EMLc) u publikua në 2007 për të njohur nevojat e veçanta për barna tek fëmijët dhe për të promovuar përfshirjen e barnave pediatrike në programet kombëtare të prokurimit.

Objektivat: Ky studim synoi vlerësimin sasior të barnave në listën e barnave thelbësore të OBSH-së për Fëmijë (EMLc) (2021) dhe barnave të përfshira në listën e barnave të rimbursuara shqiptare nga Fondi I Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

Metodat: Lista e 8-të e OBSH EMLc 2021 (n=471) u krahasua me barnat (n=1166) në listën e barnave të rimbursuara e vitit 2022. Është kryer një vlerësim sasior për të krahasuar barnat pediatrike të përfshira në Listën e Barnave të Rimbursuara nga FSDKSH dhe barnave në Listën e Barnave Esenciale për Fëmijët (EMLc-WHO).

Rezultatet: Gjithsej 284 barna u gjetën në të dyja listat. Ndër këto, 137 (48.2%) barna në listën e MHIF kishin të njëjtin formulim, dozim dhe indikacion si në EMLc të OBSH-së. Kategoritë EMLc më së shumti të pranishme në listën e FSDKSH ishin barnat për çrregullime mendore dhe të sjelljes 100% dhe 75% e barnave kardiovaskulare respektivisht. Nga 24 vaksinat e listuara në EMLc, 14 janë pjesë e Programit Kombëtar Shqiptar të Imunizimit dhe Programit të Imunizimit të Gripit Sezonal, pavarësisht se nuk janë përfshirë në listën e barnave.

Përfundim: Ky është studimi i parë në Shqipëri që hulumton vlerësimin sasior të listës së OBSH EMLc dhe FSDKSH. Rezultatet japin një pasqyrë të kategorive farmaceutike në të cilat ka ngjashmëri në të dyja listat për sigurimin e aksesit në barna për fëmijët në Shqipëri, siç rekomandohet nga OBSH EMLc.

**ALOPECIA: RISITË E TRAJTIMIT**

**MSc. Dorilda Çela<sup>1</sup>, MSc. Sabihe Cenaj<sup>2</sup>, MSc. Orion Dido<sup>3</sup>**

*<sup>1</sup>Farmacist dhe Specialist në Farmakovigjilencë, Importues farmaceutik*

*<sup>2</sup>Specialist i Çështjeve Regulatorë dhe Farmakovigjilencës, Importues farmaceutik*

*<sup>3</sup>Inspjektor, Agjencia e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore*

Hyrje: Alopecia është mungesa ose humbja e flokëve në një zonë ku priten të jenë të pranishme. Kjo gjendje mund të jetë e lokalizuar ose e përhapur, e përkohshme ose e përhershme, prek të dy gjinitë dhe të gjitha grupmoshat. Anamneza, ekzaminimi fizik dhe/ose rezultatet laboratorike janë të nevojshme për të përcaktuar shkaku të alopecisë, i cili do të ndikojë në zgjedhjen e trajtimit më të përshtatshëm për të patur rezultatet më të mira.

Qëllimi: Në këtë rishikim sistematik synohet të paraqitet një përmbledhje e risive më të reja në trajtimin e llojeve të ndryshme të alopecisë, ku diskutohet për mekanizmat e veprimit, kostot, efikasitetin dhe profilet e sigurisë së terapive ekzistuese, alternative dhe atyre më të reja.

Metodologjia: Studimi është bazuar në rishikimin e literaturës dhe botimeve të pesë viteve të fundit në Pubmed dhe Medscape. Nga 157 artikuj të publikuar që u rishikuan u morën në shqyrtim 22 prej tyre, të cilat ishin në fokusin e këtij studimi.

Rezultatet: Në përfundim të këtij studimi rezultoi se ekzistojnë alternativa të ndryshme trajtimi duke përfshirë A) trajtime farmakologjike sistematike dhe lokale, B) trajtime jo farmakologjike jo kirurgjikale si: Plazma e pasur me trombocite, terapia me lazer e nivelit të ulët, terapia ndihmëse me mikrogjilpëra, C) trajtimi kirurgjikal i transplantit të flokëve, si dhe kombinim i tyre. Trajtimi i sëmundjeve shoqëruese si hiperandrogjenizmi dhe deficencave nutricionalë mund të ndihmojë në ruajtjen e rritjes së flokëve.

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

Ndërsa efikasiteti i disa trajtimeve është studiuar në provat klinike, për disa të tjera të dhënat janë më të kufizuara, prandaj nevojitet vazhdimi i përpjekjeve kërkimore për të përcaktuar qasjet optimale për vlerësimin dhe menaxhimin e të prekurve nga kjo gjendje.

**Konkluzionet:** Natyra kronike dhe origjina multifaktoriale e alopecisë e bëjnë më sfiduese menaxhimin e saj, por jo të pamundur duke marrë parasysh se tashmë janë në dispozicion opsione të shumëllojshme terapeutike. Është e rëndësishme të merret parasysh kostoja, efektet anësore, lehtësia e përdorimit dhe preferencat e pacientit kur diskutohen mundësitë e trajtimit.

Përhapja e gjerë e kësaj problematike në popullatë dhe impakti i saj në cilësisë e jetesës, e bën të nevojshme vazhdimin e përpjekjeve për të realizuar studime që krahasojnë efektivitetin e opsioneve të ndryshme të trajtimit, për të patur strategji më të mira dhe optimale trajtimi.

**Fjalët kyçe:** Alopeci, Dermatologji, Folikul.

**KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII**

**KONFERENCA MBARËKOMBËTARE  
FARMACEUTIKE VII “SË BASHKU PËR  
FARMACEUTIKËN”: FARMACI INDUSTRIALE  
DHE KËRKIM NË SHKENCA FARMACEUTIKE**



**Farmaci Industriale dhe Përgatitje Galenike**

**POLIMERËT SI EKSPIENTË NË TEKNOLOGJINË**

**FARMACEUTIKE, RISHIKIM LITERATURE**

***Brunilda Myftari\*, Ledjan Malaj, Eni Bushi, Gentjan Mataj, Partizan Malkaj, Suela Këlliçi, Erjon Troja***

*\*Institucioni: Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë  
Adresa: Rr. e Dibrës, Nr. 371, 1005, Tiranë, Shqipëri  
Cell: +355 695175374*

Polimerët multifunksionalë janë komponime makromolekulare të cilat, bazuar në literaturë përveç funksionit të tyre bazë, mund të kenë veti shtesë si p.sh: ndjeshmëria ndaj stimujve, mukoadezioni, frenimi i enzimave, rritja e depërtimit të epitelit të zorrëve, rritja e kapacitetit tampon, vetitë thithëse, aftësia për maskimin e shijes, aktiviteti farmakologjik dhe aftësia për të formuar konjugate ose ndërvepruar me enzimat përgjegjëse për metabolizmin e barit.

Një faktor i rëndësishëm, që ndikon në progresin e transportuesve të rinj të barnave është zhvillimi i eksipientëve që kanë veti që, në varësi të nevojave terapeutike, të rrisin biodisponibilitetin dhe stabilitetin e barit, si dhe të mundësojnë formulimin e formave farmaceutike me çlirim të kontrolluar ose të lokalizuar të barit etj.

Qëllimi i këtij punimi është krahasimi i grupeve të ndryshme të polimerëve që përdoren në teknologjinë farmaceutike. Gjatë klasifikimit të grupeve specifike të polimerëve multifunksionalë, vlen të theksohen përparësitë e përdorimit të tyre gjatë formulimit të një bari të ri. Përparësi të tilla përfshijnë: rritjen e biodisponibilitetit të barit, përmirësimin e qëndrueshmërisë së tij gjatë formulimit dhe mundësinë e përfuturit të formave farmaceutike me çlirim të

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

kontrolluar ose të lokalizuar të barit në një vend specifik në organizëm.

Si përfundim mund të thuhet se polimerët përbëjnë një klasë të rëndësishme të eksipientëve në teknologjinë farmaceutike, e cila po rritet vazhdimisht. Prandaj zbulimi i vetive të tyre bëhet jetik. Polimerët multifunksionalë përbëjnë një grup përbërësish, të cilët përveç funksioneve të tyre bazë, mund të luajnë një rol të rëndësishëm në formulimin e sistemeve inteligjente të shpërndarjes së barnave, duke kontribuar kështu në përmirësimin e efektit terapeutik të arritur. Përdorimi i vetive të polimerit të përshkruara në këtë përmbledhje duhet të merret parasysh kur zgjidhen eksipientët e dëshiruar për formulimet e reja.

**Fjalët kyçe:** Polimerë multifunksionalë, lëndë ndihmëse polimer, terapi polimerike, polimer inteligjent.

*\* Ky botim është realizuar në kuadër të projektit “Përdorimi i një sistemi polimerik në optimizimin e biodisponibilitetit të barnave. Zhvillimi industrial i një bari cilësor dhe kosto-efikas për popullatën shqiptare” dhe është pronë e institucionit financues të grantit (AKKSHI).*

**MUNDËSIA E TRANSFORMIMIT TË PRODUKTEVE  
FARMACEUTIKE TË GATSHME NË LABORATORIN  
MAGJISTRAL**

*Prof. Asoc. Zehadin Gashi<sup>1</sup>, Prof. Ledjan Malaj<sup>2</sup>, MSc. Drilon Gashi<sup>3</sup>*

*<sup>1</sup>Alma Mater Europaea, Campus College “Rezonanca”, Prishtinë*

*<sup>2</sup>Fakulteti i Mjekësisë, Departamenti i Farmacisë*

*<sup>3</sup>Barnatore “Barkos”, Prizren*

Tregu farmaceutik, të shumtën e rasteve, nuk posedon të gjitha format e produkteve farmaceutike. Ekzistojnë forma farmaceutike që në momente të caktuara mungojnë. Kjo ka bërë që laboratorit magjistrat të jetë një mundësi e mirë për transformimin e produkteve të gatshme në forma farmaceutike të dëshiruara.

Qëllimi i punimit: Qëllimi i këtij punimi është që të paraqesim mundësinë e transformimit të produkteve të gatshme farmaceutike në forma farmaceutike të dëshiruara.

Metoda e hulumtimit: Si material për përgatitje janë marrë produktet farmaceutike industriale, mjediset shpërndarëse për këto forma farmaceutike, si: shurupi i thjeshtë dhe formulimet e gatshme Ora-Plus, Ora-Sweet dhe Ora-Blend, ambalazhi dhe mjetet e punës në laboratorin magjistrat.

Nga format farmaceutike, të cilat janë përgatitur në laborator, kanë qenë 6 formulime farmaceutike pezulli, të cilat janë analizuar lidhur me stabilitetin fizik dhe mikrobiologjik. Të gjitha këto produkte të përgatitura kanë treguar një qëndrueshmëri të mirë fizike dhe mikrobiologjike në afat deri në 10 ditë.

Diskutimi: Bazuar në stabilitetin e tyre, të krahasuar edhe me literaturën nga farmacia pediatrike, këto preparate kanë treguar veprim të mirë terapeutik, si dhe lehtësim në mënyrën e përdorimit



## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

qoftë për pacientët pediatrikë, qoftë për pacientët të cilët kanë pasur probleme në qëllitjen e barnave.

**Konkluzioni:** Si konkluzion mund të themi se transformimi i produkteve të gatshme në forma farmaceutike të dëshiruar në laboratorin magjistral është i mundur dhe ofron mundësin e mirë për zëvendësimin dhe lehtësimin e përdorimit të tyre.

**Rekomandimi:** Mbështetur edhe nga të dhënat e literaturës, rekomandojmë që këto forma farmaceutike, në raste kur nuk ekziston mundësia për t'i gjetur të gatshme në treg, të përgatiten në laboratorin magjistral.

**Fjalë kyçe:** produkte të gatshme, forma farmaceutike, mjedis shpërndarës.

### HARTIMI DHE VLEFSHMËRIA E INSTRUMENTIT PËR PËRGATITJE TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM SIPAS GMP NËPËRMES METODËS DELPHI

*Edita Alili-Idrizi<sup>1</sup>, Sihana Ahmeti-Lika<sup>1</sup>, Merita Dauti<sup>1</sup>, Lulzime Ballazhi<sup>1</sup>, Drita Yzeiri Havziu<sup>1</sup>*

*<sup>1</sup>Programi studimor Farmaci, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti i Tetovës, RMV*

*\*Autor korrespondues: edita.alili@unite.edu.mk*

Hyrje dhe qëllimi: Praktika e mirë e prodhimit (GMP) përbën një grup standardesh dhe kërkesash që prodhuesit farmaceutik duhet të plotësojnë për të siguruar prodhimin e përgatesave me cilësi të lartë, të sigurt dhe efektive. Një mënyrë për të siguruar përmbushjen e këtyre standardeve është realizimi i një auditimi të brendshëm, si një hallkë themelore e sistemeve të menaxhimit në industrinë

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

farmaceutike. Një listë kontrolli është një instrument i mirë për të ndihmuar në kryerjen e një auditimi të thelluar dhe të qëndrueshëm në një mënyrë sistematike, që do të adresojë pikat kritike të nevojshëm për të përmbushur kërkesat e GMP. Kështu, qëllimi i këtij studimi ishte hartimi i një instrumenti efektiv që do të ndihmojë në procesin e auditimit të brendshëm për një prodhues të përgatesave të gatshme farmaceutike dhe validimi i përmbajtjes së tij duke përdorur metodën Delphi.

Materiale e metoda: Instrumenti është një listë kontrolli, dhe përmban 45 pyetje që lidhen me Praktikën e Mirë të Prodhimit (GMP). Pyetjet për versionin e parë të instrumentit u përpiluan duke u bazuar në rezultatet nga rishikimi i literaturës dhe artikujve të publikuar në bazat e të dhënave Scopus dhe PubMed. Një panel i përbërë nga 10 ekspertë nga industria farmaceutike, autoritetet dhe universiteti u rekrutua për të vlerësuar vlefshmërinë e përmbajtjes së instrumentit nëpërmes qarkullimit Delphi të listës së kontrollit.

Rezultate: Të gjithë 10 ekspertët e kthyen të plotësuar instrumentin, me nivele të pajtimit për pyetjet që varionin nga 78% deri në 100%. Të gjithë 45 pyetjet plotësonin kriteret e paracaktuara të pranueshmërisë (75%). Pothuajse të gjitha pyetjet (43 nga gjithsej 45) u konsideruan thelbësore nga secili anëtar i panelit të ekspertëve. Vetëm 2 nga 45 pyetjet që u propozuan për t'u riformuluar u ridërguan në një qarkullim shtesë Delphi. Rezultatet e studimit tonë tregojnë se vlefshmëria e përmbajtjes së instrumentit të hartuar për procesin e auditimit të brendshëm ishte shumë e mirë. Përfundime: Sipas vlerësimeve nga paneli i ekspertëve, instrumenti i propozuar është i vlefshëm dhe i gatshëm për t'u përdorur në përgatitjen e auditimit të brendshëm dhe të sigurojë informacion bazë për prodhuesin e përgatesave të gatshme farmaceutike dhe sistemin e tij të menaxhimit të cilësisë.

*Fjalët kyçe:* Auditim i brendshëm, GMP, listë kontrolli, metoda Delphi.



**STUDIMI I MODIFIKIMIT TË CILËSIVE TË POLIMERIT  
PVA, ME MUNDËSI APLIKIMI PËR INKAPSULIMIN E  
BARNAVE MJEKËSORE.**

*Partizan Malkaj<sup>1</sup>, Ledjan Malaj<sup>2</sup>, Albana Hasimi<sup>1</sup>, Eni Bushi<sup>2</sup>,  
Brunilda Myftari<sup>2</sup>, Gentjan Mataj<sup>2,3</sup>, Suela Këllici<sup>2</sup>, Erjon Troja<sup>2</sup>*

*<sup>1,2,3</sup> Universiteti Politeknik i Tiranës; Universiteti i Mjekësisë, Tiranë;  
Njësia NanoALB, Akademia e Shkencave e Shqipërisë. <sup>2</sup> Universiteti  
i Mjekësisë, Tiranë, <sup>3</sup>Profarma sh.a.*

*Hyrje:* Gjatë viteve të fundit janë bërë shumë përpjekje për zhvillimin e membranave të reja artificiale polimerike, të cilat plotësojnë kushtet e domosdoshme për përdorime të ndryshme biomjekësore [1]. Një nga polimerët më të testuar është Poli (vinil alkool) [PVA], i cili ka gjetur aplikime edhe në fushën e farmaceutikës, sepse një polimer i tillë njihet për vetitë e tij jotoxike.

*Qëllimi:* Studimi ynë synon të vlerësojë mundësinë e përfuturit të membranave me bazë PVA dhe e modifikimit të vetive të tyre duke shtuar argjila shqiptare (Montmorillonite [MMT], me qëllim përdorimin e këtyre kompozimeve në inkapsulim të produkteve farmaceutikale.

*Materialet dhe metoda:* Polimeri kokrizor PVA tretet në ujë duke iu nënshtruar procesit të përzierjes. Procesi vazhdon me shtimin e argjilës shqiptare në sasi të caktuara. Studimi i vecorive mekanike të membranave u realizua me anë të teknikave Differential Scanning Calorimetry (DSC). Mostrat priten në pjesë me përmasa rreth 2 mm dhe me masë 5-10 mg, duke u trajtuar termikisht nga 25 në 300 °C. Ky proces pasohet nga ftohja 300 në 25 °C, sipas një procedure të caktuar. Studimi i morfologjisë së membranave të prodhuara bëhet nëpërmjet teknikës së Scanning Electron Microscopy (SEM). Produkti i nështrohet edhe teknikave të tjera karakterizuese. Gjithashtu është studiuar edhe procesi i difuzionit të ujit në keto membrana.

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

*Rezultatet:* Metoda e karakterizimit me DSC tregon se prania e argjilës shqiptare në përqëndrime të ndryshme të polimeri PVA shkakton ndryshim të vlerës së temperaturës së ngurtesimit (Tg) si dhe atë të cilësisë së kristalizimit. Teknika SEM konfirmon efektin e përqëndrimeve të ndryshme të argjilës, sepse në nanofazë vërehet krijimi i zonave të dallueshme të ndara të PVA dhe argjilës. Membranat ruajnë qëndrueshmërinë e tyre mekanike në rastin e përqëndrimit në masën 0.5% të argjilës. Po kështu, këto membrana shfaqin cilësi të mira përsa i përket difuzionit të ujit, c'ka e tregojnë edhe diagramat e Fick-ut. Studimi tregon se prania e argjilës nuk shkakton krijimin e lidhjeve të reja apo hibride me PVA. Një fakt të tillë e vërteton edhe teknika e karakterizimit me rreze infra të kuqe (FT-IR).

*Përfundime:* Kërkimet tona të deritanishme tregojnë se mebranat e përgatitura nga PVA me përmbajtje argjile shqiptare, paraqesin vecori të mira mekanike, c'ka i bën ato të pershtatshme për tu përdorur si materiale inkapsulimi në produktet farmaceutikale.

***\* Ky botim është realizuar në kuadër të projektit “Përdorimi i një sistemi polimerik në optimizimin e biodisponibilitetit të barnave. Zhvillimi industrial i një bari cilësor dhe kosto-efikas për popullatën shqiptare” dhe është pronë e institucionit financues të grantit (AKKSHI).***



**FORMULIMI I TABLETAVE ME ÇLIRIM TË VONUAR TË  
DIKLOFENAK NATRIUMI DUKE PËRDORUR NJË  
SISTEM POLIMERIK**

*Entela Muça, Ertol Muzina, Eni Bushi, Ledjan Malaj, Brunilda Myftari, Gentjan Mataj, Partizan Malkaj, Erjon Troja, Suela Këlliçi*

*Profarma sh.a., Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë,  
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë*

Diklofenak Natriumi, një bar jo-steroidal anti-inflamator, i përdorur në raste të dhimbjeve të lehta deri në të moderuar, njihet për efektet anësore serioze, të shtuara në traktin gastro-intestinal siç janë gjakderdhjet, ulçërat gastrike etj. Në studimin tone aktual, për të evituar problemet gastrike, u formulua Diklofenak natriumi si tabletë e veshur me film gastro-rezistent.

Tabletat gastro-rezistente të Diklofenak natriumit, 50mg, u realizuan duke përdorur mikrokristaline celuloze (Microcel 102) 45%, amidon të prexhelatinizuar (Starch 1500) 30%, glikolat natriumi i amidonit 2% dhe stearat magnezi 1%. Acryl-EZE® (acid kopolimer metakrilik), një system ujqor enterik akrilik, u përdor si material veshës. Tabletat e diklofenak natriumit u veshën me shtresën enterike në përqëndrime të ndryshme (5%, 7.5%, 10%), për të përcaktuar një formëdozë gastro-rezistente të qëndrueshme.

Testi i disolucionit u realizua në bazë të USP 44, duke përdorur si medium të fazes acide, HCl 0.1N dhe medium të fazes së buferit, buffer fosfat pH 6.8. Për çdo variacion u analizuan vetitë fizike, përmbajtja sasiore dhe papastërtitë e tabletave gastro-rezistente.

*\* This study is part of the project "Use of a polymeric system to optimize the biodisponibility of drugs. The industrial development of a quality and cost-efficient drug for the Albanian population." and is not for sale but is the property of the grant finance institution.*



**NDËRVEPRIMET ME NDIKIM MBI  
BIODISPONIBILITETIN E BARNAVE ANTI  
INFLAMATORE JO STEROIDALE**

*Suela Këlliçi, Ledjan Malaj, Eni Bushi, Brunilda Myftari, Gentjan Mataj, Partizan Malkaj, Erjon Troja*

*Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë*

Barnat anti inflamatore jo steroidale (AIJS) janë një grup barnash me përdorim jashtëzakonisht të gjerë në praktikën mjekësore. Një pjesë e këtyre barnave gjenden edhe si produkte OTC duke bërë të mundur aksesin e shtuar të pacientëve për to si dhe probabilitetin e shtuar për keqpërdorim të këtyre barnave. Prevalenca e përdorimit të AIJS në popullatën mbi 65 vjeç llogaritet në mbi 90%.

Mekanizmi i veprimit të AIJS si frenues të ciklooksigenazave në organizëm sjell një sërë efektesh farmakologjike të ndërmjetësuar nga përndryshimet në sintezën e prostaglandinave, prostaciklinave dhe tromboksanit. Të njëjtët mekanizma çojnë gjithashtu në zhvillimin e efekteve anësore të këtyre barnave, të cilët konsistojnë kryesisht në efekte gastro intestinale dhe të sistemit kardio vaskular.

AIJS janë akuzuar gjithashtu si barna me potencial të lartë të ndërveprimeve medikamentoze si dhe të ndërveprimeve bar-ushqim. Sigurimi i biodisponibilitetit të këtyre barnave është me rëndësi të veçantë për suksesin e terapisë medikamentoze si dhe për parashikimin e efekteve të mundshme anësore.

Njohja e faktorëve që mund të çojnë në modifikimin e biodisponibilitetit të këtyre barnave përbën domosdoshmëri nga ana e mjekut dhe e farmacistit, në mënyrë që të optimizohet terapia medikamentoze me këto barna. Aq më tepër në vitet e fundit në

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

kushtet e rritjes së jetëgjatësisë, rritjes së sëmundshmërisë kronike, aplikimit të shtuar të politerapisë dhe pranisë gjithnjë e më të lartë të produkteve medikamentoze. Optimizimi i terapisë së AIJS përbën një aktivitet multidisiplinar ku secili profesionist duhet të njohë dhe të ushtrojë rolin e tij.

*\* This study is part of the project" Use of a polymeric system to optimize the biodisponibility of drugs. The industrial development of a quality and cost-efficient drug for the Albanian population." and is not for sale but is the property of the grant finance institution.*

### **NJË RRUGË E LEHTË PËR ZBATIMIN E SISTEMEVE ME PËRDORIM TË VETËM NË PRODHIMIN E PRODUKTEVE TË MEDIKAMENTEVE NË INDUSTRIJË FARMACEUTIKE**

*\*Prof. ass. Dr. Ylber Qusaj, MSAT Expert Drug product*

*\*Lonza AG, Schaffhauserstrasse 101, CH - 4332 Stein, Switzerland  
(ylber.qusaj@lonza.com)*

*\*Kolegji i Shkencave Mjekësore – Rezonanca, Prishtina, Kosove  
(ylber.qusaj@rezonanca-rks.com)*

Hyrja dhe qëllimi: Që nga fillimi i tyre në prodhimin e produkteve të barnave, sistemet me përdorim të vetëm (SUS) kanë evoluar dhe përmirësuar falë lidhjes së vazhdueshme midis shitësve dhe prodhuesve biofarmaceutikë, duke akomoduar një gamë të gjerë nevojash operationale. Nga fillimi i kulturës në kontainer me vëllim të vogël, tek bioreaktorët e prodhimit në shkallë të gjerë, përgatitja e solu-cioneve kimike, përbërja dhe mbushja e produktit

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

medikamentoz, zbatimi i teknologjive me një përdorim është një nismë kyçe që po ndërmarrin shumë kompani farmaceutike. Shkallëzimi, fleksibiliteti, kostot më të ulëta të shërbimeve, investimet e reduktuara kapitale dhe rreziku i reduktuar i kontaminimit janë avantazhet kryesore të ofruara nga sistemet e disponueshme.

**Metodologjia:** Pavarësisht nga lloji i pajisjeve të përdorura, suksesi i operacioneve prodhuese varet kryesisht nga adoptimi i një procesi biznesi efikas të kombinuar me teknologjinë e duhur operacionale, kryesisht automatizimin e impianteve, sistemet e ekzekutimit të prodhimit (MES), aplikimet e planifikimit dhe planifikimit, dhe analitika e të dhënave.

**Rezultatet:** Miratimi i sistemeve me përdorim të vetëm dikton që prodhuesit farmaceutike të rimendojnë praktikatat e tyre ekzistuese si dhe specifikimet e kërkesave të përdoruesit (URS) të të gjitha sistemeve elektronike të përfshira në procesin e prodhimit, duke mundësuar ekzekutimin optimal dhe arritjen e përfitimeve shtesë. Ndër fushat kryesore që kërkojnë ekzaminim dhe ripërkufizim të afërt janë: planifikimi i hapave të rinj të procesit që rrjedhin nga inspektimi dhe montimi i SUS; receta automatizimi për të lejuar pauza dhe aktivitete manuale; konfigurimi dhe mirëmbajtja e të dhënave kryesore në mjetet e Planifikimit të Burimeve të Ndërmarrjes (ERP); menaxhimi i materialit në MAS; përcaktimi i modeleve realiste për të vlerësuar kontributin e mundshëm të sub-stancave të Leachables dhe Extractable (L/E).

**Përfundimet:** Zbatimi i Sistemeve me një përdorim (SUS) fillon me një përzgjedhje efektive të komponentëve me një përdorim. Fokusi i këtij punimi do të jetë gjetja e një rruge të lehtë në hartimin dhe kualifikimin e produkteve të disponueshme për përdorimin e tyre të duhur në një proces, me theks të veçantë në çështjet për të cilat rregullatorët kanë shprehur shqetësime, duke përfshirë të nxjerrshmerin dhe leachabilitetin e produktit, dhe duke theksuar kriteret për përzgjedhjen dhe kualifikimin e komponentëve me përdorim të vetëm. Vlerësimi thekson metodat e menaxhimit të



## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

rrezikut për të identifikuar komponentët me përdorim të vetëm që janë më të kualifikuar për të përbushur kërkesat e proceseve tuaja.

**Fjalët kyçe:** Single Use Systems, Biologics Manufacturing, Biopharmaceutical Manufacturing Single-Use Bags, Bioreactors, Single Use Technologies, Contamination, Disposable Systems, Plant Automation, Execution Systems, MES, Data Analytics, Manufacturing Process, Extractables and Leachables, SUT, SUS, Disposables.

### ROLI I FARMACISTIT NË KËSHILLIMIN E PACIENTËVE PËR VETËMJEKIMIN E SËMUNDJEVE TË LËKURËS ME KORTIKOSTEROIDE

*Prof. Asoc. Zehadin Gashi<sup>1</sup>, MSc. Drilon Gashi<sup>2</sup>*

<sup>1</sup>*Alma Mater Europaea, Campus College “Rezonanca”, Prishtinë*

<sup>2</sup>*Barnatore “Barkos”, Prizren*

Kohëve të fundit vetëmjekimi i pacientëve me kortikosteroide për lëkurë po bëhet gjithnjë e më shumë. Kjo për faktin se veprimi i tyre në lëkurë është i shpejtë, sidomos te proceset e sëmundjeve inflamatore.

Qëllimi i punimit: Është të analizojmë vetëmjekimin e sëmundjeve të lëkurës me kortikosteroide, bazuar në mekanizmin e veprimit, qëllimin dhe mënyrën e përdorimit, për të nxjerr në pah rolin e farmacistit lidhur me këshillimin për përdorimin e tyre.

Metoda e hulumtimit: Është bazuar në analizën e marrjes së këtyre preparateve sipas kategorive nga ana e pacientëve pa u vizituar te

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

mjeku dhe anketa me pacientët të cilët kanë kërkuar këto produkte lidhur me njohjen e veprimit dhe mënyrës së përdorimit.

Diskutimi: Në analizën e kërkesave të 80 pacientëve për kortikosteroide, rezultoi se më së shumti janë përdorë kortikosteroide të grupit të parë dhe të dytë, siç janë: derivatet e hidrokortizonit, betametazoni, fluocinoloni etj. Bazuar në format farmaceutike të kortikosteroideve, si: pomadat, kremrat dhe xhelet, pacientët nuk kanë pasur njohuri se cila formë duhet të përdoret për sëmundjen dhe gjendjen momentale të lëkurës. Sa i përket njohurive lidhur me indikacionet dhe kontraindikacionet, mënyrën e veprimit dhe mënyrën e përdorimit, përgjigja e tyre më tepër ka qenë nga njohuritë e përdorimit të pacientëve paraparak se sa njohurive elementare lidhur me përdorimin e tyre.

Konkluzioni: Si konkluzion mund të themi se pacientët i përdorin kortikosteroidet pa udhëzimin e mjekut dhe pa pasur njohuritë elementare lidhur me mjekimin dhe mënyrën e përdorimit.

Rekomandimi: Rekomandojmë që farmacistët mos të lejojnë dhënien e tyre pa recetë, në veçanti pa dhënien e udhëzimeve lidhur me indikacionet, mënyrën e veprimit, rreziqet dhe mënyrën e drejtë të përdorimit.

**Fjalë kyçe:** kortikosteroide, vetëmjekim, pacient.

**MJALTI, E ARDHMJA NË PËRDORIMET  
FARMACEUTIKE PËR MJEKIMIN E PLAGËVE SFIDUESE**

*Kleva Shpati, Erda Qorri, Aida Dama, Aurora Napuce, Nilena Eriksen, Erina Hilaj, Edlira Kaloshi, Xhesika Shehu, Matilda Keci*

*Departamenti Farmacisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Albanian University*

Hyrje: Mjalti është një produkt natyral që është futur së fundmi në praktikës moderne mjekësore. Janë rishikuar studimet mbi efektet terapeutike në plagët e lëkurës, ulcerat e lëkurës dhe stomakut dhe djegiet dhe janë diskutuar mekanizmat e veprimit. Vetitë antibakteriale të mjaltit dhe efektet e tij në shërimin e plagëve janë hetuar tërësisht. Studimet laboratorike dhe provat klinike kanë treguar se mjalti është një agjent efektiv antibakterial me spektër të gjerë.

Qëllimi: Nëpërmjet këtij punimi, ne kemi rishikuar të dhënat që mbështesin efektivitetin e mjaltit natyral në shërimin e plagëve dhe aftësinë e tij antibakteriale në plagët e infektuara sfiduese.

Rezultate dhe Diskutime: Formulimi bazë është mjaltin e Tropojës dhe nanoeksipientët, i cili njihet si formues i një nanosistemi me trientanolemaninë. U provua se qëndrueshmëria, pH dhe viskoziteti ishin të pandryshueshëm gjatë ruajtjes. Literatura e fundit evidenton që problemet që lidhen me shërimin e plagëve sfiduese, ulçerave dhe djegieve të pashëruara ka një ndikim të madh në shëndetin cilësinë e jetës së pacientëve si dhe në ato ekonomike. Shumë ndërhyrje, duke përfshirë barna dhe teknologji të reja, po përdoren, një ndër to edhe nanoteknologjia për të ndihmuar në arritjen e shërimit të konsiderueshëm të plagëve të vështira dhe për të eliminuar infeksionet. Prandaj, gjetja e një ndërhyrjeje që ka një efekt terapeutik në procesin e shërimit dhe aftësinë për të vrarë mikrobet ka një vlerë të madhe, madje ulçerat dhe djegiet përfshihen si shembull i plagëve

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

sfiduese. Studimi ynë rikonfirmoi vetitë shëruese të plagëve të duke përdorur mjaltin natyral, duke përfshirë stimulimin e rritjes së indeve, rritjen e epitelizimit dhe minimizimin e formimit të plagëve. Këto efekte i atribuohen aciditetit të mjaltit, përmbajtjes së peroksidit të hidrogjenit, efektit osmotik, përmbajtjes ushqyese dhe antioksiduese, stimulimit të imunitetit dhe përbërësve të paidentifikuar dhe nanoeksipentëve. Prostaglandinat dhe oksidi nitrik luajnë një rol të madh në inflamacionin, vrasjen e mikrobeve dhe procesin e shërimit. U zbulua se mjalti ul nivelet e prostaglandinës dhe rrit produktet përfundimtare të oksidit nitrik. Këto veti mund të ndihmojnë për të shpjeguar disa veti biologjike dhe terapeutike të mjaltit, veçanërisht si një agjent antibakterial ose shërues i plagëve.

**Konkluzione:** Rezultatet inkurajojnë përdorimin e mjaltit në praktikën klinike si një shërues natyral dhe i sigurt i plagëve sfiduese.

**Fjalë kyçe:** mjalti, terapi e së ardhmes, mekanizëm veprimi, plagë të vështira

## EKSTRAKTET BIMORE SI ANTIOKSIDANTE NATYRORE NË PRODUKTET KOZMETIKE

*Rezarta Shkreli<sup>1</sup>, Sarah Malolli<sup>2</sup>, Klodiola Dhamo<sup>3</sup>*

<sup>1</sup>*Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti Aldent, Tiranë*

<sup>2</sup>*Farmaci rrjeti hapur, Tiranë*

<sup>3</sup>*Departamenti Laborant Mjekësor dhe Imazheri, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti Aldent, Tiranë*

**Hyrje:** Për shekuj me radhë produktet natyrore janë përdorur tradicionalisht në kujdesin e lëkurës. Kërkimet e fundit shkencore

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

fokusohen në hulumtimin e principeve bioaktive natyrore me funksion jo vetëm promovimin e kujdesit ndaj lëkurës por edhe mbrojtjen ndaj faktorëve të jashtëm të dëmshëm, si: rrezatimi ultraviolet dhe radikalet e lira. Radikalet e lira, ROS, përmes demtimeve indore ulin efektin mbrojtës të lëkurës dhe përshpejtojnë plakjen e saj. Interesi i shtuar ndaj fitokimizmit natyror lidhet pikërisht me materialet bimore si antioksidantë natyrore, të tilla si: polifenolet, tokoferolet, karotenoidet, vitaminat, vajrat esenciale etj.

Qëllimi: Qëllimi i këtij rishikimi ishte të përshkruajë rolin e radikaleve të lira dhe stresit oksidativ në fiziologjinë dhe plakjen e lëkurës, dhe të diskutojë rolin e përbërjeve të zgjedhura bioaktive antioksiduese në produktet kozmetike.

Materiale dhe metoda: Një rishikim sistematik i literaturës së publikuar në anglisht u realizua duke përdorur udhëzuesit për “Systematic and Meta-Analysis Reviews”. Hulumtimi u realizua në sitet shkencore: PubMed, Web of Science, Research Gate dhe Medline për periudhën kohore janar 2018 deri në dhjetor 2022, duke patur në fokus studime që evidentonin efektin antioksidant të principeve me origjinë bimore.

Rezultate: Një numër bimësh mjekësore janë tashmë të njohura për përmbajtjen në përbërës antioksidues të cilët mund të reduktojnë stresin oksidativ të shkaktuar nga rrezatimi dhe prania e oksigjenit. Në ditët e sotme shumë produkte kozmetike kanë në përmbajtje ekstrakte bimore: çaji jeshil, rozmarina, fara e rrushit, farat borzilokut, boronicë etj. Studimet e marra në rishikim tregojnë që polifenolet, flavonoidet, antocianinat, stilbenet, terpenet, karotenoidet dhe vajrat esenciale janë antioksiduesit natyrore më të zakonshëm. Në grupin e antioksidantëve primarë ose antioksidantët natyrore bëjnë pjesë: antioksidantët minerale: selenium, baker, hekur, zink, dhe magnez (kofaktor i antioksidanteve enzimatik), vitaminat (C dhe E), dhe fito-antioksidantët me origjinë bimore. Në grupin e antioksidantëve sekundarë ose ndryshe antioksidantët sintetikë të cilët frenojnë zinxhirin e formimit të radikaleve të lira bëjnë pjesë:

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

butilhidrokinone, butilhidroksitolueni, galatet, butilhidroksianisoli etj.

Përfundime: Një nga epërsitë e komponimeve natyrore është efekti antioksidant dhe aftësia e tyre për të parandaluar çrregullimet në lëkurë nga rrezatimi UV, të cilat çojnë në plakjen e parakohshme të lëkurës e deri në melanome. Megjithëqë bimët aromatike dhe mjekësore zotërojnë një potencial mbrojtës ndaj lëkurës, akoma nevojiten evidenca kërkimore dhe klinike, kjo për arsyen e mosnjohjes së saktë të efikasitetit dhe sigurisë së shumë ekstrakteve bimore.

**Fjalë kyçe:** antioksidant natyror, polifenole, flavonoide, tokoferole, karotenoide, vajra esenciale, vitamina

## TRENDI I PËRDORIMIT TË DERMOKOZMETIKËVE

### GJATË VITIT 2020 NË SHQIPËRI

*Dr. Eftiola Pojani<sup>1\*</sup>, Prof. Asoc. Silvi Bozo<sup>1</sup>*

*<sup>1</sup>Departamenti i Teknologjive Kimiko-Farmaceutike dhe Biomolekulare, Fakulteti i Farmacisë Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”*

Hyrje: Roli i dermokozmetikëve në kujdesin e lëkurës ka evolura, kjo e mbështetur nga qasja e shtuar e individëve përkundrejt kujdesit lidhur me mirëmbajtjen dhe trajtimin e duhur të patologjive të ndryshme që prekin lëkurën<sup>1</sup>. Zgjedhja e produkteve të duhura dermokozmetike është thelbësore në kontrollin dhe parandalimin e shumë problematikave të lëkurës<sup>2</sup>. Duke qenë se për këto produkte ka një kërkesë dukshëm në rritje në mbarë botën<sup>3</sup>, qëllimi i këtij studimi

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

është përpjekja për të kuptuar dhe raportuar trendin e përdorimit të dermokozmetikëve në Shqipëri.

**Materiale e metoda:** Për të përmbushur objektivat e këtij studimi, të dhënat lidhur me frekuencën e përdorimit të dermokozmetikëve janë ofruar nga distributori farmaceutik Pharma One Shpk. Të dhënat e marra në konsideratë i përkasin periudhës nga 1 janari 2020 deri më 31 dhjetor 2020 dhe i referohen frekuencës me të cilën këto produkte janë porositur nga farmacitë e rrjetit të hapur që operojnë në qarqe të ndryshme brenda territorit shqiptar.

**Rezultate:** Numri total i dermokozmetikëve të porositur nga farmacitë e rrjetit të hapur gjatë vitit 2020 ka qenë 4438 njësi. Produktet më të porositura rezultuan të ishin dermokozmetikët e rekomanduar për lehtësimin e simptomave të inflamacionit, thatësisë dhe parehatisë si edhe ato të përshkruara për trajtimin e dermatit atopik dhe *psoriasis*. Përkatësisht pomadat me përmbajtje betametazon dipropionate dhe acidi salicilik rezultuan më të porositurit (31%), shoqëruar nga kremrat me përmbajtje vazeline dhe parafine (23.5%) si edhe ato me përmbajtje glicerinë, acidi hialuronik dhe zink sulfat (12.8%). Ndërkohë kremrat e rekomanduar për llojet e lëkurës me tendencë akneike rezultuan më pak të kërkuarat (0.05%).

**Përfundime:** Përdorimi i dermokozmetikëve për një sërë çrregullimesh të lëkurës është ngushtësisht i lidhur me faktorë si statusi socio-ekonomik, stili i jetesës, kushtet mjedisore dhe mbivendosja e patologjive të tjera që prekin lëkurën<sup>4,5</sup>. Duke analizuar shpeshësinë e porosive të këtyre produkteve për vitin 2020, duket se tregu shqiptar po has një kërkesë të gjerë krahasuar me një dekadë më parë. Diagnostikimi i hershëm si dhe fokusi ndaj formulimeve të reja që mund të çojnë në pajtueshmëri më të madhe, janë objektiva të së ardhmes.

**Fjalët kyçe:** dermokozmetikë, frekuenca, farmaci të rrjetit të hapur, patologji të lëkurës.

**ROLI I PRODUKTEVE KOZMETIKE DHE  
KOZMECEUTIKE NË SINERGJI ME PREPARATET  
FARMACEUTIKE, NË PARANDALIMIN DHE  
MENAXHIMIN E SIMPTOMAVE KLINIKE TË ACNE  
VULGARIS**

*Iva Vaso*

*Farmaciste, Mjeke Estetiste*

AV është një çrregullim multifaktorial, me natyrë inflamatore, ku do të përfshihen androgjenët dhe hormone të tjera të aksit hormonal, prezenca e patologjive të mundshme të aparatit riprodhues, shprehja e gjeneve, sistemi nervor, faktorë ambjentalë, stili i jetesës dhe faktorë të tjerë fiziologjikë. Sipas rasteve të ndjekura dhe të studiuara “in-vivo”, në këtë punim propozohet, rëndësia e produkteve kozmeceutike e kozmetike, terapitë periodike dermo-estetike në klinikë, në sinergji me terapitë farmaceutike topike dhe/ose orale, kombinuar me ekzaminimet e duhura mjekësore (kur duhen), stilin e jetesës dhe higjënën personale, në ruajtjen dhe përmirësimin e barrierës epidermale, që do të rezultojë në parandalimin dhe përmirësimin e shenjave klinike të AV.

Hyrje: Një nga problemet më të mprehta të lëkurës në kohët tona janë aknet. Edhe pse, patogjeneza e AV kërkon ende studime të mëtejshme, në këtë studim do të vërtetojmë përmes rasteve klinike “in vivo” se, suksesi në parandalimin dhe përmirësimin e simptomave klinike të AV arrihet përmes ndërthurjes së trajtimeve dhe terapive dermo-kozmetike në kushte klinike, ekzaminimeve mjekësore dhe terapive farmaceutike (kur duhen), një rituali kozmetik dhe kozmeceutik të personalizuar, sikurse, një stil i shëndetshëm jetese dhe higjënës personale.

Objektivat: Të dëshmohet, përmes studimeve “in-vivo”, roli i produkteve kozmeceutike e kozmetike profesionale dhe trajtimeve periodike estetike mjekësore, të kombinuara me preparate farmaceutike (kur duhen), në parandalimin, përmirësimin dhe menaxhimin e shenjave klinike të AV. Përkujdesja ndaj lëkurës së



## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

yndyrshme dhe/ose akneike. Kombinimi, aplikimi dhe përdorimi i duhur i produkteve kozmetike, kozmeceutike dhe farmaceutike, si faktorë përmirësues dhe ndihmues në menaxhimin dhe trajtimin e simptomave të akneve. Stili i jetesës dhe higjena personale, si faktorë përmirësues në AV.

Materiale dhe metodat: Në studim morën pjesë 40 pacientë akneikë, Grada I e II, ku, 20 prej tyre iu nënshtruan trajtimeve dhe terapive dermoestetike në kushte klinike kombinuar me ritualin kozmetik dhe kozmeceutik në kushte shtëpie si dhe rekomandimi për një dietë ushqimore me fokus tek lëkurat e yndyrshme dhe/ose akneike. Pjesa tjetër e pacientëve u trajtua lokalisht/oralisht përmes terapisë farmaceutike (jo në të gjitha rastet), pa fokus në terapitë klinike dhe atë në përditshmëri dhe pa ndjekur një dietë të posacme për reduktimin e yndyrës.

Rezultate dhe Perfundime: Produktet kozmetike dhe kozmeceutike, të cilat iu rekomanduan pacientëve, për krijimin e një rituali të përditshëm, ndihmuan në ekuilibrimin e yndyrës, hidratim dhe në tolerimin më efikas të produkteve farmaceutike topike/orale. Terapitë e përjavshme klinike ndikuan jo vetëm në përmirësimin e simptomave të AV në një kohë shumë më të shkurtër, por, edhe në përmirësimin e cikatriceve dhe hiperpigmentimeve postinflamatore. Pastrimi i thellë profesional i lëkurës në kohën e duhur fiziologjike reduktoi ndjeshëm incidencën e formimit të papulave dhe pustulave në lëkurën, ekuilibroi yndyrën, rivendosi pH fiziologjik të lëkurës, duke forcuar imunitetin e saj. Stili i jetesës dhe higjena e duhur personale ndikuan në reduktimin e yndyrës si, edhe në uljen e shfaqjes së simptomave klinike të akneve.

**ZHVILLIMI I FORMULIMIT TË MINOKSIDIL 2% DHE 5%  
TRETËSIRË PËR SKALPIN**

*Ledia Kushi, Entela Muça, Ardita Emiri, Albana Pellumbi, Blerina Hazballa*

*Profarma sh.a.*

Minoksidili është një agjent hipertensiv që përdoret gjerësisht në pacientë me raste hipertensionit të rëndë dhe refraktor që nuk i përgjigjen terapive konvencionale. Minoksidili gjithashtu përdoret si trajtim topikal në alopeci në androgjenike në meshkuj dhe femra në rritje dhe stabilizimin e rënies së flokëve.

Përthithja pre-kutane e minoksidilit shfaqet minimale, pas aplikimit topical të solucionit të minoksidilit në skalpin e padëmtuar. Absorbimi sistematik i minoksidilit topical varion dhe varet nga disa faktorë që përfshijnë transportuesin në formulim, vendin e aplikimit, gjendjen e lëkurës dhe variacionet të tjera interindividuale. Në mënyrë të veçantë është i aftë të veprojë në enët e gjakut duke favorizuar oksigjenimin dhe ushqyerjen e folikulit të flokut.

Objekti i këtij studimi është formulimi i tretësirave Minoxidil 2% dhe 5% për skalpin, duke përdorur instrumente laboratorike, të përshtatshme për prodhim në seri, me biodisponibilitet të përshtatshëm. Studimi tregon hapat që janë ndjekur për të arritur në formulimin përfundimtar të solucionit topikal, i cili kalon provat e stabilitetit.

**INOVACIONI NË RECETAT E RIMBURSUESHME NË SHQIPËRI: PËRPARIMET, TENDENCAT DHE NDIKIMI NË KUJDESIN SHËNDETËSOR. NJË UDHËRRËFYES PËR TË ARDHMEN.**

*Jurgen Babamusta, Ilda Babamusta*

Hyrje dhe qëllimi: Recetat e rimbursueshme luajnë një rol kritik në ofrimin e kujdesit shëndetësor në Shqipëri, duke siguruar qasje të barabartë për barnat dhe trajtimet e nevojshme për pacientët. Në këtë temë, do të sygjerojmë përmirësimet që mund të kemi në recetat e rimbursueshme në Shqipëri, duke adresuar përparimet, tendencat dhe ndikimin e tyre në kujdesin shëndetësor në vend.

Metodologjia: Ky studim është një analizë në përditshmërinë e farmacistit dhe është i bazuar në informacionet e marra nga farmacistët e mbi 50 farmacive të rrjetit të hapur. Ai vjen si një analizë cilësore e procesit ekzistues të rimbursimit, duke përfshirë reagimet nga profesionistët e kujdesit shëndetësor, farmacistët dhe pacientët. Për më tepër, ai krahasohet me standardet e BE-së për të identifikuar boshllëqet dhe mundësitë për përmirësim.

Rezultatet: Rezultatet e këtij vëzhgimi nënvizojnë ndikimin e rëndësishëm që ka mënyra e konceptimit të recetës si në kohën dedikuar pacientit në farmaci ashtu edhe në kursimin që mund të ishte gjeneruar nëse receta do ishte ndryshe.

Konkluzionet: Sistemi i kujdesit shëndetësor në Shqipëri ka bërë hapa të rëndësishëm në përmirësimin e aksesit në shërbimet mjekësore. Megjithatë, procesi i rimbursimit mjekësor mbetet një fushë që kërkon përmirësime thelbësore për të përmbushur nevojat në zhvillim të ofruesve të kujdesit shëndetësor dhe pacientëve. Kjo përmbledhje përshkruan sfidat aktuale me të cilat përballen farmacistët dhe profesionistët e kujdesit shëndetësor në sistemin ekzistues të recetave për barna me rimbursim dhe propozon ndryshime kyçe që synojnë përafrimin e praktikave të Shqipërisë me standardet e Bashkimit Evropian.

SONDA MOLEKULARE “DUAL MODE” PËR APLIKIME  
NË IMAZHIT BIOLOGJIK.

*Ilir Pecnikaj<sup>1</sup>, Simonetta Orlandi<sup>2</sup>, Gianluca Pozzi<sup>2</sup>, Durim Çela<sup>1</sup>,  
Ledjan Malaj<sup>1</sup> Gabriele Losi<sup>3</sup>.*

*<sup>1</sup>Departamenti i Farmacisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.  
(Albania)*

*<sup>2</sup>Instituti i Shkencave dhe Teknologjive Kimike CNR “Giulio Natta”,  
Milano. (Italy)*

*<sup>3</sup>Consiglio Nazionale delle Ricerche, Istituto Nanoscienze (CNR-  
Nano) Modena (Italy)*

Termat bashkim neurovaskular (NVC) ose hiperemia funksionale përdoren aktualisht për të treguar mekanizmat me anë të të cilave aktivizimi nervor shkakton ndryshime në rrjedhën e gjakut cerebral për të siguruar marrjen e saktë të oksigjenit dhe glukozës që mbështetin aktivitetin neuronal. NVC ndërpritet në kushte patologjike, si hipertensioni, sëmundja Alzheimer dhe goditjet ishemi. Si pasojë, humbet përputhja midis kërkesave metabolike dhe rrjedhës së gjakut cerebral. Aktualisht supozohet se aktivizimi lokal i neuroneve çon në çlirimin e neurotransmetuesve dhe metabolitëve që modulojnë perfuzionin lokal të gjakut nga ndërhyrja e astroцитеve të qelizave gliale që janë në kontakt të rreptë me enët e vogla të gjakut, por se si ndodh kjo është ende një çështje debati. Rritja e fluksit të gjakut i atribuohet përgjithësisht zgjerimit lokal të kapilarëve, një fenomen që ndodh me një vonesë prej 2-3 sekondash nga fillimi i aktivitetit neuronal. Kjo pikëpamje është kundërshtuar nga studimet in-vivo me mikroskop foton (2PM), të cilat kanë treguar se rritja e fluksit lokal të gjakut i paraprin zgjerimit të vazave dhe është pothuajse e njëkohshme me rritjen e aktivitetit neuronal. Fatkeqësisht, zbatimet e vendosura të 2PM janë shumë të kufizuara në shpejtësi dhe fuqi rezolucioni për të ofruar informacione të mëtejshme kritike që do të ndihmonin për të kuptuar më mirë të gjitha aspektet e NVC. Në të vërtetë, të dhënat si për aktivitetin qelizor ashtu edhe për dinamikën e rrjedhës së gjakut duhet të merren me shpejtësi deri në diapazonin kHz, mbi një vëllim të plotë tre dimensional, i cili është i realizueshëm vetëm duke aplikuar teknika të avancuara si

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

mikroskopi 2P i bazuar në modulimin hapësinor të dritës. Deri më tani, aplikimet e këtyre teknikave holografike janë fokusuar kryesisht vetëm në aktivitetin qelizor, jo në NVC të vërtetë, kryesisht për shkak të pamjaftueshmërisë së fluoroforeve me qëllim të përgjithshëm (përfshirë proteinat fluoeshente dhe pikat kuantike inorganike) të disponueshme si etiketa. Ky skenar kërkon zhvillimin e fluoroforeve specifike me veti të përmirësuara fotofizike dhe kimike dhe aftësi të larmishme të synimit. Për këtë qëllim, ne kemi iniciuar një program për të dizajnuar fluorofore organike me molekula të vogla (OF), superiore ndaj proteinave fluoeshente për sa i përket përgjigjes optike dhe fotostabilitetit, dhe më lehtë të përshtatshme për shënjestrim specifik sesa pikat kuantike, për t'u përdorur si sonda në 2P holografike. Studimet mikroskopike të NVC. Ne kemi identifikuar modelin molekular modular të ngjyrave të ndjeshme ndaj tensionit të bazuar në transferimin e elektroneve të fotoinduktura (PeT VSD) si platformën ideale për dizajnimin e OF-së për thithjen e multifotonit me kohë përgjigjeje nënmilisekonda për monitorimin e dinamikës së potencialit të membranës në kuadër të studimeve NVC. Këto ngjyra posedojnë një fluorofor, një tel molekular të konjuguar dhe një dhurues aniline. Në potencialet e pushimit, në të cilat qeliza ka një potencial të hiperpolarizuar ose negativ në lidhje me pjesën e jashtme të qelizës, PeT nga dhuruesi i anilinës rritet dhe fluoeshenca zvogëlohet. Në potencialet e depolarizuara, potenciali i membranës ul shkallën e PeT, duke lejuar një rritje të fluoeshencës.

***Fjalë kyçe:*** fluorofore, fotone, teknika holografike.

**PREVALENCA E PËRGATITJEVE GALENIKE NË  
PRAKTIKËN FARMACEUTIKE NË SHQIPËRI**

*Arvjola Hodaj<sup>1</sup>, Bianka Hoxha<sup>2</sup>, Glori Kamberi<sup>3</sup>*

<sup>1</sup> *Universiteti Katolik Zoja e Këshillit të Mirë, Departamenti për Vlerësimin Kimiko-Toksikologjik dhe Farmakologjik të Barnave, Rruga Dritan Hoxha, Tiranë, Shqipëri; [a.hodaj@unizkm.al](mailto:a.hodaj@unizkm.al)*

<sup>2</sup> *Universiteti Katolik Zoja e Këshillit të Mirë, Departamenti i Teknologjive Kimiko-Farmaceutike dhe Biomolekulare, Rruga Dritan Hoxha, Tiranë, Shqipëri; [b.hoxha@unizkm.al](mailto:b.hoxha@unizkm.al)*

<sup>3</sup> *Farmaciste, Tiranë*

Hyrje dhe qëllimi: Terapitë e personalizuara mund të arrihen me anë të përshkrimit të përgatitjeve galenike, të cilat në realitetin shqiptar janë pak të përhapura. Përgatitjet galenike mund të ndihmojnë mjekët duke u dhënë atyre akses për të përshkruar barna dhe formë doza të cilat mund të jenë të dobishme në krijimin dhe zbatimin e një strategjie efikase trajtimi për pacientin. Studimi ka për qëllim përcaktimin e sasisë së përgatitjeve galenike në farmacitë e pavarura të komunitetit në të gjithë vendin dhe identifikimin e variablave të cilët ndikojnë në zgjedhjen e farmacistëve për të ofruar këtë shërbim.

Materiale e metoda: Një anketim përshkrues i strukturuar në formën e një interviste iu drejtua farmacistëve të rrjetit të hapur të zgjedhur rastësisht në shtatëmbëdhjetë qytete të ndryshme të Republikës së Shqipërisë. Në total, 295 farmaci të rrjetit të hapur pranuan të merrnin pjesë. Anketimi përfshiu njëmbëdhjetë pyetje, disa prej të cilave ishin të mbyllura dhe të tjera të hapura.

Rezultate: Nga 295 farmaci të intervistuar, vetëm 34 (11.5%) prej tyre përgatisin preparate galenike, me një përqindje relative prej 20% në qytetet Tiranë dhe Gjirokastër, Fieri me 14%, Durrës, Vlorë dhe Korçë me 13%. Vetëm 28% e 34 farmacive të cilat pretendonin se

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

kryenin përgatitje galenike bazoheshin në recetat e përshkruara nga mjeku. Principet aktive narkotike psikotrope nuk përfshiheshin në asnjë llojë përgatitje galenike. Rreth 17% e farmacive të cilat kryenin përgatitje galenike i referohen Formularit Farmaceutik Shqiptar të vitit 1973. Kapsulat përgatiten rrallë, afërsisht 8.8% e farmacive i përgatisin ato, ndërsa asnjë farmaci nuk përgatit tableta. Shurupet zënë vetëm 8.8% të formave farmaceutike galenike, ndërsa ovulat dhe supozitorët përkatësisht 20.6% dhe 14.7%. Së fundi, kolirët përgatiten nga vetëm 11.8% e farmacive të cilat kryenin përgatesa galenike. Gjithashtu duhet theksuar se 88.2% e farmacive përgatisin preparate galenike për përdorim pediatrik. Vetëm 5 farmaci përgatisin një numër të lartë përgatitjesh galenike në ditë (10-20) në qytetin e Tiranës. Pjesa më e madhe e farmacive (38%) kryejnë 5 deri në 7 përgatitje galenike në ditë.

Përfundime: Studimi i ndërmarrë ka nxjerrë në pah se krahasuar me farmacitë e shumta ekzistuese, vetëm një numër i vogël i tyre zhvillojnë artin e lashtë të galenikës. Numri i farmacive që krijojnë përgatesa magjistrale është edhe më i ulët. Arsytet e këtij aktiviteti të kufizuar të lidhur ngushtë me profesionin e farmacistit varen nga mungesa e një Farmakopeje Zyrtare Shqiptare. Mungesa e rregullave të detajuara dhe të sakta për menaxhimin e laboratorit dhe praktikave galenike ndikojnë në përfitim të një përgatitje galenike e cila të garantojë standarte të cilësisë, sigurisë dhe efektivitetit të krahasueshme me barnat industriale.

**STRATEGJIA E KONTROLLIT TË KONTAMINIMIT- NJË  
RRUGË DREJT SUKSESIT**

*Dr. Eva Troja*

*Illumina, Distributor farmaceutik, Tiranë, Shqipëri*

Strategjia e kontrollit të kontaminimit është një hap kritik për të garantuar barna cilësore, të sigurta dhe efikase, fabrikuesit duhet të ndërtojë një strategji të kontrollit të kontaminimit. Barnat gjatë procesit të prodhimit janë predispozitë e kontaminimit nga bakteret, viruset dhe kërpudhat. Strategjia e kontrollit të kontaminimit është një tërësi holistike dhe sistematike e mekanizmave të kontrollit që mundëson një garanci të lartë të eliminimit të kontaminimit në produktin final. Strategjia e kontrollit të kontaminimit garanton një përfaqje strukturore që rishikon burimet potenciale të kontaminimit me një hierarki kontrollesh që përfshin projektimin, procedurat dhe monitorimin. Aneksi 1 i EU-GMP specifikon 15 elemente kyç për ndërtimin e një strategjie. Shumë fabrikuesë farmaceutikë mund të zbatojnë disa prej elementeve kyç për ndërtimin e planit/strategjisë të kontrollit të kontaminimit, por ende nuk e kanë përfshirë një përfaqje të ciklit jetësor sipas kërkesave të Aneks 1. Përfaqja infrastrukture e menaxhimit të riskut përmes një strategjie nënvizon rëndësinë e dokumentimit dhe njohurisë së personelit. Programi i kontrollit të kontaminimit përmbledh jo vetëm identifikimin e rrënjës së shkakut, menaxhimin e riskut, validimin, monitorimin, korrigjimin, parandalimin, por edhe përmirësimin e vazhdueshëm dhe vlerësimin e efikasitetit. Realizimi i një dokumentacioni të strategjisë të kontrollit të kontaminimit, si një provë e pajtueshmërisë bëhet përmes pajisjeve moderne që lehtësojnë gjurmimin e informacionit në përputhje me kërkesat rregullatore.



**TEKNIKAT E ANALIZËS DHE KONTROLLIT PËR  
NANOPRODUKTET FARMACEUTIKE**

*Toskë Kryeziu<sup>1,2</sup>, Venesa Lupçi<sup>3</sup>, Aida Loshaj-Shala<sup>1</sup>, Mimoza Basholli-Salihu<sup>1\*</sup>*

*<sup>1</sup>Departamenti Analizë e Kontroll i barnave dhe Teknologji Farmaceutike, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës, Kosovë*

*<sup>2</sup>Institute of Pharmaceutical Sciences, Department of Pharmaceutical Technology, Karl-Franzens-University of Graz, Austria*

*<sup>3</sup>Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës, Kosovë*

Hyrje dhe Qëllimi: Nanoteknologjia ka shënuar një revolucion në zhvillimin e produkteve farmaceutike, duke ofruar zgjidhje inovative për sfidat e trajtimit të sëmundjeve. Kjo studim synon të vlerësojë dhe të përshkruajë teknikat aktuale të analizës dhe kontrollit që janë të përshtatshme për nanoproduktet farmaceutike.

Materiale dhe Metoda: Ky studim përfshin një analizë të thelluar të literaturës shkencore dhe të dhënave të grumbulluara nga burime të ndryshme, duke përfshirë publikime dhe raporte të agjensive rregullatore.

Rezultate: Rezultatet tona tregojnë se ka një nevojë të qartë për protokolle të standardizuara në vlerësimin e cilësisë së nanoprodukteve farmaceutike. Ne zbuluam se teknikat ekzistuese të analizës dhe kontrollit kërkojnë përshtatje për të adresuar specifikat e strukturave nanogrimcore. Gjithashtu, u vërejt një mungesë në legjislacionin ekzistues që adreson sfidat e sigurisë dhe efikasitetit të këtyre produkteve.

Përfundime: Studimi ynë konkludon se zhvillimi i metodave të reja të analizës dhe kontrollit për nanoproduktet farmaceutike është i domosdoshëm për të garantuar sigurinë dhe efikasitetin e tyre. Është me rëndësi që të zhvillohen standarde të reja rregullatore dhe protokolle të testimit që reflektojnë specifikat e këtyre produkteve.

**PROFILI KIMIK I VAJRAVE ESENCIALË, NGA DISA  
BIMË AROMATIKO-MJEKËSORE TË VENDIT TONË, ME  
AKTIVITET POTENCIAL ANTIMIKROBIK**

*V. Papajani<sup>1</sup>, T. Mastori<sup>1</sup>, E. Hoti<sup>1</sup>, E. Goci<sup>2</sup>, M. Miraçi<sup>1</sup>, I. Xhangolli<sup>2</sup>, E. Haloçi<sup>1</sup>*

<sup>1</sup> *Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë Tiranë.*

<sup>2</sup> *Departamenti i Farmacisë, Universiteti Aldent, Tiranë*

Bimët mjekësore dhe aromatike (BMA) të vendit tonë krahas vlerës së tyre mjekësore kanë rëndësi ekonomike, sociale dhe mjedisore. Prej shekujsh ato kanë luajtur rol të rëndësishëm në mjekësinë tradicionale si dhe vazhdojnë të jenë burim të ardhurash ekonomike, si pjesë e rëndësishme e eksportit të produkteve natyrore të vendit tonë. Shqipëria bën pjesë në 25 eksportuesit kryesorë të BMA në botë. Vajrat esencialë, kryesisht ato të pasura me komponime terpenike te oksigjenuara, sipas evidencave shkencore, kanë demonstruar aktivitet antibakterial, antimikotik me potencial për tu aplikuar në praktikën terapeutike. Një nga mundësitë e aplikimit të tyre në terapi është përfshirja në forma të mikrokapsuluara që mundësojnë shpërndarjen e kontrolluar të tyre, eliminonjë efektet anësore dhe ndikojnë në ruajtjen dhe përmirësimin e vetive fiziko kimike.

Qëllimi i këtij punimi është karakterizimi kimik i vajrave esenciale të përfuara nga disa bimë aromatiko mjekësore të vendit, si hap i parë në përfitimim e formave farmaceutike (për përdorim të jashtëm) me vajra esenciale të mikrokapsuluara. Ky studim është në kuadër të projektit kërkimor mbi prodhimin dhe aplikimin e formave farmaceutike nga bimë mjekësore të vendit tonë.

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

Materiali dhe metoda. Vajrat esenciale u përfytuar me hidrodistilim në aparat tip Clevenger nga BMA të vendit tonë përkatësisht: *Thymus capitatus* (thrumja), *Origanum vulgare sub. hirtum* (rigoni i bardhë), *Salvia officinalis* (sherebela). Profili kimik i vajrave esenciale u analizua me gas kromatografi në aparat GC/FID tip Varian 450.

Përmbajtja më e lartë në vajra esenciale, të përfytuar me hidrodistilim, rezultoi në mostrën e rigonit (2.8 %) ndërsa në mostrat e sherebelës dhe thrumjes sasi të ishin respektivisht 2 % dhe 0.9 %. Nga analizat gas kromatografike u përcaktua se esenca e sherebelës përmban sasi të larta të monoterpeneve të oksigjenuara (68.4%) me përbërës kryesor  $\alpha$  tujon, kamfur, cineol. Karvakroli është përbërësi kryesor në vajin esencial të thrumjes (58.7%); po kështu ky fenol terpenik ndodhet në sasi shumë të lartë edhe tek rigoni i bardhë.

Vajrat esenciale, nga BMA të vendit tonë të analizuar, rezultojnë me sasi të lartë të komponimeve terpenike të oksigjenuar, me aktivitet potencial antibakterial, antimikotik etj. Studime të mëtejshme po kryhen për përfshirjen e tyre në formulime farmaceutike, për përdorim të jashtëm.

Key words: Vajra esenciale, hidrodistilim, analiza GC/FID, thrumje, rigoni i bardhë, sherebelë.

VALIDIMI I METODËS BIOANALITIKE  
KROMATOGRFIA E LËNGËT BASHKË ME  
SPEKTROMETRIN E MASËS (LC-MS/MS) PËR  
VLERËSIMIN E MBETJEVE TË ANTIMIKROBIKËVE NË  
QUMËSHT

*Gjylai Alija<sup>1\*</sup>, Dorentina Bexheti<sup>1</sup>, Merita Dauti<sup>1</sup>, Sihana Ahmeti-Lika<sup>1</sup>, Drita Havziu<sup>1</sup>, , Edita Alili-Idrizi<sup>1</sup>, Lulzime Ballazhi<sup>1</sup>,  
<sup>1</sup>arlinda Haxhiu-Zajmi<sup>1</sup>, Nexhibe Nuhii<sup>1</sup> Arijeta Shabani<sup>1</sup>*

*<sup>1\*</sup>Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti i Tetovës, Tetovë, Republika e Maqedonisë së Veriut*

*\*Autori korrespondues: e-mail: [gjylai.alija@unite.edu.mk](mailto:gjylai.alija@unite.edu.mk)*

Hyrja: Agjentët antimikrobikë janë përdorur për parandalimin dhe trajtimin e infeksionit bakterial dhe nxitës të rritjes për rritjen e efikasitetit të ushqimit. Përdorimi jashtë kriterëve të këtyre barnave rezulton me prezencë të mbetjeve të tyre në qumësht, të cilët shkaktojnë efekte patologjike në shëndetin e njeriut siç janë: reagimet alergjike te njerëzit me mbindjeshmëri, efekte toksike dhe kancerogjene, çekuilibër të mikroflorës së zorrëve dhe rezistencë bakteriale. Për të garantuar sigurinë ushqimore, efikasitetin e saj dhe për të mbrojtur shëndetin e konsumatorit Bashkimi Europian vendosi Limitet Maksimale të Lejuara (MRL-të) për mbetjet e medikamenteve në produktet ushqimore, të bazuara në vlerësimin shkencor të sigurisë së këtyre substancave.

Qëllimi: Ky studim ka për qëllim validimin e metodës LC-MS/MS për të zbuluar njëkohsisht të gjithë mbetjet e antimikrobikëve e synuar të paktën në nivelin e interesit (MRL).

Materiale e Metoda: Janë validuar parametrat e metodës: lineariteti, selektiviteti, limiti i vendimit ( $CC\alpha$ ), aftësia detektuese ( $CC\beta$ ), kufiri i zbulimit (LOD), kufiri i kuantifikimit (LOQ), rifitimi dhe përpikmëria (përsëritshmëria dhe riprodhueshmëria) për çdo

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

antimikrobikë në studim. Validimi u krye në përputhje me Vendimin e Komisionit European 2002/657/EC. Është bërë optimizimi i kushteve kromatografike, parametrave MS/MS dhe procedurës së ekstraktimit.

Rezultatet: Procesimi i optimizimit të metodës siguroi rezolucion të mirë dhe përqendrimin selektiv të analitëve të synuar në qumësht. Analiza e regresionit linear tregoi korrelacion të mirë me  $R^2 > 0.98$ . Vlerat e marra për  $CC\alpha$  dhe  $CC\beta$  ishin më të ulët se MRL-ja. Vërtetësia u shpreh në termat e rritimit dhe përpikmërisë të shprehur si shmangie standarte relative (CV%). Vlerat e shmangieve standarte relative (%) nuk e kalonin limitin 15 % të përcaktuar në AOAC të llogaritur sipas ekuacionin-Horwitz, ndërsa vlerat e riprodhueshmërisë brenda-laboratorike nuk e kalonin vlerën 23%.

Rifitimet e analitëve ishin brenda intervalit të përcaktuar nga Codex 71.96-108.70%, duke provuar që procedurat e përgatitjes së mostrave ishin të përshtatshme për analizimin e mbetjeve të antimikrobikëve në qumësht.

**Konkluzioni:** Monitorimi i mbetjeve të barnave është i nevojshëm për të mbrojtur shëndetin e njeriut. Validimi I sukseshëm i metodës tregoj ndjeshmëri dhe selektivitet të lartë e cila mund të aplikohet në analizat rutinore për kontrollin e medikamentve në produktet ushqimore.

**Fjalë kyçe:** Mbetjet e antimikrobikëve, optimizimi, validimi i LC-MS/MS

**PËRDORIMI I SHKARKIMEVE UJORE TË IMPIANTEVE  
TË PËRPUNIMIT TË BIMËVE MEDICINALE NË  
SHQIPËRI DHE ROLI INHIBUES I TYRE NDAJ  
KORROZIONIT ELEKTROKIMIK TË METALEVE**

*Bujar Seiti<sup>1</sup>, Dritan Topi<sup>1</sup>, Manjola Bani<sup>1</sup>, Aurora Rrapushi<sup>2</sup>,  
Klejda Seiti<sup>3</sup>, Mimoza Bala<sup>1</sup>, Denisa Loke<sup>2</sup>, Sara Duçi<sup>2</sup>, Keivin  
Bala<sup>2</sup>*

*<sup>1</sup>Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës,  
Departamenti i Kimisë*

*<sup>2</sup>Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Fakulteti i Mjekësisë, Departamenti  
i Farmacisë <sup>3</sup>Universiteti “Aldent” Tiranë, Fakulteti i Mjekësisë  
Dentare, Departamenti i Protetikës e-mail: [bujar.seiti@fshn.edu.al](mailto:bujar.seiti@fshn.edu.al)*

Përmbledhje: Shqipëria është një vend mesdhetar që mbart një florë e larmishme. Kultivimi dhe përpunimi i bimëve mjekësore dhe aromatike në vendin tonë është i hershëm dhe përbën një aktivitet të rëndësishëm në ditët e sotme. Bimët mjekësore dhe aromatike janë një burim i rëndësishëm biologjik për sintezën e barnave mjekësore dhe për aplikimin e tyre si additivë ushqimor. Disa nga bimët medicinale që kultivohen dhe përpunohen në vendin tonë, janë: *Salvia officinalis*, *Laura nobilis*, *Origami heracleoticum*, *Helichrysum italicum*, *Lavandula officinalis* dhe *Rosmarinus officinalis*, etj.

Procesi industrial i distilimit/hidrodistilimit të bimëve mjekësore dhe aromatike në impiantet e përpunimit të tyre shoqërohet me krijimin dhe shkarkimin mbetjeje ujore në ekosistem. Këto shkarkime ujore përmbajnë sasi të konsiderueshme të hidrosolve të ndryshëm. Trajtimi, riciklimi dhe përdorimi i këtyre shkarkimeve ujore për prodhimin e detergjentëve, antimikobikëve, në kozmetikë, farmaceutikë, por dhe si inhibitorë për mbrojtjen e metaleve nga korrozioni elektrokimik përbëjnë një alternativ të qëndrueshme për të ardhmen.

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

Me metoda te ndryshme është realizuar vlerësimi i përbërjes kimike të shkarkimeve ujore të kësaj industrie (Gas-chromatography Mass-spectrometry (GC-MS) technique, Fourier Transform Infra Red (FTIR), etj).

Qëllimi i këtij punimi është përdorimi si inhibitorë për mbrojtjen e metaleve nga korrozioni elektrokimik i shkarkimeve ujore të industrisë së përpunimit të bimëve medicinale. Këto shkarkime ujore përmbajnë komponime organike të larmishte (të tilla si: terpene, komponime heterociklike që përmbajnë oksigjen, aminoacide, estere, vitamina, etj). Ky studim paraqet një alternative për minimizimin/riciklimin e shkarkimeve ujore nëpërmjet përdorimit të tyre si inhibitorë biologjik kundrejt korrozionit të metaleve.

Nëpërmjet metodës së humbjes në peshë dhe metodës së polarizimit potenciodinamik është vlerësuar roli inhibues i këtyre hidrolateve përkundrejt korrozionit të metaleve. Disa testime tregojnë zvogëlim të shpejtësisë së korrozionit elektrokimik në prezencë të këtyre komponimeve.

**Fjalë kyçe:** implant përpunimi, ndotje mjedisore, korrozion, inhibitor, hidrosolë, mjedis korrodues

**QASJET E REJA TE NUTRACEUTIKEVE NE TRAJTIMIN  
E PATOLOGJIVE KORONARE.  
EVIDENCAT E RASTEVE KLINIKE *IN VIVO***

*Patricia Daliu<sup>1</sup>, Giuseppe Annunziata<sup>2</sup>, Fabrizia Guerra<sup>2</sup>, Ettore Novelino<sup>2</sup>*

*<sup>1</sup>Albanian University, Departamenti i Farmacisë, Tiranë, Shqipëri.  
<sup>2</sup>Universiteti Federico i II, Departamenti i Farmacisë, Napoli, Itali.*

Hyrja dhe Qëllimi: Sëmundja e arterieve koronare që njihet ndryshe edhe si sëmundje ishемike e zemrës është shkaktari kryesor i vdekjeve në ditët e sotëshme në vendet e zhvilluara. Qëllimi i këtij studimi është që të ofrojë udhëzime të bazuara në evidencat e fundit mbi rëndësinë e antioksidantëve natyrore tek pacientët me patologji koronare shkaktuar nga mbyllja e një ene gjaku dhe rikthimi i mëvonshëm i qarkullimit, si dhe monitorimi i vlerave të trimetilaminëoxidazës (TMAO), metabolitit pro-atherogjen dhe protrombotik dhe të LDL-së duke vlerësuar *in vivo* efikasitetin e një nutraceutiku me ekstrakte polifenolike përgatitur nga bërsitë e rrushit (*Vitis vinifera* L.)

Metodologjia: Për realizimin e këtij studimi u zgjodhën në kushte laboratorike 5 kavie eksperimentale të tipit C57BL/6 të anestetizuara paraprakishtë me Ketaminë 80 mg/kg /Buprenorfinë: 0.05-0.1mg/kg dhe 60 pacientë vullnetarë të rastësishëm mbipeshë që plotësuan kriteret e pranimit duke respektuar Deklaratën e Helsinkit dhe Bazuar në Komitetin e Etikës. Forma e administrimit të nutraceutikut për kavjet ishte IV dhe për pacientët per os në formën e tabletave të standartizuara me ekstraktet polifenolike të rrushit ndërkohë grupi placebo me maltodextrinë.

Rezultatet: Pas administrimit të nutraceutikut në dozën IV 10 mg/kg peshë në kavie, dhe 400 mg per os në pacientë, për një periudhë 90 ditore, u vu re përmes Floureshencës (DAF 2 DA) një ulje e ndjeshme



## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

e radikalve të lira në pllakat endoteliale të duktusit arterioz, pas përfundimit të fazës ishkemike në kaviet e eksperimentit, dhe ulje e niveleve plazmatike të TMAO (trimetilamineoxidave) si dhe ox-LDL (low density lipoprotein) dy ndër markuesit kryesorë të patologjiave koronare me  $-49.78\% \pm 0.2$  ( $p < 0.0001$ ), dhe  $-43.12\%$   $p < 0.0001 \pm 0.1$  respektivisht krahasuar me grupin placebo.

Përfundimet. Këto rezultate premtuese hedhin dritë për rëndësinë e antioxidantëve dhe përbërësve natyralë si dhe për zhvillimin e testimeve të mëtejshme për të formuluar suplemente efektive në tregun e industrisë farmaceutike.

**Fjalët kyçe:** patologji koronare, trimetilamineoxidave, resveratrol, produkte natyrale, antioksidant.

## VLERËSIMI I DISA BRENDEVE TË FILM-TABLETAVE TË METFORMINËS PËR CILËSINË DHE EKUIVALENCËN QË QARKULLOJNË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

*Gentiana Mehmeti*<sup>1</sup>, *Gentrida Mehmeti*<sup>2</sup>, *Bujar Qazimi*<sup>3</sup>, *Jelena Acevska*<sup>4</sup>

<sup>1</sup> *Institute of Applied Chemistry and Pharmaceutical Analysis, Faculty of Pharmacy, University Ss. Cyril and Methodius, Skopje, Republic of North Macedonia*

<sup>2</sup> *Dompé Pharmaceutical Company, Prishtina, Kosovo*

<sup>3</sup> *UBT-Higher Education Institution, Faculty of Pharmacy, Lagjja Kalabria, p.n. 10000 Prishtina, Kosovo*

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

<sup>4</sup> *Institute of Applied Chemistry and Pharmaceutical Analysis,  
Faculty of Pharmacy, University Ss. Cyril and Methodius, Skopje,  
Republic of North Macedonia  
genta89m@gmail.com*

Hyrje dhe qëllimi: Përcaktimi i profilit karakteristik analitik (gjurmët e gishtërinjëve) mund të lejojë diferencimin midis mostrave sipas origjinës, vërtetimi i mostrave të dyshimta dhe zbulimi i suksesshëm i mostrave të falsifikuara.

Është thelbësore të zgjidhen mostrat me dyshime për t'u falsifikuar, bazuar në faktorët kritik të rrezikut, si: siguria e pacientit, numri i furnitorëve dhe sfondi rregullator, mundësia e mungesës së barnave, kërkesat aktuale rregullatore, etj.

Qëllimi i hulumtimit është elaborimi i fuqisë diskriminuese të metodologjisë analitike gjithëpërfshirëse të propozuar për diferencimin e origjinës së mostrave me pikë të rrezikut të lartë për shfaqjen e falsifikimit në Republikën e Kosovës.

Materiali dhe metoda: Film-tabletat që përmbajnë klorhidrat të metforminës u identifikuan si produkt me rrezik të lartë në Republikën e Kosovës për falsifikim të bazuar në faktorët më të rëndësishëm të mëposhtëm: produkti që përdoret zakonisht për trajtimin afatgjatë të sëmundjeve kronike, vëllimi i madh i shpërndarjes dhe prania e mundshme e papastërtive toksike.

Zgjedhja e metodave analitike të propozuara (spektroskopia infra e kuqe me rreze të mesme të transformuar nga Fourier, FTIR; spektroskopia infra e kuqe afër, spektri NIR & Raman, profili i papastërtisë LC dhe profili i shpërbërjes) dhe metodës kimimetrike (modelet e njohjes së modelit të zhvilluara në softuerin SIMCA).

Rezultati: Spektroskopia infra e kuqe e mesme (IR), afër-IR dhe spektroskopia Raman, të dhënat e kombinuara nga këto teknika shpjegojnë plotësisht mënyrat vibruese të formulimit, në formën e tij pluhur dhe formën përfundimtare të dozimit.

Metoda e përshkruar në monografinë e USP-së për film-tabletat Metformin përdoret për përcaktimin e curva-ve të lëshimit të API nga

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

tabletat, gjatë kryerjes së testit të shpërbërjes duke marrë kampion në disa pika kohore (5 min, 10 min, 15 min, 30 min, 45 min, 60 min).

Krahasimi i profileve të papastërtive kromatografike midis grupeve të ndryshme jep mundësinë e ndryshimit në stabilitetin e API-ve të përdorura gjatë procesit të prodhimit, si dhe një tregues mbi çështjet e stabilitetit nga prodhues të ndryshëm të film-tabletave me metforminë.

Përfundimi: Rezultatet nga ky hulumtim janë të pasura me informacione për karakterizimin e formës së zgjedhur të dozimit, duke siguruar kështu përmirësimin e strategjisë për dallimin midis mostrave duke identifikuar origjinën e tyre dhe zbulimin e falsifikimit të mundshëm.

**Fjalët kyçe:** metformina, gjurmë të gishtërinjëve (fingerprinting), API, Kimiometria

### ELEMENTET ME POTENCIAL TOKSIK NË ÇAJIN E MALIT (*SIDERITIS SCARDICA*) NGA MAQEDONIA E

#### VERIUT

*Bujar Qazimi<sup>1\*</sup>, Valon Ejupi<sup>1</sup>, Trajçe Stafilov<sup>2</sup>, Katerina Bačeva-Andonovska<sup>3</sup>, Krsto Tašev<sup>4</sup>, Hyrije Koraqi<sup>1</sup>, Arianit Jakupi<sup>1</sup>, Gentiana Mehmeti<sup>5</sup>, Gentiana Balaj<sup>1</sup>, Shpend Dragusha<sup>1</sup>*

<sup>1</sup>*Faculty of Pharmacy, UBT- Higher Education Institution, Lagjia Kalabria, 10000 Prishtina, Republic of Kosovo*

<sup>2</sup>*Institute of Chemistry, Faculty of Natural Sciences and Mathematics, University Ss. Cyril and Methodius, 1000 Skopje, North Macedonia*

<sup>3</sup>*Research Center for Environment and Materials, Macedonian Academy of Sciences and Arts, Bul. Krste Misirkov 2, 1000 Skopje, North Macedonia*

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

<sup>4</sup>*State Phytosanitary Laboratory, Bul. Aleksandar Makedonski bb, 1000 Skopje, North Macedonia*

<sup>5</sup>*Institute of Applied Chemistry and Pharmaceutical Analysis, Faculty of Pharmacy, University Ss. Cyril and Methodius, Skopje, North Macedonia*

*bqazimi2003@yahoo.com*

Hyrje dhe qëllimi: Bimët përfaqësojnë një burim shumë të rëndësishëm mineralesh për njerëzit, meqë përmbajnë pothuajse të gjitha mineralet e konsideruara si thelbësore për ushqimin e njeriut. Ndotja e materialeve bimore me metale të rënda përbën një rrezik potencial për shëndetin . Qëllimi i këtij studimi ishte përcaktimi i përmbajtjes së elementeve minerale me potencial toksik në gjethet e poshtme të rozetës dhe në pjesën e sipërme mbitokësore të *Sideritis scardica* Griseb. (çajit të malit) spontan.

Materiali dhe metoda: Materiali bimor është mbledhur në tre lokalitete të ndryshme në Maqedoninë e Veriut në gusht të vitit 2021. Mostrat janë trajtuar në një sistem mikrovalor me metodën e digjestionit. 0,5 g material bimorë u hodhën në tubin Teflon, ku u shtuan 7 ml HNO<sub>3</sub> dhe 2,5 ml H<sub>2</sub>O<sub>2</sub>. Përzierja lihet të reagojë për 10 min. Pastaj tubat e Teflonit u vendosën në sistemin e mikrovalës. Mineralet u përcaktuan me zbatimin e metodës së plazmës së çiftuar me induksion- spektrometria e emisionit atomik (ICP-AES) dhe metodës së plazmës së çiftuar me induksion – spektrometria e masës (ICP-MS).

Rezultatet: Në gjethet e poshtme të rozetës dhe në pjesën mbitokësore të *S. scardica* u përcaktuan gjithsej 10 elementë me potencial toksik. Përqëndrimet e Al dhe Cr në të gjitha mostrat e analizuara u përcaktuan nga ICP-AES, ndërsa përqëndrimet e As, Be, Cd, Hg, Ni, Pb, Tl dhe U u përcaktuan me metodën ICP-MS.

Përfundimi: Në të gjitha mostrat e analizuara, përmbajtja e elementeve me potencial toksik ishte më e lartë në gjethet e poshtme

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

të rozetës në krahasim me pjesën mbitokësore të *S. scardica*, por brenda limiteve të rekomanduara nga Ph. Eur dhe OBSH.

**Fjalët kyçe:** *Sideritis scardica*, elemente toksike, ICP-AES, ICP-MS

### FITOTERAPIA PER FARMACISTET

*Mr.ph. Mehrixhana Dervishi Llazorja*

Cilësia dhe siguria e përdorimit të preparateve bimore mbeten një prioritet në dorën e farmacistit, që duhet të rregullohet ligjërisht në nivel shtetëror. Për regjistrimin e një preparati bimor si ilaç ka të njëjtat kërkesa si për regjistrimin e barnave të tjera për sa i përket dokumentacionit që duhet të përmbajë teste paraklinike dhe klinike. Teste të tilla janë shumë kërkuese, dhe duke qenë se kompleksiteti i strukturës molekulare të bimëve paraqesin një sfidë në vete, madje edhe i preparateve bimore me një përbërës, pengon vendosjen e kriterëve unike për monitorimin e qartë të efekteve terapeutike të tyre, përmbushja e kërkesave për regjistrimin e një ilaçi bimor. Në dorën e farmacistit mbetet dija dhe përvoja profesionale, gjithmonë e bazuar në fakte shkencore univerzitare dhe pasuniverzitare, si dhe literatura shkencore.

Ajo që duhet të cekim është që preparatet bimore sot janë në dispozicion në shumë vende ku nuk ekziston rekomandimi profesional farmaceutik, madje edhe reklamohen pa kriterë duke rrezikuar shëndetin e pacientit. Këtu vjen në pozicionin e meritur këshilla e farmacistit, për një fitoterapi të sigurt për pacientin dhe ngritjen e kompetencave profesionale të farmacistit.

**Fjalët kyçe:** fitoterapi, ilaç bimor, farmacist, siguria e barnave bimore.

**NDËRVEPRIMET E BARNAVE NË TË SËMURËT  
DIABETIKË**

*Rezarta Shkreli<sup>1</sup>, Ernela Hoxha<sup>2</sup>, Sara Alcani<sup>3</sup>*

*<sup>1</sup>Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore,  
Universiteti Aldent, Tiranë*

*<sup>2</sup>Farmaci rrjeti hapur, Durrës*

*<sup>3</sup>Farmaci rrjeti hapur, Tiranë*

Hyrje: Është i njohur fakti se sëmundja e diabetit shkakton hipertension për arsye të rritjes së inflamacionit, stresit oksidativ dhe disfunksionit endothelial, e cila çon në ngushtim të venave. Politerapia mund të shkaktojë ndërveprime të barnave, të cilat shkaktojnë disa komplikacione kërcënuese për jetën si nefropatia diabetike dhe hipoglicemia. Barra e sëmundjes së diabetit është e lartë dhe në rritje në çdo vend, e nxitur dhe nga rritja globale e mbizotërimit të mbipeshës dhe mënyrës së jetesës jo të shëndetshme. Vlerësimet e fundit tregojnë një prevalencë globale prej 382 milion njerëz me diabet në 2013, që pritet të rritet në 592 milion deri në vitin 2035.

Qëllimi: Qëllimi i studimit ishte identifikimi i ndërveprimeve të barnave, si dhe graviteti i tyre në pacientët e shtruar në pavionin e diabetit në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

Materiale dhe metoda: Një studim ndër-seksional retrospektiv është kryer në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” në pavionin e diabetit duke analizuar 300 kartela të sëmurësh të shtruar në këtë qendër me diagnozë diabet. Në databasen e përgatitur janë hedhur të dhënat përsa i përket të dhënave demografike të pacientëve, diagnozat e shtrimit në spital, sëmundjet shoqëruese, barnat e përdorura për mjekim, reaksionet e padëshirueshme të barnave që mund të jene shfaqur si dhe ndërveprimet e barnave të nxjerra nga programi Medscape Drug Interactions. Përpunimi statistikor i rezultateve te

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

përftuara është bërë me paketen statistikore Statistical Package for Social Science (SPSS) version 21.

**Rezultate:** Nga analiza e të dhënave rezultoi se pjesën me të madhe e të shtruarve e përbënin pacientët e gjinisë mashkullore me 64%. 66% e pacienteve i përkisnin moshës 54-79 vjeç dhe numri i barnave që përdornin luhatej nga 2 derinë 10 barna në ditë. Pacientët me sëmundje bashkëshoqëruese përbënin 84.70% të numrit total të pacientëve. Gjithsej u zbuluan 1868 ndërveprime të barnave ku predominonin nderveprimet mesatare me 77.73%, ato të lehta me 17.76% dhe serioze me 4.51%. Përsa i përket natyrës së ndërveprimeve 47.74% ishin farmakodinamike, 41.75% farmakokinetike dhe 10.50% ishin ndërveprime me natyrë të panjohur.

**Përfundime:** Nga ky studim rezultoi se në pacientët e shtruar në spital me diagnozën diabet aplikohej mjekimi i polifarmacisë dhe numri i barnave që përdornin në ditë ishte i lartë. Në përgjithësi predominonin tipet e ndërveprimeve mesatare dhe përsa i përket natyrës së ndërveprimeve rezultoi se kishin një diferencë të vogël ndërmjet ndërveprimeve farmakodinamike me ato farmakokinetike.

**Fjalë kyçe:** Diabet mellitus, ndërveprimet bar-bar, polifarmacia, sëmundje bashkëshoqëruese.

**TEKNOLOGJITË INOVATIVE PËR TË MENAXHUAR  
AFLATOKSINAT B1 DHE M1 NË USHQIME DHE  
PËRFITIMET E APLIKIMIT**

*MSc. Lorena Mato (PhD Candidate), MSc. Andis Bekteshi,  
Prof. Dr. Dritan Topi*

Aflatoksinat në kultura të ndryshme bujqësore, prodhohen nga disa lloje të kerpudhës *Aspergillus Flavus* që gjendet veçanërisht në zonat me klimë të nxehtë dhe të lagësht. Në shumë vënde me të ardhura mesatare dhe të ulëta, aflatoksinat paraqesin probleme serioze të shëndetit publik pasi shfaqja e këtyre toksinave mund të jetë mjaft e zakonshme në ushqime dhe sidomos në drithera. Për shkak të qëndrueshmërisë së tyre të lartë, aflatoksinat nuk janë problem vetëm gjatë mbjelljes, por edhe gjatë ruajtjes, transportit, përpunimit dhe trajtimit të drithërave.

Janë analizuar 101 mostra, prej të cilave 40 mostra miell misri dhe 61 mostra miell gruri të cilat janë marrë në mënyrë rastësore në supermarketet e Tiranës. Pas analizimit të këtyre mostrave, rezultuan pozitive 11 mostra të miellit të misrit dhe 3 mostra pozitive prej mostrave të grurit. Incidenca për secilin grup mostrash ishin 27.5 % për mostrat e miellit të misrit dhe 4.9% për mostrat e miellit të grurit. Vlerat minimale ishin përkatesisht 0.390 µg/kg dhe 0.221 µg/kg ndërsa vlerat maksimale 69.122 µg/kg dhe 0.401 µg/kg.

Rrjedhimisht kërkohen teknologji inovative për kontrollin dhe minimizimin e ekspozimit ndaj aflatoksinave. Kontrolli biologjik është teknologjia më inovative e kontrollit të ndotjes me aflatoksinë që në momentin e mbjelljes së drithërave e cila përdor përjashtimin konkurrues të shtameve toksigjenë nga ato jotoksigjene. Llojet jotoksigjene të aplikuara në tokë zënë të njëjtat pika si shtamet toksigjene natyrore. Disa teknologji të tjera efektive si rrezatimi, teknologjia me ozon, agjentët e kontrollit kimik dhe biologjik dhe materialet e përmirësuara të paketimit mund të minimizojnë gjithashtu ndotjen me aflatoksinë pas korrijës së drithërave. Megjithatë, adoptimi i integruar i këtyre teknologjive para dhe pas vjeljes kërkohet ende për të reduktuar ndotjen me aflatoksinë, e cila



## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

rrit sigurinë ushqimore, permirëson kequshqyerjen dhe forcon qëndrueshmërinë ekonomike.

**Fjalë kyçe:** Aflatoksinë, kërpudhë, teknologji inovative, shtame toksigjene, shtame jotoksigjene, kequshqyerje, kontroll biologjik.

### VENDOSJA E VLEFSHMËRISË SË NJË METODE PËR IDENTIFIKIMIN DHE PËRCAKTIMIN E PENICILLAMINËS ME METODA INSTRUMENTALE

*David Lekli\*, Eva Gavani, Leonard Deda*

*\*Lekli Pharma*

Në këtë studim kemi vendosur vlefshmërinë e metodës për përcaktimin dhe identifikimin e Penicillaminës, me ndihmën e Kromatografisë së Lëngët me Performancë të Lartë të pajisur me UV-DAD në gjatësi vale  $\lambda=210$  nm. U studiua lineariteti i kësaj metode dhe zona e punës duke përgatitur shtatë solucione të holluara në 1.0 g/L EDTA dinatrium në ujë, me përqëndrime të njohura (0.02 mg/ml deri në 1.25 mg/ml). Kushtet e eluimit isokratik me kolonë RP C18 (250mm x 4.6 mm x 5  $\mu$ m), me fazë lëvizëse 6.9 g/L natrium fosfat monobazik dhe 0.2 g/L natrium 1-hexan sulfonat të tretura në ujë, me vlerë të pH  $3.0 \pm 0.1$  të përshtatura me  $H_3PO_4$  të holluar. Shpejtësia e rrjedhjes 1 ml/min temperatura e kolonës dhe autosample  $t=25$  °C. Ekuacioni i linearitetit:  $y=60.261x-0.3887$  dhe koeficienti i linearitetit  $R^2 = 0.9998$ , treguan për një linearitet të mirë dhe zonë pune të gjerë me vlera të ulëta të gabimeve sistematike. Kufiri i dedektimit dhe kufiri i përcaktimit u gjetën sipas formulave përkatëse, LOD = 0.067 mg/L dhe LOQ = 0.073 mg/L

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

Studimi i saktësisë dhe precizionit u testuan me 10 injektive të njëpasnjëshme prej të cilave u dhanë vlerat e RSD = 0.17 % për sipërfaqen e pikut. Numri teorik i pjatave  $N = 3701.8$  dhe faktori i asimetrisë  $fas = 0.91$ .

U studiua saktësia e ndërmjetme e metodës duke kryer matje nga dy analistë të ndryshëm në të njëjtat kushte, të cilat dhanë nivele të krahasueshme me vlera RSD % të afërta me njëra tjetrën ( $< 1\%$ ) dhe vlerë të Kriterit të Fisherit  $F = 0.6$ .

Vlefshmëria e kësaj metode u provua në kapsula të Penicillaminës me formë doze  $x 250$  mg. Rezultatet nga matjet ( $n=24$ ) treguan se riprodhueshmëria dhe ripërsëritshmëria e uniformitetit të përmbajtjes është 99.46 % për nivel besueshmërie 95 % me vlerë të RSD = 0.37 %, dhe 99.15 % me vlerë të RSD = 0.42 %.

Kjo metodë gjithashtu rezultoi selektive pasi matja e kapsulës nuk ndikon në pikun kryesor të Penicillaminës.

**Fjalë kyçe:** HPLC- DAD, Penicillaminë, RSD%, lineriteti, vlefshmëria, metodë.

### FORMULIMI I DISA FORMAVE FARMACEUTIKE ME BIMË MJEKËSORE SI ALTERNATIVË E PËRDORIMIT TË ANTIINFLAMATORËVE DHE ANTITUMORALËVE NË PATOLOGJI ORALE

*MSc. Ina Xhangoli<sup>1</sup>, MSc. Tea Mastori<sup>2</sup>, Prof. Asoc. Entela Haloçi<sup>2</sup>, Prof. Asoc. Enkelejda Goci<sup>3</sup>, Prof. Dr. Vilma Papajani<sup>2</sup>*

*<sup>1</sup>Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti Aldent, Tiranë*

*<sup>2</sup>Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë*

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

<sup>3</sup> *Qendra kërkimore farmakoterapeutike, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti Aldent, Tiranë*

Hyrje: Ky punim synon të realizojë testimin e efektivitetit antiinflamatorë dhe antitumoral në patologjitë malinje orale. Në tregun farmaceutik ka mungesë të theksuar lidhur me format farmaceutike, që mund të përdoren në gjëndjet inflamatore potencialisht premalinje, por edhe në patologjitë malinje të kavitetit oral me qëllim uljen e inflamacionit dhe veprimin citostatik. Për shkak të përmbajtjes me ekstrakte bimore/vajra esencial për shkak të përdorimit të gjere të tyre në mjekësinë alternative, këto forma farmaceutike parashikohen të kenë efekte anësore dhe efekte të padëshirueshme minimale.

Qëllimi: Evidentimi i bimëve mjekësore, që përmbajnë në nivele të larta lëndët vepruese tymol dhe karvacrol për trajtimin e patologjive malinje orale, gjëndjeve premalinje dhe ato inflamatore të kavitetit oral.

Materiale dhe metoda: Janë marrë në konsideratë në këtë studim bimët aromatike mjekësore si *O.vulgaris*, *T.vulgaris*, *S.montana* për shkak të përmbajtjes së tyre të lartë të timolit dhe karvakrolit. Ekstraktimi i vajrave esenciale nga bimët mjekësore aromatike u realizua me distilim në avull me aparat Clevenger. Analiza e vajrave esenciale u realizua me aparatën Gas/Mass sipas metodikave të publikuara nga grupi kërkimor. Kompleksimi i vajrave esenciale me përmbajtje tymol dhe karvakrol me  $\beta$ -cyclodextrinën u realizua me precipitim në të ftohtë. Procesi është në fazën e Formulimit të xheleve orale dhe kolutorëve me baza hidrofile. Më tej parashikohet të bëhet testimi i efekteve biologjike të formave farmaceutike me disa metoda. Rezultate të pritshme: Ekstraktimi i vajrave esenciale të tymol dhe karvakrol nëpërmjet metodës së distilimit me avull në aparat Clevenger dhe analiza fiziko-kimike i tyre rezultuan me nivele të larta timoli dhe karvakroli perkatesisht në vlerat (45%-65%) dhe (23%-60%). Kompleksimi u realizua në raportet vaj: Ciklodekstrine në raportet 20:80. Grupi i punës është në fazën e formulimit të formave farmaceutike.

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

Përfundime: Nga studimet e kryera për tymol dhe carvacrol, të cilat mbartin efektin antiinflamator, antibakterial dhe antitumoral, mbeten për tu evidentuar të gjitha efektet farmakologjike në grup targetin e përzgjedhur.

**Fjalë kyçe:** carvacrol, timol, patalogji malinje, Gas Chromatograph, aparat Clevenger.

### SHËNDETI MENDOR, NJË STUDIM TEK ADOLESHENTËT E QYTETIT TË TIRANËS DHE ELBASANIT. TERAPIA E KOMBINUAR

*Jona Keri<sup>1\*</sup>, Rezi Xhaja<sup>2</sup>, Vjola Kajanaku<sup>2</sup>, Lorena Memushaj<sup>3</sup>,  
Lindita Vrushi<sup>4</sup>, Ina Xhangoli<sup>5</sup>*

*\*<sup>1</sup>Universiteti Aldent, Qendra Kërkimore Farmakoterapeutike,  
Fakulteti i Shkencave Mjekësore, 1001 Tiranë, Shqipëri*

*<sup>2,3,5</sup>Universiteti Aldent, Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i  
Shkencave Mjekësore, 1001 Tiranë, Shqipëri*

*<sup>4</sup>Essential® - Herbalist dhe Prodhues, Elbasan, Shqipëri.*

*Autori korrespondues: \*jona.keri@ual.edu.al*

Hyrje dhe Qëllimi : Studimet e viteve të fundit mbi çështjet e shëndetit mendor tregojnë një rritje të numrit të fëmijëve dhe adoleshentëve (midis moshës 12 dhe 19 vjeç), të cilët paraqesin shqetësime si ankthi apo stresi. Në shumicën e këtyre rasteve kërkohet një diagnozë, pikërisht në 12-20% të rasteve.

Studimi bazohet kryesisht në evidentimin e problemit dhe në njohjen e terapisë së ndjekur, terapisë medikamentoze të kombinuar me suplemente bimore.

Materiale e Metoda: U hartua një pyetësor anonim, i dërguar në mënyrë elektronike për adoleshentët e shkollave 9-vjeçare dhe të

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

mesme si dhe ata të vitit të parë të universitetit në qytetet e Tiranës dhe Elbasanit. Janë analizuar 3 bimë kryesore, të cilat gjenden në farmacitë e Tiranës dhe Elbasanit, në formën e infusioneve të delipitizuara dhe dekontaminuara me teknikën e dioksidit të karbonit superkritik: si lule livando, kamomil dhe lule basani. Profili i tyre kimik u përcaktua duke përdorur GC-FID, pas ekstraktimit me metoden e SC -CO<sub>2</sub>.

Rezultate: Sipas rezultateve të marra, rezultoi se 97.1% e të intervistuarve ishin në dijeni të të ashtuquajturave shenjat e para të ankthit, moshë në të cilën shumica e adoleshentëve shfaqin shenja ankthi është nga 15 deri në 19 vjeç.

Në përmbajtjen e bimëve u vu re se: në livando përbërësi i cili u gjet në sasinë maksimale ishte Linalil acetat 21.21%, në kamomil:  $\beta$ -Farnesene 25.6% dhe nga rezultatet e marra nga analiza e gazkromatogramës me detektor me flakë, u vu re prania e 3 përbërësve kryesorë të bimës se melissa officinalis, përbërësit kryesorë aktivë të saj, ishin Citronellal 39,41%, Citronelol 14,86% dhe Geraniol 6.18 %.

Përfundime: Probleme të shëndetit mendor dhe evidentimi e trajtimi i tyre, mbetet një nga problemet madhore të shtetit shqiptar. Numri i adoleshenteve të diagnostikuar me probleme si ankth ose stres, kërkesat për preparate farmaceutike (pa recetë) tek farmacitë e Tiranës dhe Elbasanit është kthyer në një problem madhor. Me anë të këtij punimi është e mundur të pasqyrohet disi realiteti dhe sigurisht njohja e adoleshentëve me probleme të tilla, ku duhet të kërkojnë ndihmë të specializuar si dhe marrja e informacionit të nevojshëm rreth terapisë së kombinuar, që mjeku specialist përshkruan. Rekomandimet e farmacistëve për suplementët me bazë bimore.

**Fjalë kyçe:** adoleshentë, ankth, terapi e kombinuar, terapi me suplemente me bazë bimore

**VLERËSIM KRAHASUES I SHKALLËS SË DEPËRTIMIT  
TË NJË PRODUKTI TOPIK NË VARËSI TË MEMBRANËS  
SË PËRDORUR**

*Prof. Asoc. Brunilda Myftari, MSc. Elton Myftari<sup>1</sup>, MSc. Eni Bushi<sup>1</sup>, MSc. Dea Kristina Cenomeri*

*Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë*

Hyrje: Vlerësimi *in vitro* i farmakokinetikës topike (dermale) është një aspekt kritik i procesit të zhvillimit të barnave për produktet gjysmë të ngurta.

Qëllimi është vlerësimi i shkallës së depërtimit të një produkti topik përmes lëkurës së gicit krahasuar me atë përmes një membranë sintetike.

Materiale dhe Metoda: Pomadë 1% acetat hidrokortizoni, Standard Acetat Hidrokartizoni, Alkool 99%, Lëkurë gici (8 javësh), Membranë sintetike, Aparati Franz Diffusion Cell (6 njësi, diametër 9 mm), Aparat për Spektrofotometër UV-VIS, Kyveta kuarci 10 mm, Përzierës me ultratinguj, Letër filtri G<sub>2</sub>, Peshore analitike (max 210 g, d=0.1mg).

Rezultate dhe Diskutime: Nga 15' në 60' ka rritje të lehtë të depërtueshmërisë të acetatit të hidrokortizonit nga pomada nëpërmjet membranës dhe kalimit në medium. Një luhatje e lehtë absorbance dallon vetëm në javën e tretë, ku deri në intervalin 60' nuk ka shumë përthithje. Një faktor që ndikon në këtë rast është mosha e lëkurës së derit. Me kalimin e javëve supozohet që lëkura e ruajtur në frigorifer të mos ruajë tërësisht karakteristikat e lëkurës së freskët. Ky fenomen nuk vihet re tek membranat sintetike, të cilat kanë epërsinë e të pasurit të karakteristikave fiziko-kimike të njëjta gjatë gjithë kohës së përdorimit.

Përfundime: Si përfundim mund të thuhet se rezultatet e mara nga përdorimi i lëkurës së gicit janë të ngjashme me ato të përfuara duke përdorur membranat sintetike. Me anë të këtij studimi u stabilizua një metodë e përcaktimit të shkallës së depërtimit të lëndëve vepruese

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

përmes lëkurës duke përdorur Qelizën e Difuzionit Franz me lëkurë gici.

**Fjalë kyçe:** aparat i difuzionit Franz, membranë natyrore, membranë sintetike, produkte topike

### SINTEZA DHE ANALIZA FIZIKO-KIMIKE E DERIVATEVE TË POLISULFURUARA

*Prof. Asoc. Entela Haloçi, Msc. Redon Kashari*

Hyrje: Polisulfidet organike nga hudhra kanë qenë në qendër të vëmendjes për shumë vite për shkak të aktiviteteve të tyre biologjike, duke përfshirë vetitë antibakteriale, antifungale, antivirale, fitombrojtëse dhe antiproliferative, të cilat shoqërohen me mënyrat e tyre të shumta të veprimit. Këto përbërje kanë tërhequr interesin mjekësor kohët e fundit, si agjentë kimioparandalues dhe/ose kimioterapeutik si një burim premtues për agjentët e rinj të kancerit. Midis polisulfideve të ndryshme të studiuara, trisulfidet dhe tetrasulfidet zënë një pozitë të spikatur pasi këto janë përbërjet më aktive dhe më të qëndrueshme. Ato gjenden të kudondodhur në natyrë, duke përfshirë së pari bimët e gjinisë *Allium*, *Scorodophleus* zenkeri, etj.

Qëllimi kryesor i këtij punimi ka qenë sinteza e polisulfideve simetrike, më së shumti futja e grupeve të ndryshme alkilike në lidhjen trisulfide. Është punuar dhe me sintezën e një trisulfidi asimetrik (APTS) dhe me derivatet e alkiluara të cisteinës (S-propil-L-cisteina). Një nga standardet më të larta të këtij punimi, është mundësia për të zëvendësuar ndonjë nga atomet e sqfurit me selenium. Pas sintetizimit hapi tjetër është identifikimi, purifikimi dhe analizimi i këtyre produkteve, duke përdorur disa nga metodat instrumentale të analizës.

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

Materiale dhe Metoda: Reagentët kimikë janë siguruar nga kompania Sigma-Aldrich, Mynih dhe Universiteti i Saarlandit. Pastrimi u krye me kromatografi në kolonë duke përdorur silicagel (Macherey-Nagel, me diametër 50-200 µm). Kromatografia me shtresë të hollë u krye në pllaka alumini të veshura me silicë (Merck, silica gel 60 F254). Spektrat NMR u regjistruan në një Bruker Avance 500. Frekuenca e matjes ishte 500 MHz për <sup>1</sup>H-NMR dhe 125 MHz për <sup>13</sup>C-NMR. LC-MS u krye në një Bischoff Lambda 1000 UV/VIS në 275 nm duke përdorur një kolonë YMCC 18 Pro dhe metanol/ujë (85:15) si fazë lëvizëse me një shpejtësi rrjedhjeje prej 1.0 ml/min.

Rezultate dhe perfundime: Rendimentin më të lartë e pati S-propil-L-cisteina (99%) e ndjekur më pas nga trisulfidi i dibenzilit (94%). Radikalet alkilike që u perftuan me sukses në lidhjen trisulfide duke filluar nga tre atome karbon deri në tetë atome karbon. Grupi metil dhe etil nuk dhanë rezultat dhe radikalet cikloalkilike dhe aromatike gjithashtu nuk paraqitën rezultat. Në lidhje me zëvendësimin e atomit të sqfurit me selen, u bënë përpjekje për të zëvendësuar sqfurin e mesit tek lidhja trisulfide, por mbetet përsëri të punohet në këtë drejtim. Pak rezultate morëm me produktin e Se-propil-L-cisteinës i cili është premtues në fushën terapeutike.

**Fjalë kyçe:** Alicinë, aliinë, asimetrik, cisteinë, DADS, DAS, DATS, DATTS, NMR, OSC, polisulfide, selen, simetrik, sintezë, trisulfide.

**Shënim.** Ky punim është realizuar në kuader të mobilitetit Erasmus së UMT me U. Saarlandit Gjermani.



**NJË KËNDVËSHTRIM I RI RRETH EKSTRAKTIMIT TË  
SPECIT DJEGËS (*Capsicum Annum*) ME ORIGJINË  
SHQIPTARE**

*Jona Keri*<sup>1\*</sup>, *Valentina Malo*<sup>2</sup>, *Lorena Memushaj*<sup>3</sup>, *Lindita Vrushi*<sup>4</sup>,  
*Ina Xhangoli*<sup>5</sup>

<sup>\*1</sup>*Universiteti Aldent, Qendra Kërkimore Farmakoterapeutike,  
Fakulteti i Shkencave Mjekësore, 1001 Tiranë, Shqipëri*

<sup>2,3,5</sup>*Universiteti Aldent, Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i  
Shkencave Mjekësore, 1001 Tiranë, Shqipëri*

<sup>4</sup>*Essential® - Herbalist dhe Prodhues, Elbasan, Shqipëri.*

*Autori korrespondues: \*jona.keri@ual.edu.al*

Hyrje dhe Qëllimi: Në farmaci gjithnjë e më shumë po përdoren edhe rekomandohen forma të ndryshme farmaceutike me përmbajtje bimore, dhe me kuriozitet është principi aktiv si kapsaicina, e cila gjendet në shumë preparate në forma të ndryshme farmaceutike, por mbi të gjitha përdoret për shqetësime të ndryshme shëndetësore.

Përfitimet e ndryshme shëndetësore të përdorura ndër vite nga shqipëtarët, pa patur të dhëna shkencore shërbejnë si pikënisje për studimin e karakteristikave fiziko-kimike dhe të përmbajtjes kimike të specit djegës (*Capsicum Annum*). Një krahasim i përmbajtjes së kapsaicinës në suplemente dhe artikuj të tjerë që gjenden në farmacinë shqiptare, është kryer.

Materiale e Metoda: Është analizuar bima e *Capsicum annum* (speci djegës, me origjinë nga zona e Elbasanit), i cili i është nënshtruar procesit të ekstraktimit me dioksid karboni në gjendjen superkrite. Profili i tij kimik u përcaktua duke përdorur GC-FID, pas ekstraktimit me metoden e SC -CO<sub>2</sub>. Një sërë analizash fiziko – kimike dhe mikrobiologjike u realizuan gjithashtu.

Një krahasim i sasisë së kapsaicinës tek suplementët, dhe tek artikujt farmaceutikë është kryer.

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

Rezultate: Sipas rezultateve të marra, sipas analizës GC-FID të ekstraktit total të Capsicum annum me SC CO<sub>2</sub>, përbërësi kryesor aktiv i Capsicum annum është Capsaicin, i cili është i pranishëm në 36.82% të ekstraktit, (së bashku me derivatet e tij dihydrocapsaicin 16.33%) dhe nonivamide 7.89% duke i atribuar kështu specit djegës një sërë efektesh të dobishme. Vlera të saj janë krahasuar me disa forma të ndryshme farmaceutike të pranishme në farmaci.

Përfundime: Me anë të këtij punimi është e mundur të pasqyrohet sesi një metodë e thjeshtë kimike mundet të nxjerrë një ekstrakt i cili jo vetëm që ruan profilin e bimës që ekstrakton, por e pastron atë nga papastërtitë e ndryshme fiziko – kimike, si metalet e rënda. Sasia e lartë e principit aktiv dhe pastërtia e tij, mund ta bëjë këtë ekstrakt të shërbejë si një semiprodukt për prodhimin e formave të ndryshme farmaceutike. Një rritje e ndërgjegjësimit të farmacistëve te rinj për rekomandimet e suplementëve me bazë bimore.

*Fjalë kyçe:* spec djegës, ekstraktim me dioksid karboni superkritik, capsaicin.

### STUDIMI DHE ANALIZA E PRANISË SË AFLATOKSINES B1 NË QUMËSHTET FORMULË DHE DRITHËRAT E SHITURA NË FARMACI

*MSc. Lorena Mato (PhD Candidate), Prof. Dr. Dritan Topi, MSc.  
Andis Bekteshi*

Aflatoksina B1 (AFB1) dhe aflatoksina M1 (AFM1) mund të çojnë në probleme të rënda në shëndetin e fëmijëve. Aflatoksinat janë toksina kërpudhore të njohura si kancerogjene dhe klasifikohen si ndotës ushqimor. Aflatoksina B1 është më kancerogjenia nga të gjitha mykotoksinat, me mëlcinë si organin target. Tek njerëzit, shfaqja e

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

aflatoksinës B1 dhe metabolitëve të saj është raportuar në disa organe si veshka, zemra, si dhe në indet e trurit, urinën ose feçet. Është në gjendje të hyjë në membranën qelizore dhe të lidhet me ADN-në e saj, duke ndryshuar gjenomën në mënyrë që të bëhet më e qëndrueshme. Qellimi i këtij studimi është zbulimi i pranisë së AFLB1 dhe AFLM1 në mostrat e mbledhur në mënyrë rastësore tek qumështet dhe drithërat e shitura në farmaci.

Janë mbledhur 120 mostra të ndryshme dhe janë analizuar me metodën Elisa. Mostrat më tej janë analizuar me HPLC. Një nivel maksimal prej 2 µg/kg për aflatoksinë B1 dhe në total 4 µg/kg është vendosur për aflatoksinën në drithërat dhe të gjitha produktet që rrjedhin nga drithërat me përjashtim të misrit për të cilin është vendosur një nivel maksimal prej 5 µg/kg për aflatoksinë B1 dhe 10 µg/kg për totalin e aflatoksinës.

U gjet një incidencë pozitive prej 12.0% për AFM1 në mostra e qumështit dhe 58.8% për AFB1 në mostrat me prejardhje nga drithërat e foshnjave. Nivelet e AFM1 në mostrat e qumështit të foshnjave arritën intervalin prej 0,007 deri në 0,112 µg/kg, me tre mostra që tejkaluan nivelet maksimale të mbetjeve. Nivelet e zbuluara AFB1, në ushqimet me bazë drithrash për mostrat e grumbulluara varionin nga 0,006 në 0,125 µg/kg dhe vetem një prej tyre e tejkalonte nivelin maksimal.

Ky studim tregon se rreziku i ekspozimit ndaj këtij grupi të popullsisë përmes dietës është evident në Shqipëri. Një sistem alarmi për sigurinë ushqimore dhe një program mbikëqyrjeje janë thelbësore për sigurimin e shëndetit të foshnjave dhe të gjithë popullatës. Ne sugjerojmë që kontaminimi me mykotoksina duhet të monitorohet në mënyrë rutinë në ushqimet për foshnjat në mënyrë që të reduktohen rreziqet që vijnë nga konsumimi i tyre.

**Fjalë kyçe:** Mykotoksinë, Aflatoksinë, karcinogjen, ELISA, HPLC.

**KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII**

**KONFERENCA MBARËKOMBËTARE  
FARMACEUTIKE VII “SË BASHKU PËR  
FARMACEUTIKËN”: LEGJISLACION,  
MARKETING, MENAXHIM I FARMACISË DHE I  
COVID-19**

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

### NJOHURITË E STUDENTËVE TË SHKENCAVE MJEKËSORE QË NDJEKIN STUDIMET PRANË UMT MBI FARMAKOVIGJILENCËN

*Leonard Deda, Laerta Kakariqi, Edi Grabocka, Monika Belba*

*Departamenti i Lëndëve Biomjekësore dhe Eksperimentale, Fakulteti i Mjekësisë, UMT*

**Hyrje:** Të dhënat lidhur me shkallën e njohurive për farmakovigjilencën në studentët që ndjekin studimet pranë Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, mungojnë. Ky studim ka për qëllim vlerësimin kryesisht të njohurive lidhur me farmakovigjilencën në studentët e Fakultetit të Mjekësisë dhe Fakultetit të Mjekësisë Dentare të UMT.

**Materiali dhe metodat:** Ky ishte një studim transversal (cross-sectional), i realizuar përmes një pyetësoi të dërguar online studentëve të Fakultetit të Mjekësisë (Mjekësi e Përgjithshme dhe Farmaci) dhe të Fakultetit të Mjekësisë Dentare (Stomatologji) të Universitetit të Mjekësisë Tiranë.

**Rezultatet:** Nga 703 studentë, u përgjigjën gjithsej 631 (89.8%), nga të cilët 542 (90.0 %) studentë të Fakultetit të Mjekësisë (Mjekësi e Përgjithshme 443, Farmaci 99) dhe 89 (88.1%) studentë të Fakultetit të Mjekësisë Dentare. 71.8% e tyre pohuan që kanë njohuri të pamjaftueshme lidhur me farmakovigjilencën. Përkatësisht, 31.5 % dhe 30 % e studentëve dinë saktësisht nëse ka rregullim ligjor për Farmakovigjilencën në vendin tonë dhe nëse ka një Qendër të Farmakovigjilencës në vendin tonë. 21.3% e studentëve nuk dinë se çfarë raportohet pranë një Qendre të Farmakovigjilencës. Studentët e stomatologjisë kanë njohuri më të pakta, statistikisht sinjifikative, krahasuar me studentët e degëve të tjera (mjekësi dhe farmaci).

**Përfundime:** Niveli i njohurive të studentëve të shkencave të kujdesit shëndetësor ndaj Farmakovigjilencës është i ulët dhe i pamjaftueshëm. Kjo situatë kërkon kryerjen sa më shpejt të studimeve të tjera, më të gjëra dhe më të thella, lidhur me njohuritë, qëndrimet

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

dhe perceptimet e studentëve të shkencave mjekësore për farmakovigjilencën dhe raportimin e efekteve/reaksioneve të padëshiruara të barnave, si edhe përfshirjen e menjëhershme të Farmakovigjilencës të paktën në kurrikulën e lëndës të farmakologjisë klinike.

**Fjalë kyç:** Farmakovigjilencë, efekt i padëshiruara, student i shkencave mjekësore

## ROLI I FARMACISTIT NË DHËNIEN E SHËRBIMEVE FARMACEUTIKE

*Milaim Abdullahu*

*“Santefarm”, Prishtinë*

Sistemi legjislativ ka bërë të mundshme që ushtrimi i profesionit të farmacistit të jetë më shumë në shërbim të biznesit se sa dhënies së shërbimeve të mirëfillta profesionale. Sipas legjislacionit në fuqi, sot farmaci mund të hap çdo qytetar i Republikës së Kosovës që posedon mundësinë materiale. Kjo ka bërë që roli i farmacistit në dhënie e shërbimeve profesionale të jetë i parëndësishëm dhe me shumë rreziqe.

Qëllimi i kësaj analize është që të vëmë në pah faktorët të cilët ndikojnë në zbehjen e rolit të farmacistit në dhënie e shërbimeve profesionale.

Metoda e analizës bazohet në legjislacionin në fuqi, funksionimin e barnatoreve dhe rolin e farmacistit në dhënie e shërbimeve profesionale.

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

Bazuar në analizën e legjislacionit në fuqi, farmaci mund të hap çdo person, i cili ka mundësi materiale të sigurojë punësimin (licencën) e farmacistit dhe të ketë një hapësirë minimale për zhvillimin e veprimtarisë. Kjo ka bërë të mundur që farmacia të veprojë jashtë rregullave profesionale dhe në farmaci të ofrohen shërbime të shitjes së zakonshme si në shitore.

Bazuar në funksionimin e barnatoreve, në kushtet e sotme, roli i farmacistit në dhënien e shërbimeve profesionale është i zbehur, për të mos thënë me pak rëndësi dhe se rreziku nga mënyra e gabuar e përdorimit të barnave të jetë në një shkallë jashtëzakonisht të lartë.

Si përfundim, mund të themi se roli i farmacistit në dhënien e shërbimeve profesionale duhet të mbështetet në respektimin e rregullave profesionale të rregulluara dhe të sanksionuar, si në aspektin juridik, ashtu edhe etik, me qëllim që në barnatore udhëzimet lidhur me përdorimin e barnave të merren drejtpërdrejt nga farmacisti.

Rekomandojmë që të ndryshohet legjislacioni në fuqi për hapjen dhe funksionimin e barnatoreve, si dhe të faktorizohet dhe fuqizohet roli i Urdhrit dhe Odës së Farmacistëve lidhur me vënien para përgjegjësisë së farmacistit, i cili pranon të jetë bartës i licencës për veprimtarinë e barnatores, duke ja bërë të mundur që barnatorja të ofrojë shërbime jo profesionale .

**Fjalë kyçe:** Farmacist, legjislacion, shërbime profesionale.

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

### FARMAKOVIGJILENCA DHE RAPORTIMI I EFEKTEVE TË PADËSHIRUARA NËPËRMJET APLIKACIONIT AKBPM

*MSc. Jovisa Marku\*, MSc. Eledia Qirici*

*\*Specialiste e Farmakovigjilencës (AKBPM)*

Hyrje: Ky referim shpjegon rëndësinë e Farmakovigjilencës në Shqipëri, se çfarë është Farmakovigjilenca sipas legjislacionit, ndryshimet në Ligjin Nr. 105/2014 “Për Barnat dhe Shërbimi Farmaceutik”. Si anëtare me drejta të plota në “WHO Program for International Drug Monitoring” të UPPSALA MONITORING CENTER, bën që të jemi me aktive për sa i përket ativiteteve dhe angazhimeve në këtë fushë. Kalimi i raportimeve lokale nga formularët e raportimit të pacienteve dhe për profesionistët e shendetit në aplikacionin AKBPM “VigiFlow eForms” për barnat (ADR reporting) dhe vaksinat (AEFI reporting) duke e bërë më të lehtë mënyrën e raportimit.

Metodat: Nga funksionimi i sistemit të Farmakovigjilencës në Shqipëri kemi:

- Promovimin e Farmakovigjilencës
- Raportimi i efekteve të padëshiruara
- Identifikimin e sinjaleve
- Vlersimin e riskut dhe opsionet për menaxhimin e riskut.

Rritja e ndërgjegjësimit të profesionistëve të shendetit për të raportuar efektet e padëshiruara bën që të kemi siguri për barnat që ne përdorim. Kur mund të themi se një bar ka efekte të padëshiruara për të plotësuar një formular raportimi. VigiFlow. Të dhënat kombëtare ADR dhe AEFI, Sistem menaxhimi, Forcimi i Farmakovigjilencës – në nivel lokal, kombëtar, rajonal dhe global. Disponueshmëria e të dhënave WHO GIS mundëson rezultate të përmirësuara statistikore. Çdo formular mund të instalohet si një aplikacion në pajisje e disponueshme përmes barkodit QR të cilët këto nuk kërkojnë instalime ose konfigurime nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.



## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

Përfundimet: Sensibilizim i profesionistëve të shëndetit dhe pacientëve në raportimin e efekteve të padëshiruara të barnave dhe vaksinave në mënyrë që të kemi një rritje të sigurisë së barnave e vaksinave nëpërmjet aplikaciont AKBPM.

**Fjalet kyçe:** Farmakovigilencë, Efekt i padëshiruar, Formulari i Raportimit, VIGIFLOW, VIGILIZE, UMC, Aplikacion AKBPM

### KRAHASIMI I RREGULLOREVE /UDHËZUESVE EVROPIANE PËR PRODHIMIN E RADIOFARMACEUTIKËVE DIAGNOSTIKUES ME RREGULLORET AKTUALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

*Sihana A. Lika, Hanife Rustemi, Faton Ahmeti, Edita Alili Idrizi,  
Merita Dauti, Lulzime Ballazhi, Arbnore Qaili*

*Programi studimor i Farmacisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore,  
Universiteti i Tetovës*

Hyrja dhe qëllimi: Zhvillimi i përgatesave farmaceutike më specifike dhe me potencial të lartë diagnostikues dhe terapeutik rritet në mënyrë maramendëse. Sfidë në vete në këtë kontest janë korrnizat rregullatore për radionuklidet dhe radiofarmaceutikët si dhe hulumtimet klinike aktuale të cilat lidhen me opsionet potenciale që janë në zhvillim e sipër si në Evropë ashtu edhe në suaza botërore. Praktika e Mirë e Prodhimit (GMP- Good Manufacturing Practice) është një sistem për organiziminin, mbikqyrjen dhe kontrollin e kualitetit të cilësisë gjatë fazës së prodhimit të radiofarmaceutikut i cili do të përdoret në PET (Positron Emision Tomography).

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

Materiale e metoda: Për të bërë krahasimin në mes rregulloreve evropiane dhe udhëzuesve rregullatorë me rregulloren ekzistuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut që ka të bëjë me prodhimin e përgatesave radiofarmaceutike kemi përdorur dy dokumente si që janë: draft versioni i udhëzuesit të *IAEA/OBSH për Praktikën e Mirë të Prodhimit për produkte radiofarmaceutike hulumtuese* dhe Rregulloren e Republikës së Maqedonisë së Veriut të emërtuar si: *Rregullorja për përmbajtjen e kërkesës, dokumentacionit dhe kushtet më të afërta në aspektin e hapësirës, paisjeve dhe personelit për marrjen e miratimit për prodhimin e barnave - versioni i fundit nga viti 2016 (neni 16 deri në nenin 25).*

Rezultate: Në vendet e BE –së radiofarmaceutikët llogariten si produkte medicinale. Gjithmonë për fillimin e një prove klinike kërkohet miratimi nga Autoriteti Kompetent Kombëtarë siç janë: Direktiva për Hulumtime Klinike dhe Komiteti i Etikës në vendin ku do të kryhet hulumtimi.,

*Në Republikën e Maqedonisë së Veriut - Rregullorja pjesërisht e përcjell zbatimin në lidhje me prodhimin e radiofarmaceutikëve me theks të veçantë në dallimet që kanë të bëjnë me zbatimin e Praktikës së Mirë të Distributimit të "përgatesave mjekësore klasike" nga ajo e përgatesave të ndryshme radiofarmaceutike.*

Përfundime: Pretendimet e hulumtimit për ndryshimet kryesore në lidhje me kuadrin e ri rregullator që mund të ndikojnë në radiofarmaceutikët diagnostikues janë si më poshtë:

- Nuk është i nevojshëm autorizimi për prodhim dhe import për radiofarmaceutikët diagnostikues të cilët janë përgatitur në përputhje me udhëzimet e prodhuesit për përdorim në vendet e studimit në shtetet anëtare të BE.
- Praktika e Mirë e Prodhimit (GMP) në përputhje me Vëllimin 4 të EudraLex nuk duhet të jetë kusht për radiofarmaceutikët diagnostikues. Megjithatë, mund të aplikohen kërkesa nga rregullorja e shtetit përkatës.
- Thjeshtëzimi i kërkesave për etiketimin e paketimin parësor të radiofarmaceutikut në fjalë.

**STUDIM MBI NJOHURITË DHE KONTRADITAT MBI  
PËRGJEGJËSITË MORALE DHE LEGALE NË  
PRAKTIKËN FARMACEUTIKE**

*Merita Dauti<sup>1\*</sup>, Sihana Ahmeti- Lika<sup>1</sup>, Drita Havziu<sup>1</sup>, Gjylai Alija<sup>1</sup>,  
Edita Alili-Idrizi, Lulzime Ballazhi<sup>1</sup>, <sup>1</sup>Arlinda Haxhiu-Zajmi<sup>1</sup>*

*<sup>1\*</sup>Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore,  
Universiteti i Tetovës, Tetovë, Republika e Maqedonisë së Veriut*

*\*Autori korespondues: e-mail: [merita.dauti@unite.edu.mk](mailto:merita.dauti@unite.edu.mk)*

Hyrje: Farmacistët që ushtrojnë profesionin e tyre në farmacitë e rrjetit të hapur shpesh përballen në situata dilematike në të cilat e kanë të vështirë të marrin vendime të sakta duke u munduar në njërën anë të respektojnë normat e etikës profesionale dhe nga ana tjetër të respektojnë në përpikmëri normat ligjore të profesionit si dhe respektimin e të drejtave të pacientëve të garantuara me ligj. Këto situata dilematike shpesh mund të rezultojnë në vendime të gabuara dhe pasoja serioze.

Qëllimi: Ky studim ka për qëllim që nëpërmjet instrumenteve matëse të përcaktojë perceptimin dhe qëndrimin që kanë farmacistët e komunitetit mbi përgjegjësitë etike dhe ligjore të profesionit të tyre si dhe të identifikojë disa nga faktorët ndikues që sjellin deri në situata dilematike gjatë punës së tyre në farmacitë e rrjetit të hapur.

Metodologjia: studim i tipit ndër-seksional, deskriptiv dhe kuantitativ ku respondentët i janë nënshtruar studimit vetëm një herë. Përpunimi i të dhënave është bërë me analiza statistikore deskriptive. Variablat e studimit janë: vlerësimi i njohurive të farmacistëve mbi normat etike dhe ligjore profesionale dhe ndërlidhja me zbatimin/moszbatimin e këtyre normave . Janë shpërndarë gjithësej 300 pyetësor. Në studim kanë marrë pjesë gjithësej 285 respondentë. Popullacioni i mostrës është për zgjedhur me metodën e qëllimshme , Studimi është realizuar në farmacitë e rrjetit të hapur në disa qytete në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe poashtu në Departamentin e Farmacisë në Universitetin e Tetovës me studentët e vitit të V. Pas grumbullimit të të dhënave nga respondentët, të dhënat janë përpunuar dhe proceduar me programin softuerik SPSS apo Paketën Statistikore për Shkencat

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

Sociale, versioni 27. Më pas janë paraqitur sipas modelit APA të hulumtimeve. Për analizimin e të dhënave janë paraqitur rezultatet deskriptive të frekuencave dhe përqindjes, mesatares, devijimit standard dhe tabelave të kryqëzuara

Rezultatet: Rreth 70% e pjesëmarësve në studim kanë qenë të gjinisë femërore dhe afërsisht 30% të gjinisë mashkullore. 31.92% nga pjesëmarësit kanë qenë student të vitit të fundit, 35.43% të grupmoshës 25-35 vjeç dhe 32.63% të grupmoshës mbi 30 vjeç. Përgjigjet e pyetjeve që kanë rezultuar nga pyetësorët janë paraqitur me anë tabelave dhe grafiqeve me anë të cilave në mënyrë vizuale tregohet diversiteti i përgjigjeve të dhëna në bazë të grup moshave të caktuara.

Konkluzioni: Përballja me situata të dilemave etike është një problem i shpeshtë dhe stresues për komunitetin e farmacistëve. Mungesa e njohurive mbi kodin e etikës profesionale është arsyeja kryesore që farmacistët i çojnë në zgjedhje të gabuara. Shpesh marrëdhëniet jo profesionale dhe jo korekte mes mjekëve dhe farmacistëve e vështirësojnë situatën. Duke qenë nën presion për të respektuar ligjin dhe rregulloret administrative farmacistët neglizhojnë përgjegjësitë e tyre morale.

**Fjalë kyçe:** dilema etike dhe ligjore, farmacist, farmacitë e rrjetit të hapur

## BARNAT E FALSIFIKUAR – ASPEKTET LIGJORE

*Arlinda Haxhiu Zajmi<sup>1\*</sup>, Drita Yzeiri Havziu<sup>1</sup>, Merita Dauti<sup>1</sup>, Gjylai Alija<sup>1</sup>, Sihana Ahmeti Lika<sup>1</sup>, Lulzime Ballazhi<sup>1</sup>*

*<sup>1\*</sup>Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti i Tetovës, Tetovë, Republika e Maqedonisë së Veriut*

*\*Autori korespondues: e-mail: [arlinda.haxhiu@unite.edu.mk](mailto:arlinda.haxhiu@unite.edu.mk)*

Hyrje dhe qëllimi: Fenomeni me barnat e falsifikuara është një problematikë serioze globale dhe paraqet një sfidë të madhe si për

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

organet rregullatore shëndetësore nga njëra anë dhe nga ana tjetër për industrinë farmaceutike. Pasojat nga barnat e falsifikuara janë shumë të mëdha së pari për shëndetin publik sepse mund të shkaktojnë efekte toksike dhe anësore ndonjëherë me pasoja fatale. Nga ana tjetër, barnat e falsifikuara kanë pasoja ekonomike për industrinë farmaceutike..

Prandaj qëllimi i këtij punimi janë barnat e falsifikuara, faktorët që ndikojnë në paraqitjen e këtij fenomeni, ligjet dhe Direktiva Evropiane për barnat e falsifikuara.

Materiale dhe metoda : Hulumtimi bazohet në analizë dhe rishikim të literaturës profesionale dhe shkencore , të ligjeve dhe rregulloreve për barnat e falsifikuara , të dhënave dhe statistikat nga organizatat dhe organet rregullatore relevante si OBSH, EMA, FDA, FIP, PSI, Komisioni Evropian.

Rezultate dhe përfundim : Në bazë të analizave dhe rishikimit të të dhënave mund të vërehet se OBSH dhe EMA jep disa definicione në lidhje me barnat e falsifikuara. Rastet e rritjes së këtij fenomeni janë evidente , që vërtetohet edhe në bazë të të dhënave të raportuara nga PSI sipas të cilëve , në periudhën 2018-2021 , incidentet janë rritur për 47% . Spas të dhënave të OBSH, rreth 10% e barnave në tregun global janë të falsifikuara ndërsa në disa vende mund të jetë edhe 30%. Rreth 50% e barnave të blera nga faqet e internetit të paligjshme llogaritet se janë të falsifikuara . Tregtia me barnat e falsifikuara është e përhapur gjithandej dhe prek si vendet e zhvilluar dhe vendet në zhvillim. Prandaj nevojitet një qasje serioze dhe angazhim nga të gjitha palët relevante të interesuara si: qeveritë, organet rregullatore kompetente, industria farmaceutike, policia, doganat dhe organet juridike për të parandaluar dhe luftuar fluksin e barnave të falsifikuara. OBSH ka marrë një sërë aktivitetesh në lidhje me parandalimin dhe luftën kundër barnave të falsifikuara. Gjithashtu Komisioni Evropian në vitin 2011 hartoi Direktivën për barnat e falsifikuara (Directive 2011/62) e cila synon të parandalojë hyrjen në zinxhirin e furnizimit legal të produkteve medicinale të falsifikuara. Në këtë Direktivë janë të dhanura rregullat dhe masat strikte për të pasur barna të sigurta dhe mbikqyrje të rreptë të tregtisë me barna.

**Fjalët kyçe :** Barna, falsifikim, Direktiva Komisioni evropian

**MENAXHIMI DHE MARKETINGU FARMACEUTIK**

*Jehona Hakaj, Laureta Berisha Kosumi , Lindita Aliaga*

Hyrje dhe qëllimi: Menaxhmenti dhe marketingu farmaceutik janë disiplina shumë intensive, që përfshijn njohuri të përgjithshme , specifike dhe aktivitete të biznesit që lidhen me ofrimin e produkteve /shërbimeve që përdoren për të kuruar, trajtuar e parandaluar sëmundjet.

Materiale dhe Metoda: Në këtë punim ne grumbulluam, analizuam dhe rishikuam metodat dhe parimet e menaxhimit dhe marketingut farmaceutik duke përfshirë legjislaturën që duhet ndjekur. Gjithashtu anketuam një numër të konsiderueshëm qytetarësh të moshave, gjinive dhe profesionëve të ndryshme lidhur me marketingun farmaceutik dhe besueshmërin e tij. Metoda se si do të zbatohet marketingu farmaceutik varet nëse janë ilaçe Rp apo OTC dhe produkte të tjera që përdoren në funksion të shëndetit (produkte bimore, produkte dietike etj.). Për informimin e punonjësve shëndetësorë përdoren broshura, literaturë profesionale, publikime të ndryshme, prezantime në institucionet shëndetësore dhe takime profesionale. Përveç kësaj vendi kryesor i aktiviteteve të marketingut janë barnatoret, me të cilat kryesisht vendoset komunikimi tregtar.

Rezultatet: Sa më konkret dhe real menaxhimi (furnizim në çdo kohë, jo munges stoku, çmim i arsyeshëm) dhe marketingu farmaceutik, aq më e madhe shkalla e besueshmëris ndaj prodhuesit-prezentuesit dhe si rezultat shitje më e lartë

Përfundimi: Në kohët e sotme qëllimi kryesor i marketingut të kompanive farmaceutike, përveç zhvillimit të produkteve – shërbimeve të mira, ofrimit të mjedisit më të mirë të shërbimit, monitorimit të konkurrencës, zbatimit të strategjive të duhura është edhe të përmbush nevojat dhe dëshirat konsumatorëve. Kjo siguron rritje të shitjes së produkteve, besueshmëri më të lartë dhe realizim i fitimeve afatgjata,e këtu rëndësi të vecant ka ofrimi i shërbimit-produktit kualitativ dhe marketing korrekt që mos të haset mashtrimi i pacientit i cili vec se është i prirur të mashtrohet duke tentuar kurimin, e në vecanti marketing i pa kontrolluar online i cili më shumë mund të sjellë dëm sesa dobi.

**RENDËSIA DHE SFIDAT NË SHPËRNDARJEN E  
MATERIALEVE INFORMUESE TEK PROFESIONISTËT  
SHËNDETËSOR SI PJESË E FARMAKOVIGJILENCËS**

*Skender Radoniqi<sup>1</sup>, Tringa Kurti<sup>1</sup>, Arianit Jakupi<sup>1,2</sup>*

<sup>1</sup>*Meditech - Rr. Marigona Residence 10500 Preoce, Gracanicë, Kosovë*

<sup>2</sup>*UBT – Institut i Arsimit të Lartë, Fakulteti i Farmacisë, Lagjja Kalabria p.n., 10000 Pristina, Kosovë*

Hyrje dhe qëllime: Ky punim hulumton rolin kryesor dhe sfidat e shpërndarjes së materialeve informative për profesionistët shëndetësor në sigurimin e efikasitetit të strategjive të farmakovigjilencës. Këtu tregohet rëndësia për praktikuesit e kujdesit shëndetësor me përditësimin e njohurive aktuale mbi sigurinë e barnave dhe raportimin e efekteve të padëshirueshme, duke i pozicionuar ata si kontribues kryesor të mbikëqyrjes dhe sigurisë. Ndikimi pozitiv i informimit të kujdesit shëndetësor në zbulimin, raportimin dhe uljen e reaksioneve të mundshme negative të barnave përmes përdorimit të materialeve informuese është analizuar më tutje. Materiale dhe metoda: Studimet nga literatura, eksperiencat nga puna e përditshme dhe legjislacioni lokal në Kosovë janë përdorur si materiale për zhvillimin e hulumtimit.

Rezultate: Pjesa e parë e hulumtimit nënvizon rolin kryesor që kanë materialet informative të profesionistëve shëndetësorë me njohuri të përditësuara mbi farmakovigjilencën. Duke analizuar studimet e rasteve, ne eksplorojmë ndikimin pozitiv që kanë këto materiale informuese në sigurinë e pacientit. Megjithatë, shpërndarja e materialeve informuese të farmakovigjilencës përballet me sfida të ndryshme. Strategjitë për të kaluar këto barrierë, të tilla si komunikimi i përshtatur dhe përdorimi i teknologjisë diskutohen në këtë hulumtim.

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

Përfundime: Si përfundim, ky prezantim synon të potencojë ndërlidhjen mes profesionistëve shëndetësorë dhe farmakovigjilencës, konkretisht përmes shpërndarjes në mënyrë efektive të materialeve informuese. Adresimi i sfidave në këtë proces do të kontribuojë në një sistem farmakovigjilence më të përgjegjshëm dhe efektiv, duke avancuar në sigurinë e pacientit dhe duke përmirësuar cilësinë e kujdesit shëndetësor.

**Fjalë kyçe:** Farmakovigjilencia, Siguria e barnave, DHCP, Legjislacioni

### PLATFORMAT MEDIATIKE DHE PROMOVIMI I SHËNDETIT PUBLIK

*Ph. D. Freskida Miloti*

*Master Internacional në 'Shëndet Publik' në Liverpool John Moores University*

*Farmaciste / Gazetare*

Kjo temë eksploron rolin e medias në shëndetin publik, duke u fokusuar në Shqipërinë si rast studimi. Burimet e medias, duke përfshirë gazetat, radion, televizionin dhe mediat sociale, formësojnë ndjeshëm perceptimet e publikut, shpërndajnë informacione dhe ndikojnë në sjelljet e lidhura me shëndetin. Aftësia e medias për të rritur ndërgjegjësimin, për të dhënë informacion të saktë dhe për të inkurajuar debatin publik mbi çështjet shëndetësore ndikon ndjeshëm në rezultatet e shëndetit publik.

Qëllimi i kësaj teme është të shtojë informacionin tashmë të disponueshëm mbi këtë temë dhe të ofrojë perspektiva nga të cilat mund të përfitojnë praktikant dhe politikat e shëndetit publik shqiptar. Objektivi i këtij studimi është të kuptojë se si media, përfshirë



## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

platformat e mediave sociale, ndikojnë në politikat dhe praktikat e shëndetit publik në Shqipëri. Tema eksploron ndikimin e medias në shëndetin publik në Shqipëri, duke përdorur një qasje meta-analitike (PRISMA). Shqyrtohen platformat, kanalet dhe shtrirjet e ndryshme të mediave sociale në vend, si dhe mjedisi mediatik. Studimi shqyrton gjithashtu kornizën, mesazhin dhe përmbajtjen e përdorur nga mediat shqiptare kur raportojnë për shqetësimet e shëndetit publik. Metodologjia e përdorur përfshin një rishikim sistematik dhe një meta-analizë.

Hulumtimi synon të sigurojë një kuptim gjithëpërfshirës të rolit të medias në formësimin e perceptimeve të shëndetit publik dhe adresimin e çështjeve të shëndetit publik. Peizazhi mediatik i Shqipërisë që ndryshon me shpejtësi ofron mundësi dhe sfida në kontekstin e shëndetit publik. Komunikimi efektiv është thelbësor për shëndetin publik dhe media shërben si një kanal jetik për ndarjen e informacionit, fushatat e promovimit të shëndetit dhe programet e modifikimit të sjelljes. Të kuptuarit e funksionit të medias në shoqërinë shqiptare dhe ndikimin e saj në komunikimin e shëndetit publik është thelbësor për hartimin e sfidave të suksesshme shëndetësore dhe promovimin e zakoneve të shëndetshme.

Media ndikon ndjeshëm në qëndrimet, aktivitetet dhe perceptimet e publikut për shëndetin.

Analizimi i përmbajtjes së medias dhe mesazheve të shpërndara nëpërmjet platformave të ndryshme mediatike mund të ndihmojë të kuptojmë se si media ndikon në perceptimet e publikut për shqetësimet shëndetësore dhe ndikimin e saj të mundshëm në rezultatet shëndetësore.

Politikëbërësit mund të kuptojnë më mirë ndikimin e medias në opinionin publik dhe të bëjnë gjykime të informuara mbi politikat dhe ndërhyrjet e shëndetit publik duke rishikuar nga afër mbulimin mediatik dhe duke vlerësuar mesazhet që ajo përcjell. Komunikimi efektiv dhe avancimi i programeve të shëndetit publik varet nga kuptimi i rolit të medias në këtë fushë. Synohet të informojë strategjitë dhe veprimet e ardhshme për të përmirësuar rezultatet e

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

shëndetit publik duke ekzaminuar përmbajtjen e medias, duke vlerësuar ndikimin e saj në perceptimet publike dhe duke hetuar implikimet e saj në politikat e shëndetit publik.

**Fjalët kyçe:** media, shëndet publik, komunikim, ndikim, politika, perceptim publik, sjellje shëndetësore, shpërndarje informacioni, konsiderata etike, sfida, pandemia e Covid-19.

### FARMAKOVIGJILENCA: INICIATIVAT NË PROGRAMET E FARMAKOVIGJILENCËS NË BOTË DHE SITUATA NË SHQIPËRI

*M.Sc. Sabihe Cenaj<sup>1</sup>, M.Sc. Dorilda Çela<sup>2</sup>, M.Sc. Stelina Rrajta<sup>3</sup>*

*<sup>1</sup>Specialist i Çështjeve Regulatorë dhe Farmakovigjilencës,  
Importues Farmaceutik, Tiranë*

*<sup>2</sup>Farmacist dhe Specialist në Farmakovigjilencë, Importues  
Farmaceutik, Tiranë*

*<sup>3</sup>Specialist i Çështjeve Regulatorë dhe Farmakovigjilencës,  
Importues Farmaceutik, Tiranë*

Hyrje: Farmakovigjilenca është shkenca e monitorimit të efekteve anësore dhe sigurisë së barnave. Për të monitoruar efektet anësore të barnave që tregtohen, janë krijuar programet e farmakovigjilencës. Pjesë e farmakovigjilencës janë metodat e detektimit dhe parandalimit të efekteve anësore në faza të herëshme, për të parandaluar dëmin në popullata më të madha.

Qëllimi: Ky rishikim literature synon të paraqes një përmbledhje të zhvillimeve më të fundit të farmakovigjilencës në vendet me të ardhura ekonomike të larta dhe një krahasim me situatën në vendin tonë. Qëllimi është të evidentohen iniciativat e reja në botë (farmakovigjilenca me në qendër pacientin; farmakovigjilenca në

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

popullata të veçanta; implementimi i inteligjencës artificiale në sistemet e farmakovigjilencës etj) si dhe të paraqiten përfitimet dhe sfidat e secilës prej tyre.

Metodologjia: Studimi bazohet në kërkimin me fjalët kyç të botimeve në PubMed dhe ResearchGate gjatë intervalit kohor 2019-2024. Nga numri i artikujve të gjeneruar fillimisht vetëm 203 artikuj ishin plotësisht të aksesueshëm. Si përfundim, 14 artikuj u morën në studim pasi kishin përmbajtje të përshtatshme me fokusin e studimit. Gjithashtu është kryer dhe një studim i situatës në Shqipëri.

Rezultatet: Në përfundim të studimit u vërejt se mirëfunksionimi i një sistemi farmakovigjilence kërkon 1) ekspertë mjekësor dhe shkencor, 2) ekselencë operationale dhe kompijancë si dhe 3) trajnim të vazhdueshëm të ekspertëve. Kryerja e aktiviteteve të farmakovigjilencës dhe implementimi i iniciativave të reja ka kosto ekonomike, prandaj niveli i të ardhurave të një vendi ndikon direkt në masat e marra për sigurinë e barnave. Kahasuar me shumicën e vendeve Europiane në Shqipëri, duket se ka shumë për të bërë në fushën e farmakovigjilencës. Kjo kërkon bashkëpunimin e të gjithë pjestarëve të sistemit shëndetësor, duke përfshirë profesionistët e kujdesit shëndetësor, institucionet e kujdesit shëndetësor si dhe konsumatorët.

Konkluzione: Farmakovigjilencia lidhet ngushtë me mjetet e teknologjisë së informacionit dhe përdorimi i inteligjencës artificiale në sistemin e farmakovigjilencës do të lehtësonte në masë punën e burimeve njerëzore. Të gjitha vendet me të ardhura të larta kanë sisteme të qëndrueshme të farmakovigjilencës. USFDA dhe EMA janë liderë botërorë në fushën e farmakovigjilencës.

Në Shqipëri është i nevojshëm financim qeveritar për përgatitjen e ekspertëve si dhe në implementimin e iniciativave të reja të PV.

**Fjalët kyçe:** Farmakovigjilencë; të dhëna të sigurisë; sistem i farmakovigjilencës.

**NDIKIMI I PROMOCIONIT NË KËRKESËN PËR BARNA  
PA RECETË (OTC BARNA)**

*Granit G. Çeku*

*e-mail: [granitceku@gmail.com](mailto:granitceku@gmail.com)*

Hyrje dhe qëllimi: Promocioni si funksion komunikues i marketingut është një çështje me rëndësi dhe interes në zhvillimin e aktivitetit në ndërmarrjet farmaceutike. Promocioni është një faktor i rëndësishëm në organizimin e shitjes së produkteve farmaceutike dhe për të qenë konkurrent në treg. Qëllim i punimit është të shikohet ndërlidhja e kërkesës me reklamimin e barnave që merren pa recetë. Ky punim do t'i japë përgjigje pyetjes kërkimore: A ka ndikim promocioni në kërkesën për barna pa recetë (OTC barna)?

Materiale e metoda: Për realizimin e këtij punimi është përdorur një metodologji që konsiston në një kombinim të të dhënave primare me ato sekondare. Ky studim u zhvillua mbi bazë pyetësorësh dhe intervistave, realizuar në qyteteve të ndryshme në Kosovë, në një mostër prej 100 individëve. Pastaj të dhënat e mbledhura janë sistemuar dhe përpunuar në programin SPSS, dhe janë nxjerrë rezultatet e kërkuara.

Rezultate: Ne mund të pohojmë se kërkesa e barnave pa recetë është e lidhur në masë të caktuar sa i përket reklamave. Sa i përket pyetjes kërkimore, nga të dhënat e mbledhura për pyetjen kërkimore, interpretimi do të ishte ky: nëse e marrim në tërësi shohim se promocioni ka ndikim pozitiv në kërkesën për barnat pa recetë.

Përfundime: Bazuar në rezultatet e punimit, e që kanë të bëjnë me ndikimin e promocionit në rritjen e shitjes së produkteve farmaceutike që jepen pa recetë, kemi gjetur se promocioni ka ndikim në shitjen e produkteve farmaceutike të tilla. Rekomandojmë që për barnat që jepen pa recetë, aktivitetet promocionale të jenë prezentë e sidomos të kenë njohuri mjekët, farmacistët e pacientët, por që të arsyetohet nevoja e përdorimit të tyre, dhe të merren këshillat e nevojshme nga profesionistët shëndetësorë, sepse edhe për barnat pa recetë, roli i tyre në përdorim të sigurt dhe efektiv të barnave është i jashtëzakonshëm. **Fjalë kyçe:** Barna pa recetë, farmaceutike, promocioni.

FARMACIA SOCIALE, ROLI DHE RËNDËSIA NË  
KUJDESIN SHËNDETËSOR

*Rezarta Shkreli<sup>1</sup>, Judita Përndrecaj<sup>2</sup>*

*<sup>1</sup>Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore,  
Universiteti Aldent, Tiranë*

*<sup>2</sup>Farmaci rrjeti hapur, Tiranë*

Hyrje: Pavarësisht përparimit global në teknologjinë mjekësore, gjendja shëndetësore e shumë individëve ende nuk është përmirësuar. Kjo për shkak të faktit se statusi shëndetësor i popullsisë varet kryesisht nga faktorët socioekonomikë dhe politikë të individit dhe vendit ku ata jetojnë. Në shumicën e vendeve në zhvillim, ofrimi i shërbimeve efektive të kujdesit shëndetësor pengohet gjithashtu nga mungesa e personelit të kujdesit shëndetësor të kualifikuar dhe kompetent, të cilët duhet të kuptojnë jo vetëm origjinën klinike të sëmundjeve dhe modalitetet e trajtimit, por edhe aspektin social dhe të sjelljes ndaj nevojave të kujdesit shëndetësor. Farmacia sociale (FS), është fushë multidisiplinare e arsimimit dhe kërkimit që fokusohet në rolin, sigurimin, rregullimin dhe përdorimin e barnave në shoqëri, duke mbuluar aspektet sociale, psiko-sociale, ekonomike dhe organizative të fushës së mjekësisë.

Qëllimi: Qëllimi studimit ishte njohja dhe prezantimi i aspekteve sociale të ushtrimit të profesionit të farmacistit, roli dhe rëndësia në këndvështrimin e promovimit të shëndetit të pacientit më tepër sesa në trajtimin e sëmundshmërisë.

Materiale dhe metoda: Një rishikim sistematik i literaturës së publikuar në anglisht u realizua duke përdorur udhëzuesit për “Systematic and Meta-Analysis Reviews”. Huluntimi u realizua në sitet shkencore: PubMed, Web of Science, Research Gate, Medline

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

dhe EBSCOhost për periudhën kohore janar 2018 deri në maj 2023, duke patur në fokus studime që raportojnë rolin e farmacistëve të rrjetit hapur në parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve të ndryshme si edhe në perceptimin e pacientëve lidhur me këtë rol.

**Rezultate:** Një total prej 45 studimesh raportuan që 78% dhe 22% e farmacistëve të rrjetit hapur respektivisht kishin rolet parandaluese dhe kontrolluese në sëmundjet kardiovaskulare (SKV). Rolet më të rëndësishme për farmacistin ishin: monitorimi i terapisë medikamentoze, këshillimi mbi përdorimin e barnave dhe stilin e jetesës, ndërsa rolet më pak të zbatuara ishin përshkrimi i barnave nga vetë farmacisti dhe suporti social. Perceptimi i pacientëve ishte që 78% e farmacistëve kontribuonin në parandalimin e SKV dhe 27% në trajtim dhe vetëm një përqindje e vogël ishte e kënaqur me shërbimin farmaceutik. Nga 17 studime të cilat përfshinin rolin e farmacistit në optimizimin e përdorimit të antibiotikëve, vetëm 3 prej tyre raportuan përmirësim në cilësinë e shpërndarjes, vlerësim më intensiv të simptomave (deri në 30%) dhe një reduktim të dhënies së barnave pa recetë, deri në 53%. 13 studime të tjera raportuan rolin e farmacistëve në përmirësimin dhe parandalimin e depresionit dhe dhimbjes dhe në menaxhimin e sëmundshmërisë në përgjithësi.

**Përfundime:** Gjetjet theksojnë aftësinë e farmacistëve të rrjetit hapur për të ofruar shërbime të kujdesit parësor shëndetësor në parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve të ndryshme. Hulumtimet e ardhshme duhet të vlerësojnë efektivitetin e këtyre roleve dhe të ofrojnë një vlerësim gjithëpërfshirës të rezultateve klinike, humane dhe ekonomike.

**Fjalë kyçe:** farmaci sociale, përdorim racional, perceptim i pacientit, kujdesi shëndetësor

**VLERËSIMI I FLETËUDHËZUESVE TË BARNAVE NGA  
KËNDVËSHTRIMI I PACIENTËVE**

*Sonila Vito<sup>1</sup>, Ornela Veliu<sup>2</sup>, Edlira Papamihali<sup>3</sup>, Anjeza Kaleci<sup>4</sup>*

*<sup>1</sup>Pedagoge, Albanian University, Fakulteti i Shkencave Mjekësore,  
Departamenti i Farmacisë*

*<sup>2</sup>Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore*

*<sup>3</sup>Zyra e Përfaqësisë Bayer, Tiranë*

*<sup>4</sup>Zyra e Përfaqësisë Novartis, Tiranë*

Hyrje: Fletudhëzuesit kanë një rol thelbësor në compliancën e pacientit ndaj trajtimit dhe si rrjedhojë edhe në efektshmërinë e barit. Është e domosdoshme që informacioni mjekësor që u ofrohet pacienteve të jetë i saktë dhe i besueshëm për t'i ndihmuar ata të përdorin barnat në mënyrë të sigurt dhe efektive.

Pavarësisht nga të gjitha përpjekjet e autoriteteve rregullatore dhe kompanive farmaceutike për të siguruar që fletudhëzuesit të jenë të orientuar drejt pacientit, ato vazhdojnë të jenë subjekt i diskutimeve dhe debateve aktuale të kujdesit shëndetësor.

Qëllimi: Të vlerësojë shkallën e përdorimit të fletudhëzuesve nga pacientët si dhe përvojat tyre të lidhura me lexueshmërinë dhe vështirësinë për t'i kuptuar ato.

Metodologjia: Metodologjia bazohet në shyrtrimin e literaturës shkencore dhe bashkëkohore mbi përdorimin dhe vlerësimin e fletudhëzuesve nga pacientët. Strategjia e kërkimit për këtë studim u bazua në përdorimin e fjalëve kyçe në anglisht për kërkimin e atikujve të plotë në **Google Scholar**, **PubMed** dhe **Scopus** të publikuar përgjatë periudhës 2019-2024. Në këtë rishikim literature u përzgjodhën për t'u marrë në shqyrtim 17 artikuj të ndryshëm.

Rezultatet: Literatura aktuale zbulon se pacientët tregojnë një interes të madh për të mësuar rreth barnave përmes informacionit të paraqitur në fletudhëzuesit përkatës. Megjithatë, dëshmitë tregojnë se pacientetët jo gjithmonë i shohin si të përshtatshëm apo informues. Gjithashtu u konstatua se fletudhëzuesit paraqesin një sërë

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

problemesh, që lidhen me vështirësinë në lexim si dhe listimin e informacionit të pambështetur në prova.

Gjithashtu u konstatua se shqetësimi që përmendet më shpesh së fundmi është i lidhur me pengesat që hasin pacientët e moshuar në aksesimin e informacionit mjekësor elektronik.

Përfundimet: Edhe pse fletudhëzuesit përfaqësojnë një burim të besueshëm dhe të kënaqshëm informacioni rreth barnave për shumicën e pacientëve, është e nevojshme të eksplorohehen të gjitha mundësitë për t'i bërë ato më efektive dhe të dobishme.

Nëse aspekte të ndryshme të barit si efektet anësore, kundërindikacionet ose ndërveprimet e barnave nuk paraqiten në mënyrën e duhur, atëherë kjo mund të ndikojë negativisht në përdorimin e sigurt dhe racional të barnave nga popullata.

**Fjalët kyçe:** Fletudhëzues, pacientë, informacion mjekësor, lexueshmëri.

## MARKETINGU DIXHITAL SI FORMË E RITJES DHE FUQIZIMIT TË MARKËS NË INDUSTRIJË FARMACEUTIKE

*Nevjana Bakaj (Bejkolli) Msc<sup>1\*</sup>, Silva Ibrahimimi PhD<sup>2</sup>, Dott.Ervin Ibrahimimi PhD<sup>3</sup>*

*<sup>1</sup>Project Manager, Florfarma shpk, <sup>2</sup>Kërkuuese Shkencore Akademike PLOS ONE, Boston, USA, <sup>3</sup>Përgjegjës Mjekësor, Area Vasta 2, Cooss-Marche, Itali*

Hyrje dhe Qëllimi: Industria farmaceutike, krahasuar me sektorët e tjerë, ka një veçori unike në trajtimin, ruajtjen dhe përmirësimin e jetës së njerëzve. Çdo kompani që operon në këtë sektor ka fillimisht funksion social dhe më pas ekonomik; andaj ruajtja e një standardi të



## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

lartë nuk shihet si një pikë mbërritjeje apo një tipar dallues, por edhe si një standard i pajtueshem. Industria farmaceutike është një sektor shumë i avancuar teknologjik e cila mbeshtetet në sektorin e Kërkimit dhe Zhvillimit dhe, rrjedhimisht, në kapitalin e miretrajnuar njerëzor. Evolucioni dixhital ka ndikuar fuqishem në modelet organizative të industrisë farmaceutike në Shqipëri. Ky punim synon të analizojë se si një ekosistem dixhital i integruar, i lidhur me një strategji të marketingut dixhital, mund të çojë në një përmirësim thelbësor të efciences se brandeve farmaceutike dhe sjelljen e konsumatorit.

**Materiale e Metoda:** Metodologjia e përdorur në këtë punim është e përzier: sasiore dhe cilësore. Instrumentat e vlerësimit përfshijnë pyetësorët dhe shkallën CBR për efekshmërinë me besueshmëri  $\alpha = 0.914$ . Në këtë punim, propozohet një model i përdorimit të mediave sociale si nje praktike efikase e komunikimit te brandit dhe menaxhimit ne tregun farmaceutik.

**Rezultate:** Indekset në lidhje me korrelacionin ndërmjet komunikimit (empatisë ose funksionalitetit) dhe reputacionit të organizatës në sektorin farmaceutik konkludojnë se ka efekte të konsiderueshme moderimi në rastet kur mesatarja e përgjigjeve në shkallën e matjes së reputacionit të markës është 3.85 (efekti = .315;  $t = 5, 356$ ;  $p = .000$ ) dhe 4.50 (efekti = -.324;  $t = -5.609$ ;  $p = .000$ ).

**Përfundim:** Si konkluzion në këtë punim, është me rëndësi të thuhet se komunikimi dixhital, i ndërthurur me një strategji marketingu dixhitale që synon një pozicionim specifik mund të rrisë eficiencën në kompanitë farmaceutike në strategji afat-gjata të zhvillimit. Mbështetur në modelin e propozuar në këtë punim, kjo strategji sistematike duhet të jetë efektive në modifikimin e perceptimit individual në favor të rritjes dhe fuqizimit të sipërmarrjes farmaceutike.

**Fjalë kyçe:** industri farmaceutike, transformim dixhital, marketing, zhvillim teknologjik, fuqizim.

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

### VEPRA PENALE E FALSIFIKIMIT TË PRODUKTEVE FARMACEUTIKE

#### *Artenca Shkenza Kraja*

*Farmaciste, Instituti i Ekzekutimit te Vendimeve Penale "Ali Demi"*

Hyrje: Shqetësimi që lidhet me cilësinë e barnave është po aq i vjetër sa vetë barnat. OBSH ka raportuar se fenomeni i barnave të falsifikuara është tepër i përhapura, raportime të shumta vijnë nga çdo vend i botës duke e kthyer në një problem të shkallës globale.

Qëllimi: Ky punim ka si objekt prezantimin me veprën penale të "Prodhimit dhe tregtimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore të falsifikuara ose të rrezikshme për jetën dhe shëndetin" neni 284/d dhe argumentimin e rëndësisë së saj përmes impaktit të gjërë që ka kjo veprë penale. Një ndër qëllimet kryesore është edhe trajtimi dhe analizimi i dispozitës ligjore në vendin tonë dhe krahasimin me standartet ndërkombëtare.

Shqyrtimi i literaturës dhe metodologjia. Për të arritur në të dhëna të sakta janë përdorur disa burime të informacionit siç janë: ligjet dhe aktet ligjore, të dhëna nga artikuj shkencorë, udhëzime nga protokollet ndërkombëtare, të gjitha këto që kanë në qendër të vëmendjes legjislacionin farmaceutik, kodin penal. Ky studim është konceptuar si një hulumtim shumë dimensional: përshkrues, analitik dhe krahasues.

Rezultate: Përmes analizës u vu re që produktet farmaceutike të falsifikuara kishin impakt në shëndetin e pacientëve, te prodhuesit, në sistemet qeveritare dhe në ekonomi.

Nga analiza dhe krahasimi me njërin nga vendet e BE siç Spanja e cila ka krijuar një legjislacion akoma më të përafërt me atë të BE lidhur me barnat, vërej disa ndryshime të cilat vlejné të meren në konsideratë. Fusha e zbatimit: Vepra penale 284/d duke u bazuar edhe në ligjin e barnave përfshin vetëm barnat për përdorim human. Ndërsa

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

në kodin penal spanjoll janë të përfshira edhe barnat për përdorim veterinar. Dokumentacioni: Mendoj që është e përshtatshme që të përfshihet edhe elementi i falsifikimit të dokumenteve në nenin 284/d, pasi pasoja që sjell ky veprim është i rrezikshëm. Në nenin 284/d përdoren vetëm termat “i falsifikuar”, “të rrezikshme përjetën dhe shëndetin” besoj që do të ishte me vend nëse do të përfshiheshin edhe në Kodin tonë Penal termat të “skaduar”, “të dëmtuara” e “ jashtë standarteve” si elemente të cilët dëmtojnë jetën dhe shëndetin, ashtu siç specifikohet në Kodin Penal Spanjoll. Veprimtaria profesionale. Sipas interpretimit të bërë tek kodi i procedurës së posaçme veprimtaria profesionale ka të bëjë me profesionistë të fushës së mjekësisë si mjek, infermier etj. Duke u mbështetur në Kodin Penal Spanjoll mendoj që të ketë një zgjerim të veprimtarive profesionale që ushtrojnë këtë vepër penale.

Përfundime dhe sugjerime: Përfshirja e nenit 284/d ne Kodin Penal ka një rëndësi të madhe për shkak të impaktit të lartë që kanë produktet farmaceutike të falsifikuara.

Përveç bashkëpunimit ndërkombëtar është i nevojshëm edhe një harmonizimin me legjislacionin ndërkombëtar, duke krijuar nje legjislacion akoma më të përafërt me atë të BE lidhur me barnat.

**HARMONIZIMI I LEGJISLACIONIT FARMACEUTIK: NJË  
STUDIM KRAHASUES MIDIS EMA DHE FDA**

*Lisjada DUSHI*

*Amicus, Swixx BioPharma company, Regulatory affairs departament.*

Hyrje: Suksesi i industrisë farmaceutike është lidhur ngushtë me mbikqyrjen e organeve rregullatore. Ky artikull eksploron peisazhin rregullator të tregut farmaceutik, me një fokus specifik në rolin e Administratës së Ushqimit dhe Barnave të Shteteve të Bashkuara (FDA) dhe Agjencisë Evropiane të Barnave (EMA).

Metodologjia: Studimi është i llojit deskriptiv-krahasues. Metodatat e përdorura në këtë studim janë: metoda e hulumtimit analitik, metoda e hulumtimit krahasues, metoda e hulumtimit interpretues. Në këtë artikull, janë shqyrtuar sistemet rregullatore të FDA dhe EMA, duke listuar parimet, rregullat dhe metodatat e përdorura për të garantuar sigurinë dhe efikasitetin e produkteve farmaceutike.

Përfundimi: Njohja e thellë e këtij kuadri rregullator është e domosdoshme për të gjithë pjesëmarrësit në sektorin farmaceutik. Harmonizimi i rregulloreve është i domosdoshëm në një treg mbarbotëror. Në këtë artikull kemi adresuar sfidat dhe tendencat në rregullimin farmaceutik, të cilat kanë ndikim në inovacionin, sigurinë dhe qasjen në treg. Ky artikull kontribuon në diskutimet aktuale për arritjen e këtij ekuilibri.

**Fjalë kyçe:** Agjenci rregullatorë, FDA (Administrata e Ushqimit dhe Barnave e Shteteve të Bashkuara), EMA (Agjencia Evropiane e Barnave), Harmonizim, Siguri dhe efikasitet.

**STUDIM MBI MARKETINGUN FARMACEUTIK NE  
SHQIPERI, NE PERIUDHEN JANAR 2024**

*Msc. Elefteri Baba*

*Farmaci "Ungjillëzimi", Tiranë*

Hyrje dhe qëllimi : Marketingu farmaceutik është procesi i promovimit të barnave që jepen me recetë dhe të produkteve të tjera mjekësore ndaj profesionistëve të mjekësisë, pacientëve dhe konsumatorëve.

Qëllimi i këtij studimi është të pasqyrojë situatën e marketingut farmaceutik në Shqipëri, gjatë muajit janar 2024 ; sfidat dhe faktorët kryesorë që ndikojnë në të .

Materiale e metoda : Studimi është i llojit deskriptiv. Ai u realizua nëpërmjet një pyetësori të strukturuar, i cili u shpërnda në mënyrë rastësore në 75 agjentë shitje të depove të ndryshme farmaceutike në Shqipëri . Përpunimi i rezultateve të përfuara u bë me metodën statistikore SPSS 16.

Rezultate : Nga ky studim rezultoi se : 44 % e të anketuarve ishin meshkuj , 56 % femra ; 32 % e tyre kishin më pak se 5 vjet eksperiencë, 36 % kishin 5 – 10 vjet eksperiencë, 32 % më shumë se 10 vjet ; 30.7 % e agjentëve të shitjes u përgjigjën se shitjet në janar 2024 ishin më pak se në janar 2023 , 69.3 % u përgjigjën se ishin njëjloj ; 32% e të anketuarve u përgjigjën se profesionalizmi i agjentëve të shitjes ishte faktori kryesor që ndikon në rritjen e shitjeve të produkteve farmaceutike, 20 % ofertat e produkteve, 20 % ofertat dhe profesionalizmi, 16 % profesionalizmi, reklamat dhe fletëpalosjet, 12 % ofertat dhe reklamat; 28 % e agjentëve u përgjigjën se estetika e ambalazhimit ndikon pak në shitje , 12% mesatarisht, 60 % shumë ; 20 % e agjentëve të shitjes ishin pak të kënaqur nga bashkëpunimi me farmacistët, 34.7 % mesatarisht, 45.3 % shumë; sipas 37.3 % e të anketuarve qëndrimi ndaj produkteve të reja farmaceutike nga mjekët dhe farmacistët ishte indiferent, 62.7 % pozitiv; sipas 34.7 % e të anketuarve sfida më e madhe për ta ishte vështirësia e bashkëpunimit me farmacistët, 26.7 % vështirësia e bashkëpunimit me mjekët, 5.3 % prezantimi i produkteve në

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

farmacitë e zonave të thella, 33.3 % procesi i digjitalizimit në marketingun farmaceutik; 70.7 % e të anketuarve ishin mesatarisht të kënaqur me profilin e tyre të punës dhe 29.3 % shumë të kënaqur .

Përfundime : Nga rezultatet e këtij studimi vërejmë se situata e marketingut farmaceutik në Shqipëri paraqitet jo shumë pozitive. Duhet të ketë më shumë investim në këtë sektor, më shumë bashkëpunim nga ne farmacistët si dhe më shumë trajnime për agjentët e shitjes, sidomos në procesin e digjitalizimit të marketingut farmaceutik , që e ardhmja të jetë premtuese.

**Fjalët kyçe** : marketing farmaceutik, agjent shitje, mjek, farmacist, shitje.

### **ROLI I FARMACISTIT NË MJEKËSINË NUKLEARE GJATË PUNËS ME BURIME RADIOAKTIVE, SFIDAT DHE RREZIQET**

*Prof. Ass Dr. Armend M. Jashari PharmD. MBA.*

*Dr. Ismet Bajrami, PhD Candidate*

Mjekësia Nukleare është ndër disiplinat më të reja mjekësore që fillon të zhvillohet në gjysmën e parë të shekullit XX. Përparësitë e mjekësisë nukleare ndaj metodave tjera diagnostike në pasqyrimin e funksionit qelizor janë shumë të mëdha dhe gati të pa krahasuara.

Në mjekësinë nukleare është gati e domosdoshme puna e ekipore e përbërë nga mjeku specialist i mjekësisë nukleare, fizikani mjekësor, radiofarmacisti, biokimisti dhe mjekë të profileve tjera mjekësore.

Paisjet që përdoren në Mjekësi Nukleare janë Gamma Camera, Spect CT, PET-CT, PET-MRI, Gamma counter-RIA dhe së fundi edhe DEXA për matjen e Osteodenzitometrisë.

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

Diagnostika radionuklide in vivo përmes materieve radioaktive shërben për qëllime diagnostikimi duke futur ato brenda në organizëm.

Diagnostiken radionuklide in vitro përmes vënies në kontakt të radioizotopeve me lëngjet trupore në ambient jashtë organizmit (metodat-RIA)

Për dallim nga radionuklidet, radiofarmakët janë preparate farmakologjike që shënohen apo markohen me radionuklide.

Radiofarmakët pra janë substanca farmakologjike që kanë afinitet të lidhen për radionuklidë, pa dëmtuar strukturën e tyre kimike.

Radiofarmakët pasi që të markohen, mund të futen në trupin e njeriut dhe varësisht prej afinitetit të tyre metabolik, ofrojnë mundësinë e përcjelljes së proceseve metabolike në qeliza, inde apo organe të caktuara.

## THE IMPORTANCE AND APPLICATION ARTIFICIAL INTELLIGENCE IN PHARMACY

*Bojana Djuricic*

**Artificial intelligence (AI)** is a branch of computer science that deals with the development of software and systems capable of performing tasks normally performed by humans, such as speech and image recognition, decision making, learning, planning and problem solving. Artificial intelligence uses various techniques and algorithms to recognize patterns and learn from data. For example, machine learning algorithms are used to train models that can recognize patterns in data and make decisions based on those patterns. Neural networks are used to simulate the brain and solve complex problems. Genetic algorithms are used to optimize processes and solve optimization problems.

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

In the last 30 years the development of artificial intelligence (AI) that can be applied in all areas of science has brought numerous benefits. Many researchers have explored potential applications of intelligent techniques in every field of medicine.

The importance of AI is reflected in the possibility of proper decision-making, without subjectivity, fatigue, with unlimited possibilities of remembering and making conclusions. This is important in medicine, for the prevention and diagnosis of various diseases, as well as therapy monitoring. Numerous studies have shown that AI will soon replace medical staff in numerous activities, as results obtained by AI are better and more precise.

A number of applications have been developed to simplify patient adherence to therapy, which ultimately affect the therapy. The application of AI is present in the pharmaceutical industry, in the design of new drugs. This precludes preclinical tests, which are extremely long and expensive. AI makes conclusions based on the available data, so the validity of data must be taken into account because extremely important algorithms are based on them. An important aspect is the protection of patient data since the possibility of data becoming public is a major ethical problem.

Clinical data analysis: Artificial intelligence is used to analyze large amounts of clinical data to find patterns and identify risk factors for various diseases. This helps in improving the diagnosis, treatment and prevention of various diseases.

Production optimization: Artificial intelligence is used to optimize the drug production process, which allows for cost reduction, quality improvement and efficiency increase. Robotics in Pharmacy: Artificial intelligence is being used to develop robots that can help in drug manufacturing, packaging, storage and delivery. This helps reduce costs and improve efficiency in the pharmaceutical industry.



**MANIFESTIMET KARDIOVASKULARE TË SINDROMËS  
SË ZGJATUR COVID NË POPULLATËN SHQIPTARE ME  
DIABET**

*Aida Dama, Era Gorica, Kleva Shpati*

*Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore,  
Albanian University*

Në vazhden e pandemisë globale COVID-19, komuniteti mjekësor është përballur me shfaqjen e sindromës së zgjatur COVID-19, një gjendje komplekse e karakterizuar nga një grup simptomash që vazhdojnë shumë kohë pasi sëmundja është zgjidhur. Ndër sfidat e panumërta shëndetësore që paraqiten, janë shfaqur ndërlikimet kardiovaskulare si një aspekt veçanërisht shqetësues, duke pasur parasysh potencialin e tyre për të dëmtuar ndjeshëm cilësinë e jetës dhe për të rritur sëmundshmërinë dhe vdekshmërinë. Kjo është veçanërisht e vërtetë për pacientët me gjendje shëndetësore para-ekzistuese, si diabeti, të cilët janë në një rrezik të shtuar të zhvillimit të pasojave të rënda nga COVID-19 dhe mund të përjetojnë manifestime më të theksuara ose unike të sindromës së zgjatur COVID. Shqipëria, si shumë vende, është përballur me betejën e saj me COVID-19 dhe pasojat e tij, duke përfshirë sindromën e zgjatur COVID. Ndërthurja e kësaj gjendje me diabetin, paraqet një sfidë unike për sistemin shëndetësor shqiptar. Dihet se pacientët diabetikë kanë një rrezik në rritje të sëmundjeve kardiovaskulare dhe barra shtesë e Covid mund të komplikojë prognozën dhe menaxhimin e tyre. Duke njohur rëndësinë e kësaj çështjeje, në këtë studim synojmë të eksplorojmë manifestimet kardiovaskulare të sindromës së zgjatur COVID në popullatën shqiptare, duke u fokusuar tek pacientët me diabet.

Ky hulumtim është përshtatur në mjedisin e kujdesit shëndetësor shqiptar dhe kërkimet përkatëse janë kryer brenda vendit nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me farmacistët, pacientët dhe mjekët si dhe studimet ndërkombëtare të aplikueshme.

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

Qëllimi është të zbulohen komplikacionet specifike kardiovaskulare dhe manifestimet e Covid te zgjatur në këtë grup pacientësh vulnerabël, të kuptohet patofiziologjia e këtyre komplikimeve dhe të vlerësohen qasjet aktuale diagnostike dhe terapeutike që përdoren. Duke pasur parasysh shkallën globale të pandemisë COVID-19 dhe sfidën universale të menaxhimit të sindromës së gjatë COVID-19, ky studim jo vetëm që kontribuon në rritjen e njohurive mbi këtë temë, por gjithashtu thekson rëndësinë e kërkimit të kontekstualizuar. Të kuptuarit e ndikimeve specifike të COVID-it të zgjatur në popullata të ndryshme, si pacientët me diabet në Shqipëri, është thelbësore për zhvillimin e strategjive të përshtatura të kujdesit shëndetësor që mund të trajtojnë në mënyrë efektive sfidat e paraqitura nga kjo gjendje.

**Fjalë Kyçe:** COVID-19, komplikacione, kardiovaskulare, diabet

### PËRDORIMI I ANTIBIOTIKËVE NË KONTEKSTIN E

#### COVID-19: PERSPEKTIVA NGA FARMACISTËT

#### SHQIPTARË

*Prof. Asoc. Silvi Bozo<sup>1\*</sup>, Dr. Shk. Irsida Mehmeti<sup>2</sup>, Dr. Shk Eftiola Pojani<sup>1</sup>*

<sup>1</sup> *Departamenti i Teknologjive Kimiko-Farmaceutike dhe Biomolekulare, Fakulteti i Farmacisë, Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", Tiranë, Shqipëri.*

<sup>2</sup> *Departamenti i Shkencave Farmaceutike, Fakulteti i Farmacisë, Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", Tiranë, Shqipëri.*

Hyrje dhe qëllimi: Në kuadrin e pandemisë globale të COVID-19, përdorimi racional i antibiotikëve është shfaqur si një shqetësim kritik<sup>1,2</sup>. Farmacistët, si ofrues të kujdesit shëndetësor të vijës së parë, luajnë një rol kyç jo vetëm në shpërndarjen e antibiotikëve por gjithashtu në optimizimin e përdorimit të tyre, duke ofruar informacion dhe nxitur edukimin e publikut<sup>3</sup>. Ky studim synon të vlerësojë perspektivat e farmacistëve në Shqipëri, mbi përshtatimin dhe përdorimin e antibiotikëve gjatë Covid-19. Ky hulumtim është

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

thelbësor për hartimin e ndërhyrjeve të synuara që sigurojnë përdorimin racional të antibiotikëve, duke nxitur si shëndetin publik ashtu edhe kujdesin antimikrobik<sup>4</sup>.

Materiale dhe metoda: Për të përmbushur këto qëllime, gjatë vitit të dytë të pandemisë u zhvillua një anketim mbarëkombëtar, duke përdorur një pyetësor online drejtuar farmacistëve shqiptarë. Më pas u analizuan faktorët që ndikojnë në këto perceptime, veçanërisht në lidhje me mjedisin e punës. Gjithashtu, farmacistët u pyetën për mungesa në kategoritë e barnave, me fokus të veçantë tek antibiotikët. Për të eksploruar varësinë midis variablave, u përdorën teste statistikore, duke përfshirë testet chi-square.

Rezultate: Nga farmacistët e rekrutuar, 174 prej tyre pranuan të merrnin pjesë në studim. Pjesa më e madhe e farmacistëve pjesëmarrës ishin femra (86.2%), i përkisnin grupmoshës 30-39 vjeç (51.7%) dhe punonin në farmacitë e rrjetit të hapur (73%). 63.2% e farmacistëve konfirmuan se gjatë pandemisë Covid-19 ka patur abuzim në përshkrimin dhe përdorimin e antibiotikëve. Analiza e mëtejshme tregoi një lidhje të fortë midis këtij perceptimi dhe vendit të punës ( $X^2= 22.439$ ,  $p=0.033$ ), veçanërisht në farmacitë e komunitetit (64.6%). Për sa i përket mungesës së barnave, më shumë se 1/3 e farmacistëve (35.6%) kanë cituar antibiotikët si katëgorinë më të prekur.

Përfundime: Rezultatet e këtij studimi theksojnë ndikimin e thellë të pandemisë Covid-19 në përdorimin e antibiotikëve sipas perspektivës së farmacistëve në Shqipëri. Dinamikat e lidhura me vendin e punës theksojnë nevojën për ndërhyrje të përshtatura, veçanërisht në farmacitë e rrjetit të hapur për të adresuar sfidat që lidhen me përdorimin e antibiotikëve gjatë krizave shëndetësore. Planifikimi proaktiv është thelbësor për të siguruar disponueshmërinë dhe përdorimin racional të antibiotikëve, duke mbrojtur shëndetin publik. Ky hulumtim nxit gjithashtu zhvillimin e studimeve të mëtejshme në këtë fushë duke theksuar rolin e domosdoshëm të farmacistëve në optimizimin e praktikave antibiotike gjatë dhe përtej krizave shëndetësore.

**Fjalë kyçe:** antibiotik; Covid-19; farmaci të rrjetit të hapur; Shqipëri.

**FARMAKOGJENOMIKA NË FARMACEUTIKË**

*Klodiola Dhamo, Rezarta Shkreli, Artjola Malija*

*Departamenti i Farmacisë; Fakulteti i Shkencave Mjekësore;  
Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri.*

Hyrje dhe Qëllimi: Sfidat me të cilat përballlet industria farmaceutike, si kostoja e lartë dhe ritmi i ngadaltë i zhvillimit të barnave, duket se vazhdojnë. Ekzistojnë barrierat socio-ekonomike që zbusin integrimin e plotë të bioinformatikës dhe farmakogjenomisë në procesin e zbulimit dhe zhvillimit të barnave, duke kufizuar kështu efektet e dëshiruara dhe të pritshme. Punimi do të vlerësojë faktorët ekonomikë dhe rregullatorë që përcaktojnë praktikën aktuale të zbulimit dhe zhvillimit të barnave dhe sa mirë përshtaten këto qasje me zbulimin dhe zhvillimin e barnave të krijuara nga bioinformatika

Materiale e Metoda: Ky punim është një përmbledhje e literaturës ekzistuese mbi farmakogjenomikën dhe farmakogjenetikën me theks në publikimet dhe materialet kërkimore që diskutojnë zbulimin dhe zhvillimin e barnave. Kërkimi gjithëpërfshirës përfshiu shumë botime të publikuara përmes tre bazave të të dhënave shkencore në 5 vite të fundit.

Rezultate: Zbulimi i barnave sot është një proces shumë kompleks, konkurrues, delikat dhe i rrezikshëm. Kostoja e zbulimit dhe zhvillimit të barnave përgjithësisht konsiderohet si kosto totale nga zbulimi deri në miratim. Tradicionalisht, kompanitë farmaceutike kanë përdorur një qasje të kujdesshme kryesisht të bazuar në kimi dhe farmakologji për zbulimin e barnave, dhe po e kanë gjithnjë e më të vështirë gjetjen e komponimeve të reja që do të çojnë në barna të reja. Njohuritë e reja të biomarkerëve gjenetikë për sëmundjet po nxisin zhvillimin e strategjive të zbulimit dhe zhvillimit të barnave me bazë farmakogjenomike që lejojnë kompanitë farmaceutike të hartojnë regjime dhe doza më të individualizuara të barnave.

Përfundime: Bioinformatika dhe farmakogjenomika janë aspektet më të fundit të evolucionit të vazhdueshëm të procesit të zbulimit dhe zhvillimit të barnave. Adoptimi i tyre në procesin e zbulimit dhe zhvillimit të barnave është sinonim i mbijetesës së ardhshme të kompanive të mëdha farmaceutike.

**VAKSINIMI KUNDËR LISË NË SHQIPËRI DHE  
PERSPEKTIVAT NË MBROJTJEN IMUNITARE EDHE  
NDAJ LISË SË MAJMUNIT**

***Adriana Manuka<sup>1</sup>, Carlo De Giuli Morghen<sup>1</sup>, Antonia Radaelli<sup>2</sup>,  
Irsida Mehmeti<sup>1</sup>***

*<sup>1</sup> Departamenti i Shkencave Farmaceutike Fakulteti i Farmacisë  
Universiteti “Zoja e Këshillit të Mirë”, Tiranë, Shqipëri*

*<sup>2</sup> Departamenti i Bioteknologjisë Mjekësore dhe Mjekësisë  
Translacionale Universiteti Shtetëror i Milanos, Milano, Itali*

Hyrje dhe qëllimi. Lija e majmunit është një sëmundje zoonotike virale, e ngjashme me lijën, shkaktohet nga virusi i lisë së majmunit (monkeypox virus, MPXV), anëtar i familjes së orthopoxviruseve. Viruset që i përkasin kësaj gjinie njihen si kërcënimi më i madh për shëndetin publik pasi lija u zhduk në Shqipëri dhe vaksinimi kundër saj me virusin vaksinal (VACV) u ndërpre në vitin 1980. Në vitin 2022 u identifikuan mbi 87’000 raste të reja infektimi nga MPXV tek njeriu, në botë.

Në mungesë të një vaksine specifike kundër MPXV, të dhënat në literaturë tregojnë që vaksina e përdorur për profilaksinë ndaj lisë, është efikase edhe ndaj viruseve të tjera të së njëjtës familje (1).

Qëllimi i këtij studimi është vlerësimi i pranishë së antitropave anti-VACV tek individët shqiptar që i përkasin grupmoshave nga 44 në 84 vjeç të imunizuar ose jo ndaj VACV dhe mundësia potenciale që të kemi një përgjigje të përbashkët imunitare VACV/MPXV.

Materiale dhe metoda. Janë përzgjedhur 220 vullnetarë pranë Poliambulancës “At Luigji Monti”. Përpara përfshirjes së tyre në studim, iu kërkua nëse gëzonin shëndet të plotë, kishin kaluar virozë dhe temperaturë në 7 ditët e fundit. Gjithashtu, iu kërkua miratimi i tyre me shkrim konform rregullores së Komitetit Etik të Universitetit “Zoja e Këshillit të Mirë”. Mostrat e gjakut u centrifuguan, serumi u

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

ruajt në -20 °C dhe u testuan me anë të testit *in vitro* ELISA për prezencën apo jo të antitropave anti-VACV dhe anti-MPXV.

Rezultatet. Janë mbledhur 227 mostra të klasifikuar sipas moshës në 5 grupe. Katër grupet e para përbëhen nga 50 vullnetarë përveç grupit që shërbejnë si kontroll-negativ, përbëhet nga 20 vullnetarë (20-43 vjec) që nuk janë të vaksinuar ose të kenë pasur një histori infektimi nga lija. Testet ELISA të kryera në serumet e grupit D (74 - 84 vjec) kanë treguar prezencën e antitropave kundër VACV të inaktivizuar, 4 proteinave të virusit variola (VV) (A33R, B5R, A27L, L1R) dhe të proteinave ortologe të saj, pra të MPXV.

Përfundime.Të dhënat e para tregojnë mundësinë potenciale e një përgjigje të përbashkët imunitare VACV/MPXV dhe aktivitetit neutralizues ndaj MPXV. Në rast që këto hipoteza vërtetohen, tek individët që vazhdojnë të kenë antitropa anti-VACV, nuk do të përfshihen në planin e vaksinimit ndaj MPXV.

**Fjalët kyçe:** Vaksinim, Test ELISA

## SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE NE LIDHJE ME VIROZAT RESPIRATORE DHE PRAGU EPIDEMIK NE SHQIPERI NE JANAR TE 2024

*D. Ulqinaku, A. Vasili, A. Simaku, Sh. Qyra*

*Instituti i Shendetit Publik*

Hyrje; Sezoni i gripit është një përsëritje vjetore që karakterizohet nga një rritje të prevalencës (dhe të incidencës) të një shpërthimi nga virusit i gripit. Sezoni në përgjithësi ndodh në gjysmën e ftohtë të sejcilës hemisferë. Aktiviteti i epidemisë së gripit shpesh herë mund të parashikohet. Situata epidemike nga infeksionet virale dhe gripi në veçanti zgjat mesatarisht 10 javë (me një shtrirje nga 6 deri në 25).

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

Epidemiologët e fushës e llogarisin prapë epidemik si dhe intensitetin e virusëve qarkulluesë duke përdorur MEM (*The Moving Epidemic Method*). Ndërthurja dhe me virusin e SARS-CoV-2 ishte prezente dhe në shumë raste krijoi konfuzion në popullatë por edhe midis profesionistëve shëndetsor.

**Qëllimi:** Eshtë të përshkruaj kurbën epidemike të infeksioneve respiratore akute (ARI) apo të infeksioneve të ngjashme me gripin (ILI) si dhe të diskutojë në lidhje me prapë epidemik për vitin 2024.

**Materiali dhe Metoda:** Materjalet janë marrë nga të dhënat e survejancës epidemiologjike ALERT si dhe survejancës sentinel në vëndin tonë. Ky është një përshkrim deskriptiv për të parë incidencën e infeksioneve respiratore në fillim vitin e 2024 si dhe për të diskutuar çfarë do cilësojmë si epidemi, fillim epidemie apo pikun e saj.

**Rezultatet:** Numri i infeksioneve respiratore të poshtme dhe të sipërme arriti në 17 052 në javën e tretë të janarit, duke patur një trend rritje gati 20% nga java e fundit e vitit 2023, javë e cila shënonte 11 042. Grupmosha më e prekur rezultoi grupmosha pediatrike. Nga ana laboratorike kishim prezencë si të gripit ashtu edhe të SARS-CoV-2.

**Konkluzionet dhe rekomandimet:** Të diturit të fillimit të aktivitetit epidemik është një task shumë e rëndësishme si për personelin shëndetsor ashtu edhe për systemin në përgjithësi. Informacioni mbi kohën dhe intensitetin e epidemisë ndihmon në trajtimin dhe parandalimin më të mirë të rasteve.

**Fjalët kyçe:** Epidemi, Infeksionie respiratore, grip, SARS-CoV-2

**IMUNOLOGJIA E INFEKSIONIT NGA SARS-COV-2 DHE  
PËRGJIGJJA IMUNE NË SUBJEKTET E IMUNIZUARA**

*Enton Kaçulini<sup>1</sup>, Alma Shehu<sup>2</sup>, Kleva Shpati<sup>1</sup>, Amarildo Bakia<sup>2</sup>*

*<sup>1</sup>Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Albanian University, Tiranë, Albania, <sup>2</sup>Mjek, Tiranë, Albania*

Edhe pse Sars-Cov-2 ka aftësi ta shmangë sistemin imun të lindur dhe çon në një dëmtim të përgjigjes të sistemit imun të fituar, në pjesën më të madhe të njerëzve infeksioni kalon pa pasoja. Sistemi imun i lindur, në luftën me viruset, ka dy krahë: inflamacionin dhe gjendjen antivirale. Aktivizimi i njërit apo tjetrit krah përcakton edhe shkallën e gravitetit të sëmundjes. Është e arsyeshme të konsiderojmë se hospitalizimi nga Covid-19 parandalohet nga një kombinim i duhur i antittrupave, qelizave B të memories dhe qelizave T CD4/CD8. Çdo pjesë e imunitetit të fituar ka shkallën e vet të kontributit. Antittrupat janë mekanizmi i vetëm që mund të sigurojë imunitet sterilizues të vërtetë. Qelizat T janë kritike për përgjigjen antikorpale dhe evidenca të shumta tregojnë për një kontribut mbrojtës të këtyre qelizave ndaj Covid-19. Memoria imune ndaj Sars-Cov-2 ndihmon për të përcaktuar mbrojtjen nga ri-infektimet dhe rreziku i sëmundjes. Mbrojtja që jep infeksioni natyral ndaj ri-infektimit zbehet dhe mund të zhduket brenda pak viteve. Kjo zbehje mund të përshpejtohet nga shmangia imune virale. Mbrojtja ndaj ri-infektimit të rëndë mbetet shumë e fortë, pa evidenca të zbehjes, pavarësisht nga varianti, për më shumë se 14 muaj pas infeksionit primar Mbrojtja e nxitur nga BNT162b2ndaj infeksionit me Sars-Cov-2 duket se zbehet shpejt pasi arrin kulmin me dozën e dytë, por mbrojtja nga hospitalizim dhe vdekja persiston në nivele të larta edhe 6 muaj pas dozës së dytë. Vaksinimi i fëmijëve, edhe pse jep rritje domethënëse të mbrojtjes ndaj Covid-19, shoqërohet me efekte anësore disa herë më të larta se në popullatën normale.

**Fjalët kyçe:** Covid-19, sistemi imun i lindur, sistemi imun i fituar, miokardit, vaksinë mRNA, memorie imune



**REZISTENCA ANTIMIKROBIKE (AMR) NJË FENOMEN  
NË RITJE PAS PANDEMISË**

*Oltiana Petri*

Hyrje dhe qëllimi: Pandemia e COVID-19 ka nxitur krizën globale të vazhdueshme të rezistencës antimikrobike (AMR) për shkak të rritjes së përdorimit të antibiotikëve për trajtimin e pacientëve me COVID-19; ndërprerjeve të praktikave të parandalimit dhe kontrollit të infeksionit në sistemet e mbingarkuar shëndetësore; devijimit të monitorimit dhe reagimit të burimeve njerëzore ndaj kërcënimeve AMR. Për më tepër, AMR ka të ngjarë të ketë shkaktuar më shumë vdekje nga COVID-19, pasi infeksionet bakteriale dytësore mund të përkeqësojnë sëmundjen. Ka një rënie të prodhimit të antibiotikëve pasi shumë pak antibiotikë janë zhvilluar në 20 vitet e fundit. Shumica e antibiotikëve "të rinj" janë variacione të antibiotikëve ekzistues; vetëm 5 klasa të reja janë zhvilluar në 20 vitet e fundit. Bakteret Gram-negative rezistente ndaj shumë barnave antimikrobike (MRGN) sfidojnë globalisht mjekët dhe personelin e kontrollit të infeksionit për shkak të opsioneve të kufizuara të trajtimit dhe nevojës për të zbatuar masa paraprake penguese për parandalimin e transmetimit të MRGN. Ekzaminimi i pacientëve për bartshmerine e *Staphylococcus aureus* (MRSA) rezistent ndaj metilicilinës gjatë shtrimit në spital pranohet gjerësisht si një pjesë thelbësore e programeve të kontrollit të MRSA. Supozohet, megjithëse nuk është vërtetuar, se raportimi i shpejtë i rezultateve të screening do të përmirësojë kontrollin e MRSA, me kusht që të ekzistojë dhe të ndiqet një plan i qartë veprimi për rastet pozitive.

Materiali dhe metodat: Ky është një studim retrospektiv i shtameve të izoluar dhe të ekzaminuara për Rezistencën mikrobike në Laboratorin e Mikrobiologjisë pranë ALNET për periudhën 2019 dhe 2021. Ne kemi nxjerrë në mënyrë retrospektive antibiogramat nga sistemi jonë elektronik. Të gjitha izolatet e përfshira kanë origjinën nga pacientë të trajtuar në 4 spitale dhe ambulatorë.

Rezultatet: Patogjeni më i zakonshëm në pacientët e hospitalizuar ishte *Escherichia coli* e pranishme në 53,75% të rasteve e ndjekur nga *Staphylococcus spp* 13,6 % (*aureus* + *saprophyticus*); *Enterobacter*

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

spp 8,09%; Enterococcus spp 9,48 % dhe Staphylococcus spp. Në pacientët ambulatorë patogjeni më i zakonshëm ishte Escherichia coli e ndjekur nga Enterococcus spp dhe Proteus Spp.

Konkluzione: Tani është më urgjente se kurrë që të prioritizohen përpjekjet drejt kontrollit të AMR dhe të mbështeten vendet për të përmirësuar identifikimin, karakterizimin dhe reagimin e shpejtë ndaj AMR-së në zhvillim. Duhet që politikëbërësit dhe vendimmarrësit të vazhdojnë t'i japin përparësi AMR dhe zbatimit të planeve kombëtare të vepimit të zhvilluara për AMR, duke siguruar fonde perkatese.

### ANALIZA EPIDEMIOLOGJIKE E SEZONIT TË PARË TË INFLUENZËS MBAS PANDEMISË SË COVID-19 NË WALES

#### ***MSc. Inesa Delimeta***

*Ky prezantim është bazuar në punimin e diplomës për mbrojtjen e Master in Public Health (MPH) në Cardiff University, nën udheheqjen e mentorit Dr. Simon Cottrell dhe mbështetjen e Institutit të Shëndetit Publik në Wales.*

Hyrja dhe Qëllimi. Influenza është një sëmundje respiratore me një incidencë vjetore globale 5-10% tek të rriturit dhe 20-30% tek fëmijë. Në mars të 2020-ës, bota do të përballej me virusin e COVID-19 që shumë shpejt do të kthehej në një pandemi. Kjo situatë ndikoi në uljen e aktivitetit të influenzës dhe mungesë stabiliteti, prezente dhe në periudhën 2020-2022. Ky studim fokusohet në sezonin 2022-2023 të influenzës në popullatën e Wales si sezoni i parë i këtij virusi mbas pandemisë së COVID-19. Synimi i këtij projekti qëndron në matjen dhe vlerësimin e ngarkesës së virusit të influenzës për sezonin 2022-2023 bazuar në tre indikatorë kryesorë: konsultimet në mjekun e famijes (GP consultation rate), shtrimet në spitale dhe të dhënat

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

virologjike duke e krahasuar trendin në këtë sezon me të dhënat historike të periudhës para COVID-19.

Materiali dhe metoda. Një studim longitudinal u përdor për të analizuar në mënyrë retrospektive të dhënat nga database e shërbimit parësor (GP-s), shtrimet në spital dhe të dhënat virologjike të testeve diagnostikuese për popullatën në Wales. Shtrirja kohore e të dhënave fillon nga 2010 deri në 2023 ku sezonet 2010-2019 referohen si periudha para-COVID-19 dhe sezonet 2020-2023 si post-COVID-19. Çdokush i regjistruar në database, pa kushtëzim moshe apo gjinie u bë pjesë e këtij studimi. Analiza deskriptive u kryen për të tre database-t, ndersa për të dhënat e shtrimeve në spitale dhe ato virologjike u krye një *time series analysis* për të kuptuar nëse diferenconin dukshëm apo jo me atë çfare mund të pritej.

Rezultate. Në 2022-2023 sezoni i influenzës rezultoi më i shkurtër, i dominuar nga tipi A(H3). Ndër shtrimet në spitale, 18% i përkisnin grupmoshës nën 4 vjeç, duke indikuar një përqindje të lartë infektimi në popullatën e re. Nga tetori deri në dhjetor 2022, rastet e observuara tejkaluan pritshmëritë, duke arritur kulmin në javën 50-51. Kjo periudhë përkonte dhe me një rritje të pazakonta të rasteve me scarlet fever (ethet e kuqe) dhe iGAZ, duke sugjeruar një përfshirje të faktorëve të tjerë të jashtëm në shpjegimin e pikut të rasteve me grip. Përfundime. Aktiviteti i influenzës qëndroi dukshëm më poshtë krahasuar me periudhën para COVID-19. Në bazë të modelit atipik aktual të këtij virusi, parashikimi i sezonit të ardhëm mbetet sfidues. Rritja e vaksinimit në popullsinë e re, sidomos fëmijët të cilat nuk kanë mundur të zhvillojnë imunitetin natural, mund të ketë efekt pozitiv në sezonet e ardhshme. Përdorimi i metodave të parashikimit për periudha të shkurtra kohore si *time series analysis* mund të ndihmojë në monitorimin efektiv të influenzës dhe në vendimarrje të informuar në të ardhmen.

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

### **FITOTERAPIA OSE MJEKESIA BIMORE NENKUPTON PERDORIMIN E BIMEVE PER VLEREN E TYRE MJEKESORE, EFEKTIN E TYRE TERAPEUTIK DHE KUADRI LIGJOR RREGULLUES PER PERGATESAT BIMORE**

*MSc. Hysni Allushi*

*Drejues teknik ne farmaci "ÇERMENIKA" Rrjeti hapur.*

Permbajtja e mjekesise bimore. 1- Bimet, 2- Materialet bimore, 3- Pregatitjet bimore, 4- Produkte bimore te perfunduara , 5 – Fabrikuesi

Pergatesa komplementare dhe alternative iu referohemi te gjitha pergatesave te perfunduara bimore, alternative, homeopatike dhe suplementeve. Informimi ne menyre te duhur dhe rigoroz i konsumatorit per mjekesine tradicionale Kete duhet tabejne punonjësit e shendetesise mjeke, farmaciste qe te informojne perdorusit (pacientet) efektet e tyre dhe bashkeveprimin me medikamentet e tjera qe perdor pacienti, po e njejta gje duhet dhe per suplemente, por personeli mjekesor duhet trajnuar per keto problem.

Kuadri ligjor duhet zaturar ai qe eshte ne fuqi si ligji per barnat 2014 neni 11 dhe 13 dhe VENDIM Nr. 299, datë 8.4.2015 “Për miratimin e rregullores për dhënien e autorizimit të tregtimit të barnave e të klasifikimit të tyre”, duke prere rrugen personave qe nuk jane punonjes shendetesie.

Informimi ne menyre te duhur dhe rigoroz i konsumatorit per mjekesine tradicionale, te kontrollohet dhe cilesia e bimeve dhe menyra e mbledhjes magazinimit.

Hysni Allushi Farmacist nga viti 1982 dhe deri 1995 me Sherbimin farmaci shteteror, nga viti 01 shkurt 1995 drejtues teknik i farmacie “ÇERMENIKA” ELBASAN.

**NDËRHYRJET DHE ROLI I FARMACISTIT NË  
MENAXHIMIN E SËMUNDJES PULMONARE  
OBSTRUKTIVE KRONIKE (SPOK)**

*MSc. Irina Argjiri<sup>1,2</sup>, Prof. Asoc. Klejda Harasani<sup>2</sup>*

<sup>1</sup>*Profarma Sh.a.*

<sup>2</sup>*Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë*

Hyrje dhe qëllimi: Sëmundja Pulmonare Obstruktive Kronike (SPOK) ka një ndikim të konsiderueshëm në shëndetin publik dhe kërkon një menaxhim të vazhdueshëm dhe të efektshëm. Farmacistët mund të luajnë një rol të rëndësishëm në menaxhimin dhe përmirësimin e trajtimit të kësaj patologjie. Objektivi i studimit tonë ishte realizimi i një rishikimi të literaturës rreth ndërhyrjeve të farmacistëve dhe rolit të tyre në menaxhimin e SPOK.

Materiale e metoda: U përdorën udhëzuesit PRISMA dhe strategjia e kërkimit PICO. Kriteret e përfshirjes ishin: prova klinike të randomizuara, në të gjitha gjuhët, të botuara 25 vitet e fundit të aksesueshme në Pubmed ose Google Scholar. U ekstraktuan të dhëna rreth mjedisit dhe popullatës së studimit, llojit dhe periudhës së ndërhyrjeve, rezultatet e ndërhyrjeve dhe mjetet e matjes së tyre.

Rezultate: U shqyrtuan 161 artikuj shkencorë në analizën fillestare. Ndërhyrjet e zbatuara nga farmacistët të vetëm ose si pjesë e ekipeve multidisciplinare ishin të shtrira në mjedisin spitalor, në komunitet dhe në qendrat e kujdesit afatgjatë. Ato përfshinin kryesisht programe edukimi rreth përdorimit të duhur të inhalatorëve dhe marrjes së përshtatshme të barnave, vetë menaxhimi, të lënies së duhanit, rishikimit të farmakoterapisë dhe pakësimit të barnave të përshkruara. Ndër mjetet e përdorura ishin pikëzimi SGRQ, testi CAT, pyetësi i aderencës Morisky, treguesi BODE, HrQOL dhe pyetësi EQ-5D.

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

Rezultatet e ndërhyrjeve më të shpeshta përfshinin përmirësimin e teknikës inhalatore, rritjen e aderencës ndaj mjekimit, lënien e duhanit, përfitime klinike si ulje e shpeshtësisë së simptomave, rritjen e cilësisë së jetës, rezultate të kënaqshmërisë së pacientit dhe rezultate ekonomike (ulje e kostove të mjekimit dhe të shtrimit në spital).

Përfundime: Mundësitë për të integruar farmacistët në kujdesin e pacientëve me SPOK janë të shumta dhe një numër i madh provash klinike vërtetojnë rezultatet pozitive të ndërhyrjeve të tyre farmakologjike dhe jo-farmakologjike. Ka nevojë për studime të mëtejshme mbi barrierat dhe faktorët që ndikojnë në implementimin e këtyre ndërhyrjeve të udhëhequra nga farmacistët për përmirësimin e menaxhimit të SPOK.

### **EDUKIMI I VAZHUESHËM PROFESIONAL PËR FARMACISTËT PAS PËRFUNDIMIT TË STUDIMEVE UNIVERSITARE PËRMIRËSIMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL DHE KUJDESIT NDAJ PACIENTËVE**

*Mr. Ph. Laureta Berisha Kosumi, Mr. Ph. Jehona Hakaj*

Hyrja dhe qëllimi: Ky prezantim ka për qëllim të theksojë rëndësinë e edukimit të vazhdueshëm për farmacistët, duke shqyrtuar rolin e tyre në ofrimin e kujdesit shëndetësor, si dhe në vehte do të përmbajë shembuj të iniciativave dhe strategjive edukative, që synojnë përmirësimin e njohurive dhe ngritjen e aftësive profesionale të farmacistëve pas përfundimit të studimeve bazike. Përpjekjet e përditshme gjatë punës së farmacistëve, konsistojnë në ndihmën që ju ofrojnë njerëzve për të jetuar shëndetshëm, duke qenë në vijën e parë të kujdesit shëndetësor që nga menaxhimi i barnave e deri te siguria e plotë shëndetësore e pacientëve. Pas përfundimit të studimeve bazike universitare të farmacistëve, edukimi i vazhdueshëm i tyre luan rol kyç në ruajtjen dhe zhvillimin e kujdesit profesional, duke qenë në hap me përparimet bashkëkohore

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

në shkencat farmaceutike dhe sigurinë profesionale në ofrimin e kujdesit të lartë për pacientët. Farmacisti kryen një rishikim gjithëpërfshirës të barnave së bashku me pacientin, me qëllim sigurimi të efikasitetin terapeutik, duke ndikuar në parandalim dhe shfaqjen e reaksioneve të padëshiruara të barnave, si dhe për t'ju përgjigjur çdo pyetje ose shqetësimi që pacienti mund të ketë në lidhje me barnat e tij. Andaj, kalimi nga studimet bazike në punë direkte apo indirekte me pacientët, ruajtja dhe promovimi i shëndetit në përgjithësi, kushtëzojnë farmacistët të jenë në hap me përditësimet e njohurive profesionale, jo vetëm për të fituar pikë të domosdoshme rilicencimi, por për të ruajtur dhe promovuar shëndetin e popullatës në tërësi. Materiale e metoda. Ky prezantim do të analizojë iniciativat dhe strategjitë edukative për farmacistët, duke përfshirë kurset e strukturuar në internet dhe seminarët online të cilat ofrojnë mundësi të rehatshme për farmacistët, duke u angazhuar në mësimet të cilat mund ti përzgjedhin në temat në interes të lartë si: Përditësimet farmakoterapeutike, Menaxhimi i barnave dhe Teknologjitë e reja shëndetësore. Gjithashtu, pjesëmarrja në konferenca dhe seminare ndërfushore, inkurajon bashkëpunimin e lartë mes profesionistëve të kujdesit shëndetësor, promovon praktikën e mirë profesionale bazuar në dëshmi dhe nxitë mësimin gjatë gjithë jetës. Kjo arrihet edhe nga organizatat profesionale, si Oda e Farmacistëve të Kosovës (OFK), Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë (UFSH), shoqatat e ndryshme të farmacistëve, të cilat ofrojnë programe çertifikimi dhe burime të domosdoshme për nevojat e vazhdueshme të zhvillimit profesional të farmacistëve.

Po ashtu, projektet e kërkimeve klinike të drejtuar nga farmacistët dhe iniciativat e përmirësimit të cilësisë brenda institucioneve të kujdesit shëndetësor, ofrojnë përvojë të çmuar praktike dhe kontribuojnë në përparimin e praktikës farmaceutike.

Rezultatet: Rezultatet e kësaj përpjekje do të çojnë në përmirësimin e njohurive dhe aftësive profesionale të farmacistëve, ndihmë më efektive për pacientët dhe ruajtjen e shëndetit të popullatës në tërësi.

Përfundimi: Si përfundim, iniciativat e edukimit vazhdueshëm për

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

farmacistët pas diplomimit universitar, janë të rëndësishme për ruajtjen e kompetencës profesionale, përmirësimin e rezultateve në mjekimin e pacientëve dhe avansimin e profesionit të farmacisë. Pranimi i mundësive të ndryshme edukative dhe mësimi gjatë gjithë jetës, është i rëndësishëm për farmacistët për të përshtatur me programet shëndetësore në zhvillim dhe për të plotësuar rolin e tyre si anëtarë të rëndësishëm të ekipit të kujdesit shëndetësor.

Duke qenë dëshmitarë që sëmundjet e trajtimet e reja (së fundi edhe ballafaqimi i farmacistëve me trajtimet e COVID-19) janë në evoluim e sipër, padyshim që një program i vazhdueshëm i edukimit për farmacistët, duhet të bazohet në njohuritë e fundit nga fusha e Farmakologjisë dhe terapeutikës. Farmacistët e rinjë duhet të jenë në hap me trajnimet rreth komunikimit efektiv me pacientët dhe menaxhimit të situatave të vështira, rrjedhimisht të forcojnë aftësitë e tyre për të ofruar kujdes cilësor dhe të ndjeshëm ndaj nevojave të pacientëve.

Gjithmonë farmacistët duhet që të vënë në rradhë të parë mirëqenien dhe sigurinë e pacientëve, e këtë më së miri e realizojnë me trasimin e një rruge të edukimit të vazhdueshëm profesional, ndërveprimeve kolegjiale dhe përvojës gjatë punës së tyre si në farmacitë komunitare ashtu edhe në ato spitalore.

## INTELIGJENCA ARTIFICIALE (AI) NË FARMACEUTIKË

*Joana Kollçaku*

Hyrje: Industria farmaceutike ka qenë një nga sektorët më të favorizuar për përdorimin e teknologjisë në zhvillim, siç është dixhitalizimi i detyrave manuale për të kursyer kohë dhe përpjekje. Por ndryshimi më i rëndësishëm ka ardhur nga Inteligjenca Artificiale (AI), e cila ka mundur disa përparime, veçanërisht në drejtim të përshpejtimit të zbulimit dhe zhvillimit të barnave, si dhe uljes së kostove të kërkimit dhe shkallës së dështimeve në provat klinike. Algoritmet e mësimi të makinerive mund të ndihmojnë në hartimin e provave dhe parashikimin e farmakokinetikës dhe toksicitetit të kandidatëve për barna. Ky kapacitet lejon zgjedhjen dhe optimizimin



## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

e përbërjeve të plumbit, duke minimizuar nevojën për teste të gjata dhe të shtrenjta tek kafshëve. Algoritmet e AI që ekzaminojnë të dhënat e pacientëve në botën reale mund të ndihmojnë në lehtësimin e qasjeve mjekësore të personalizuara, duke rezultuar në rezultate më të suksesshme të trajtimit dhe aderencës së pacientit.

**Qëllimi:** Dizajni De novo inkurajon zhvillimin e komponimeve medicinale shumë më të reja me vetitë e dëshiruara/optimale. Robotët po përdoren në një sërë operacionesh mjekësore pasi janë më të besueshëm për mjekët, janë më të avancuar në punën e tyre dhe mund të kryejnë çdo detyrë në më pak kohë dhe me efikasitet më të madh se njerëzit. Është përcaktuar se AI është një subjekt i ri në zhvillim në të gjithë sektorët, përfshirë farmacinë, dhe se nevojitet zhvillim shtesë për të përditësuar skenarin aktual, si dhe për të kryer kërkime të reja. **Materialet dhe metodat:** Bazat e të dhënave të indeksuara u ekzaminuan në mënyrë të pavarur dhe pa kufizime kohore, duke përfshirë Scopus, EMBASE dhe PubMed/Medline (National Library of Medicine).

**Përfundime:** Në të ardhmen, inteligjenca artificiale (AI) mund të transformojë sektorin farmaceutik duke përshpejtuar zhvillimin dhe zbulimin e barnave. Metodatat virtuale të shqyrtimit do të përshpejtojnë identifikimin dhe do të analizojnë me shpejt bibliotekat masive kimike dhe duke identifikuar kandidatët terapeutikë me karakteristikat e nevojshme. Duke ekzaminuar gjenomet, proteomet dhe të dhënat mjekësore, mjekësia precize me ndihmën e AI mund të jetë në gjendje të klasifikojë pacientët, të parashikojë rezultatet e trajtimit dhe të personalizojë medikamentet. Duke përdorur modele gjeneruese dhe mësim të thellë, shkencëtarët mund të prodhojnë komponime të reja me veti lidhëse target, që rrisin efikasitetin e barit dhe ulin efektet anësore. AI do të mundësojë gjithashtu formulime dozash të përshtatura për pacientët individualë.

**Fjalë kyçe:** Inteligjenca Artificiale (AI), algoritëm, farmaceutike, bar

**SITUATA POST-COVID DHE TENDENCA E PËRDORIMIT  
TË ANTIBIOTIKËVE; (SPITALI RAJONAL I LEZHËS SI  
RAST STUDIMI)**

*Emiliano Shqefni*

*Pharmacist*

Që nga periudha kur Covid-i u shfaq në Shqipëri, përpos antiviralëve, në skemën e mjekimit, ndër të tjera, kanë qenë pjesë edhe antibiotikët. Këta janë përdorur për të mos lejuar mbivendosjen e ndonjë infeksioni bakterial oportunist. Por sot duket se vazhdon akoma “mania” për përdorimin e antibiotikëve edhe në infeksionet virale, ku ata nuk japin efekt.

Ky punim ka për qëllim të merret me studimin e rasteve në 3-vjeçarim e fundit në zonën e Lezhës, për të parë dhe evidentuar sesi është përdorur mjekimi; kur ka pasur raste me simptoma të ngjashme ose të njëjta me simptomat e Covid-it; rastet kur janë refuzuar mjekimet dhe hospitalizimet e pacientëve; tendenca për “vetëmjekim” ose paraqitja pranë farmacive me kërkesa për mjekim pa recetë, të lexuara në internet, në rastet kur kishin simptoma të ngjashme virale.

Do të shqyrtohen raste të paraqitura pranë urgjencës së spitalit rajonal Lezhë dhe pranë specialistëve të këtij spitali, do të bëhet krahasimi me situatën pre-Covid dhe post-Covid mbi përdorimin dhe kërkesën e antibiotikëve, Po ashtu, do t’i referohemi literaturës bashkëkohore në lidhje me këtë problem, intervistave me farmacistë dhe mjekë specialistë mbi rritjen ose uljen e kërkesave nga ana e pacientëve për antibiotikët në rastet e simptomave virale.

Nga ky studim do të vërehet se në periudhën post-Covid, ka pasur shtesa të rasteve ku kërkoheshin antibiotikë pa recetë, sepse ishin të njëjtët që kishin përdorur në periudhën e Covid-it. Sidoqoftë, do të vihet re se ka shumë raste kur nga këshillimi i farmacistit/es, pacienti e kuptonte dhe nuk insistonte në përdorimin e atij mjekimi, por vepronte në bazë të asaj që udhëzonte mjeku dhe farmacisti. Gjithashtu, në urgjencat dhe zyrat e mjekëve specialistë pacientët

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

kanë qenë më të pranishëm në mjekimin e rekomanduar, qoftë ky shtrim në spital apo mjekim në shtëpi.

Nga ky studim do të konkludohet se, me anë të bashkëpunimit në shumë hallka të zinxhirit mjekësor, kultura mjekësore në Shqipëri duket se është në rritje dhe po arrihen rezultate të kënaqshme, por prapë vazhdon të ndeshet mjaft shpesh tendenca dhe stigma që “antibiotiku merret edhe pa recetë” ose “antibiotiku përdoret edhe në infeksione virale”.

**Fjalë kyçe:** pacient, antibiotikë, farmacist, mjek, vetëmjekim, rezistencë

### TERAPITË GJENETIKE NË DISA PATOLOGJI ME

#### INTERES SOCIAL & KLINIK

*Ornela Prengzaj<sup>1\*</sup>, Erjon Troja<sup>1</sup>, Ranela Ceci<sup>2</sup>, Delina Troja<sup>3</sup>*

<sup>1</sup> *Universiteti i Mjekësisë, Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri*

<sup>2</sup> *Zyra e Përfaqësimit "BGP Products Switzerland GmbH", Tiranë, Shqipëri*

<sup>3</sup> *Zyra e Përfaqësimit "Hoffmann-La Roche", Tiranë, Shqipëri*  
**email kontakti** : *erjontroja@umed.edu.al*

Hyrje: Terapitë gjenetike, prej dekadash janë kthyer në fokus studimor, duke u parë si alternativa shumë premtuese (në disa raste të vetmet) për trajtimin dhe kurimin e një sërë patologjish gjenetike, të cilat deri në aktualitetin e sotëm konsiderohen si të pashërueshme. Ndër rëndësitë e këtyre terapive qëndron edhe mundësia optimale për të hequr barrën e trajtimeve afatgjatë (deri përgjatë gjithë jetës) si dhe problematikat shoqëruese të tyre.

Synimi i zhvillimit të terapive gjenetike është "korrigjimi i shkaktarit të sëmundjes", në nivel molekular, por ndonëse krahasur me dekada më parë, përparimet janë të dukshme, kjo fushë e kujdesit mjekësor

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

modern është ende në evolucion konstant dhe mbart shumë pikëpyetje.

Terapitë e bazuara në korrjimin e gjeneve nuk janë më vetëm një shpresë për të ardhmen, por një risi me aplikime aktuale, një dritare e re që pritet të ndryshojë jetët e qindra-mijëra pacientëve.

Metodologjia: Punimi u fokusua në mbledhjen dhe përpunimit e informacionit, nga burime publikuese, me faktor të rëndësishëm impakti, bashkëkohore dhe me besueshmëri të lartë, mbi risitë dhe avancimet më të fundit, në fushën e terapive gjenetike. Fokus primar do të kenë disa patologji me interes social-klinik (edhe në vendin tonë), si Distrofia Muskulare Duchene, Hemofilinë, Beta-talasemitë etj., si dhe konsiderata të tjera shoqëruese, mbi çështjet etike dhe perspektivën.

Rezultate dhe Përfundime: Në përfundim të këtij prezantimi synimi është të ofrojmë një pasqyrë sa më të saktë dhe bashkëkohore, informuese dhe analizuese mbi aktualitetin e kësaj tematike, anëtarë pozitivë me arritjet e saj por edhe dyshimet shqetësuese, duke integruar rolin e farmacistit globalisht dhe lokalisht, në vendin tonë.

**Fjalë kyçe:** terapi gjenetike, sëmundje gjenetike, e ardhmja, biomjekësi, gjene, farmacist

## NANOTEKNOLOGJIA DHE NANOMJËKËSIA NË BARNË

*Griselda Guri*

Hyrje dhe qëllimi: Nanoteknologjia është shkencë që studion elementët deri në detajet më të vogla. Ajo bën zhvillimin e qarqeve të vogla. Ndërsa nanomjekësia në farmaceutikë e studjon trupin deri në detajet më të imta duke mundur shpërndarjen e ilaceve edhe në zonat më të vogla brenda trupit. Nanoteknologjia ka si synim shënjestrimin e ilaceve specifiku në zonat e nevojshme të

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

organizmit. Si rrjedhojë përmirsimin e jetesës së pacientëve që kanë një shumëllojshmëri sëmundjesh.

Materiale dhe metoda: Në këtë shkencë bëhet e mundur shfaqje më e sofistikuar dhe karakteristika më unike. Kjo shkencë zhvillon ilacet në nanogrimca, trupin e njeriut në nano-qeliza edhe aparaturat të cilat do studiojnë gjithë procesin e prodhimit dhe shpërndarjes së ilacit në organizëm, në nanoelement. Më së shumti kërkohet të shfrytëzohet në kimioterapi.

*Shembuj konkret:* Një studim i bërë në universitetin e Uashington ku janë krijuar nanogrimca të karbonatit të kalciumit të cilat janë çliruar në qelizat e prekura nga tumori. Ato rrisin nivelin e pH lokalisht, përreth tumorit. Qelizat e kancerit kërkojnë një pH të ulët acid, dhe në këtë mënyrë ato nuk kanë mjedis për tu rritur.

Studim tjetër kemi në Egjipt me miliacinen e shoqeruar me MPL (fosfolipid –acid Linoleik) e cila rrit efektin e miliacines duke rritur përthithjen në skalp. Dhe në rastet që shoqerohet me biotinë, vepron në receptorët IGF1 që stimulon folikulat në skalpin e kokës

Një tjetër risi që kërkohet të arrihet është zhvillimi i vaksinave funksionale për të gjithë gripat. Kjo ka për qëllim shpërndarjen e antigeneve për vaksinim.

Një fushë tjetër ku e shofim të zbatuar nanomjekësinë është çlirimi i ilaceve kur ka një forcë të shtuar. Përshembull në rastet e holluesve të gjakut, kur ilaci kalon në një arterie të bllokuar nga mpiksja e gjakut, aty kërkohet një veprim më i fuqishëm.

Rezultate: Nanoteknologjia ben te mundur diagnostifikimin dhe parandalimin e sëmundjes. Gjithashtu një analizim më të hollësishëm të organizmit duke gjetur ekzaktesisht zonën e dëmtuar. Dhe njëkohësisht arrin prodhimin e ilacit për të vepruar specifikisht në atë zonë të cilën duam të trajtojmë.

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

Perfundimi: Si përfundim kërkohet prodhimi i ilaceve të personifikuara në bazë të sëmundjes që ka pacienti dhe njëkohësisht eliminimi i efekteve anësore në zona të tjera po prapë me rezikshmëri për të shfaqur efekte anësore. Dhe kërkohet një shpërndarje e ilaceve në zona të tjera të vogla brënda trupit, pa u depozituar në zonat jo të prekura.

### STRATEGJITË E REJA TË NANOSISTEMEVE PËR TRAJTIMIN EFEKTIV TË SËMUNDJEVE KRONIKE

*Venesa Lupçi<sup>1</sup>, Toskë Kryeziu<sup>2,3</sup>*

<sup>1</sup> *Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës, Kosovë*

<sup>2</sup> *Departamenti Analizë e Kontroll i barnave dhe Teknologji Farmaceutike, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës, Kosovë*

<sup>3</sup> *Institute of Pharmaceutical Sciences, Department of Pharmaceutical Technology, Karl-Franzens-University of Graz, Austria*

Hyrje dhe Qëllimi. Ky prezantim përqendrohet në studimin e strategjive të reja të nanosistemeve shpërndarëse në trajtimin e sëmundjeve kronike, siç janë kanceri, diabeti dhe sëmundjet kardiovaskulare. Qëllimi ka qenë në studimin se si nanoteknologjia mund të përdoret për të përmirësuar efikasitetin dhe të reduktoj efektet anësore të terapive ekzistuese, përmes shfrytëzimit të nanosistemeve të reja shpërndarëse të medikamenteve që janë të qëndrueshme, me targetim dhe biokompatibile.

Materiale dhe Metoda. Prezantimi përfshin një analizë të zgjeruar të literaturës shkencore dhe studimeve të rastit mbi nanosistemet e reja shpërndarëse siç janë liposomet dhe nanoemulsionet. Gjithashtu janë analizuar studime paraklinike dhe klinike që demonstrojnë përdorimin praktik të këtyre nanosistemeve në trajtimin e sëmundjeve kronike.

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

Rezultate. Rezultatet e këtij studimi tregojnë një potencial të madh të nanosistemeve në përmirësimin e administrimit të medikamenteve dhe në rritjen e efikasitetit të trajtimeve ekzistuese. Nanosistemet e studiuara kanë treguar një përmirësim në shpërndarjen e medikamenteve, duke lehtësuar kalimin e barrierave biologjike dhe duke siguruar një çlirim më të kontrolluar të medikamenteve/substancave aktive në vendet e synuara/targetuara. Kjo ka rezultuar në një rritje të efikasitetit dhe një ulje të efekteve anësore.

Përfundime. Nanosistemet shpërndarëse janë një hap i rëndësishëm përpara në trajtimin e sëmundjeve kronike. Nanoteknologjia ofron një platformë të fuqishme për zhvillimin e nanosistemeve si liposomet dhe nanoemulsionet që janë të efektshme dhe të sigurta. Kjo do të ndihmojë në përmirësimin e adherencës së pacientëve dhe do të ulë potencialisht kostot e kujdesit shëndetësor në të ardhmen.

### **NDIKIMI I TRETËSAVE NË KARAKTERISTIKAT E NANOGRIMCAVE TË MENADIONIT DHE STUDIMI I TRETSHMËRISË SË TIJ**

*Msc. Aleksandra Thodhori, Prof. Dr. Ledjan Malaj, Msc. Kristela Shehu, Prof. Dr. Marc Schneider*

Menadioni, derivat i vitaminës K, njëkohësisht pjesë e klasës së naftokinoneve, ka tërhequr vëmendjen për shumllojshmërinë e aplikimeve të tij, duke përfshirë rolin si fuqizues i aktivitetit të antibiotikëve. Gjenerimi i radikaleve të lira të oksigjenit (ROS) dhe ndërveprimet me membranën bakteriale e kanë bërë atë një kandidat premtues për rritjen e efikasitetit të antibiotikëve, në luftimin e infeksioneve mikrobike. Megjithatë, duke marrë në konsideratë karakterin e theksuar hidrofobik dhe toksicitetin që ai shkakton, shpërndarja optimale e Menadionit për të arritur rezultatet e dëshiruara terapeutike mbetet një sfidë më vete.

## KONFERENCA MBARËKOMBËTARE FARMACEUTIKE VII

Studimi jonë ka për qëllim të hulumtojë ndikimin e tretësave të ndryshëm në karakteristikat e nanogrimcave të Menadionit (MEN). Tretësit e marrë në studim janë acetoni, acetonitrili (ACN), di-metilsulfoksidi (DMSO), di-metilforamidi (DMF) dhe metanoli. Duke përdorur nanoprecipitimin si metodë, maltodekstrinën e acetiluar (AcMD) si polimer tranportues dhe MEN si lëndë aktive, nanogrimcat u karakterizuan sipas përmasave, indeksit të polidispersitetit (PDI), potencialit zeta, karakteristikave morfologjike, efikasitetit të enkapsulimit (EE) dhe *drug loading* (DL).

DMSO, edhe pse tretësi me viskozitet më të lartë, formoi nanogrimcat me përmasa më të vogla (158-178 nm), ndërsa ACN ato me përmasa më të mëdha (255-295 nm). Bazuar në vlerat e DL dhe përmasave të nanogrimcave të formuara, arritëm të realizonim këtë renditje të tretësave: DMSO < DMF < Metanol < Aceton < ACN. Vlerat e PDI ishin të ulta për të gjithë tretësit, duke indikuar në këtë mënyrë një shpërndarje homogjene të nanogrimcave. Potenciali zeta ishte lehtësisht negativ në të gjitha rastet.

Hetimi i tertshmërisë së MEN, me qëllim shpjegimin e rezultateve të mësipërme, bëri pjesë të studimit softwar-in e parametrave të tretshmërisë së Hansen (HSP). U vu re një lidhje jo-lineare midis tretshmërisë së Menadionit dhe DL, me DL më të madh të shfaqur nga ACN (4%). Metanoli, i parashikuar nga literatura për të pasur tretshmëri më të ulët të Menadionit sesa ACN, shfaqti një DL midis DMF dhe acetoni, duke nxitur kështu hetime të mëtejshme për këtë sjellje.

Ky studim ofron këndvështrime të vlefshme në ndërveprimin kompleks midis ndikimit të tretësit, tretshmërisë së lëndës aktive dhe karakteristikave rezultuese të nanogrimcave, duke ofruar një bazë për optimizimin e formulimit të nanogrimcave si sisteme transportuese të barit.

***Fjalë kyçe:*** Nanogrimca të Menadionit, AcMD, nanoprecipitim, karakterizim, HSP, ndikim i tretësit